

Mid'hat Shamiq

Si shkruhet
vepra
shkencore





© LOGOS - A
2 0 0 5



S H K U P
P R I S H T I N Ě
T I R A N Ě



Mid'hat Shamiq

Si shkruhet vepra shkencore





E përktheu:
Nexhat Ibrahim

Titulli i origjinalit:
Midhat Šamic
KAKO NASTAJE NAUČNO DJELO
Svjetlost - Sarajevo, 1988
ISBN 86-01-01157-8

Mid'hat Shamiq

Si shkruhet vepra shkencore



Përmbajtja:

Përmbajtja:	6
Parathënie.....	9
Hyrje.....	13
I. Mbi punën, metodën dhe veprën shkencore—hulumtuese.....	21
A. Cilësitë themelore të punës dhe metodës shkencore-hulumtuese	21
B. Veçoritë e veprës së mirë shkencore	29
II. Zgjedhja e temës.....	40
III. Hulumtimi i dokumentacionit	52
A. Zbulimi i dokumenteve.....	53
B. Hartimi i bibliografisë së punës	57
1. Skeda për librat.....	72
2. Skeda për artikuj në revista dhe gazeta	75
3. Skeda për artikuj në doracakë dhe antologji	77
C. Dy biblioteka të huaja shkencore dhe puna në to	79
Biblioteka Kombëtare në Paris	81
Biblioteka e Muzeumit Britanik në Londër	88
IV. Tubimi i lëndës	96
A. Leximi dhe kritika e teksteve	99
B. Shkrimi i shënimeve	103
V. Organizimi dhe sistemimi i lëndës së turbuar	119
VI. Redigjimi i dorëshkrimit	131
A. Pjesët e librit	133
B. Të shkruarit e tekstit	139
1. Koncepti.....	140
2. Teksti përfundimtar	144

VII. Mbështetja dokumentuese e dorëshkrimit.....	151
A. Citatet.....	151
B. Poshtëshënimet (Fusnotat).....	156
C. Bibliografia përfundimtare	171
VIII. Veçoritë stilistike dhe korrektësia gramatikore	178
A. Zgjedhja e fjalëve.....	185
B. Struktura dhe raportet e fjalive	194
C. Struktura dhe veçoritë e paragrafit	200
Ç. Korrektësia gramatikore dhe drejtshkrimore	205
D. Mënyrat e arritjes së stilit dhe gjuhës së mirë	210
IX. Përpunimi teknik dhe shtypja e dorëshkrimit.....	216
A. Përpunimi teknik.....	216
B. Shtypja e dorëshkrimit	232
1. Llojet e shkrimeve dhe përdorimi i tyre.....	234
Korrektura dhe shtypja.....	239
Shenjat dhe shembujt e përmirësimeve	244
X. Mbrojtja e tezës	248
A. Vlerësimi i tezës	249
B. Ekspozeu i kandidatit	255
C. Vërejtjet kritike dhe pyetjet e referentëve	257
XI. Doracakët.....	260
Përfundimi.....	265
XII. Literatura e shfrytëzuar	267
XIII. SHTOJCA	270
A. Disa refleksione mbi procesin krijues dhe krijuesin	270
B. Çka kanë krijuar dhe çka kanë menduar për procesin krijues disa autorë të dalluar francezë	283
1. Motivet dhe synimet e të shkruarit	284
2. Pasioni i autorit me veprën	285
3. Botëkuptimet mbi frymëzimin	287
4. Kënaqësitë dhe vështirësitë e të shkruarit.....	291
5. Kushtet e volitshme për punë dhe metodat e ndryshme të të shkruarit	297

6. Domosdoshmëria e punës së ngulshme dhe përkryeshmërisë	302
7. Qartësia dhe natyrësia e të shprehurit	305
8. Vështirësitë e thirrjes së shkrimtarit.....	306
Elaboration d'un ouvrage scientifique	309
Summary	310
Treguesi i emrave	312
Pasthënia e botuesit.	316
Hyrje	316
1. Konceptioni i programit për trajtësimin e tekstit.....	319
2. Pajisjet kompjuterike për DTP.....	324
3. Trajtësimi i tekstit dhe interneti	328
Disa vepra të dr. M. Shamiqit.....	335

Parathënie*

Nga çasti kur doli nga shtypi libri “Si shkruhet vepra shkencore” e deri më sot, erdhi deri te zhvillimi i teknikës ose më saktë deri te i a.q. kompjuterizimi i planetit. Përdorimi i këtij “mjeti magjik” të kohës moderne, të kompjuterit, në masë të madhe e ka lehtësuar edhe punën hulumtuese të shkencëtarëve në çdo disiplinë. Nëse, pra, pajtohemi me këtë fakt të pathyeshëm të lartpërmendur, do të mund të mendohej se metodat e hulumtimit për të cilat flet vepra e profesor Mid`hat Shamiq jo vetëm që janë vjetruar, por edhe janë tejkaluar dhe janë të papërdorshme, e me këtë do të bëhej i papërdorshëm edhe ky libër. Megjithatë, mos ta harrojmë të vërtetën banale, por të amshueshme, se pa marrë parasysh, në të gjitha makinat dhe teknologjitë, mjeti kryesor dhe i pazëvendësueshëm gjatë çdo pune hulumtuese dhe përgjithësisht krijuese, mbetet njeriu dhe truri njerëzor. Prandaj, edhe pse zbulimi i kompjuterit dhe përdorimi i tij i gjithanshëm, sidomos përdorimi i “internetit” (ndërlidhja e rrjeteve kompjuterike) i kanë mundësuar hulumtuesit akses të shpejtë deri te të dhënat e domosdoshme (bibliografike dhe të gjitha të dhënat e tjera), “stili i vjetër” ka mbetur ende në përdorim, qoftë paralel me stilin “e ri”, kompjuterik, qoftë ekskluzivisht si i tillë. Edhe sot hu-

* Parathënia është marrë nga botimi i fundit i librit Midhat Samić, *Kako nastaje naučno djelo*, botimi IP *Svjelost*, Sarajevë, 2003, fq. 7 - 8.

lumtuesit, madje jo vetëm hulumtuesit, por edhe autorët, krahas “shënimit” kompjuterik, do t’i përdorin edhe skedat klasike. Letra pra do ta ndjekë fotografinë në ekran. Asnjë bibliotekë e botës, edhe pse i ka futur në përdorim kompjuterët me të cilët hulumtuesi mund të vijë deri te të dhënat, nuk ka hequr dorë nga mënyra e theksuar, klasike e punës: fichiera (skedari) dhe skeda (kartela), në të cilat janë shënuar edhe emrat e autorëve, sipas rendit alfabetik edhe emrat e veprave. Kjo çështje është përpunuar mjaft hollësisht në librin “Si shkruhet vepra shkencore” dhe nuk është e nevojshme të përsëritet ajo që tashmë është thënë. Por, ajo që është e nevojshme të theksohet është se hulumtuesit aktual përdorin edhe një mjet plotësues gjatë hartimit të punimit të tyre: kompjuterin.

Kjo makinë moderne ka rol të shumëfishtë: nga një anë shërben për kërkimin e të dhënave, d.m.th. për arritje më të lehtë deri te ato (për shembull në biblioteka, por edhe nëpërmjet (“internetit”), kurse nga ana tjetër shërben si makinë shkrimi (e cila “e mban mend tekstin”, e mbanë mend gabimin dhe përmirësimin, “vetë duke e përmirësuar”, duke mundësuar përmirësime, fshirje dhe shtojca të shpejta). Ajo së pari shërben për sajimin e kartotekës vetjake, një lloj të “bazës së të dhënave” dhe futjen e skedave (kartelave) vetjake, e pastaj mundëson “daktilografim” të shpejtë, së pari në trajtë koncepti, e pastaj në trajtën përfundimtare. Në këtë mënyrë, hulumtuesi nuk ka nevojë më ta rishkruajë veprën e vet shumë herë si dikur, duke përdorë indigon dhe letrën. Ka shumë pak hulumtues që i kanë mbetur besnikë makinave të shkrimit dhe ka shumë pak që nuk dinë të manipulojnë me kompjuterët personalë të quajtur PC.

Atë që në këtë libër është “vjetruar”, por edhe këtë, ndërkaq, pranojeni me rezervë. Ato janë pjesët në të cilat flitet për shtypin. Kompjuteri në këtë aspekt ka luajtur rol revolucionar. Njëkohësisht nuk bën të shpërfilllet as

gjeneza e procesit të shtypit në Evropë, për të cilën është fjala në veprën “Si shkruhet vepra shkencore”.

Vepra ka pasur për qëllim t’u ndihmojë të gjithë atyre që dëshirojnë të hulumtojnë: që të njoftohen për atë se çka është metodologjia e studimit të një problemi, të mësohen të mendojnë në mënyrë efikase, që të dinë t’i sistemojnë të dhënat e nevojshme dhe të zbuluara, që të dinë t’i trajtojnë, si edhe të dinë “t’i sistemojnë” dhe komponojnë në këtë të arriturat vetjake, që më në fund të arrijmë deri te ajo që e quajmë rezultat i punës dhe i sintezës. Me qartësinë, erudicionin, pasurinë e të dhënave dhe të shembujve, kjo vepër ka arritur të tregohet e dobishme jo vetëm për fillestarët, por edhe për hulumtuesin më me përvojë. Për këtë dëshmojnë edhe ribotimet e shumta të këtij libri që ai i përjetoj deri në vdekjen e autorit të saj në vitin 1990. Për këtë dëshmon edhe interesimi i jashtëzakonshëm për këtë vepër, jo vetëm i banorëve të Bosnje Hercegovinës, por edhe të ish-Jugosllavisë, dhe të diasporës, tashmë të shpërndarë pas luftës (1991-1995), nëpër tërë botën. Breza të ndryshëm të njerëzve, ndonëse punojnë tezat e magistraturës dhe të doktoratës në universitete të mëdha të botës, i drejtohen familjes së autorit të ndjerë me lutje që ta marrin veprën “Si shkruhet vepra shkencore”, e cila do “t’i udhëzojë në rrugë të drejtë, hulumtuese” dhe do t’i pengonte lajthitjet e panevojshme.

Pa marrë parasysh, pra, që libri pakontestueshëm mbetet aktual, mendimi i botuesit ka qenë që vepra do të duhej të bëhej më bashkëkohore, respektivisht që në të të theksohen risitë teknologjike që kanë ndodhur prej botimit të këtij libri e deri sot. Meqë është thujse e pamundur të përmirësohet vepra e njeriut të vdekur, trashëgimtarët kanë pranuar këtë që krahas veprës të shtohet pasthënia, e cila lexuesve, respektivisht hulumtuesve të rinj, do t’ua afronte këto metoda të reja. Ndërkaq me-

to dat e re ja janë para së gjithash të dhënat mbi atë çka është kompjuteri, për çka shërben dhe si përdoret ai. Pashënia në këtë botim flet hollësisht për këtë dhe për aspektin tjetër të hulumtimit: aspektin kompjuterik.

Prof. dr. Jasna Shamiq

Hyrje

Nuk është e tepërt të thuhet që për mbarë përparimin dhe transformimin e vet, material dhe shpirtëror, njerëzimi në rend të parë duhet t'i falënderohet shkencës, krijimit shkencor dhe hulumtimit, sikur që edhe pa shkencë të zhvilluar nuk mund të ketë as përparim e as mirëqenie të një vendi dhe populli në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Këtë kushtëzim reciprok të zhvillimit të shkencës dhe të zhvillimit të vendit dhe popullit që jeton në të e ka vërejtur qysh në shekullin XVI, R. Bekoni i pavdekshëm, i cili ka pohuar se shkenca dhe fuqia njerëzore shkojnë tok, paralelisht, se ato në realitet gërshetohen, përshkohen, ndikojnë në njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë, dhe qysh atëherë, në shekullin e renesansës, ai i mahnitej transformimit që shkencat e ndryshme me aplikimin e vet të gjerë, të nduarnduart dhe të shumëfishtë, kanë bërë në jetën e popujve të civilizuar, të njeriut të kulturuar. Ndërkaq bashkëkohaniku i tij, mendimtari i madh francez Montenji, ka theksuar se shkenca është 'dekor i madh', duke shtuar menjëherë se ajo njëkohësisht është edhe *"mjet që çuditërisht na ndihmon shumë."* E kur njerëzit për shkencën dhe fuqinë e saj janë shprehur ashtu në shekullin XVI, çfarë do të mund të themi për të sot, në epokën tonë bërthamore?

Në pajtim me këtë, mund të themi se thirrja shkencore bën pjesë ndër thirrjet më të lartësuara që njeriu mund t'ia dëshirojë dhe zgjedh vetes: çdokush që shton

për ndonjë lëndë qoftë edhe një kokërr të shumës së njohurisë dhe thesarit të dijes që tashmë ekziston ka bërë diç të vlefshme në jetë dhe për këtë mund të jetë krenar. Përbri kësaj, nuk duhet nxjerrë jashtë mendjes as gëzimin e thellë, të paturbulluar që e ofron çdo krijimtari, e sidomos hulumtimi dhe shkrimi shkencor.

Por, në të njëjtën kohë, profesioni shkencor është njëri nga profesionet më të rënda: ai e kërkon tërë njeriun, i preokupon të gjitha mendimet e tij, i angazhon të gjitha forcat shpirtërore dhe trupore të tij. Sepse, sikur në shumë punë të tjera, ashtu edhe në këtë nuk mjaftojnë vetëm vullneti i mirë, dëshira të punohet, por puna në shkencë, sado qoftë ajo modeste, është profesin i rëndë dhe i ndërlikuar, që parashtron veti të shumta nga ai që dëshiron t'i përkushtohet. Do të shkonim tej larg po qe se këtu do t'i numëronim të gjitha vetitë që janë të domosdoshme për një shkencëtar solid. E megjithatë, do të ishte mirë që prej tyre t'i përmendim së paku disa: zellin e jashtëzakonshëm, vullnetin dhe durimin e fuqishëm, aftësinë për vrojtim intensiv dhe koncentrim të thellë, aftësinë e zhvilluar të përsiatjes, shprehitë e formuara të disiplinës dhe ekzaktësisë, e mbi të gjitha, kulturën e përgjithshme të gjerë dhe arsimimin solid profesional në fushën dhe disiplinën e caktuar shkencore, sikur edhe zotërimin me metodologjinë e asaj discipline dhe fushe shkencore. (Çdo shkencë, disiplinë, degë, fushë posedon, siç është e ditur, parimet, metodat, veprimet e veta teknike më pak apo më shumë të përcaktuara.¹

Shumë punëtorë të dalluar shkencorë kanë tërhequr vërejtjen në peshën e këtij lloj preokupimi. Në mesin e shumë të tjerëve të përkujtojmë këtu vetëm në fjalët e njohura të Marksit, i cili shumëherë ka cekur se në shken-

¹ Gjatë shekujve, në vendet e zhvilluara kulturore, janë stabilizuar, pos tjerash, format e caktuara të gjithëpranuara të teknikës së punës shkencore, të cilat po ashtu duhet të mësohen e respektohen.

cë nuk ka rrugë të gjerë e të lehtë dhe se deri te lartësitë e saj të shkëlqyeshme mund të arrijë vetëm ai që, duke mos iu frikësuar lodhjes, ngjitet shtigjeve të saj të rrëpishme.

Por, sikur edhe për të gjitha llojet tjera të veprimtarisë, ashtu edhe për punën në shkencë munden, nën kushte dhe rrethana të caktuara të favorshme, të arrihen veçori të domosdoshme dhe të kalohen metodologjia dhe teknika e punës shkencore-kërkimore: shkathtësia e një shkencëtari pikërisht përbëhet në njohjen e tij solide të disiplinës së caktuar shkencore dhe në dominimin e sigurt me grumbullin, sistemin e caktuar të veprimeve metodologjike dhe teknike, karakteristike për atë disiplinë shkencore.

Shumë punëtorë shkencorë, duke mos i përjashtuar as më të mëdhenjtë, shpeshherë vetë, në mënyrë empirike, pothuaj pa ndihmën e askujt, kanë arritur njohuri të gjera dhe kanë zotëruar me metodologjinë e disiplinës së vet shkencore. Por këtë, në të shumtën e rasteve, e kanë arritur falë angazhimit dhe breddhjeve të shumta, shpenzimit të kotë të kohës dhe energjisë; kurse disa prej tyre as nuk e kanë arritur cakun dhe suksesin e dëshiruar, apo e kanë arritur me përpjekje e breddhje shumë më të mëdha se që do ta bënin këtë sikur të ishin në dijeni si duhet të punohet. Dhe pikërisht që njerëzve të rinj të papërvojë, por të talentuar që përgatiten për thirrjen shkencore t'ua kursejmë së paku deri diku ato breddhje të kota dhe shpenzim të tepërt të forcave, në shumë vende, në rend të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Sovjetik, ekzistojnë (sidomos prej para do kohe, kurse duke e marrë parasysh zhvillimin e shpejtë e të gjallë të shkencës), pos tjerash edhe vepra të ndryshme, të karakterit të përgjithshëm ose special, që kanë për qëllim që këta njerëz të rinj të futen në metodat dhe teknikën e kërkimeve shkencore dhe të punës shkencore në disa degë e fusha.² Për më tepër, në shumë universitete

² Të shihet literatura e shfrytëzuar për këtë libër.

dhe kolegje në botë, veçan në dy vendet e cekura, tashmë disa dhjetëvjeçarë, në pikëpamje të ndryshme dhe me emërtime të ndryshme, ekzistojnë kurse (për trajnim) kushtuar kësaj lënde - metodologjisë dhe teknikës së kërkimeve dhe të punës shkencore.

Te ne, ndërkaq, nëse përjashtojmë përkthimin e veprës së shkencëtarit rus S. A. Rajnberg,³ që u destinohet më shumë punëtorëve shkencorë medicinalë, por që me këshillat e veta të përgjithshme dhe praktike mund të jetë e dobishme edhe për ekspertë të tjerë, nuk ekziston ende, sipas njohjes sime, asnjë vepër e këtij lloji.⁴ Kurse nevoja për të edhe te ne po ndihet tashmë kaherë, sidomos kohëve të fundit, duke e marrë parasysh interesimin gjithnjë e më të gjallë të njerëzve të rinj për punën dhe thirrjen shkencore - kërkimore.⁵ Së këndejmi, që së paku deri diku ta plotësojmë këtë zbrazëti, kemi vendosur ta shkruajmë këtë vepër e cila ka për qëllim - siç shihet nga titulli dhe nëntitujt - që lexuesit të interesuar t'i shpjegojë, në pikat më kryesore, procesin e lindjes (krijimit) të veprës shkencore, ta njoftojë atë me principet themelore të metodologjisë dhe teknikës së punës shkencore e kërkimore. Themi kështu ngase, duke e shkruar këtë libër,

³ S. A. Rajnberg, Metodika i tehnika naučnog rada, Beograd, Medicinska knjiga, 1948. - Në vërejtje nuk do t'i cekim të gjitha të dhënat e rëndomta bibliografike për ato vepra që i kemi cituar në kaptinën "Literatura e shfrytëzuar", në fund të librit.

⁴ Edhe në disa fakultete tona organizohen, në shkallën e tretë, kurse destinuar metodologjisë së punës shkencore. Disa nga ato kurse po fillojnë edhe të publikohen. Kështu dr. Slavoljub Dubiq ka publikuar kursin e vet me titull "Uvodženje u naučni rad", (Sarajevo, Zavod za izdavanje udžbenika, 1970). Krihs. po ashtu: Dr Rudolf Sajović, Uvod u tehniko znanstvenega dela. (Ljubljana, Pravna fakulteta, 1962).

⁵ Në atë interes të gjallë dëfton deri diku edhe fakti se në Universitetin e Sarajevës që nga themelimi i tij, 1949 e deri në fund të vitit 1965, shkallën e doktorit të shkencës e kanë arritur 308 persona (prej të cilëve 201 arsimtarë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Sarajevës), kurse interesimi për studimet e shkallës së tretë dhe për punimin e disertacioneve të magistraturës po rritet nga viti në vit.

kemi pasur parasysh parimet që pak a shumë janë të përgjithshme, të përbashkëta, për numrin më të madh të shkencave dhe degëve shkencore. Secila nga ato shkencat, disiplina e fusha shkencore ka edhe metodat e veta të veçanta të kërkimeve dhe punës shkencore, në të cilat në këtë vepër nuk kemi patur mundësi të ndalemi, përveç që nga ato aty-këtu kemi marrë ndonjë shembull për ilustrimin e parashtrimeve tona.⁶

Menjëherë duhet thënë: nuk ekziston ndonjë formulë magjike që mund t'i zbulojë fshehtësitë e kërkimeve shkencore, sikur që nuk ekzistojnë as disa veprime të shpejta dhe mekanike që, kur të mësohen e të kapërcehen, aftësohen për këtë lloj veprimtarie: që dikush të aftësohet të punojë shkencërisht, është e domosdoshme që paraprakisht t'i përmbushë dy kushte themelore: 1) që për këtë të ketë prirje, dispozicione natyrore; 2) që dikush ta përuddhë në punën shkencore dhe metodat e tij, duke zhvilluar, "duke kultivuar" tek ai veçoritë e domosdoshme për këtë punë.⁷ Së këndejmi edhe mjeshtria e shkencëtarit, sikur edhe shumë mjeshtri të tjera, më së miri mësohet në kontakt me mjeshtrin, mësuesin, duke

⁶ Disa teoricienë (ksh.: Otto Frank, Ratschlage für schriftliche Arbeiten..., fq. 6), bëjnë distinkcion të rreptë ndërmjet metodologjisë dhe teknikës së punës shkencore: teknikë konsiderojnë grumbullimin e veprimeve të përbashkëta për të gjitha shkencat, derisa metodat për disa disiplina dhe fusha shkencore janë të ndryshme (tjetërfare janë, për shembull, metodat e hulumtimit në fushën e shkencave biologjike, sociologjike apo linguistike). E megjithatë, ne nuk i jemi përmbajtur këtij distinkcioni të rreptë: kemi konsideruar se edhe për grupin e caktuar të shkencave (për shembull, për shkencat humaniste), pa marrë parasysh atë që secila prej tyre ka edhe metodat e veta të veçanta, ekzistojnë veprimet e përbashkëta metodologjike, në të cilat ne aty-këtu edhe jemi ndalur, ndonëse veprimet teknike shumë më tepërkane qënë në qendër të vëmendjes tonë.

⁷ Shprehjen **edukim** këtu e marrim në domethënien që ia ka dhënë Bogdan Popović: si "çdo gjë që njeriu e bën vetë, dhe çka të tjerët e bëjnë për të, të vijë deri te njëfarë lloj përsosjeje", ndryshe nga "mësimi dhe këshillimi në kuptimin më të ngushtë, gjatë të cilave, vërtet, çdo gjë bëhet nga jashtë për nxënësin, deri sa ai vetë mbetet pasiv". (Iz teorije književnosti..., fq. 156).

punuar me të në “punëtori”, d.m.th. në seminar apo në laborator, duke kundruar se si punon ai, duke lexuar në mënyrë inteligjente dhe duke i analizuar me kujdes punimet e tij dhe të punëtorëve tjerë të dalluar shkencorë në disiplinën e caktuar shkencore. Me një fjalë, kyçja në mjeshtrinë e shkencëtarit më së miri arrihet si me leximin e veprave të ndryshme shkencore dhe doracakëve, e aq më tepër, me praktikë: *Fit fabricando faber* (Farkëtarit bëhet duke farkuar), thotë thënia latine.⁸

E megjithatë, kjo nuk do të thotë se ekspertit të ri e të papërvojë nuk do t'i ndihmojë vepra në të cilën do të shtroheshin përvojat, mendimet, vërtetimet mbi metodologjinë dhe teknikën e punës shkencore-kërkimore: ato përvoja dhe mendimet mund t'i shërbejnë si udhërrëfytes, që t'ia lehtësojnë kalimin e rrugës që duhet ta shpie deri te caku, kurse të cilën ai duhet ta kalojë (ashtu përfërsisht sikur që harta dhe busullat ia lehtësojnë kalimin e rrugës udhëtarit në rrugën e panjohur). Me fjalë të tjera, njohja e metodologjisë dhe teknikës së punës dhe të kërkimit shkencor do t'ia kursejë ekspertit të ri shpenzimin e kotë të kohës dhe shkapërderdhjen e energjisë, do t'i ndihmojë që më mirë t'i shfrytëzojë forcat e veta kreative dhe aftësitë e punës.

Ky punim, në rend të parë, është fryt i përvojave dhe i përsiatjeve vetjake për etapat dhe problemet e ndryshme të procesit të krijimit të një vepre shkencore, për metodat dhe teknikën e punës shkencore-kërkimore. Por, gjatë shkruarjes së tyre, në masë më të vogël apo më të madhe, kemi shfrytëzuar, edhe përvojat, idetë dhe të dhënat e të tjerëve.⁹ Gjatë kësaj, më së shpeshti, thelbin e kemi përqëndruar në anën praktike të problemit, u kemi dhënë përparësi çështjeve praktike, të bindur se

⁸ Edhe gjermanët posedojnë thënie të ngjashme: *Wbung macht den meister* (Mjeshtri bëhet me të ushtruar).

⁹ Të konsultohet literatura e shfrytëzuar.

libri do të mund ta ofrojë ndihmën e domosdoshme vetëm nëse bëhet edhe mjaft praktik.¹⁰ Për këtë qëllim parashtrimet tona i kemi ilustruar me shembuj, ndonëse këtë, duke e marrë parasysh karakterin e përgjithshëm të veprës dhe hapësirën e kufizuar, nuk ishim në mundësi që atë ta bëjmë ashtu si dhe sa kemi dëshiruar.

Trajtimi i një teme më të gjerë dhe hartimi i një punimi më voliminoz shkencor përfshinë, sipas rregullit, shumë etapa dhe kaptina, sikur: *zgjedhja e temës; tubimi dhe përpunimi i materialit; organizimi dhe klasifikimi i materialit; redigjimi i dorëshkrimit, duke pasur kujdes të veçantë në korrektësinë stilistike dhe gramatikore; përpunimin teknik dhe botimin e veprës*, e nëse ka të bëjë me tezen (e doktoraturës apo të magistraturës), edhe *recensionin e saj dhe mbrojtjen*. Secilën nga këto çështje - të gjitha ato etapa të procesit hulumtues dhe problemet themelore që janë në lidhje me to - ne do t'i shqyrtojmë në kaptina të veçanta. Kësaj do t'i ndajshtojmë edhe: disa vërtetime për cilësitë themelore të punës shkencore-kërkimore dhe veçoritë e veprës së mirë shkencore (pas hyrjes); dhe, në fund, literaturën e përdorur, e në shtojcë, kaptinën për procesin kurijues dhe krijuesit.¹¹

Ky libër u destinohet, *grosso modo*, ekspertëve të rinj të shkencave humaniste, në rend të parë atyre që i punojnë tezat e doktoraturës dhe të magistraturës. Por i njëjti shpresojmë se do të jetë i dobishëm edhe për të tjerët: për studentët, gjatë hartimit të punimit të diplomës dhe atyre seminarike, sikur edhe përgjithësisht intelektualëve profesioni dhe aktiviteti i të cilëve janë të natyrës së tillë që herë pas here ua imponon edhe obligimin që të hartojnë ndonjë shkrim: artikull për revistë, referat për ndonjë tubim, elaborat apo raport për ndonjë institucion ose organizatë e të ngjashme. Me fjalë tjera,

¹⁰ Tejet e qëlluar është thënia e Bogdan Popoviqit që “Kurrë asgjë nuk është tepër praktike”. (Po aty., fq. 165).

¹¹ Të shihet kreu XIII (“Shtojca”) vërejtja 1.

përvoja ka treguar se këta të fundit shpeshherë kanë ide të vlefshme dhe vrojtime interesante, por nuk kanë mundësi që me sukses t'i organizojnë në tërësi dhe t'i shtrojnë qartë, pasqyrueshëm, në një nivel të lartë stilistik, sikur që nuk dinë punën e vet as teknikisht ta përkryejnë. Kurse në jetën profesionale dhe afariste sot ka pakë fusha në të cilat, pos tjerash, nuk janë të domosdoshme, ose së paku të mirëseardhura, aftësia dhe përvoja për grumbullimin e informatave, zhvillimin e ideve dhe për një shkrim të mirë.

Është larg nesh mendimi që veprimet metodologjike dhe teknike që këtu janë të shtruara t'i vlerësojmë si reçeta të vetme të mira e korrekte: përkundrazi ekziston një varg i tërë i veprimeve të tjera të llojllojshme metodologjike dhe teknike, të cilat po ashtu mund të jenë të mira e më të mira: çdo gjë varet nga rasti konkret dhe përvoja personale, nga shija dhe shprehja. Në pajtim me këtë, parashtrësats tona duhet kuptuar më tepër si një varg sugjestionesh, që i lënë lexuesit dhe hulumtuesit lirinë dhe iniciativën e plotë.

Duke ia dorëzuar këtë libër opinionit, do të dëshirojm të përmendim se ai, sipas mendimit tonë, më së miri do t'i përgjigjet qëllimit të vet, nga njëra anë, po qe se ua ofron qoftë edhe ndihmën më modeste ekspertëve të rinj të cilët fillojnë të punojnë në shkencë dhe janë në hamendje se si t'i zgjidhin çështjet e ndryshme të natyrës praktike në lidhje me punën shkencore ose profesionale, ndërsa, nga ana tjetër, nëse ai nxitë diskutimin për disa pyetje të prekura këtu dhe, eventualisht, t'i motivojë për shkrimin e doracakëve të ngjashëm të karakterit të përgjithshëm dhe, veçan, atij special, të cilët në realitet do të paraqitnin përpunimin dhe plotësimin e disa pyetjeve të këtij doracaku, në pajtim me thëniet latine: *Si duo faciunt idem non est idem* dhe *Faciant meliora potentes!* (Nëse dy veta punojnë një punë të njëjtë, kjo nuk është e njëjtë. Ata që munden, le të punojnë edhe më mirë.)

I. Mbi punën, metodën dhe veprën shkencore—hulumtuese

A. Cilësitë themelore të punës dhe metodës shkencore-hulumtuese

Tërheqja e kufirit ndërmjet punës dhe veprës shkencore e specialistike nuk është çdoherë e lehtë; për këtë arsye shpesh është i domosdoshëm shqyrtimi dhe hulumtimi i kujdesshëm. Që më përparësisht të përcaktohet se ç'janë në realitet, puna dhe vepra shkencore-kërkimore dhe cilat janë cilësitë e tyre themelore, medoemos paraprakisht duhet thënë së paku disa fjalë për atë se ç'janë shkenca dhe kërkimi (hulumtimi).

Me termin *shkencë* rëndom nënkuptojmë mësimin (njohjen) e rregulluar, të sistematizuar e të verifikuar për diçka, të arritur me hulumtim dhe shqyrtim metodik, të kujdesshëm e të ndërgjegjshëm. Ndonëse me termin *kërkim (hulumtim)* nënkuptojmë gjurmimin sistematik të fakteve nga të cilat mund të nxirren parimet dhe ligjmëritë e caktuara shkencore. Në pajtim me këtë, shkencën, në të vërtetë, e përbëjnë rezultatet, ligjet deri te të cilat vihet me anë të kërkimeve.

Nga e sipërpërmendura rezulton se punimi që dëshiron ta fitojë kualifikimin *shkencore-kërkimor* medoemos duhet të zë fill në një problem të caktuar dhe të mbëshetet në faktet deri te të cilat vihet nëpërmjet hulumtime-

ve. Punimi, në pajtim me këtë, nuk mund të jetë i karakterit të pastër spekulativ, që do të thotë se nuk mund të mbështetet në spekulimin dhe teoretizimin e zbrazët, shterpë, pa bazament solid faktik, pa material solid faktik.

Por, nuk është irelevante as cilësia e fakteve në të cilat zë fill puna shkencore: ato duhet të jenë të vlefshme, d.m.th. të sakta, të verifikuara e veçanërisht të vjelura në pjesën më të madhe nga *dora e parë*, qofshin ato fenomene të natyrës, rezultate të eksperimenteve, dokumente historike, tekste letrare etj. Sepse vetëm kontakti i drejt-përdrejtë dhe i gjallë me faktet autentike punimit mund t'i japë bazamentin shkencor, karakterin shkencor. Kuptohet se edhe faktet të marra nga *burimet dytësore*, nga literatura për lëndën, kanë po ashtu vlerë, dhe medoemos duhet të shfrytëzohen, ashtu që rezultatet shkencore në realitet paraqesin lidhjen, sintezën e fakteve të nxjerrura nga të dy këto lloje të burimeve, d.m.th. lidhjen dhe sintezën e fakteve të vjetra e të njohura dhe të fakteve të reja e të panjohura. Por megjithatë vepra nuk mund të mbështetet vetëm në faktet e dorës së dytë, d.m.th. në burimet dytësore, në literaturën e lëndës, sepse në atë rast ajo nuk do të ketë karakter shkencor në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, që në asnjë mënyrë nuk do të thotë se punimi i tillë nuk mund të jetë interesant, i dobishëm dhe i vlefshëm duke iu falënderuar disa vlerave të tjera të veta (qasjes së re, interpretimit të ri të fakteve e të ngjashme).

Mirëpo, sado që faktet dhe vlefshmëria e tyre të jenë kushte të rëndësishme që ndonjë punim të jetë i karakterit shkencor e hulumtues, vargimi i tyre mekanik nuk mjafton: janë të domosdoshme analiza dhe interpretimi i përshtatshëm i fakteve dhe, që është edhe më me rëndësi, përgjithësimi i tyre, d.m.th. është e domosdoshme nxjerrja - nga faktet e dhëna - e parimeve të përgjithshme, ligjëshmërive, normave e të ngjashme. Derisa nuk arrin deri te ato përgjithësimet, hulumtuesi nuk mund të

konsiderojë se e ka mbaruar punën e vet, e as që mund të konsiderohet që punimi i tij i kënaqshëm.

Nga parashtresa e deritashme rezulton se cilësitë themelore të ndonjë pune shkencore-kërkimore mundën *grosso modo* të redukohen në tri pikat vijuese:

1. Punimi duhet të zë fill në një problem të caktuar dhe i ri, deri atëherë i pahulumtuar e i pazgjidhur, ose së paku pjesërisht të zgjidhur, dhe se me ndihmën e analizës (dhe hipotezave) së tij të themeltë vjen deri te rezultatet e reja: Me fjalë tjera, puna shkencore-kërkimore në rend të parë duhet të jetë punë origjinale. Ky origjinalitet mund të manifestohet qoftë me zgjedhjen e problemit krejtësisht të ri, temës së re, qoftë me trajtimin e problemit tashmë të përpunuar, por mënyra e përpunimi i të cilit nuk është e kënaqshme ose nuk ka ardhur deri te zgjidhja përfundimtare e temës. Në këtë rast, para se të bëhet zgjedhja përfundimtare e temës duhet mirë të shqyrtohet se a do të rezultojnë hulumtimet eventuale me fryte të njëmendta, me rezultate të reja, duke iu falënderuar dokumentacionit të ri, veprimeve të reja metodologjike dhe teknike, qasjes së re kritike të problemit e të ngjashme.

2. Faktet dhe idetë që shtrohen, dhe në të cilat zë fill puna shkencore-kërkimore, duhet të jenë të sigurta, të mbledhura me kujdes dhe në numër të mjaftueshëm, të shqyrtuara dhe të verifikuara në mënyrë kritike, të analizuar e të interpretuara në mënyrë korrekte, me një fjalë, të atilla që në to lexuesi të mund të mbështetet, që edhe vetë të mund t'i verifikojë (duke iu falënderuar aparatit shkencor në të cilin këto fakte mbështeten). Gjatë kësaj veçanërisht duhet pasur kujdes nga gabimet që *a priori* dalin nga botëkuptimet dhe paragjykimet e ndryshme, soditjes së keqe e sipërfaqësore, përfundimit jo të saktë e të ngutshëm (në bazë të numrit të pamjaftueshëm të fak-

teve), të cituarit sipërfaqësor të të dhënave (sipas mbamendjes e të ngjashme) e të tjera.¹²

3. Në punim - në pajtim me karakterin e problemit dhe të hulumtimit, sikur edhe të burimit të informatave - duhet të aplikohet metoda më e përshtatshme shkencore.

Me termin *metodë shkencore* rëndom nënkuptojmë grumbullin e veprimeve dhe proceseve të ndryshme me anë të të cilave vihet deri te njohuritë dhe deri te të vërtetat shkencore.

Teorecienët rëndom dallojnë tri metoda themelore, standarde shkencore-kërkimore: *normative, eksperimentale* dhe *historike*. Secila prej tyre është karakteristike për grupet e ndryshme të shkencave të cilat duke e marrë parasysh metodën e hulumtimit që në to më së shpeshti aplikohet - mund të ndahen në *shkenca normative, eksperimentale* dhe *historike*. Kështu, për shembull, metoda eksperimentale aplikohet kryesisht në shkencat natyrore (në fizikë, biologji etj.), që nuk d.m.th. se ajo nuk ka vend edhe në disa shkenca shoqërore (në psikologji etj.); metoda historike në pjesën më të madhe aplikohet në shkencat shoqërore (histori etj.), në masë të caktuar edhe në shkencat natyrore e të tjera (për shembull, kur ka të bëjë me ndonjë problem nga historia e biologjisë, mjekësisë e të ngjashme).

Ti themi së paku nga disa fjalë për secilën nga këto metoda:

Metoda normative. - Kjo metodë, sikur që këtë e dëfton edhe vetë emri, ka për qëllim ta gjejë atë që paraqet jo ligjin por normën, standardin, mesataren në botë dhe në jetë, që u nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme, dhe shpesh, atë që në fushën e caktuar dhe në momentin e pikërishtëm është më e mirë. Kjo metodë më së shpeshti ka të bëjë me statistikat e ndryshme dhe me të

¹² Almack, *Research and Thesis Writing...*, pp. 64-65.

dhënat e tyre, të cilat duhet t'i zbulojë, t'i interpretojë në mënyrë korrekte, t'i vlerësojë në mënyrë korrekte dhe t'i verifikojë. Konform kësaj rezultatet e saj paraqesin vlera të caktuara. Ndonëse nuk është e privuar nga disa dobësi (sikur edhe të gjitha metodat që zënë fill në të dhënat statistikore), edhe kjo metodë ka përparësinë që rezultatet e saj fitojnë vlerën dhe dobinë e vet praktike, të cilat i verifikojnë praktika dhe jeta.

Metoda eksperimentale. - Kjo bazohet, sikur që edhe vetë emri e thotë, në eksperimentin, d.m.th. në "vështimin e kontrolluar" dhe në "verifikimin e ndonjë ligji". Pos në shkencat natyrore, metoda eksperimentale ka vend të konsiderueshëm se edhe në fushat tjera të ndryshme të veprimitarisë njerëzore, duke filluar "që nga afarizmi e deri te stili". Ekzistojnë dy kushte elementare që duhet të përmbushen me qëllim që ndonjë eksperiment të japë rezultate të dobishme: kontrolli preciz "i lëndëve relevante" dhe numri i mjaftueshëm i eksperimenteve të kryera. Për eksperimentin e kryer hartohet zakonisht përpilohet raporti, që shpesh ka formën e vet të përhershme, "standarde": "prezentimin e fushës kryesore ose të lëndës së eksperimentit; hipotezës; objektet në të cilat janë zbatuar eksperimentet; përshkrimi i aparatit (e nëse është e domosdoshme edhe fotografia e tij); ecuria e eksperimentit; të dhënat e fituara; rezultatet dhe përgjithësimet, sikur edhe raporti i gjithë kësaj ndaj fushës së përgjithshme apo teorisë së përgjithshme."¹³

Metoda historike. - Historia, shkurt dhe ngapak e thjeshtëzuar, do të mund të përkufizohet si "njohuri e saktë mbi atë që ka ndodhur" dhe, sipas mundësisë, si dhe përse kjo edhe kështu ka ndodhur. Metoda me të cilën ajo shërbehet që të vijë deri tek ajo njohuri është historike, e cila i merr parasysh sidomos disa faktorë, si

¹³ Hubbell, Writing Term Papers and Reports, p. 80.

psh.: kronologjinë, zhvillimin, shkaqet, konsekuencat. Ndërkaq, instrumentet kryesore me të cilat disponon ajo që të arrijë deri te kjo janë shkresat e shumëllojshme dhe dokumentet. Sigurisht që kjo metodë nuk është karakteristike vetëm për historinë politike dhe shkencat historike marrë në përgjithësi: “Çdo gjë, duke i përfshirë këtu edhe të gjitha shkencat dhe metodat e studimit, kanë shkaqet e veta, prejardhjen, historinë, zhvillimin”, - thotë saktë Habeli,¹⁴ por kjo metodë përdorim më së shpeshtë ka në shkencat historike.

Me këtë rast të theksojmë edhe atë se në hulumtime jo rrallë kombinohen metodat e ndryshme shkencore.

Përveç këtyre tri metodave themelore (‘standarde’) shkencore-kërkimore, përmenden edhe disa metoda të tjera, ‘minore’, si: *studimi i rastit* (case study), *metoda gjenetike*, *metoda krabasimtare*, *metoda e shqyrtimit*, *metoda e kompilimit*, *metoda e anketimit*, *metoda e intervistimit* e të ngjashme¹⁵; por hulumtimi rigoroz i metodave të përmendura minore dëfton, sikur që në mënyrë të qartë e cekë Almeku (Almack), “ose se ato janë jopërkafëse si metoda të shkencës induktive, ose se janë identike me ndonjërin nga metodat standarde: historike, eksperimentale dhe normative - sidomos me këtë të fundit. Si metoda të pavarura ato nuk shpëjnë deri te përgjithësimet; por më e saktë është se ato nisen prej të përgjithshmes nga individualja.”¹⁶

Duhet të themi disa fjalë së paku për ata që na duken më të rëndësishëm për këtë rast.

Studimi i rastit. - Sikur që këtë e thotë edhe vetë emri, ky është studim i ndonjë rasti individual nga fusha e caktuar shkencore - judikatura, sociologjia, psikologjia, mjekësia etj. (për shembull: “studimi i një libri, një episode

¹⁴ Po aty, p. 81.

¹⁵ Disa metodologjistë bëjnë distinkcionin ndërmjet metodave (eksperimentale, historike etj.) dhe teknikave (anketimit, intervistimit, testimit, etj.). Ne nuk i jemi përmbytur këtij distinkcioni.

¹⁶ Almack, o. c., p. 217.

ose eksperimenti, i një pacienti në klinikë, i një rasti juridik, i një projekti teknik, ose cilitdo problem, individual të kufizuar,¹⁷ me ç'rast është studiuar ndonjë tipar karakteristik dhe interesant, cilësi, dukuri e atij rasti. Marrë vetvetiu, kjo metodë nuk është shkencore në kuptimin e mirëfilltë, rigoroz të fjalës: ky është vetëm siç cek Lundberg (Lundberg), "hapi i parë në metodën shkencore". Me fjalë të tjera, është i domosdoshëm vështrimi jo vetëm i një rasti por i më shumë rastesh që, në bazë të të dhënave të fituara nga ky vështrim, të mund të nxirren ligjmeritë e caktuara. "Disa raste", - thotë hulumtuesi i njëjtë,- fitojnë rëndësi shkencore vetëm nëse klasifikohen dhe përmbledhen ashtu që zbulojnë uniformitetet, tipet dhe modelet e mirësjelljes".¹⁸ E megjithatë, edhe kjo metodë ka vlerën e vet praktike dhe duke iu falënderuar asaj, mund të shënohet ndonjë përvojë e dobishme.

Metoda gjenetike. - Është e ngjashme me metodën e studimit të rastit. Sikur edhe kjo e fundit, ajo paraqet vetëm hapin e parë në shkencë. Theksi vihet në "faktorët dinamikë të rritjes, ndryshimit dhe zhvillimit": "Ajo përpiket t'i përshkruajë faktet me studimin e rrjedhës së zhvillimit të tyre paraprak."¹⁹

Anketimi. - Instrumenti themelor për zbatimin metodës së anketimit është kuestionari (pyetësi anketues), që shërben për mbledhjen e informatave, mendimeve, materialeve. Vlefshmëria dhe besueshmëria e kësaj metode në tubimin e informatave varet nga vlefshmëria dhe besueshmëria e vetë informatave të fituara kësaj rruge. Në disa raste, vlefshmëria e tyre është e pakontestueshme. Por dobia dhe arsyeshmëria me këtë metodë janë mjaft të kufizuara. Në rend të parë për shkak se ajo

¹⁷ Hubbell, a. c., p. 82.

¹⁸ George A. Lundberg, "Case Work and the Statistical Method", in: Social Forces, vol. 5, sept., 1925, p.

¹⁹ Almack, o.c., p. 207.

është vështirë e zbatueshme. Të metat e saj janë të njohura për të gjithë ata që kanë pasur rast ta aplikojnë në praktikën e vet: një numër i konsiderueshëm, jo rrallë edhe i madh i individëve në pyetësonin anketues fare edhe nuk përgjigjen, kurse edhe ata që përgjigjen këtë e bëjnë në mënyrë tejet të pakujdesshme. Në pajtim me këtë, hulumtuesi shumë rrallë mund të mbështetet plotësisht në faktet dhe informatat e fituara nëpërmjet pyetësonit. Së këndejmi, është e dëshirueshme, shpesh edhe e domosdoshme, që faktet dhe informatat e fituara në këtë mënyrë të plotësohen edhe të verifikohen me ndonjë metodë tjetër. Krahas kësaj, kjo metodë është edhe e shtrenjtë: organizimi, dërgimi dhe studimi i pyetësorëve anketues kërkon mjete të konsiderueshme financiare, kështu që hulumtuesit këtë metodë hulumtimi e përdorin vetëm në raste të domosdoshme.

Gjatë përpilimit të pyetësonit është e nevojshme të kihet kujdes në momentet vijuese: 1) që pyetjet e parashtruara në pyetëson të jenë ashtu të përpiluara që përgjigjet e individëve hulumtuesit t'ia ofrojnë informatat e dëshiruara; 2) që pyetësoni të jetë sa më i shkurtër, ashtu që individët e anketuar të mundën sa më shpejtë e sa më lehtë të përgjigjen; 3) që çdo pyetje në pyetëson të jetë qartë dhe saktë e formuluar, ashtu që ajo të kërkojë përgjigje të qartë, koncize dhe precize.

Intervistimi. - E ngjashme me pyetësonin anketues është intervista: dallimi themelor ndërmjet tyre qëndron në atë që në rastin e pyetësonit, informatat tubohen me shkrim, pa praninë e atij të cilit i drejtohen pyetjet, derisa intervistimi zbatohet gojarisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kontakt personal me personin që intervistohet.

Intervistimi në krahasim me pyetësonin ka atë përparësi që është më elastik dhe më i gjallë. Vlera e fakteve dhe informatave të grumbulluara me anë të intervistimit varet, kuptohet, nga një numër jo i vogël i faktorëve, në

rend të parë nga ai që interviston: nga informimi i tij, shkathtësia e tij që të shtrojë pyetje interesante dhe me vend, që të zhvillojë dialog interesant me të intervistuarin. Për këtë qëllim është e domosdoshme që autori i intervistës paraprakisht t'i përgatisë pyetjet, duke pasur kujdes në momentet për të cilat tashmë është bërë fjalë në pyetësor.

Në lidhje me intervistimin nuk është irelevante as pyetja: a thua ai që interviston duhet menjëherë edhe t'i shkruajë fjalët e të intervistuarit? Në këtë pyetje nuk mund të jepet përgjigje e gjithëpranueshme: nëse ekziston rreziku se shkruarja e drejtpërdrejtë do të ndikojë jo-favorshëm në spontanitetin dhe çiltërinë e përgjigjes, fjalët është më mirë të shkruhen më vonë, dhe këtë sa më parë, derisa faktet dhe informatat ende janë të freskëta në mbamendje. Të theksojmë me këtë rast dobinë që, në këtë aspekt, mund ta ofrojë magnetofoni si mjet i shkëlqyeshëm i regjistrimit besnik të të folurit.

Të përmendim edhe atë se për të gjitha këto metoda (dhe të tjera) si dhe lloje të hulumtimit shkencor, më pak apo më shumë janë të përbashkëta (dhe të domosdoshme) aktivitetet e caktuara shpirtërore, si psh. vështrimi (i pastër dhe me anë të eksperimentit), krahasimi (vërejtja e analogjive, ngjashmërive dhe kundërtive), analiza dhe sinteza, imagjinata, hipoteza, nxjerrja e përfundimeve (me induksion dhe deduksion).

B. Veçoritë e veprës së mirë shkencore

Çdo punë shkencore, nga cilado lëmi shkencore qoftë, ka vlerat e veta personale. Së këndejmi; për veçoritë e punës së mirë shkencore mund të flitet vetëm përgjithësisht, mund të dëftohet në veçoritë e caktuara të ci-

lat mund të jenë të përbashkëta për shumë punime shkencore të cilësisë të mirë.

Kur është fjala për veçoritë karakteristike dhe të përgjithshme për ndonjë punim të mirë shkencor, duhet cekur në vend të parë që, në të shumtën e rasteve, cilësia e ndonjë punimi shkencor nuk varet nga vëllimi i tij: është e njohur se disa zbulime epokale janë publikuar në një numër të vogël faqesh (psh. Teoria e Relativitetit e Ajnshtajnit). Vëllimi i punimit varet nga shumë faktorë dhe ai mund të ndryshojë për disa disiplina, degë, tema shkencore, duke i kontribuar në masë më të vogël ose më të madhe vetë cilësisë së punimit. Por, ajo që gjatë kësaj është me rëndësi thelbësore, veçan kur është në pyetje punimi më i vëllimshëm, është fakti që lënda të shteret, që punimi të paraqesë, aq sa është e mundur, së paku për atë çast, studimin definitiv të një problemi, ashtu që për të njëjtin problem së paku për disa vjet, të mos mundet përsëri të shkruhet ose që ai të plotësohet. Meqë punimi, ndërkaq, nuk është e domosdoshme t'i përfshijë dhe zgjidhë menjëherë të gjitha çështjet, këtë menjëherë që në fillim, në vetë parathënien ose në hyrje, sinqerisht duhet theksuar dhe eventualisht, në përfundim të jepet shenjë në pyetjet më të rëndësishme që mbeten të përpunohen.

Ç'është e vërtetë, vëllimi i shkrimit, sidomos në disa shkencë (humaniste), në masë të konsiderueshme mund të jetë kriter i besueshëm për gjerësinë dhe thellësinë e hulumtimeve, për angazhimin e dhënë dhe për punën e shpenzuar në përpunimin e temës, e në pajtim me këtë edhe për vlerën e vetë veprës. Sidomos kur është fjala për tezën e doktoraturës, vëllimi i saj i gjerë tregon, sipas rregullit, se autori ka hulumtuar tërë materialin dhe dokumentacionin e domosdoshëm, se e ka thelluar lëndën dhe se ka mësuar që materialin ta përpunojë dhe organizojë në tërësi më të madhe harmonike. Në pajtim me këtë, teza e denjë e doktoraturës nga shkencat humaniste do të duhej që edhe sipas vëllimit të jetë vepër më e rën-

dësishme, që të ketë përafërsisht 250 deri 300 faqe tekst të daktilografuar, që nuk do të thotë se edhe tezat me vëllim më të vogël nuk mund të kenë vlerë, nëse autori në formë të përgjithshme i ka komunikuar rezultatet e çmueshme të hulumtimeve të veta disavjeçare e të frytshme. Megjithatë, është rregull i përgjithshëm që duhet synuar nga shkurtësia (e cila, krahas qartësisë dhe drejtpërdrejtshmërisë, është veçoria themelore e prozës shkencore), nga mënyra e ekspozimit të përgjithshëm e të fuqishëm të fakteve dhe të ideve. E gjithë kjo për shkaqe të shumta, prej të cilave, si kryesore na duken këta që vijojnë:

Në rend të parë, këtë e kërkon tempa i sotshëm i jetës: njeriu i të sotmes nuk ka shumë kohë dhe durim për leximin e shkrimeve të gjata dhe të shkruajë diç më të gjerë dhe më të gjatë se sa që është e domosdoshme, d.m.th., në realitet, t'i keqpërdor kohën dhe durimin e huaj. Të përkujtojmë se që në shekullin XVII, ka thënë Volteri: "Frikohem nga librat e mëdha"! E ne, çfarë do të mund të themi për këtë?

Pastaj, shkurtësia në masë të konsiderueshme është dëshmi se autori e ka zotëruar me lëndën deri në atë shkallë, saç ka qenë në gjendje që t'i japë formë të përgjithshme, të ngjeshur. Së këndejmi, ka pasur të drejtë Çehovi, që shkurtësinë e ka quajtur "motër të talentit", dhe Paskali, kur ka kërkuar falje, në fund të një letre të vet provinciale, që e ka shkruar gjerësisht, ku si shkak ka cekur se nuk ka pasur kohë të shkruajë letër më të shkurtë.²⁰

Më në fund, shkurtësia ka çmimet e veta të veçanta: ajo është shenjë e gjallërisë, fuqisë, qëndrueshmërisë, por në të njëjtën kohë edhe e veçanërisht, maturisë dhe shi-

²⁰ Në këtë pikëpamje ka shkruar edhe S. A. Rajnberg: "Sikur që disa miligramë të radiumit të pastër e të çmueshëm fitohen me përpunimin më të ndërlikuar mekanik dhe teknik të qindra tonë xehe të papërpunuar, ashtu pas punës së madhe e të mundimshme kreative literare (më saktë: përpunimit të literaturës për lëndën, vët. M. Sh.) kristalizohen disa mendime dhe formulime të pastra." (O. c., fq. 110 - 111).

jes së bukur të një autori. E megjithatë, duhet pasur parasysh se shkurtësia nuk guxon të shkojë në dëm të qartësisë: kurdo që ekziston, qoftë edhe dyshimi më i vogël se parashtrësia nuk do të kuptohet mirë dhe drejtë, duhet të plotësohet dhe zhvillohet ndërkaq mendimi më hollësisht të sqarohet.

Sa i përket kësaj, të cekim disa parime të përgjithshme të cilave autori do të duhej t'u përmbahej në parashtrësën e tij që ta arrijë shkurtësinë, përkatësisht që t'i shmanget preliksitetit (zgjatimit).

1. *Parashtrësia të mos fillojë nga larg, por aty ku kejo është e domosdoshme, e nevojshme.* - Ndaj këtij parimi gabojnë sidomos njerëzit pa prirje për shkrim: ata hyrjen e vet e fillojnë nga larg dhe në të kyçin shumë sosh pa lidhje të drejtpërdrejtë me temën. Një shembull: Duke e përpunuar për punimin e vet profesional (të diplomës) lëndën "Temat e mëdha në poezinë e Vijnovit", një studente, në vend që në hyrje të përqëndrohet shkurtimisht vetëm në veprën e Vijnovit, ka folur për kohën, jetën dhe veprën e poetit. Kështu hyrja e saj doli tepër e gjatë dhe e zgjatuar, e kështu edhe e dështuar. Por, nga ana tjetër, punimi as nuk guxon të zgjatet më shumë se sa që është e nevojshme.

2. *Mos të kyçet në punim asgjë që nuk është në lidhje të drejtpërdrejtë me temën, që punimin e bën të ndarë.* - Të nxitur nga imagjinata dhe gufimi, shumë shkencëtarë harrojnë në lëndën e vet dhe fillojnë të shkruajnë për diç tjetër. Ose, gjatë të shkruarit u bie ndër mend ndonjë pyetje që është interesante vetvetiu, por del nga suazat e temës, dhe ata, në vend që eventualisht vetëm ta përmendin, fillojnë që për të të flasin gjerë e gjatë. Pasojat e kësaj discipline të pamjaftueshme të mendimeve dhe kujdesit jo të mjaftueshëm vigjilues janë largimi prej temës, digresionet. Që ta evitojë këtë mangësi, Bogdan Popoviq studentëve të vet ua ka dhënë këshillën vijuese: "Në krye të çdo faqeje të letrës në të cilën shkruani (...) shkruani për çka duhet të flitni, dhe posa të pushoni të flitni për këtë,

ndaluni, mos shkoni më tutje – në të vërtetë, kthehuni në vendin ku e keni lënë lëndën.”²¹

Në lidhje me këtë parim të cekim se ndonjë digresion mund të bëhet; por ai duhet të bëhet në mënyrë të vetëdijshme, të arsyeshme dhe, eventualsiht, shkurtimisht të arsyetohet.

3. *Të mos ngarkohet punimi me imtësi të parëndësishme.* - Në vend që t'i zgjedhin faktet dhe idetë thelbësore për lëndën, disa grumbullojnë në shkrimin e vet hollësi të shumta irrelevante. Kjo vjen, pjesërisht, nga shkaku që shpesh nuk dallohet thelbësorja prej jothelbësore, e rëndësishmja prej të parëndësishmes, kurse edhe më shumë nga shkaku që mendohet se se duhet shfrytëzuar tërë dokumentacionin e tubuar të gjitha “fishat” (skedat) për ndonjë temë, duke mos hequr dorë as nga hollësitë më të vogla, më të parëndësishme, që e ngarkojnë punimin. Pasojë e kësaj është që parashpresa e tyre nuk është larg nga rrëfimi i atyre plakave senile, “të thata e pa imagjinatë”, për të cilat flet Viliam Xhejms dhe “të cilat nuk ju kursejnë nga asnjë detaj i rrëfimit të tyre, sado që ai të jetë i imët dhe në vargun e rrëfimit të të cilave janë radhitur të dhënat e parëndësishme me atë këmbëngulësi sikur edhe ato të rëndësishmet.”²²

Në respektimin dhe aplikimin e këtij parimi disa, si p. sh. Shopenhaueri, shkojnë aq larg saqë konsiderojnë se është më mirë të lëshohet nga punimi diç e mirë se sa të futet në të diç e parëndësishme.²³

4. *Të mos përsëritet ajo që tashmë në njëfarë mënyre është thënë.* – Po që se autori, para se të ketë kaluar në ridigjimin e dorëshkrimit, mjaft dhe gjatë nuk ka menduar për lëndën, në mënyrë solide nuk e ka asimiluar materialin

²¹ Cit. në: Ljubomir Petrović, Tehnika stila, fq. 59.

²² William James, Principles of Psychology, I, 570-571.

²³ Artur Šopenhauer, O pisanju i stilu, fq. 119.

dhe nuk e ka përpunuar planin e hollësishëm të parashtrimit, përsëritja e fakteve do të jetë pothuaj e pashmangshme. Në këtë mënyrë edhe lindin ato “ide - parazite”, të cilat punën shkencore e privojnë nga kompozicioni i fuqishëm, e bëjnë të zvarritur, të derdhur, të shpërndarë.

Një lloj i përsëritjes megjithatë është i lejuar, duke e marrë parasysh dobinë që e sjellë: rikapitulimet e shkurt-ra, rezymetë e asaj që më herët është shtruar, sikur edhe paralajmërimet paraprake të asaj që do të vijë. Ato rikapitulime dhe paralajmërimet e lehtësojnë të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit dhe të planit të tij. Ato zakonisht bëhen kur është në pyetje punimi me vëllim më të madh apo me kompozicion më kompleks; kur janë në pyetje punimet më të vogla, por sidomos nëse plani është më i thjeshtë dhe më i kontrolluar, ato janë rrallëherë të nevojshme.

5. *Të mos sqarohen dhe shpjegohen gjerësisht gjerat që vetvetiu janë mjaft të kuptueshme.* - Nga dëshira që çdo gjë ta thonë dhe çdo gjë ta shpjegojnë, disa autorë të punimeve shtrojnë, sqarojnë dhe arsyetojnë çdo gjë gjerë e gjatë. Me këtë ata lexuesin e privojnë nga mundësia dhe kënaqësia, që pas leximit vetë të përsiasë dhe eventualisht, diç të zbërthejë e të shtojë. Ata e nënçmojnë intelektin e lexuesve të vet. Këtë më së miri e thotë anekdota e vjetër franceze. *‘Fshehtësia që njeriu të jetë i bezdisshëm qëndron në atë që të thotë çdo gjë.’*²⁴ Ndërkaq, sipas Monteskie, tërë

²⁴ Le secret pour être ennuyeux c’est de fant dire. - Përkundër mendimit se puna shkencore, sipas rregullit, është e bezdisshme, duhet theksuar që edhe ajo duhet të jetë sa më interesante. I vetëdijshëm për këtë, hulumtuesi duhet të përpiqet ta bëjë interesante, ta mbajë interesin e lexuesit. Ivo Andriq bukur ka tërhequr vërejtjen në këtë, se tashmë vetë frika nga ajo që njeriu mos të jetë monoton, është shenjë e autorit të mirëfilltë, të mirë e të ndërgjegjshëm. Në atë drojë është përfshirë ndjenja e përgjegjesisë dhe kushti për arritjen e stilit të mirë ose, së paku më të mirë të mundshëm. Njerëzit me intelekt të ulët rrallëherë frikësohen që mos të jenë monoton, ata nuk mendojnë për këtë. Autorët e dobët e të papërgjegjshëm lehtë dhe shpejtë kënaqen me veprën e vet dhe i ngjasojnë asaj gruaje që e ka përçafuar fëmijën e vet duke thënë: “O Zot, e si i duket fshatit i këndshëm, kur mua më duket kë-

fshehtësia e të shkruarit të mirë përbëhet në atë që “ide-të që kuptohen vetvetiu të kapërcehen”.

Thënë shkurtimisht, gjerësia dhe zhagitja e tepërt ia marrin punimit shkencor thelbësinë, këmbëngulësinë dhe fuqinë, kështu që e dobësojnë përshtypjen e tij të përgjithshme. Së këndejmi, Shopenhaueri me të drejtë ka thënë: *“Kush dëshiron të shkruajë për të gjitha kohët, le të jetë i shkurtër, konciz dhe i kufizuar në atë që është thelbësore: le të mendojë mirë, të koprracllëku, të çdo fjali dhe çdo fjalë, se mundet edhe pa të; sikur ai që, duke e përgatitur valigjen për udhëtim të largët, të çdo imtësi që e vë në të, mendon a ta lë edhe atë.”*²⁵

Përveç koncizitetit, mund të cekën edhe disa veçori themelore karakteristike për punimin e mirë shkencor, pa marrë parasysh atë se cilit profesion i përket: Këto janë:

Uniteti. - Në një punim shkencor të cilësisë së mirë (sikur edhe, përgjithësisht, në çdo hartim të mirë), në zhvillimin e mendimit themelor, qendror, që përbën strumbullarin e punimit, duhet të ekzistojë uniteti. Kjo do të thotë se është e nevojshme që të gjitha pjesët e punimit (kapitujt, kaptinat, paragrafët etj.) t'i përkushtohen një gjëje, një lënde, një ideje, që ato të përbëjnë tërësinë organike dhe t'i kontribuojnë, secila për vete dhe të gjitha së bashku, rrjedhës së shkallërishtme dhe zhvillimit të idesë themelore, të jenë “funksionale”.

Harmonia (koherenca). - Të gjitha pjesët e punimit duhet të jetë në harmoni, si njëra prej tjetrës reciprokisht, ashtu edhe secila prej tyre, me punimin si tërësi, d.m.th. është e nevojshme që ndërmjet të gjitha pjesëve dhe tërësisë të ekzistojë koherenca logjike. Ajo do të arrihet me kusht që ndërmjet lëndëve për të cilat është fjala, që zhvillohen në disa pjesë më të mëdha dhe më të vogla të

sltu i dashur”. Të slukosh me vetëkënaqësi në tekstin tënd gjatë punimit dhe gjatë shikimit të të punuarës, kjo është rruga më e sigurt drejt suksesit të lexuesit”. (I. Andrić, “Nešto o stilu i jeziku”, Stvaranje, 1949, nr. 9-10, fq. 321).

²⁵ O. c., fq. 168.

punimit (kapitujt, kaptinat, pjesët, paragrafet etj.) të ekzistojë lidhshmëria logjike, harmonia. Në këtë bukur ka dhënë shenjë Bogdan Popoviq:

“Sipas parimit të harmonisë, të gjitha pjesët e një tërësie, e cilitdo vend qoftë ajo, duhet që të jenë në harmoni ndërmjet veti dhe me vetë tërësinë. Ajo tërësi, në një tërësi të rendit më të lartë, bëhet edhe vetë pjesë që duhet të jetë në harmoni me pjesët tjera të asaj tërësie të re e më të lartë, e cila tash, nga ana e vet, është pjesë e tërësisë së rendit edhe më të lartë, dhe kështu me radhë deri te ideja e parë, qenësore.”²⁶

Theksimi përkatës. - Çdo mendim dhe çdo varg i mendimeve të zhvilluara në ndonjë punim, duhet të theksohen varësisht nga rëndësia e vet. Ky theksim përkatës arrihet, sidomos, me hapësirën më të madhe ose më të vogël që i jepet ndonjë mendimi ose vargu të mendimeve dhe me vendin: ajo që më së shumti dëshirohet të theksohet vihet në vend të fundit, i cili është më i rëndësishmi, pastaj sipas rëndësisë vjen vendi i parë etj. Ndërkaq, disa autorë, sidomos ata pa përvojë dhe pa disiplinë të mjaftueshme, ose ata të cilët i ka përshkuar imagjinata, të entuziazmuar me ndonjë mendim që për ta është i dashur, lehtë dhe shpesh gabojnë ndaj këtij parimi të proporcionit të pjesëve në ndonjë përbërje. Dhe si pasojë e kësaj lindin punime që u ngjasojnë “trupave të cilët disa gjymtyrë janë të hipertrofizuara”, lindin “vepra të çala, gërbule, përbindësha të deformuar, që nuk mund të mbahen në këmbë dhe nuk do të mund të jetojnë.”²⁷

Originaliteti. - Në aspekt të origjinalitetit para hulumtuesit të ri nuk mund të shtrohen disa kërkesa jashtëzakonisht të larta. Thënë sinqerisht, origjinaliteti i plotë paraqet përjashtim, kurse raritet i madh janë autorët që me të shquhen. Me të drejtë ka thënë Gëte: *“Gjithnjë flitet për*

²⁶ O. c., fq. 65.

²⁷ G. Lanson, *Conseils sur l'art d'écrire*, p. 137.

*originalitet, por ç'do të thotë kjo! Posa të lindemi, bota fillon të ndikojë në ne dhe kështu kjo shkon deri në fund. Dhe kjo kudo! E çka edhe mundemi pos energjisë, fuqisë dhe vullnetit ta quajmë e jona! - Sikur të mund të thoja çka ua kam krejt borxh paraprijësve dhe bashkëkohësve të mëdhenj, nuk do të më mbetej shumë.*²⁸ E megjithatë, çdo shkrim, madje edhe ai më modesti, duhet të përmbajë diç të re që të shquhet me ndonjë origjinalitet, të sjellë material të ri deri atëherë të panjohur, për të tjerët të papërshtatshëm, ose të atillë deri te i cili autori ka ardhur me intelektin, mendjemprehtësinë e vet; ose edhe që të dallohet me përpunimin, që materialin e njohur ose të thatë dhe jointeresant, e ka bërë të vlefshëm dhe interesant, apo të shquhet me organizim origjinal dhe sistematizim të materialit (kompozicioni), me përfundime origjinale të nxjerra në bazë të materialit që autori e ka pasur në dispozicion (me përfundimet që e ndriçojnë lëndën nga një kënd i ri, hedhin mbi të pikëpamje të reja dhe hapin botëkuptime të reja), me shprehjen stilistike të punimit etj. Mirëpo, kur është fjala për punimin shkencor në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, ai duhet, siç kemi parë, të shquhet me origjinalitetin që vjen në shprehje qoftë me zbulimin e fakteve dhe ligjësi-ve të reja, deri atëherë të panjohura, deri te të cilat kanë sjellë hulumtimet, qoftë me aplikimin e veprimeve të reja metodologjike dhe teknike, qoftë - që është rast ideal edhe me njërin edhe me tjetrën. Me një fjalë, puna shkencore duhet të komunikojë rezultatet e hulumtimeve personale, përsiatjeve personale, përvojave personale të autorit, dhe këtë në mënyrën që deri atëherë këtë askush nuk e ka bërë.

Gjykimi i drejtë. - Në pajtim me karakterin e punimit shkencor dhe të metodës së aplikuar hulumtuese, hulumtuesi i komunikon në mënyra të ndryshme rezultatet

²⁸ J. P. Eckermann, Razgovori s Goetheom, fq. 37.

e hulumtimeve të veta - faktet, idetë, përfundimet: më së shpeshti me të shqyrtuar (me analizë, diskutim, polemikë, shpjegim e të ngjashme), nganjëherë me të biseduar (me narracion) dhe me të përshkruar (me deskripsion). Gjatë kësaj duhet pasur kujdes sidomos në dy gjëra: 1) që çdo pohim, gjykim, mendim të jenë të arsyetuara (ato pikërisht edhe vlejné aq sa janë të argumentuara me argumente dhe dëshmi të vlefshme e bindëse); përndryshe janë arbitrare dhe në pajtim me këtë pa vlerë; 2) që gjykimet dhe përfundimet të jenë të drejta, që autori mos t'i thjeshtojë gjerat, duke i marrë parasysht vetëm argumentet që shkojnë në favor të tezës së caktuar (që t'i shmanget këtij gabimi, Darvini, siç është e njohur, ka shënuar zellshëm, dhe gjatë hartimit të dorëshkrimit ka pasur parasysht çdo mendim që në çkado u ka kundërshtuar postulateve të tij); që, i mashtruar, i ngadhënjyer me pamjen fanitëse të gjerave, mos ta marrë për të vërtetë atë që është e pavërtetë dhe për reale atë që është joreale, sikur që ka ndodhur në tregimin e njohur të Fontenelit për dhëmbin e artë²⁹; që për shkak të ngutisë, mosdurimit, ndërgjegjes së pamjaftueshme, mos t'i marrë parasysht vetëm dy-tri fakte dhe mbi to ta ndërtojë mendimin e vet, tezën, të nxjerrë prej tyre përfundim të pabazuar, të nxitueshëm (në atë aspekt ende është aktual rregulla e

²⁹ Në atë tregim, Fonteneli rrëfen se si një fëmijë në Shlezi, në vend të dhëmbit të rënë i ka dalë dhëmbi i artë. Të befasuar dhe të magjepsur nga kjo dukuri, të gjithë shkencëtarët e njohur gjermanë të asaj kohe janë dhënë në punë ta shpjegojnë shkakun e kësaj dukurie të çuditshme dhe çudibërëse: kanë shkruar libra të tërë për atë si dhe përse kjo ka mund të ndodhë, histori të tëra të atij dhëmbi, ua kanë përgënjeshtuar njëri-tjetrit mendimet dhe i kanë pranuar, por asnjëri prej tyre nuk erdhi deri te mendimi që ta verifikojë vërtetësinë e vetë dukurisë; a ka qenë dhëmbi vërtet i artë. Këtë e ka bërë vetëm një artar, i cili më në fund u ftua dhe i cili ka konstatuar se dhëmbi, në të vërtetë, ka qenë i pranuar, por jo edhe i artë. Fonteneli e nxori nga kjo anekdotë përfundimin që deri më sot nuk e ka humbur aktualitetin e vet: "Të bindemi në vërtetësinë e faktit para se të fillojmë verifikimin e shkaqeve të tij".

njohur e katërt e Dekartit: “që në çdo gjë të bëjmë numërim dhe pasqyrime aq të përgjithshme, që të bindemi se si nuk kemi lëshuar asgjë”³⁰; që, duke iu qasur fakteve me parabindje dhe paragjykime, mos të përpiqet që realitetin t’ua përshtasë mendimeve të veta, në vend, e kundërta, mendimin realitetit; që mos të jepet - në mënyrë jokritike, të verbër - pas mendimeve të huaja, pas mendimeve të autoriteteve; etj.

Shembujt. - Mjeti më i mirë për një parashtrësë të qartë e reljefore është, krahas kontrastit, shembulli. Në pajtim me këtë, punimi nuk guxon të reduktohet në gjykim abstrakt, por duhet të argumentohet me shembuj të llojlojshëm, që mund të nxirren nga përvoja personale dhe nga përvoja e të tjerëve (nga shkrimet, librat, dokumentet etj.), nga e tashmia dhe nga e kaluara.

Veçoritë stilistike. - për to do të flitet më vonë.

³⁰ “... de faire partout des dénombrements si entiers et des revues si générales, que je fusse assure de ne rien omettre”. (Discours de la Methode.)

II. Zgjedhja e temës

Para se të kalojmë në problemet që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me vetë përpilimin e veprës shkencore, është e nevojshme të thuhet disa fjalë për çështjet e caktuara që bëjnë pjesë në etapën përgatitore: për çështjen e zgjedhjes së temës dhe për përqëndrimin e vëmendjes dhe të mendimeve në të, si edhe për çështjen e planit të punëve paraprahe, të drejtpërdrejta.

Zgjedhja e temës për punimin shkencor, sidomos për punimin me vëllim më të madh (vepër shkencore ose tezë e doktoraturës, përkatësisht magistraturës) nuk është as e thjeshtë as e lehtë; dhe këtë, nga shkaku që punimi shkencor, siç kemi parë, parashton dhe kërkon hulumtim të hollësishëm, sistematik dhe verifikim e studim të ndërgjegjshëm, të gjithanshëm të një çështjeje, duhet të japë edhe përgjigje në këtë çështje, të sjellë zgjidhjen e saj ose, së paku, t'i kontribuojë zgjidhjes së saj. Në pajtim me këtë, vepra shkencore e hartuar në mënyrë solide sjell gjithnjë diç të re, dhe me këtë paraqet kontribut të ri thesarit të dijes njerëzore, kontribut me rëndësi shkencës. Nëse ai këtë nuk e bën, nëse pra nuk e pasuron me njohuri në të njëjtën kohë edhe hulumtuesin edhe lexuesin, punimi as nuk mund ta fitojë kualifikimin *shkencor*. Në raste të shumta, edhe për vetë shtruarjen e një çështjeje, problemi të tillë, është e domosdoshme dija jo e vogël, përvoja, dhe ajo që nganjëherë quhet 'sensë'. Së këndejmi, zgjedhja e temës për punimin

shkencor paraqet, jo rrallë, pak a shumë detyrë të rëndë edhe për punëtorin shkencor më me përvojë.

Me këtë rast, medoemos duhet të thuhet se: në shikim të parë dhe marrë përgjithësisht, nuk ka tema të mira e të këqija, sikur që nuk ka as tema krejtësisht të reja as krejtësisht banale. Nganjëherë nga tema që në dukje të parë është e 'keqe', jointeresante, 'e përtypur tepër', mund të krijohet vepër e rrallë, e vlefshme dhe interesante, me kusht që në të dhe në përpunimin e saj të futet diç e re: material i ri deri atëherë i panjohur; metodë e re, origjinale e hulumtimit; qasje e re e temës, pikëpamje e re nga ajo e cila kundrohet dhe trajtohet, e të ngjashme. Kjo, natyrisht, do të jetë më lehtë të sendërtohet nëse gjendet ndonjë temë e pahulumtuar, ose jo mjaft e hulumtuar, ndonjë lëmë e hulumtimit që nuk është përpunuar në mënyrë adekuate, d.m.th. në tërësi ose në mënyrën që kënaq. Për atë qëllim, që mos të thyhen dyert e hapura, para së gjithash durueshëm dhe kujdesshëm kontrollohet literatura ekzistuese për lëndën. Por megjithatë, kjo nuk do të thotë se ndonjë temë nuk mund të jetë më e mirë ose më e keqe, më e lehtë ose më e rëndë, më e thjeshtë ose më e ndërlikuar, më miradiase ose jo-miradiase, e zgjedhur më me fat ose më me pafat. Së këndejmi, në bazë, saktësisht është thënë që punimi i mirë shkencor parashtron dhe kërkon lëndë të mirë, temë të mirë, dhe se në zgjedhjen e temës kandidati mund të tregojë origjinalitet pothuaj në shkallë të njëjtë sikur edhe në përpunimin e saj.

Gjatë zgjedhjes së temës për punimin shkencore-hulumtues duhet pasur kujdes për disa momente, nga të cilat, sipas mendimit tonë, më të rëndësishme janë vijueset:

Në rend të parë tema nuk guxon të jetë e parëndësishme, ndonjë gjë e pavlerë dhe e kotë. Por kjo edhe sot, fatkeqësisht, nganjëherë po ndodh. Kështu, në lidhje me krijimtarinë e Shekspirit, në një të kaluar jo aq të hershme, janë përpunuar disa tema krejtësisht të pavlera, që

paraqesin 'gjepura' më të rëndomta: për shembull, tema për ekzistimin e njëmendtë të pronarit të barkës Saint-Andrew (Sent Endrju), emri i të cilit përmendet në aktin e parë të *Tregtarit mletas*, ose tema për frytshmërinë e zonjës Makbeth (Sa fëmijë ka pasur zonja Makbeth), e të ngjashme.³¹

Është e domosdoshme po ashtu të kihet kujdes në përshtatshmërinë e temës për përpunimin shkencor. D.m.th., ka nevojë, nga njëra anë, të shqyrtohet a thua është tema në masë të mjaftueshme hulumtuese, d.m.th. a do të zë fill në pjesën më të madhe në materialin e arrihur në bazë të hulumtimeve personale të burimeve parësore. Kuptohet, literatura për lëndën (burimet dytësore) duhet, siç kemi parë, të përdoret e të shfrytëzohet si plotësim i hulumtimeve personale dhe literaturës parësore; por, në të nuk mund të mbështetet tërë punimi; ai në këtë rast më shumë do të ishte me karakter kompilativ se sa me karakter shkencor-hulumtues. Nga ana tjetër, duhet vlerësuar, saktë të matet se tema a mund të përpunohet në afatin e arsyeshëm kohor dhe me mjetet materiale me të cilat kandidati i caktuar, përkatësisht institucioni, qyteti apo vendi disponojnë.

Në lidhje me këtë të fundit, është e domosdoshme të kihet kujdes në atë që tema mos të jetë as tepër e ngushtë por as tepër e gjerë. Në të dy rastet autori do të hasë në vështirësi: mungesa ose shumësia e materialit. Mirëpo, nëse ndërmjet këtyre dy të këqijave duhet të zgjedhet më e vogla, atëherë është më mirë që për përpunim të merret problemi më i ngushtë se sa ai më i gjeri. Dhe këtë, nga shumë shkaqe. Pikësepari, shumë pyetje që në shikim të parë duken mjaft të ngushta gjatë kohës, kur të

³¹ Që ironia të jetë më e madhe, këto tema janë përpunuar në formë të disertacioneve të doktoraturës, që autorëve u kanë sjellë tituj të doktorave të shkencave letrare-historike, e madje edhe janë botuar. - Krihs.: V. Bohet, "La Formation des Elites", Cahiers de la Centrale du P. E. S. de Belgique, vol. X, 1934, pp. 134 - 135. Cit. në: G. Dykmans, *Initiation pratique au métier d'écrire*, I. 191.

studiohen në mënyrë më të themeltë dhe më të gjithan-
shme, tregohen mjaft të vëllimshme, jorrallë edhe shumë
të vëllimshme. Pastaj, problemi i ngushtë ofron mundësi
më të mëdha për thellim, për përpunim më të themeltë e
më të ndërgjegjshëm, dhe në atë rast, përkundër ngush-
tësisë së temës, që mundet t'i përkushtohet edhe ndonjë
detaji, punimi do ta ketë vlerën dhe rëndësinë e vet. Më
në fund, tema që përfshin problem më të gjerë, që i
është kushtuar tërësisë më të gjerë e më të madhe, është
më e rëndë për përpunim; jo vetëm për shkak të gjerësi-
së së materialit i cili duhet që të zotërohet³² dhe, në paj-
tim me këtë, për shkak se kërkon më shumë kohë dhe
mjete më të mëdha materiale, por, edhe për shkak që ajo
nga autori kërkon cilësi të veçanta (sidomos aftësinë për
sintezë) dhe përvojë më të pasur në përpunimin e prob-
lemeve shkencore. Mungesa të caktuara mjaft shpesh
manifestohen te eksperti i ri kur përpunon temën e gje-
rë, e që pjerësisht vetvetiu është inherente temave dhe
sintezave më të gjera. Mungesat e tilla, marrë në përgji-
thësi, paraqesin mosmundësi për hyrje më të thellë e më
solide në problematikën dhe kundrimin e saj, shfrytëzim
të tepruar të materialit nga dora e dytë dhe e tretë, për-
folje të mendimeve dhe e fragmenteve të huaja, shtruarje
të gjerave përgjithësisht të njohura, vendeve të përgjith-
shme, përgjithësime dhe simplifikime të tepruara, men-
dime a priori e të ngjashme. Ndërkaq, duhet shtuar se
kufizueshmëria e lëndës nuk e liron kandidatin nga obli-
gimi që më gjerësisht dhe më thellësisht t'i studiojë lë-
menjtë fqinjë shkencorë.

Tema, më në fund, duhet të jetë më bashkëkohore,
d.m.th. të ketë të bëjë me ndonjë problem me interes
dhe të dobishëm për teorinë dhe praktikën bashkëkoho-
re të disiplinës, degës, lëmit të caktuar shkencor. Gjatë

³² Qui embrasse trop, mal etreint - thotë fjala e urtë franceze. (Në përk-
thimin më të lirë, kjo fjalë e urtë thotë: Lumi i gjerë, fundi i cekët).

kësaj më ideale është, gjithsesi, nëse ajo hyn në vargun dhe sistemin e të a. q. çështje *me rëndësi* të ndonjë disipline shkencore, nëse organikisht është e lidhur me nevojat e bashkësisë shoqërore në çastin dhe vendin e caktuar dhe në botë përgjithësisht, por temat e tilla nuk janë të shpeshta, dhe gjithnjë nuk është lehtë të gjenden dhe me sukses të përpunohen.

Shkurtimisht, temë e përshtatshme është ajo që është e re, e rëndësishme dhe interesante vetvetiu, që është mjaft e ngushtë (sidoqoftë jo tepër e gjerë), për përpunimin e së cilës materiali është i përshtatshëm, kurse vetë përpunimi është i zbatueshëm në afatin e arsyeshëm kohor.

Për përpunimin e suksesshëm të temës, me rëndësi jo më të vogël është edhe 'përshtatshmëria' e kandidatit për punën shkencore përgjithësisht dhe për temën e caktuar veçanërisht: anët e tij pozitive dhe të metat, talentët e tij, aftësitë, prirjet, kufizimet.

Sa i përket faktorit të parë, hulumtuesi - pos originalitetit dhe imagjinatës kreative, veçori që sillen në botë me vetë lindjen, por të cilat në mënyrë të konsiderueshme mund të përkryhen me ushtrime - duhet të ketë një varg veçori të tjera pozitive, si: interesin dhe dashurinë për shkencën, aftësinë e përgjithësimin dhe nxjerrjes së përfundimeve të përgjithshme, gjykimeve, ligjeve, talentin e zhvilluar dhe të mprehtë vështrues, prirjen për rend, punë sistematike dhe për saktësi, frymën e zhvilluar kritike, që është një nga postulatet themelore të shkencëtarëve dhe të shkencës përgjithësisht, vetëkritikën, që i mundëson të vigjilojë ndaj simpativë dhe antipativë të veta, mendimet a priori dhe paragjykimet e të gjitha llojeve, nga të cilat askush në tërësi nuk është i privuar, nderin intelektual (veti që është e nevojshme në të gjitha veprimtaritë, e në shkencë sidomos,³³ pasionin për

³³ Ta kuptojmë thënien e Rableit. "Science sans conscience n'est que ruine de l'âme". ("Shkenca pa ndërgjegje është shkatërrim i shpirtit".)

të vërtetën, çfarëdo qoftë ajo, aftësinë për ta shtyrë gjykimin derisa nuk tubon numër të mjaftueshëm faktesh që të mund ta sjellë, dhe, mbi të gjitha, aftësinë dhe shprehinë për përpjekje të gjata e të durueshme, që do t'i ndihmojë t'ia ngadhënjejë njeriut inercionin kongenital.³⁴

Kur është fjala për përshtatshmërinë e kandidatit për temën e caktuar, rëndësi të veçantë kanë dy kushte që ai duhet t'i plotësojë: afiniteti i kandidatit ndaj temës dhe përvoja e tij në përpunimin e problemeve të ngjashme shkencore.

Sa i përket faktorit të parë, është e vërtetë se atë që a don njeriu e punon shumë më mirë dhe më lehtë nga atë që nuk e do, sikur që edhe njeriun e lodhë më së lehti dhe më së shpejti ajo që i është monotone. Në pajtim me këtë, çdo punëtori shkencor, madje edhe atij më modestit, i është i domosdoshëm, nga njëra anë, ai minimumi i entuziazmit pa të cilin nuk ka punë kreative, kurse, nga ana tjetër, ka nevojë për një afinitet psikik, ndijor ndaj lëndës që e përpunon: te ai duhet të ekzistojë kërshëria e caktuar, pasioni, që gjithnjë do ta nxisë që pyetjen e zgjedhur ta hulumtojë dhe që punën hulumtuese ta përfundojë me mbarim të suksesshëm. Ndonjëherë ndodh që entuziazmi për temën të shfaqet më vonë, gjatë vetë përpunimit, kur autori të hyjë më thellë, "të angazhohet", në lëndën (në pajtim me atë anekdotën franceze që nganjëherë oreksi vjen gjatë kohës së ushqimit). E

³⁴ Inercioni vjen në shprehje - siç ka dhënë shenjë në këtë jo vetëm një autor - sidomos në etapën e redigjimit: pasi e ka tubuar materialin, që duhet ta trajtojë, hulumtuesi gjen njëqind shkaqe që shkrimin ta shtyjë: ai duhet që ndonjë çështje ende ta verifikojë, shkrimin e caktuar ende ta lexojë, edhe diç të shikojë në ndonjë enciklopedi, ende ta shqyrtojë planin, që nuk i pëlqen, e të ngjashme. I vetëdijshëm për këtë, hulumtuesi duhet ta ngadhënjejë atë rezistencë momentale dhe, pa e marrë parasysh disponimin e vet mental, të ulet pranë tavolinës e të fillojë të shkruajë. Pas vështirësive të para çdo gjë rëndom rrjedh lehtë ose, së paku shumë më lehtë dhe më thjeshtë se sa që autori këtë në shikim të parë e ka menduar.

megjithatë, sipas rregullit, duhet shmangur temave që nuk kanë së paku njëfarë tërheqshmërie për kandidatin: jo vetëm që përpunimi i temës së tillë të zvarritet rëndom deri në pafund, por mungesa e tërheqshmërisë së saj dhe e interesimit për të të manifestohen edhe në punimin e mbaruar, dhe që këtë sigurisht do të duhet ta ndiejë edhe vetë lexuesi.

Në aspekt të faktorit tjetër, përvoja që kandidati e ka fituar në përpunimin e problemeve shkencore, duhet cekur se ndaj asaj përvoje duhet të matet edhe pesha e punimit që merret për përpunim. Kjo d. t. th. se kandidati nuk guxon të zgjedhë ndonjë pyetje të ndërlikuar e të rëndë nëse nuk ka mjaft dije dhe përvojë paraprake, nëse tashmë nuk i ka parë forcat e veta në përpunimin e problemeve më pak të ndërlikuara, më të lehta. "Sa përpjekje dhe forcë shpirtërore nevojiten që njeriu një tërësi të madhe në vete ta rregullojë dhe rumbullakojë, e çfarë fuqie duhet dhe çfarë kushtesh të qeta, të papërziera të jetës, që kjo të shprehet drejtë në një frymë" - ka thënë Gëte në bisedë me Ekermanin.³⁵

Vetvetiu kuptohet që kandidati duhet të ketë edhe njohje më të gjerë të disiplinës dhe lëmisë shkencore nga e cila është marrë tema; që më thellë dhe më gjerësisht ta njohë periudhën e caktuar, t'i njohë gjuhët në të cilat janë shkruar burimet kryesore dhe literatura, e kjo jorralë d.m.th. më shumë gjuhë evropiane: anglishten, rusishten, frangjishten, gjermanishten, latinishten etj.

Nuk është pa interes të përmendet edhe ajo se, është e dëshirueshme që temën, nga vetë fillimi, ta kufizojmë, e sipas mundësisë edhe ta precizojmë. Por, formulimi i saj nuk guxon, në gjithë këtë, të jetë tepër i

³⁵ J. P. Eckermann, o. c., fq. 9. - Duke e pasur, pos tjerash, edhe këtë parasysh, rregullat tona të reja ligjore për aritjen e doktoraturës nga kandidati si kusht kërkojnë punimet paraprake: magistraturën me punimin e magistraturës, punimet e publikuara shkencore ose rezultatet e aritura shkencore në praktikë.

rreptë; përparësia e një teme jo saktësisht të precizuar, një teme më të gjerë, më të përgjithshme, qëndron në atë që ajo autorit i ofron mundësi ta tubojë materialin në plan të gjerë, që të njoftohet më gjithanshëm dhe më thellë me lëmin e gjerë nga i cili është marrë tema, që ta “ruaj frymën e vet të hapur” derisa mjaftueshëm autori nuk zotëron me materialin e temës. Me fjalë tjera, derisa tema në tërësi nuk është përpunuar dhe derisa punimi nuk e ka fituar formën e vet përfundimtare; e sidomos në fazën e parë të përpunimit të vet, tema nuk mundet dhe nuk guxon të konsiderohet rigorozisht e kufizuar, as sipas përmbajtjes, as sipas formës. Gjatë përpunimit, e madje edhe pasi të formësohet punimi, mund të imponohet domosdoshmëria që ai të ngushtohet ose të zgjerohet, që në masë më të madhe apo më të vogël të ndërrohet, që varet nga një numër jo i vogël i faktorëve. Nuk duhet, me fjalë të tjera, të humbet para syve fakti që, ndërmjet paralajmërimeve të para të një problemi shkencor të rëndësishëm, që do të mund të shërbente si lëndë e përpunimit dhe formulimit definitiv, preciz të saj, rruga shpeshherë është e gjatë dhe e mundimshme: ky është një proces i tërë në të cilin problemi i vërejtur ashpërsohet, ngushtohet ose zgjerohet, precizohet, derisa nuk e fiton formën e vet definitive, formulimin e vet preciz, i cili më pak apo më shumë tërësisht dhe saktë përfshin dhe përcakton përmbajtjen e punimit shkencor.

Kur është fjala për tezën (e doktoraturës ose të magistraturës) shtrohet edhe një pyetje: kush ta shtojë temën - autori apo arsimtari? Në këtë pyetje nuk është e mundur të jepet përgjigje e gjithëpranishme. Nganjëherë vetë autori është në gjendje që, me ndihmën e arsimtarit ose pa ndihmën e tij, ta bëjë zgjedhjen. Në rastet tjera, temën e cakton vetë arsimtari. E megjithatë, në rastin e dytë a nuk guxon të veprojë “në mënyrë diktatoriale” dhe temën ta imponojë me dhunë, duke mos pasur llogari për afinitetin dhe shijen e vetë kandidatit: në anali-

zën skajore, zgjedhja e temës duhet të jetë çështje e marrëveshjes së dyanshme.

Udhëheqësi, po ashtu, nuk guxon ta caktojë temën ose ta miratojë lehtëzi, me nguti. Para se ta bëjë këtë, është i obligueshëm që gjithanshëm ta shqyrtojë dhe të bindet se ajo, jo vetëm që nuk është e përpunuar por që edhe është e përshtatshme për përpunim, kurse kandidati, se është i përshtatshëm për të. E që këtë të jetë në gjendje ta caktojë, arsimtari duhet që më gjerësisht dhe më thellësisht ta njohë si kandidatin ashtu edhe problematikën për të cilën tema ka të bëjë, dhe që mirë të zotërojë me metodologjinë e lëmit të caktuar shkencor: vetëm në atë rast do të mund ta përcjellë punën e kandidatit pa përvojë dhe t'i ofrojë ndihmën që i nevojitet dhe të cilën ai e pret prej tij.

Kjo ndihmë e arsimtarit është e domosdoshme sidomos në fillim: arsimtari do t'i ndihmojë kandidatit që në mënyrë sa më të saktë ta formulojë temën, do ta përu dhë në çfarë drejtimi ta gjurmojë dokumentacionin, dhe cila metodë është më e përshtatshme për përpunimin e problemit të caktuar. Por, ndihma është e nevojshme edhe më vonë: që të jetë i njoftuar për rrjedhën dhe përparimin e tezës, arsimtari me kandidatin do të mbajë takime të kohëpaskohshme. Ato takime, sipas mendimit të një hulumtuesi janë, të domosdoshme sidomos në këto raste: 1) kur tema tashmë është fiksuar dhe zgjedhur; 2) kur literatura për lëndën është kontrolluar dhe bibliografia punuese është hartuar; 3) kur plani i veprës është skicuar; 4) kur kandidati ka ardhur deri te rezultatet (përfundimet) e caktuara; 5) kur koncepti i tezës tashmë është shkruar; 6) kur të paraqitet çfarëdo vështirësie e papritur.³⁶

Detyrë e veçantë e arsimtarit, përkatësisht e udhëheqësit, do të jetë që kandidatin kohë pas kohe ta trimëro-

³⁶ Almack, o.c., p. 50.

jë, motivojë. Me fjalë të tjera, përvoja ka treguar se te kandidatët e rinj që punojnë punim më të vëllimshëm, siç është për shembull teza, mjaft të shpeshta janë çastet e dëshpërimit, madje dekurajimit, dhe në ato çaste të dobësisë atij mund t'ia kthejë besimin dhe ta trimërojë vetëm arsimtari, udhëheqësi.

Në lidhje me zgjedhjen e temës rrugët e ndryshme që shpiejnë deri te gjetja e ndonjë problemi të përshtatshëm e të papërpunuar janë: arsimtari, ligjëratat e tij dhe sugjestionet, bisedat me ekspertin e vjetër, librat dhe artikujt në publikacionet e ndryshme; materiali nga kongreset dhe simpoziumet, tezat e doktoraturës etj. Mirëpo, mbi të gjitha janë kureshtja personale, interesi dhe iniciativa, që e nxisin hulumtuesin e ri ta fillojë hulumtimin e ndonjë problemi që e 'mundon'. Këtë në mënyrën më të saktë e thotë Almeku: "Pothuajse është e sigurt se gjatë studimeve do të paraqiten probleme të reja."³⁷

Pasi që është zgjedhur tema, autori e përqëndron tërë vëmendjen e vet në te, ia kushton të gjitha mendimet e veta, mendon për të në çdo moment dhe në çdo vend; ditën dhe natën, në shtëpi dhe në rrugë, në tryezë dhe në banjo, në shëtitje dhe në udhëtim. Për të thuhet edhe nuk ekziston asgjë tjetër pos problemit për të cilin është përcaktuar dhe të cilin duhet që sa më parë dhe sa më me sukses ta përpunojë. E që ta arrijë këtë, është i detyruar të bëjë, nganjëherë gjatë disa viteve, jetë plot heqje dorë, plot keqardhje, shqetësim, vuajtje, drojë, të cilat në mënyrë tejet të ulrë i ka përshkruar Jan Parandovski:

Duke marrë vendimin, që i përfundon hamendjet e gjata, let-rari me frikë i qaset punimit që do t'i marrë shumë vite. Dubet të përshëndetet me të gjitha ato që e kanë tërbequr dhe që do t'i imponohen gjatë asaj kohe, shpesh do të ankohet që nuk është preokupuar me ndonjë temë tjetër prej qindra prej tyre, do të ketë çaste të

³⁷ Po aty, p. 48.

idhëta kur secila nga temat tjera do t'i duket më e mirë dhe më e vlefshme, do të detyrohet t'i hedh poshtë kërkesat e ditëve të reja dhe ideve të reja, duke i lënë ta presin rendin e vet ose duke i hedhur në harresë.³⁸

Nëse dijenitë dhe informatat e autorit për lëndën nuk janë më të gjera dhe më të thella, është e preferueshme që ai paraprakisht të lexojë së paku një ose dy vepra të përgjithshme nga lëmi shkencor, me të cilin ka të bëjë lënda e punimit të tij. (Për ato vepra mund të mësojë, përveç tjerash, edhe nga bibliografia e shkrimeve për atë lëndë në ndonjë enciklopedi profesionale ose të përgjithshme). Në këtë mënyrë ai vetes do t'i krijojë platformë më të fortë, "prapavijë" (background), për grumbullimin e materialit, themele më të forta mbi të cilat do të mund ta ndërtojë ndërtesën.

Që puna në përpunimin e temës të rrjedh pa pengesa më të mëdha, që të jetë sa më e organizuar, paraprakisht është e domosdoshme të kryhen disa punë përgaditore. Këtu, në rend të parë, duhet të bëhet hartimi i përkujtuesit në të cilin do të shënohen disa detyra të drejtpërdrejta, sikur: cilat biblioteka duhet kontrolluar, cilët doracakë (enciklopedi, biografi etj.) të përgjithshme dhe profesionale duhet konsultuar, me cilin ekspert duhet të bisedohet, cili libër i përgjithshëm ose profesional për atë pyetje ose për atë lëndë të përgjithshme duhet të lexohet etj. Për këtë qëllim, më së miri dhe më praktike është, që menjëherë në fillim të caktohet fletore e veçantë, e cila do të jetë si një lloj i ditarit të punës: pos detyrave të përmendura të drejtpërdrejta, në fletore rregullisht do të shënohen të gjitha që brenda një dite duhet të bëhen, sikur edhe të gjitha problemet që dalin në lidhje me punën dhe përpunimin e temës. Përvoja personale më ka treguar se ditari i tillë mund të ndihmojë dhe është tejet i dobishëm gjatë punës në një temë: në të shënoj çdo

³⁸ Alhemija reçi, p. 220.

mendim që gjatë punimit më paraqitet, në lidhje me çfarëdo pyetje që duhet zgjidhur, dhe gjërat që më vonë duhet të shikohen, të kërkohen, të verifikohen në ndonjë doracak e të ngjashme.

Para se të kalohet në vetë sajimin e punimit shkencor, medoemos duhet të skicohet, së paku në vija më të gjera, plani i punës shkencore (ose plani i hulumtimit), në të cilin do të përfshihen çështjet elementare që do të trajtohen në punim. Ky do të jetë projekti i parë i planit, apo plani paraprak i punimit, i cili thjeshtë do të përmbajë regjistrin e pyetjeve dhe nënpyetjeve të hedhura për hulumtim dhe i cili gjatë etapave të mëvonshme të përpunimit të temës, sidomos gjatë grumbullimit të dokumentacionit, do të plotësohet, do të hartohet, do të precizohen dhe do të përpunohet derisa ta fitojë formën e vet përfundimtare. (As kjo formë *përfundimtare* e planit nuk guxon, në asnjë rast, të kuptohet në mënyrë aq të ngurtë dhe se prej tij nuk mund të hiqet dorë nëse paraqitet nevoja). Por megjithatë, qoftë edhe i përgjithshëm, ky plan sigurisht do t'i shërbejë autorit si udhërrëfyes në etapat e ndryshme të hartimit të punimit, veçanërisht gjatë grumbullimit të dokumentacionit. Me fjalë të tjera, në atë rast ai nuk do t'i grumbullojë faktet dhe mendimet që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me temën, nuk do t'i fusë shënimet për hollësitë e parëndësishme që punimin do ta bëjnë të stërgjatur e të shkapërderdhur, dhe në të cilat më vonë vështirë do të gjendet me rastin e rregullimit dhe sistematizimit të materialit dhe hartimit të planit përfundimtar.

Në pajtim me këtë, plani i parë, në të vërtetë ai paraprak, duhet t'i shërbejë autorit si udhërrëfyes për organizimin sistematik të hulumtimeve, derisa plani i dytë, përfundimtar, ka për qëllim që t'i bëhet udhëheqës, instrument për parashtrimin metodik dhe të argumentuar të materialit të grumbulluar dhe të rezultateve të hulumtimeve.

III. Hulumtimi i dokumentacionit

Në procesin e hartimit të ndonjë përmbajtjeje, shkrimi, punimi shkencor, retoristët rëndom dallojnë tri etapa kryesore: 1) grumbullimi i dokumentacionit (invencioni), d.m.th. gjetja dhe grumbullimi i materialit, përkatësisht i informatave shkencore (fakteve, ideve, argumenteve, vrojttimeve e të ngjashme) që i kontribuojnë zgjidhjes së problemit shkencor të shtruar; 2) sistematizimi i materialit (kompozicioni), d.m.th. rregullimi dhe organizimi i informatave të grumbulluara shkencore në një tërësi; 3) redigjimi i materialit të sistematizuar (shprehja), d.m.th. gjetja e formës dhe e shprehjes më të përshtatshme dhe më të qëlluar për informatat e grumbulluara e të rregulluara shkencore.

Në praktikë, këto tri etapa të procesit krijues, pak a shumë, reciprokisht përzihen, gërshetohen, zhvillohen po aq njëkohësisht sa edhe suksesivisht, njëra pas tjetrës. Kështu, me rastin e grumbullimit të materialit, duke e shënuar ndonjë fakt, vrojtim, ide, shënim, autori tashmë që më parë e di, në masë më të vogël ose më të madhe se ku do ta vendosë atë fakt, ide, vrojtim, shënim; kjo d.m.th. që në këtë rast sistematizimi i materialit po zhvillohet në të njëjtën kohë kur edhe grumbullimi i tij, se kompozicioni është simultan me invencionin. Por megjithatë, për shkak të shqyrtimit më të lehtë, ndërmjet tri etapave të përmendura bëhet ndarja e qartë.

Në gërshetimin e simultanitetit dhe suksesivitetit të këtyre tri veprimeve, pas të tjerëve ka dhënë shenjë edhe G. Lanson:

Të gjitha këto veprime janë simultane aq sa edhe suksesive, dhe nëse mendja jonë mund të kalojë nga i pari në të dytin, shkakku është në atë që veprimi i dytë gjendet tashmë në të parin, që ai e vazhdon dhe e përkryen. Invencionin domosdo e përcjell sistematizimi i caktuar i pjesëve, dhe ai përcaktohet për disa shprehje: është e pamundur të gjendet ideja për çfarëdo lënde, duke mos u përcaktuar tashmë edhe për vendin që do t'ia japim dhe shprehjet që do ta shprehin. Nuk ka aso përmbajtjeje, sado qoftë ajo e papërpunuar, që nuk do ta kishte formën e vet; po ashtu disa ide, përmbajtje, nuk mund të zënë fill në vetëdije pa ndonjë formë, që d.m.th. pa ndonjë kompozicion dhe stil.³⁹

Ne do t'i shqyrtojmë me radhë secilën nga këto tri etapa, me të gjitha pyetjet dhe problemet tjera që janë të lidhura me to dhe, përgjithësisht, me hartimin e një veprë shkencore.

A. Zbulimi i dokumenteve

Detyra e parë që imponohet në procesin e hartimit të një punimi shkencor është hulumtimi (gjurmimi) i dokumentacionit, respektivisht zbulimi i dokumenteve. Dokumentacionin këtu duhet kuptuar në kuptimin më të gjerë: si përmbledhje e të gjitha atyre informacioneve shkencore, pjesëzave të materialit, elementeve, nga të cilat do të ndërtohet, do të përbëhet punimi shkencor, të gjitha atyre pjesëve përbërëse të cilat në çfarëdo mënyre do të shërbejnë si tulla për ndërtimin shkencor. Këto janë, në të shumtën e rasteve, faktet dhe mendimet, vrotimet, argumentet e të ngjashme, të nxjerra nga burime të ndryshme: dorëshkrimet dhe shkrimet e botuara (librat

³⁹ Gustave Lanson, o. c., p. 109.

dhe artikujt në revista dhe broshura), ose në bazë të hulumtimeve vetjake (dokumenteve arkivore, hulumtimeve në terren, eksperimenteve laboratorike, shikimeve dhe ekzaminimeve klinike, anketave të ndryshme me anë të pyetësorit, intervistimit e të ngjashme), sikur edhe në bazë të përsiatjeve dhe supozimeve personale etj.

Në pajtim me këtë, natyra e dokumentacionit do të varet nga natyra e lëndës, disiplinës shkencore, lëmisë. Kështu, për shembull, kur punohet tema nga lëmi i shkencave historike, dokumentacioni, përveç literaturës së lëndës, mund të përfshijë: kronika të ndryshme, ditarë, dëshmitë e pjesëmarrësve në ndodhitë e ndryshme (literaturën e memoareve), deklaratat e dëshmitarëve, reportazhet dhe artikujt e botuar në shtypin ditor dhe periodik, shkresat, raportet dhe vendimet e ndryshme zyrtare, korespondencën etj. - me një fjalë, çdo gjë që në ndonjë mënyrë mund të na zbulojë çkado qoftë për të kaluarën e njeriut, me aspekt të posaçëm të përvojës së tij të kaluar, që ne vetvetes tashmë ia kemi vënë si detyrë ta hulumtojmë.⁴⁰

Sipas natyrës së lëndës dhe disiplinës shkencore, dokumentacioni për ndonjë shkrim nxirret nga burime të ndryshme: nga përvoja personale që te ne e ka grumbulluar mbamendja dhe përvoja e të tjerëve, të komunikuar në forma të ndryshme për të cilat tashmë është bërë fjalë.

Përvoja personale, personaliteti vetjak si burim i informacioneve (fakteve, ideve, argumenteve) paraqet, sipas rregullit, burimin më të sigurt. Por kjo përvojë (idetë etj.) gjendet në vetëdijen e njeriut rëndom në gjendje katike dhe elementet e saj duhet t'i rregullojë, kanalizojë në një drejtim intelektit dhe vullnetit. Me fjalë të tjera, për temën është e nevojshme të përsiatet intenzivisht, në mënyrë të gjithanshme të analizohet, të zërthehet tërë-

⁴⁰ L'Histoire et ses méthodes (Encyclopédie de la Pléiade, 1961), p. 1511. Krlis. edhe fq. 1075.

sia në pjesët përbërëse, të kuptohet ideja e saj themelore, të veçohen idetë që me të janë në lidhje të ngushtë, të gjen-den elementet që, në realitet, edhe e përbëjnë lëndën. Për këtë qëllim duhet, siç thotë G. Lanssoni, “të kemi qëndrim ndaj vetes sikur ndonjë gjyqtar hetues që dëshiron që të vërtetën ta shkëpusë nga ndonjë i pandehur heshtak”.⁴¹

Nganjëherë, pas përsiatjes së gjatë apo të shkurtër, autori nxjerr mendimet vetëm nga vetja, “nga koka” (për shembull, kur është fjala për letrën mikut, artikullin për gazetë, eseun e të ngjashme), dhe në atë rast ato rëndom rrjedhin spontanisht, ëmbëlsisht, duke fituar menjëherë në letër pak a shumë formën e vet përfundimtare. Por, sadoqoftë përvoja personale e njeriut të jetë e gjerë dhe e pasur, sado të ketë personalitet të pasur dhe jetë të bren-dshme, ai kurrë vetëm në vete nuk mund të gjejë tërë materialin e nevojshëm për përpunimin e ndonjë proble-mi shkencor; marrë në përgjithësi, përjetimet dhe përvo-jat personale nuk janë të nevojshme. Njeriu në jetë ka re-lativisht pak mundësi që vetë të përjetojë, ndiejë, shohë, dëgjojë. Së këndejmi edhe për përpunimin e temës së ngushtë nga ndonjë lëmi shkencore, është shpesh e do-mosdoshme të shfrytëzojë edhe përvojën e huaj. Kjo d.m.th. kur është fjala për hartimin e ndonjë punimi shken-cor, pothuaj gjithnjë është e domosdoshme të nxirren in-formatat shkencore nga burimet e ndryshme, për të cilat duhet gjurmuar, pasi që hulumtimi shkencor zë fill në do-kumentacion, pa të cilën edhe nuk ka, as që mund të ketë, punë shkencore në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kurse ky dokumentacion duhet, natyrisht, të jetë solid, i tubuar me vëmendje dhe sa më shumë që është e mundur, nga dora e parë, pa marrë parasysh se për cilin burim bëhet fjalë.

Burimet nga të cilat e nxjerrim materialin rëndom ndahen, *grosso modo*, në dy lloje: parësore dhe dytësire. Në

⁴¹ O. c., fq. 46.

të parin bëjnë pjesë burimet e drejtpërdrejta, nga dora e parë. Këto janë, për shembull, në *shkencat humanitare*, veprat origjinale krijuese, veprat nga lëmenjtë e letërsisë dhe artit, rezultatet e llojeve të ndryshme të anketave (me anë të pyetësorëve, intervistave e të ngjashme), jetëshkrimeve, ditareve dhe kujtimeve të pjesëmarrësve ose të dëshmitarëve të ndonjë ndodhie, raportet nga gazetatat dhe revistat periodike, raportet e komisioneve, institucioneve dhe organizatave (shkencore, arsimore, administrative etj., materiali i ndryshëm arkivor, korrespondenca, etj.; në *shkencat natyrore* - këto janë raporte për hulumtimin e ndryshëm eksperimental etj.⁴² Burimeve dytësore u përkasin shkrimet e ndryshme (librat, artikujt, studimet e të ngjashme), të punuara në bazë të burimeve parësore, me një fjalë, ajo që quhet *literaturë për lëndën*. Burimet mund të jenë edhe terciare, të dorës së tretë; këto rëndom janë shkrimet të punuara në bazë të burimeve dytësore, literaturës për lëndën, sikur që janë, për shembull, disa artikuj, libra popullarizues e të ngjashme. Nga të gjitha ato burime më të rëndësishëm janë, gjithsesi, burimet e llojit të parë, burimet parësore. Duke sjellë materialin e ri, nga dora e parë, ato në punimin shkencor fusin njëfarë risie dhe freskie dhe i japin origjinalitet. Por as burimet dytësore, sipas rregullit, nuk janë pa vlerë, që varen edhe nga mënyra e interpretimit të fakteve, rezonimit, cilësisë së përfundimeve; madje, duke ofruar interpretimin, idetë, mendimet, qëndrimet, sugjerimet për veprimet metodologjike, burimet dytësore nganjëherë mund të kenë një-

⁴² E. S. M. Gomer dhe Fr. Cordasco (Research and Report writing, pp. 27-28) japin rendin vijues të burimeve parësore sipas rëndësisë së informatave dhe fakteve të nxjerra prej tyre: eksperimentet, intervistat dhe pyetësorët; tezat e doktoraturës dhe monografitë e shpallura në revistat profesionale (sic!); shkresat, ditarët dhe autobiografitë; punimet origjinale krijuese në lëmin e letërsisë dhe artit; raportet e institucioneve të ndryshme; gazetatat. Por për radhën dhe përpatësinë e tyre do të mund të diskutohej.

farë përparësie edhe ndaj burimeve parësore. Është vërejtur saktë se në shkencë mund të ketë përparim vetëm nëse hulumtimet e ndonjë hulumtuesi kombinohen me punën e hulumtuesve paraprakë. Së këndejmi nuk duhet nënçmuar dhe mospërfillur as burimet dytësore, respektivisht literaturën e lëndës: jo vetëm për atë që ajo në realitet paraqet pikën nismëtare për hulumtimet personale por, sidomos, së këndejmi që ajo jorrallë shërben si përrudhëse për hulumtimet e reja.

Të përmendim edhe që disa këtë etapë e quajnë heuristikë (sipas fjalës greke *εὐρίσκω* = gjej, gjendem) kjo, në realitet, është shkenca (dhe shkathtësia) e hulumtimit, d.m.th., grumbull i veprimeve të ndryshëm metodologjike dhe teknike që duhet aplikuar që të zbulohen dokumentet e ndryshme relevante për lëndën e caktuar.

B. Hartimi i bibliografisë së punës

Që ta dijë cilat vepra, artikuj, dokumente e të ngjashme duhet t'i studiojë, t'i përpunojë, hulumtuesi duhet t'ia hartojë vetes paraprakisht bibliografinë. Kjo është e a. q. *bibliografi e punës*, paraprake, orientuese, ndryshe nga bibliografia përfundimtare, që hartohet në fund dhe e vendos pas tekstit të punimit shkencor. E vërteta, hulumtuesi njoftohet me literaturën profesionale për ndonjë pyetje më së shpeshti në mënyrë empirike, duke lexuar ndonjë vepër, me anë të vërejtjeve burimore, dokumentare (fusnotave, referencave), që përveç tjerash, udhëzojnë në veprat dhe shkrimet tjera profesionale nga lëmi i caktuar shkencor dhe për pyetjen e caktuar. Për fillim nganjëherë mjafton të njihen vetëm dy-tre shkrime dhe vepra për ndonjë pyetje, dhe regjistrat bibliografikë

si dhe referencat nga ato shkrime do të udhëzojnë në shkrimet dhe veprat e reja që do të duhej konsultuar dhe studiuar. Gjatë kësaj, rol jo të vogël luan rasti, sikur edhe erudicioni dhe 'sensi' i shkencëtarit: duke u marrë, me vite të tëra, me disa probleme shkencore, degë dhe disiplina shkencore, punëtori shkencor shkallërisht bëhet një lloj i enciklopedisë së gjallë profesionale. Por, në kohën tonë kur ekzistojnë aq mjete tjera për dokumentacion, shumë më të përsosura nga mbamendja e shkencëtarit (doracakët bibliografikë, katalogët bibliotekarë e të tjera), madje as punëtori i formuar shkencor, e sidomos eksperti i papërvojë dhe i ri, nuk guxon të mbështetet në rast dhe empiri, as të kufizohet në to, sepse mund të ndodhë që t'i ikin shkrimet dhe dokumentet e rëndësishme dhe të bëjë lëshime më të rënda. Ai duhet *medoemos pra*, t'i njohë burimet dhe instrumentet e ndryshme që do t'i mundësojnë që të njoftohet në lidhje me temën e tij.

Hartimi i bibliografisë së punës për ndonjë pyetje nuk është i thjeshtë as i lehtë. Me fjalë të tjera, bibliografia nuk është kompilacion i rëndomtë: në hartimin e saj autori duhet të tregojë si domethënien e zhvilluar kritike, ashtu edhe këmbëngulësinë e madhe në kërkimin e burimeve të informatave shkencore. Gjatë kësaj ai nuk guxon as të lëshojë ndonjë burim më të rëndësishëm të dokumentacionit, as të humbet në gjurmimet e gjata të panevojshme. Hartimin e bibliografisë së punës e rëndon edhe fakti që autori disa libra dhe shkrime duhet t'i lexojë, ose së paku t'i shfletojë, që të bindet se a kanë të bëjnë ato me problemin e tij, meqë që për të nuk mund të përfundohet as të parandjehet gjithnjë nga titujt.⁴³

⁴³ Për shembull, duke punuar në librin tim 'Francuski putnici u Bosni na pragu XIX stoljeca i njihovi utisci o njoj' (Sarajevo, Veselin Masleša, 1966), më është dashur t'i kontrolloj të gjitha "udhëtimet" në Lindje dhe vendet jugosllave, që të konstatoj se ndonjëri edhe prej atyre udhëtarëve a ka udhëtuar edhe në Bosnjë.

Që ta hartojë regjistrin paraprak bibliografik të shkrimeve për temën që dëshiron ta përpunojë, autori duhet të gjurmojë për ato shkrime nëpër burimet e ndryshme të informacioneve: doracakë enciklopedikë, të përgjithshëm dhe specifikë (varësisht nga gjerësia dhe vëllimi i dijes së vet për temën;⁴⁴ pastaj nëpër bibliografite e llojeve të ndryshme, sikur edhe nëpër shënimet bibliografike të botuara në revista dhe publikacione tjera, sidomos në të a. q. 'revistat referative', nëpër katalogët e ndryshëm (sidomos katalogët e përgjithshëm të publikuara) dhe indekset e bibliotekave shkencore,⁴⁵ (popullore, universitare, të fakulteteve, të instituteve e të ngjashme), nëpër katalogët e librarive të mëdha, sikur edhe nëpër qendrat e ndryshme për dokumentacion.

Në rend të parë duhet ndërgjegjshëm të kontrollohen enciklopeditë kryesore (tonat dhe të huajat, të përgjithshmet dhe të veçantat), doracakët bibliografikë (tonat dhe të huajt), sikur edhe doracakët tjerë fundamentalë. Ata nuk janë, sipas rregullit, pa ndonjë mungesë, prej të cilëve një është mjaft i rëndë dhe ajo që publikimi i tyre rëndom zgjatë me vite të tëra dhe janë të panivelizuar; derisa vëllimet më të reja ofrojnë gjendje dhe të dhëna më të reja të ndonjë vepre dhe pyetjeje, të parët mund të jenë tashmë të vjetëruar. Mirëpo, ata kanë, përveç terash, edhe atë aspekt të mirë që, krahas njoftimeve

⁴⁴ Në qoftë se njohja e autorit e lëmisë shkencore nga e cila dëshiron ta japë punimin shkencor nuk është e gjerë, ai mundet me qëllim të njoftimit, që më afërsisht të njoftohet me "prapavinë" e temës, të konsultojë: 1) Artikullin për temën e caktuar në ndonjë enciklopedi të përgjithshme; 2) Artikullin për temën e njëjtë në ndonjë enciklopedi profesionale; 3) Ndonjë vepër të përgjithshme (libër shkollor e tngj.) nga ajo lëmi nga ndonjë ekspert i dalluar. Në këtë mënyrë në të njëjtën kohë do të mësojë edhe bibliografinë më të domosdoshme për lëndën që i intereson.

⁴⁵ Në çdo bibliotekë të madhe rëndom ekziston lokali i veçantë për doracakë. Aty gjenden enciklopeditë e ndryshme të përgjithshme dhe të veçanta, doracakët biografikë, fjalorët, veprat e përgjithshme nga disa lëmenj, bibliografite, indekset, katalogët e shtypur e të ngj.

themelore në formën e përgjithshme, sjellin edhe të dhënat më të rëndësishme bibliografike për ndonjë pyetje. Këta doracakë enciklopedikë i qëndrojnë gjithnjë në dispozicion lexuesit. Që të njoftohet se cili prej tyre gjendet në ndonjë bibliotekë, lexuesi duhet ndërgjegjshëm t'i kontrollojë.

Përveç doracakëve enciklopedikë dhe biografikë, është e domosdoshme të kontrollohen edhe bibliografitë e ndryshme, tonat dhe të huajat, të përgjithshmet dhe të veçantat, retrospektive dhe rrjedhëse që bëjnë pjesë ndër instrumentet më të rëndësishme për grumbullimin e dokumentacionit. Bibliografitë retrospektive, që përfshijnë veprat dhe shkrimet për çështjen e caktuar, të publikuara në periudhën e dhënë, hulumtuesi do t'i gjejë në enciklopeditë speciale, që rëndom sjellin, pas artikullit të caktuar, bibliografinë përkatëse, në veprat e karakterit të përgjithshëm nga disiplina e caktuar (historia e përgjithshme, historia e letërsisë etj.), në tezat e doktoraturës,⁴⁶ në përmbledhjet e kongreseve,⁴⁷ në regjistrimet e ndryshme bibliografike (regjistrimet dhe repertorët e artikujve nga revista⁴⁸ e të ngjashme, në regjistrimet e dorëshkrimeve dhe librave etj. Sa u përket bibliografive rrjedhëse, ato i publikojnë institutet e posaçme bibliografike,

⁴⁶ Tezat e doktoraturës, me regjistrat e vet të vëllimshëm bibliografikë, paraqesin burim sidomos të çmueshëm për dokumentacionin. Së këndejmi shumë universitete në botë botojnë regjistrimet dhe rezymetë e tezave të mbrojtura të doktoraturës.

⁴⁷ Materiali nga kongresi, simpoziumi e të ngjashme, paraqet po ashtu burim të çmueshëm për dokumentacionin. Aq më parë që ai buron shpesh prej penave të ekspertëve më të dalluar në ndonjë lëmi shkencore, që janë në gjendje të japin, në mënyrë kompetente, gjendjen e ndonjë pyetjeje (status questionis). Referatët dhe komunikimet nga kongresi jorrallë në hapësirë të vogël ofrojnë material të madh, që është rezultat i hulumtimeve shumëvjeçare.

⁴⁸ Shfrytëzimin e doracakëve të ndryshëm bibliografikë dhe të tjerë, me qëllim të hartimit të bibliografisë së punës, e rëndon ajo që ata doracakë janë hartuar me sisteme dhe kritere të ndryshme, tend. Së këndejmi, para se t'i qaset përpunimit të doracakut, duhet qetësisht dhe vëmendshëm të studiohet sistemi i tyre i regjistrimit të veprave dhe njësive; ky studim në masë të konsiderueshme do ta lehtësojë kërkimin e shkrimeve të dëshiruara, njësive bibliografike, materialeve.

kurse jorrallë i sjellin edhe revistat shkencore. Këta të fundit, që po ashtu është me rëndësi, publikojnë edhe recensione - kritike dhe analitike - në punimet e ndryshme, ku edhe këto recensione gjithashtu mund të shërbejnë dobishëm për hartimin e bibliografisë së punës për ndonjë temë, kurse janë të mirëseardhura edhe për orientim të leximit.

Më në fund, gjatë hartimit të bibliografisë së punës me dobi jo të vogël mund të jenë sidomos bibliotekat, me katalogë të llojlojshëm, regjistrimet dhe indeksat e veta. Në këto institucionet mjaft të vjetra - që kanë ekzistuar, siç pohojnë disa qysh rreth mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, kurse në Romë në kohën e mbretit Adrianit, në shekullin e dytë, kanë qenë njëzet e nëntë - në heshtje pushon tërë dija njerëzore. Ato përmbajnë, në të vërtetë, 'historinë e shënuar njerëzore' dhe paraqesin kushtin themelor për ndonjë punim serioz shkencor hulumtues. Ndonjë bibliotekë, mirë e furnizuar me literaturë profesionale dhe shkencore, mundëson hulumtimin në të gjitha shkencat, kurse në disa prej tyre ajo është laboratorit dhe punësoria kryesore e hulumtuesit. Së këndejmi, hulumtuesi i ri duhet të mësojë të shërbehet me një bibliotekë shkencore dhe me fondin e saj të çmueshëm librar. Saktë thotë një shkencëtar: "Dallimin ndërmjet hulumtuesit të mirë dhe të keq nuk e dëfton ... shkathtësia e tyre e shfrytëzimit të bibliotekës, por kjo shkathtësi, sigurisht është komponenta kryesore e shkëlqyeshmërisë."⁴⁹

Tërë thesari libror i një biblioteke është i shkruar në katalogë, të cilët në bibliotekat më të mëdha shkencore (popullore, universitare, të fakulteteve, instituteve e të ngjashëm) janë shumëllojesh.⁵⁰ Më të shpeshtat janë si vijon:

Katalogu emëror: - i hartuar me rendin alfabetik sipas shkronjave fillestarë të emrave (me saktë mbiemrave) të au-

⁴⁹ I. Barun and H. Graff, *The Modern Researcher*, p. 87.

⁵⁰ Në bibliotekat e ndryshme ekzistojnë sisteme të ndryshme të katalogjizimit të librave dhe shkrimeve. Së këndejmi lexuesi që synon që gjatë kohë të punojë në ndonjë bibliotekë, duhet që në vetë fillimin të njoftohet me atë sistem.

torëve. Në të kërkohen librat kur emrat e autorëve janë të njohur. Po ashtu, në të rëndom futën edhe veprat anonime.

Katalogu i lëndës. - i hartuar sipas rendit alfabetik sipas njësive të lëndës (d.m.th. sipas fjalëve me të cilat më së ploti dhe në mënyrë më adekuate është shprehur përmbajtja e veprës. Ky katalog është më i dobishëm për hulumtuesin: ai i tregon cilët autorë dhe vepra e shtjellojnë çështjen që i intereson. Ky mund të shërbejë në mënyrë të dobishme për hartimin e bibliografisë së punës, sidomos kur mungojnë bibliografitë profesionale për ndonjë lëndë.

Katalogu profesional. - në të cilin në skeda janë katalogjizuar shkrimet sipas shkencave dhe degëve shkencore: Katalogët e një dege shkencore, për shembull, përmbajnë të gjitha shkrimet që merren me disa lëmenj të asaj dege dhe të cilat gjenden në bibliotekë.

Katalogu titullar. - i hartuar me rendin alfabetik sipas titujve të librave dhe revistave, dhe këtë ndaras për libra dhe ndaras për revista të lidhura në fletore sipas viteve.

Katalogu qendror. - që përmban fondet librare të shumë bibliotekave të ndryshme në vend. Ai për punëtorin shkencor është shumë i dobishëm, duke e marrë parasysh që ky nga ai mund të mësojë edhe për veprat që gjenden në bibliotekat jashtë vendit të tij të qëndrimit ose të punës. Një katalog qendror të tillë të librave dhe revistave të huaja e udhëheq *Instituti bibliografik i Jugosllavisë* në Beograd.

Të gjithë këta katalogë përbëhen prej skedave (kartuqëve) të madhësisë standarde (7,5 x 12,5), më së shpeshti sipas sistemit decimal të klasifikimit të Djujtit (Melvil Dewey). Sipas këtij sistemi të klasifikimit që e ka përvetësuar shumica e bibliotekave në botë, e mbarë dituria njerëzore, është ndarë në dhjetë grupe themelore, dhe këtë: veprat e përgjithshme (0); filozofia (1); religjioni, me teologjinë (2); shkencat sociale dhe shoqërore (3); filologjia me linguistikën (4); matematika dhe shkencat natyrore (5); shkencat aplikative, medicina, teknika (6); arti, me fotografinë, lojën, sportin (7); letërsia artistike (8); hi-

storia me gjeografinë dhe biografisë (9). Secili nga këto grupe më tej ndahet në nëngrupe, kurse çdo nëngrup në nëngrupe të reja etj.⁵¹

Një skedë katalogjike përmbanë më pak apo më shumë të dhëna bibliografike, që varet, në rradhë të parë, nga parimet e aprovuara të katalogjizimit në ndonjë biblioteke shkencore. Më të shpeshtat janë si vijon: sinjatura, mbiemri dhe emri i autorit (Biblioteka e Kongresit në Washington shpesh pos emrit e kyç edhe datën e lindjes e të vdekjes së autorit, nëse ka vdekur), titullin e veprës, emrin e botuesit, vendin dhe datën e botimit, emërtimin e përmbledhjes ose institucionit që e ka botuar veprën (nëse libri është publikuar në përmbledhje ose e ka publikuar ndonjë institucion shkencor), numrin e vëllimeve (nëse ka më tepër), numrin e faqeve, numrin dhe natyrën e ilustrimeve, madhësinë e formatit. Përveç kësaj, disa biblioteka cekin edhe përshkrimin e shkurtër të përmbajtjes së veprës (këtë e bën, për shembull, Biblioteka e Kongresit). Është traditë shumë e dobishme e disa bibliotekave (Biblioteka e Kongresit, Biblioteka e Museumit Britanik etj.), që në fund të skedës katalogjike jepen njoftimet për lëmenjtë shkencorë dhe titujt “nën të cilët janë grupuar librat për lëndën e njëjtë ose të ngjashme. Disa biblioteka tona, pas skedës katalogjike në të cilën janë dhënë emrat e autorëve, i fusin edhe skedat

⁵¹ Biblioteka e Kongresit (Library of Congress) në Washington ka sistemin e vet të veçantë të klasifikimit, që po ashtu bën pjesë në sistemet e rëndësishme. Në fondin e saj libror seksionet kryesore janë të shënuara me shkronja, kurse nënseksionet me numra arabë. Ja seksionet kryesore: A- General Works – Polygraphy; B-Philosophy, Religion; C- History, Auxiliary Sciences; D- History and Tipography (except America); E-F- American history; G- Geography, Antropology; H- Social sciences, General; J- Political science; K- Law; L- Education; M- Music; N- Fine Arts, General; P- Language and Literature, PN – PV- Literary history, Literature; Q- Science, General; R- Medicine, General; S- Agriculture, Plant and Animal industry; T- Technology, General; U- Military Science, General; V- Naval Science, General; Z- Bibliography and Library science. (Krihs. Almack, o.c., pp. 229-230; Hutschins, o.c., pp. 13-14).

katalogjike me emrat e atyre që për ata autorë kanë shkruar. Ato njoftime shtesë (skeda orientuese) paraqesin, si u tha kjo saktë, një lloj çelësi për zbulimin e literaturës për lëndën. Më në fund, disa biblioteka mirë të organizuara, japin, para skedave katalogjike të destinuara ndonjë autori, "sistemimin e skedave". Për shembull, në Bibliotekën Popullore në Sarajevë, para skedave që kanë të bëjnë me Andrea Zhidin, gjejmë skedën vijuese:

Gide, André

- sistemimi i skedës -

1) veprat në frëngjisht;

2) përkthimet - të sistemuara me rendin alfabetik të emërtimit të gjuhëve;

3) skedat orientuese.

Nga të gjitha këto të dhëna më me rëndësi është, pa dyshim, sinjatura (frën. *cote*, angl. *call number* apo *shelf-mark*), që mundëson gjetjen e ndonjë veprë në deponë bibliotekare. Ajo, rëndom, është e hartuar prej dy pjesëve, që në revers duhet saktë të përshkruhen shenjat e klasifikimit dhe shenjat e veprës. Për shembull, në Bibliotekën e Museumit britanik po e njëjta vepër (vepra e *Almağut* që këtu e kemi cituar disa herë) mbanë sinjaturën: a 81 - në libër, kurse 11911.a.81. - në skedën katalogjike. Në disa biblioteka amerikane sinjaturën e shënojnë në këtë mënyrë ^{C 973} C 362^s - ku numri 973 shënon numrin klasifikues (lënda sipas sistemit decimal), kurse C 362 h - numrin e librit (emrin e autorit dhe titullin).

Sa për ilustrim t'i riprodukojmë këtu dy njësi bibliografike nga Katalogu i përgjithshëm i Biblioekës së Kongresit në Washington.⁵²

⁵² Ta cekim këtë sipas: *The National Union Catalogue* (Washington, The Library of Congress, 1964), IV, 1241 dhe XXXIX, 479. - Kërkoj falje që për ilustrim të njërive bibliografike po i marrim si shembuj skedat katalogji-

Šamić, Midhat

Istorijski izvori Travničke hronike Ive Andrića i njihova umjetnička transpozicija, Sarajevo, Veselin Masleša", 1962.

216 p. 21. cm.

Bibliography: p. 207-208.

1. Andrić, Ivo, 1892 -

CrY MH InU NN CU

Travnička hronika

NUC 63 - 53860

Šamić, Midhat

Les voyageurs français en Bosnie à la fin du XVIIIe siècle et au début du XIXe, et le pays tel qu'ils l'ont vu, Paris, Didier (1960).

285 p. Maps. 23 cm. (Etudes de littérature étrangère et comparée, 38).

Bibliography: p. 267-276.

1. Bosnia and Hercegovina - Desor - et. trav. 2. Travelers, French.

1. Title

A 62-2062

Harward Univ. Library

Iau NjP MiU CrY CU NIC IU NcD NN CLU WU MdBJ RPB TxU

Sikur që shihet, Katalogu i Bibliotekës së Kongresit në Washington, pos të dhënave të rëndomta bibliografike (mbiemrit, emrit, titullit, vendit të botimit, botuesit, vitit të botimit, numrit të faqeve, hartat, emërtimit dhe numrit të përmbledhjes), jep edhe disa të dhëna tjera për hulumtuesin, të rëndësishme e të dobishme, sikur: paginacionin e bibliografisë; lëndët me të cilat mund të gjendet vepra (Bosnja e Hercegovina, urdhëtarët e të nftjaëm); më në fund, të gjitha bibliotekat në SHBA që e kanë librin. Kështu, në lidhje me librin parë (Istorijski izvori...), me anë të shkurtesave janë cekur të gjitha bibliotekat në të cilat gjendej ky libër, dhe këtë: Yale University; New Haven (CrY); Harward University, Cambridge (MH); In-

ke të veprave vetjake; Po e bëjmë këtë për shkak që për ato vepra kemi në dorë të dhëna më të plota. - Madhësia e skedave të riprodhuara është diç e zvogëluar: 10.0x6.0 cm (sipas formatit standard: 12,5x7.5 cm).

diana University, Blownington (InU); New York Public Library (NN); University...) janë cekur bibliotekat vijuese: State University of Iowa, Iowa City (IaU); Princeton University (NJP); University of Michigan, Anu Arbor (MiU), Yale University, New Haven (CrY); University of California, Berkeley (CU); Cornelly University, Ithaca (NIC); University Illinois, Urbana University of California at Los Angeles (CLU); University of Wisconsin, Madison (WU); Johns Hopkins University, Baltimore (MdBJ); Brown University; Providence (RPB); University of Texas, Austi (TxU).

Me interes dhe ndihmë të veçantë janë katalogët e shtypur të bibliotekave të mëdha. Ata nuk shërbejnë vetëm si doracakë të dobishëm për punë në biblioteka që i kanë publikuar, por edhe si instrumente të rëndësishme bibliografike dhe hulumtuese përgjithësisht, duke e inkadruar edhe punën jashtë atyre bibliotekave dhe vendeve. Duke iu falënderuar atyre shkencëtarët e të gjitha vendeve dhe profesioneve mund të njoftohen me fondin libror të bibliotekës së caktuar, që në të njëjtën kohë ua vë këtë fond në disponim. Me fjalë të tjera, mjetet bashkëkohore teknike, që nga viti në vit gjithnjë e më shumë po përsosen, i mundësojnë shkencëtarit që ta marrë fotokopjen ose mikrofilmin e materialit të madhësisë së ndryshme: artikullit, kaptinës, tërë librit. Me këtë bibliotekat u bëjnë shërbim të madh shkencëtarëve. Përveç kësaj, në katalogun e shtypur të ndonjë biblioteke të madhe hulumtuesi mund të mësojë se a ekziston vepra e caktuar fare, t'i verifikojë të dhënat për këtë vepër, të marrë vesh edhe për disa vepra tjera të autorit të njëjtë e të ngjashme. E vërteta, këta katalogë të shtypur nuk janë të privuar nga të metat e caktuara, inherente për këtë lloj të repertorit: ngadalësia e publikimit dhe vjetërsia e disa librave që janë futur në të, rendi alfabetik sipas shkronjës fillestare të autorit, palëvizshmëria e caktuar, ngurëzimi e

të ngjashme; por punëtorët bibliotekarë përpiqen që këto mungesa, e të tjerat, sa më shumë që është e mundur të zbuten, nëse jo edhe krejtësisht të evitohen, me publikimin e shtesave dhe plotësimeve, sikur edhe me “azhurimin” me anë të katalogëve në skeda, ashtu që katalogët e shtypur, marrë në përgjithësi, i ofrojnë punëtorit shkencor dobinë e pavlerësueshme. Së këndejmi ata edhe gjenden në qindra biblioteka të ndryshme në vend dhe jashtë.

Ti përmendim këtu vetëm dy-tre katalogë më të rëndësishëm të shtypur (që gjenden edhe në bibliotekat tona):

Catalogue général des livres imprimés de la Bibliothèque Nationale Auteurs, Paris, Imprimerie Nationale, 1897 -.

(Deri në nëntor 1979 janë botuar 227 blejë. Në thyerje; bleu i 228 dhe 229).

Catalogue général des livres imprimés, 1960-1964, vol. 1-11. Paris, Bibliothèque Nationale.

Catalogue général des livres imprimés. Série I, vol. 1-7 (Emri i fundit. Etzsharn. Série II, vol. 1-2)

(Caractères cyrilliques russes A-M)

British Museum, Catalogue of Printed Books, London, 1881-1905, 94 vols. Suppl. 13 vols. (Botimi i ri 1931 -)

Ekziston edhe botimi i fotolitografuar: *Général Catalogue of Printed Books. Photolithografie edition. To 1955. Published by the Trustees of the British Museum, London, 1965-1966, 263 vols.*

(Për dallim nga katalogu i përgjithshëm francez, në të cilin nuk kanë hyrë veprat anonime, në katalogun e shtypur britanik edhe ata janë përfshirë).

Catalogue of books represented by Library of Congress printed cards (bleu 260 me shtojca, 1942 - 1947).

Këto tri biblioteka të mëdha botërore, pos katalogëve të cekur, që në të vërtetë janë vepra monumentale dhe intrumente të punës të rendit të parë, kanë edhe disa regjistra (repertore) tjerë me rëndësi. (Të shihet më poshtë).

Në shumë biblioteka të mëdha të botës ekzistojnë edhe disa burime tjera themelore të informatave në shkri-
met e shtypura të destinuara ndonjë lëndë, siç janë in-
dekset e ndryshme: Indeksi i periodikut (Reader's guide to
periodical literature,⁵³ 1980 -; Reader's guide supplement,
1907-1919; Ninetenth century readers' guide, 1944, 2 v.;
International index to periodicals, 1907 - etj.;⁵⁴ indeks e
ndryshme të lëndës (për shembull: Essay and general
literature index, 1900 -), Dramatic index,⁵⁵ 1909 -); etj.

Për revistat, gazetat dhe përmbledhjet, në biblioteka
ekzistojnë katalogë të veçantë (e shpesh edhe seksionet e
veçanta, siç kemi thënë).

Nuk bën të harrohen të kontrollohen edhe publika-
cionet rrjedhëse, për të cilat mund të parashtrohet se
përmbajnë ndonjë shkrim që nuk është irrelevant për te-
mën e caktuar – ai ka të bëjë drejtpërdrejt me temën ose
me ndonjë lëmi fqinje shkencore. Me fjalë të tjera, për-
veç shkrimeve që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me temën,
bibliografia e punës duhet më shpesh të përmbajë edhe
veprat nga lëmi i gjerë i temës. Njohja solide e fushës më
të vëllimshme, nganjëherë madje edhe e fushave dhe di-
siplinave shkencore fqinje, i ofron autorit horizonte më
të gjera, shikim më të gjithanshëm dhe më të mirë në
problemin që e përpunon. Për shembull, nëse tema let-
rare-historike i përket një pjese të një autori, është e do-
mosdoshme të studiohet krijimtaria e tërësishme e atij
autori; tërësia më mirë do ta sqarojë dhe ndriçojë pjesën,
pa marrë parasysh atë që vepra e veçantë e autorit mund
të ketë, dhe rëndom ka, vlerën e vet të pakontestueshme
autonome. Kështu, çdo vepër e Balzakit do të na jetë

⁵³ I inicuar në vitin 1900, ky udhëheqës bibliografik botohet edhe sot, dy herë
në muaj. Në të publikohen, të grupëzuar sipas lëndës, titujt e të gjitha kon-
tributeve të publikimeve amerikane dhe disa më të rëndësishme të huaja.

⁵⁴ Të shihet më poshtë.

⁵⁵ Pëmban regjistrin e të gjitha veprave të dramës, të shfaqura qoftë në
skenë ose në ekran, qoftë të publikuara në formë librash ose në revista

shumë më e afërt dhe më e qartë nëse e lexojmë tërë “Komedinë njerëzore”. Saktë është vërejtur se te disa autorë aktivitetet individuale letrare nga lëmenjtë e ndryshëm dhe punimet letrare nuk paraqesin shumën, por rezultatin e shumëzimit (rasti i Sartrit). Ose, kur është fjala për ndonjë temë historike, e dobishme, do të dëftohet, mbase njohja dhe studimi i disa punimeve nga lëmi i shkencave ekonomike, juridike, filozofike.

Krahas kësaj, është e dëshirueshme që në regjistrin paraprak bibliografik të përfshihet edhe ndonjë vepër e vlefshme ose shkrim që trajton temën e ngjashme, nëse jo të njëjtën. Me studimin e kujdesshëm të veprave dhe shkrimeve hulumtuesi do të njoftohet me metodat të aplikuara në to, me mënyrën e qasjes ndaj problemit, sikur edhe me mënyrën e përpunimit të saj, dhe këtë njohja do t’i ofrojë sugjerime të dobishme, nganjëherë madje do t’i shërbejë si udhërrëfyesë gjatë përpunimit të temës së vet. Për këtë qëllim duhet me kujdes dhe ndërgjegjshëm të studiohet sidomos përmbajtja e kaptinave, kompozicioni i veprës ose shkrimit, sikurse edhe problematika e trajtuar në të.

Në kërkim të shkrimeve dhe burimeve të ndryshme - të veprave, artikujve nga revistat dhe gazetat, dokumentet arkivore, dorëshkrimet etj., - nëpër bibliotekat, arkivat dhe nëpër repertorin e tyre, hulumtuesit të ri mund t’i jetë me ndihmesë jo vetëm shoku i tij më i vjetër, eksperti, shkencëtari dhe arsimtari më me përvojë, por sidomos edhe bibliotekari. Gjatë gjithë këtij procesi, ndërkaq, ai duhet në vete, nga vetë përcaktimi për thirrjen shkencore, të kultivojë prirjen për gjurmim nëpër këta thesarë të kulturës dhe të aftësohet që vetë ta gjejë materialin e domosdoshëm, literaturën; duhet të mësojë të shërbehet me katalogët dhe indeksët, doracakët e ndryshëm dhe veprat e përgjithshme, që të dijë cilat prej tyre duhet t’i konsultojë për disa çështje dhe ku ta gjejë atë që në çastin e caktuar i është e domosdoshme. Ky af-

tësim që të gjendet në materialin e tubuar, që të dijë ku se cilën të dhënë do ta vendosë, do të jetë për të shumë më e çmueshme se sa njohja e shumësisë së fakteve, dhe këtë aftësi të studentët më të talentuar duhet filluar zhvilluar qysh në vitet e para të studimeve.

E megjithatë, sado e hollësishme, bibliografia e punës rrallë herë është e plotë dhe përfundimtare; ajo gjithnjë, gjatë ditës, plotësohet. Nganjëherë madje ndodh që shkencëtari të mësojë për ndonjë vepër, të vjetër apo të re, kur punimit të tij ia ka dhënë tashmë formën përfundimtare. Në atë rast, ai duhet të ketë aq ndërgjegje shkencore që veprën ta lexojë, ose së paku ta shfletojë, dhe eventualisht, nëse ka nevojë, ta përpunojë.⁵⁶

Bibliografia e punës për ndonjë temë hartohet në skedat bibliografike, të cilat sistematizohen sipas rendit alfabetik sipas shkronjës fillestare të mbiemrit të autorit (ose, nëse shkrimi është anonim, sipas shkronjës fillestare të titullit). Skeda bibliografike (fisha) quhen, në shkencë, skeda nga kartuqi ose nga letra e rëndomtë,⁵⁷ në të cilën shkruhen të dhënat e rëndomta bibliografike të shkrimit. (Pos fishave bibliografike ekzistojnë edhe ato dokumentare, për të cilat do të bëjmë fjalë më vonë). Madhësia e tyre standarde është: 7.5 x 12 x 5 (respektivisht 3 x 5 inça). Por ato mund të jenë edhe më të më-

⁵⁶ Shpesh jepet shenjë në Marksia dhe Leninia si në shembullin e ndërgjegjes së jashtëzakonshme shkencore. Marksi, se është e njohur, ka lexuar mbi 1500 libra që t'i tubojë të dhënat për Kapitalin e vet. Por gati kur e kreu veprën, mësoi se është botuar një libër për njëfarë çështje ekonomike dhe, ndonëse nga kjo vepër nuk ka pritur asgjë më qenësore, e ka lutur Engelsin që t'ia sjellë atë libër: "Ndërgjegjia ime teorike nuk më lejon të shkruaj më tej derisa nuk njoftohem me të", - i shkruan ai Engelsit. Kurse për punën time Imperializmi si stad më i lartë i kapitalizmit, Lenini ka marrë shënime nga 148 libra (nga ato 106 gjermanë, 23 francezë, 17 anglezë) dhe 232 artikuj të publikuar në 49 revista periodike. (Shih. S. A. Rajnberg, o.c., fq. 42.).

⁵⁷ Letra e rëndomtë për këtë është më praktike për shumë arsye: është më e lirë, që më pak hapësirë, në të më lehtë shkruhet me makinë. Gjatë kësaj është me rëndësi të merret në mënyrë konstante ajo që një herë zgjedhet, - letra e thjeshtë ose kartuqi

dha: unë personalisht shërbehem me fishat e formatit: 11 x 17.5. Gjatë kësaj është me rëndësi që: gjithnjë të përdoret madhësia për të cilën njëherë është përcaktuar.

Duhet marrë si rregull dhe të aplikohet në mënyrë rigoroze: çdo njësi bibliografike, çdo shkrim (vepër, artikull nga revista ose gazeta, dorëshkrim, dokument etj.), ka skedën e vet bibliografike. Gjatë kësaj në asnjë rast nuk duhet të koprracohet: këtu, sikur edhe në vendet tjera, koprraci paguan më shtrenjtë - duke kursyer në letër, ai humb kohë të çmueshme.

Në skedën bibliografike kryesisht shënohen po ato të dhëna që futen edhe në bibliografinë përfundimtare, në fund të librit, me atë dallim që skeda bibliografike mundet dhe është e dobishme, të përmbajë edhe shënimin e shkurtër për shkrimin, që për autorin, sipas dëshirës së tij personale, do të jetë me interes, dhe detyrues, në këndin e djathtë, sinjaturën me të cilën libri i konsultuar në bibliotekën e caktuar është evidentuar. Shënimet mund të jenë të shumëllojta. Ndonjë mund të përmbajë gjykimin personal për librin ose mendimin e ndonjë recensenti, mund të jetë në lidhje me qëllimin që autori vetes ia ka shtruar në shkrim, burimet nga të cilat është nxjerr materiali, rezultatet deri te të cilat ka ardhur autori, metodën që e ka aplikuar, origjinalitetin e materialit të vjelur dhe i metodës së aplikuar, të dhënat për bibliografinë e veprës, ilustrimet dhe tabelat, lëshimet dhe pasaktësitë, etj. Në këtë mënyrë skeda bibliografike bëhet, në realitet, skedë kritike - bibliografike.⁵⁸ Nëse të

⁵⁸ Oto Frank thekson domosdoshmërinë që në skedë të shënohet sidomos ajo që është mësuar me mundim, sikur nganjëherë është rasti me të dhënën për bibliotekën në të cilën gjendet libri. Ai këtë e ilustron me shembullin vijues: Autori e ka kërkuar ndonjë libër, por ai nuk ka qenë as në librari, as në bibliotekat e qytetit. Me mund të madh ka konstatuar se ai gjendet në bibliotekën universitare të qytetit të caktuar, dhe me të është shërbyer. Më vonë po ai libër sërish i është nevojitur, por pasi nuk e ka shënuar emrin e bibliotekës universitare në të cilën ai gjendet, kurse ka harruar, sërish kanë filluar gjurmimi e shqetësimi i mundimshëm dhe i kotë. (o. c., fq. 26).

dhënat që futen janë më të vëllimshme dhe zënë më shumë vend, disa prej tyre mund të shkruhen në shpinë, e mund të shtohet edhe një skedë, me ç'rast që të dyjat lidhen me mbërthesë. Disa preferojnë që skedat bibliografike të shkruhen menjëherë në dy e më tepër ekzemplarë, ashtu që mund të klasifikohen në shumë mënyra: sipas autorit dhe sipas lëndës etj., (me, eventualisht, skeda me ngjyra të ndryshme):

Të shohim tash se si në disa raste shkruhen të dhënat e ndryshme bibliografike në fishën bibliografike.

1. Skeda për librat

Nëse ka të bëjë me veprën (librin), në skedën bibliografike futen të dhënat vijuese: mbiemri dhe, i ndarë me presë ose në kllapën e rrumbullakët, emri i autorit, titulli i veprës, të cilin duhet nënvizuar me vijë valëzore,⁵⁹ vendi i botimit, numri i faqeve dhe formati. Nëse vepra ka më shumë botime, ceket botimi me të cilin autori është shërbyer dhe viti i atij botimi; e nëse libri ka më shumë se një ble, ceket edhe numri i blenit. Sa u përket shenjave të pikësimit që duhet përdorur ndërmjet të dhënave të cekura, aty mund të ketë dallime të ndryshme: emri i autorit dhe titulli i librit mund të ndahen me pikë, ose me pikëpresë, ose me dy pika; ndërmjet titullit të veprës dhe vendit të botimit rëndom vëhet pika, derisa të dhënat tjera ndahen vetëm me presë, etj. Ja një shembull:

⁵⁹ Kjo te ne do të thotë se titullin duhet duhet shkruar me shkrim kursiv. Në vendet tjera në këtë rast titulli nënvizohet me vijë të zakonshme. Mund dhe është edhe më praktike kështu të vepronet edhe te ne, duke ia tërhequr vëmendjen radhitësit (dhe redaktorit teknik) që tekset e nënvizuara me vijë të zakonshme t'i radhisë me kursiv.

Biblioteka personale

Mornet (Daniel). - Cours pratique de composition française. Paris, Librairie Larousse, 1934, 280 pp.

[Vepra ka tre libra, nga të cilët secili ka nga tri pjesë:
1) Invencioni; 2) Kompozicioni; 3) Shprehja.]

Vëmendje të posaçme duhet kushtuar në disa raste, sikur:

a) Nëse vepra ka dy ose tre autorë, në skedë shënohen emrat e të dyve ose të të treve; e nëse ka më shumë se tre autorë, ceket vetëm emri i të parit, ku shënohet: e të tjerët (ose shkurtesa lat.: *et al.*);

b) Nëse vepra është anonime, skeda fillon me titull;

c) Kur ka të bëjë me antologji, me zgjedhjen e teksteve ose përmbledhjen e kontributeve, ceket emri i hartuesit ose edhe i botuesit;

ç) Nëse është fjala për përkthim, në skedë shënohen edhe emri dhe mbiemri i përkthyesit;

d) Në çdo skedë futen, në formë të shkurtuar, emri i bibliotekës dhe sinjatura e librit.

Dhe kështu me radhë.

T'i cekim së paku edhe një shembull për dy autorë:

B.N. fq. 38* :8 Z 31027

Wellek (Rene) and Austin Warren. - Theory of literature. New York, Penguin books, 1949; X - 403 pp.

[Posedon bibliografinë e hollësishme për problemet e ndryshme në lidhje me çështjet e ndryshme teorike të letërsisë.

Ekziston përkthimi në gjuhën serbokroate dhe italiane.]

*) B. N.: *Bibliothèque Nationale* në Paris.

N. B. S. **: I 55981

Velek, Rene, i Ostin Varen: Teorija književnosti. Përkthyer Aleksandar I. Spasić i Slobodan Djordjević, Beograd, Nolit, 1965, str. 419.

***) N. B. S.: Narodna biblioteka u Sarajevu (Biblioteka Popullore)

Nuk është gjithnjë lehtë dhe thjeshtë të shkruhet fisha bibliografike në bazë të faqes ballore të ndonjë libri: vështirësia qëndron pikërisht në vënien e drejtë të shenjave të pikësimit, të cilat rëndom nuk janë në anën ballore të librit; e ndonjëherë nevojitet jo pak mendjempreshtësi që të gjenden edhe disa të dhëna bibliografike (për shembull, viti i botimit në shumë libra të huaj).

Ja si duket, për shembull, faqja ballore në një nga librat tonin:

UNIVERZITET U BEOGRADU

MIODRAG IBROVAC

hon. profesor Beogradskog unvierziteta

UVOD

u proučavanju romanistike

i uporedne književnosti

BIBLIOGRAFSKI

PRIRUČNIK

Manuel bibliographique
des langues et des littératures romanes
et de la littérature comparée

I

Naučna knjiga
Beograd, 1959

Në bazë të kësaj faqe ballore, skeda bibliografike do të duket përafërsisht kështu:

Ibrovac, Miodrag, Uvod u proučavanje romanistike i uporedne književnosti: bibliografski priručnik.

Beograd, Naučna knjiga, 1959, I, 218.

Ose:

Ibrovac, Miodrag, Uvod u proučavanje romanistike i uporedne književnosti: bibliografski priručnik.

Beograd: Naučna knjiga, 1959, sv. I, str. 218.

Ose:

Ibrovac (Miodrag). - Uvod u proučavanje romanistike i uporedne književnosti: bibliografski priručnik.

Beograd, Naučna knjiga, 1959, sv. I, str. 218.

E të ngjashme.⁶⁰

2. Skeda për artikuj në revista dhe gazeta

Nëse fjala është për artikullin në revistë ose në gazetë, në skedën bibliografike shkruhen të dhënat vijuese: mbiemri dhe emri i autorit (po ashtu si në skedën për libra), titulli i artikullit, që nuk nënvizohet, por vëhet nën thonjëza, titulli i revistës, respektivisht gazetës që nënvi-

⁶⁰ Për rastet dhe mënyrat tjera të ndryshme të shënimit të të dhënave bibliografike të shihet më poshtë.

zohet me një vijë valore. Për revistat futet edhe numri i blenit (shifra romake), viti dhe paginacioni, e disa i shtojnë edhe muajin, që së bashku me vitin, mund të vëhen në kllapën e rumbullakët; te gazetatat shënohen data e saktë dhe faqja, e disa e shtojnë edhe numrin e shtyllës.

Në çdo skedë shënohet, patjetër sinjatura e revistës, përkatësisht gazetës dhe eventualisht, sikur edhe te librat, ndonjë vrojtim për të.

Ti cekim disa shembuj:

Royale 2104

Knight (Frank K.). - "Ethics and economic interpretation". The Quarterly Journal of Economics, t. XXXVI, 1921-1922, pp. 454-481.

Tautović, Radojica: "Stil i duh Bogdana Popovića, Život (Sarajevo), vol. XIV, str.30-41 (Septembar, 1965).

Šnajder (dr Marcel) - "Večna jeres filozofije:"
Odjek (Sarajevo), 1. Jan. 1966, str. 5

[Članak preštampan iz sarajevskog Pregleda, 1940]

Edhe këtë duhet pasur vëmendje në disa raste të veçanta, sikur:

a) nëse artikulli nga revista ose nga gazeta nuk është nënshkruar, njësia bibliografike në skedë fillon me titull;

b) artikullit pa titull i jepet titulli që më së miri i përgjigjet përmbajtjes së tij dhe në atë rast ai vëhet në kllapën katrore.

Për shembull:

[Kuvendi i Shoqatës së Arsimtarëve të Gjuhëve të Huaja i RS BeH], Oslobodjenje, (Sarajevë), 23 shkurt 1964, fq. 4, fq. 5.

Duhet pasur kujdes edhe në mënyrën e shënimit të të dhënave bibliografike kur ka të bëjë me recensionin e ndonjë vepre të publikuar në revistë ose në gazetë. Ja disa shembuj:

R[isto] T[rifković]. - "Graditelji moderne misli bez Majakovskog", [Prikaz djela: Oto Bihalji-Merin, Graditelji moderne misli, Beograd, Prosveta, 1965.] Život, XIV, 94-95 (septembar 1965).

Šamić, Midhat, Prikaz djela: R. Maixner, Ch.. Nadier et l'Illyrie, Paris, M. A. Didier, 1959, 108 pp. U: Živi jezici, X, 28-34 (12 maj 1962).

Prikaz Francusko-hrvatsko-srpkog rječnika od Valentina Putancea, Zagreb, Školska knjiga, 1965; U: Naša škola, I (juni 1965), 25-30).

(Në këtë rast recensimi i publikuar në revistë nuk është nënshkruar.).

3. Skeda për artikuj në doracakë dhe antologji

Gjatë hartimit të këtyre skedave veprohet kryesisht në mënyrën e njëjtë sikur edhe për artikujt nga revistat dhe gazetat. E vetmja, nëse në ndonjë enciklopedi artikulli është nënshkruar me iniciale, duhet shikuar, në fillim të vëllimit, shpjegimin e inicialeve dhe të shkruhet në skedën bibliografike emri i plotë i autorit të artikullit.

Ja dy shembuj:

Artikulli nga enciklopedia:

Ibrovac (Miodrag): "Francuska književnost kod Jugoslovena", Enciklopedija Jugoslavije (Zagreb, Leksikografski Zavod, 1958, III. 363-369.

Artikulli nga përmbledhja:

Škreb (dr Zdenko). - "Osnovna stilska sredstva". U: Uvod u književnost (urednici: Fran Petre i Zdenko Škreb), Zagreb, Znanje, 1961, str. 237-290.

Duhet cekur se të gjitha të dhënat bibliografike shkruhen në skedë *de visu*, nga dora e parë, d.m.th. drejtpërdrejt nga vetë vepra, revista, doracaku, e jo tërthorazi, nga ndonjë doracak bibliografik ose nga shënimi në nëntekst. Nëse autori nuk ka mundësi që këtë ta bëjë menjëherë nga teksti origjinal, të dhënat e futura tërthorazi duhet verifikuar në bazë të vetë veprës ose revistës posa për këtë të jepet rasti. Përvoja, me fjalë të tjera, ka treguar se shpesh gabimet mjaft të rënda në të dhënat e ndryshme nxirren nga vepra në vepër, nga shkrimi në shkrim.⁶¹ Marrë në përgjithësi, është me rëndësi prej vetë fillimit të kultivohet në vete shprehia e plotësimit të plotë të skedave bibliografike: në skedë duhet gjithnjë me kujdes, pa shkurtim, të shkruhen të dhënat e zakonshme bibliografike, ashtu që nuk ka nevojë sërish të kthehemi në vepër, përkatësisht në artikull, që të verifikohen ose

⁶¹ Kështu, për shembull, nja dhjetë shkencëtarë tonë dhe të huaj, ndër të cilët disa edhe mjaft të dalluar, gabimisht në shkrimet dhe veprat e veta kanë cekur vendin dhe vitin e botimit të parë të udhëpërshkrimit; Chaumette Des Fossés, *Voyage en Bosnie dans les années 1807-1808...*, sikur Bedin, 1812 (vendi Parisi, 1816) për shkak se kanë marrë ujëri prej tjetrit së bashku me të dhënat bibliografike dhe gabimin të cilin i pari prej tyre e ka bërë, kurse asnjëri nuk është angazhuar që të dhënat bibliografike të librit që e kanë pasur në duar t'i verifikojnë në vetë librin. (Kth. M. Šamić, *Voyageurs français en Bosnie...*, Paris, M. Didier, 1960, fq. 122, vër. 260.)

plotësohen të dhënat. Çdo gabim, edhe më i vogli në atë aspekt (data gabimisht e shkruar e botimit e të ngjashme) mund të ketë për pasojë jo vetëm kohën kot të humbur me verifikimin e mëpastajshëm por edhe gabimin e rëndë, madje edhe katastrofal, i cili veprës medocemos ia humb vlerën e saj. Nuk duhet hequr nga mendja se pikërisht kujdesi në 'imtësitë' e tilla bën që vepra dhe punëtori shkencor të mbjellin besim, se në to lexuesi qetësisht mund të mbështetet.

Të plotësuar dhe të korigjuar, këto skeda bibliografike do të shërbejnë për hartimin e bibliografisë përfundimtare, që shtohet në fund të tekstit dhe për të cilën do të ketë fjalë më vonë.

Të cekim se edhe krahas këtyre skedave bibliografike, është e preferuar të kihet edhe fletorja me indeksin alfabetik (fletoren bibliografike), në të cilën do të futen të dhënat bibliografike për shkrimet për të cilat ende nuk kemi konfirmuar se a duhet të kyçen në bibliografi, sikur edhe përgjithësisht veprat dhe shkrimet që për autorin janë me interes kur përpunon ndonjë temë. Përvoja personale më ka treguar se mbajtja e kësaj evidence jo vetëm që është e dobishme por edhe interesante: fletoren e shfletoj dhe lexoj kohë pas kohe jo me interes më të vogël se ndonjë roman.

C. Dy biblioteka të huaja shkencore dhe puna në to

Është fakt përgjithësisht i njohur se kontakti i parë me ndonjë bibliotekë të madhe të huaj shkencore, çfarë janë, për shembull, *Biblioteka Kombëtare* në Paris dhe *Biblioteka e Muzeut Britanik* në Londër, ose *Biblioteka e Kongresit* në Washington e të ngjashme, huton, madje ngapak edhe e demoralizon lexuesin e ri: hulumtuesi i

paudhëzuar në ndonjë bibliotekë të re ndihet pak a shumë i humbur, sikur në ndonjë vend të huaj (*dépaysé*- siç thonë Francezët), për arsye të mosnjohjes së fondit të saj libror, organizimit dhe funksionimit të saj. Nëse këtyre vështirësive u shtohen edhe vështirësitë më të mëdha apo më të vogla që rrjedhin nga njohja e pamjaftueshme e gjuhës së huaj, mund të fitohet fotografia e caktuar mbi pakëndshmëritë e ndonjë eksperti të ri kur të vijë për herë të parë të punojë në atë bibliotekë: përshtypja e tij e parë është se kurrë nuk do të mund të gjendet në atë labirinth të librave, revistave, doracakëve, enciklopedive. Mirëpo, kjo përshtypja e parë zhduket relativisht mjaft shpejtë: pas një apo dy ditëve hulumtuesi i ri fiton dituritë më të domosdoshme për atë se si të vijë deri te librat, artikujt, shkrimet dhe doracakët e dëshiruar.

Pikërisht që atij hulumtuesi të paudhëzuar që për herë të parë hyn në njërin prej dy bibliotekave të mëdha evropiane - *Bibliotekën Kombëtare* në Paris dhe *Bibliotekën e Musemit Britanik* në Londër - t'i ndihmojmë që së paku deri diku të gjendet gjatë ditëve të para, do t'i shtojmë këtu të dhënat më të domosdoshme për organizimin dhe funksionimin e atyre bibliotekave dhe disa udhëzime më të domosdoshme për shfrytëzimin e fondeve të tyre të pasura librore.

Biblioteka Kombëtare në Paris

Biblioteka Kombëtare (*Bibliothèque Nationale*) në Paris është njëra prej bibliotekave më të pasura, nëse jo edhe më e pasura në botë: vetëm fondi libror i seksionit për libra dhe gjëra të shtypura përmban mbi gjashtë milionë vëllime dhe ai edhe më tej pasurohet nga dita në ditë. Në të për çdo ditë hyjnë të gjithë librat të shtypur në gjuhën frenge dhe një numër të konsiderueshëm të librave të zgjedhur në gjuhë të huaja. E vendosur në vetë qendrën e Parisit, në bregun e djathtë të lumit Sena (hyrjen e ka nga rruga Rishelje - 58), *Rue de Richelieu*, ajo ruan thesarin libror, koleksionet e para të të cilit rrjedhin qysh nga koha e renesansës (ekzemplari i obligueshëm është vendosur me ligj qysh prej vitit 1537).

Biblioteka është e ndarë në tetë seksione (*Département*), dhe këtë: Seksioni për gjërat e shtypura (*Département des imprimés*), Seksioni furnizues (*Département des entrées*), Seksioni për periodikë (*Département des périodiques*), Seksioni për hartat (*Département des cartes et plans*), Seksioni muzikologjik (*Département de la musique*); Seksioni për dorëshkrime (*Cabinet des manuscrits*), Seksioni për gdhendje (metali) (*Département des estampes*) dhe Seksioni për medaljone (*Cabinet des médailles*).

Sallat e leximit të seksioneve më të rëndësishme të bibliotekës (Seksionit për gjërat e shtypura, për periodikun dhe Seksioni muzikologjik) janë të hapura për lexuesit çdo ditë, pos të dieles dhe festave, prej orës 9-20 pa ndërprerë. Dhe këtë gjatë tërë vitit, pos pesëmbëdhjetë ditë, duke filluar prej të hënës së dytë pas festave të Kërshëndellave, kur kjo bibliotekë është e mbyllur për publik.

Çdo lexues që të mund të punojë në te duhet të jetë i furnizuar me kartelën e lexuesve (*carte de lecteur*), kohëzgjatja e së cilës mund të jetë prej tre muaj deri më pesë vjet, ose me fletëlëshim (*laisser-passer*), që vlen vetëm disa ditë. Ato nxirren në zyren e veçantë të Bibliotekës (*Bureau de cartes des lecteurs*), në katin përdhësë. Të drejtë në këtë kartelë, përkatësisht në këtë fletëlëshim, pos francezëve ka edhe çdo i huaj që ka mbaruar ndonjë fakultet (përkatësisht bën pjesë në letrarë, artistë, punëtorë kulturorë më të dalluar), dhe i cili krahas lutjes dhe dy fotografive bashkangjet rekomandimin e ambasadës së vet ose të ndonjë profesori francez të universitetit (ose të drejtorit të ndonjë institucioni shkencor).

Më i rëndësishëm nga të gjitha seksionet, që më së shpeshti edhe e vizitojnë lexuesit tanë, është Seksioni i parë (*Départament des imprimés*). Së këndejmi për të do të japim disa informata.

Pikërisht para hyrjes në sallë të leximit të këtij seksioni (ai është ndërtuar më 1868 dhe numëron 360 vende), lexuesi e merr kartelën me numrin e vendit të vet, që, së bashku me kartelën e vet të lexuesit, (respektivisht fletëlëshimin) duhet menjëherë t'ia dorëzojë njërit prej nëpunësve në anën tjetër të sallës (*contrôle*), e të cilin ai sërish e merr me rastin e shkuarjes, kur t'i kthejë të gjitha librat që i ka përdorë atë ditë.

Nëse lexuesi për herë të parë vjen në këtë sallë, e nuk ka ndonjë njeri të njohur që ta udhëzojë për mënyrën e kërkimit dhe marrjes së librave, më së miri është që një kohë të caktuar ta përdorë si për shikim – 'rikognizim' - të vetë sallës dhe lokalit nën te, d.m.th. sallës për katalogë, ashtu edhe për leximin e shpalljeve të ndryshme dhe udhëzimeve që i bien në sy.

Në sallë të leximit ai do të gjejë, në rafte, shumësi doracakësh të ndryshëm (fjalorë, enciklopedi, biografi), pastaj përmbledhje të ndryshme, shumë vepra të përgjithshme nga shkencat e ndryshme, tekste letrare etj., të

cilat mund t'i përdorë lirisht, pa kurrfarë formalitetesh, duke i marrë në vendin e vet (kuptohet, me kusht që prap t'i kthejë në vendin e tyre). Në sallën e leximit po ashtu do të gjejë kompletin e katalogut të përgjithshëm të shtypur, sikur edhe, në formë katalogësh në skeda, regjistrin e të gjithë doracakëve dhe veprave tjera që gjenden në sallën e leximit. Është e preferueshme që lexuesi vetes menjëherë t'ia shënojë ose ta mbajë mend ku gjenden doracakët dhe veprat që do të duhet t'i konsultojë gjatë punës.

Në sallën për katalogë, në korridor janë të vendosur të gjithë katalogët më të rëndësishëm (emërorë, të lëndës, të titullit), të shtypur ose në skeda), sikur edhe të gjitha bibliografitë më të rëndësishme (franceze e të huaja): bibliografitë e bibliografive, bibliografitë universale, të përgjithshme dhe të veçanta, katalogët e bibliotekave më të rëndësishme në botë etj.

Katalogët më të rëndësishëm prej tyre janë si vijon:

Alfabetik:

Catalogue général des livres imprimés de la Bibliothèque Nationale, Auteurs... (Të shihet fq. 37).

Catalogue général des livres imprimés (auteurs - collectivités - auteurs - anonymes), 1960-1964... (Të shihet fq. 37).

Auteurs (supplément) et anonymes, 1882-1936.

(Katalogu i hartuar në skeda të lidhura në fletore. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në bibliotekë në periudhën 1882-1935, me përjashtim të atyre që i përmbanë katalogu i përgjithshëm i shtypur).

Catalogues auteurs et anonymes. Ouvrages entrés de 1936 à 1959.

(Katalogu i hartuar në skeda. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në bibliotekë prej vitit 1936 deri 1959.)

Auteurs - collectivites - auteurs anonymes. Ouvrages entrés de 1960 à 1969. (Caractères latins et grecs.)

(Katalogu në skeda. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në bibliotekë prej 1960 deri 1969. Vazhdim i katalogut paraparak.)

Auteurs, anonymes et publications des collectivites depuis 1970. (Caracteres grees et latins.)

(Katalogu në skeda. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në Bibliotekë pas vitit 1970), të shkruara në alfabetin cirilik dhe latin.)

Fischier alphabétique des périodiques (katalogu alfabetik i periodikës).

Tematik (lëndor):

Catalogue matières 1882-1935.

(Katalogu lëndor, i hartuar prej skedave të lidhura në fletore. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në Bibliotekë në periudhën prej 1882 deri 1935.)

Catalogue matières. Oeuvres entrées de 1936 à 1959.

(Katalogu lëndor, i hartuar nga skedat të vendosura në pakot katalogjike. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në Bibliotekë në periudhën prej 1936 deri 1959.)

Catalogue matières. Ouvrages entrés depuis 1960.

(Katalogu i lëndës në skeda, të vendosura në pakot katalogjike. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në Bibliotekë pas 1960.)

Catalogue matières 1894-1925.

Catalogue matières 1925-1936.

Titullor:

Catalogue par titres. Oeuvres littéraires, 1882-1936.

(Katalogu i titullit në skeda, të lidhura në fletore. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në Bibliotekë në periudhën prej 1882 deri 1936.)

Catalogue par titres. Oeuvres littéraires entrées de 1936 a 1959.

(Katalogu i titullit, i hartuar nga skedat, të vendosura në pakot katalogjike. Përmban të dhënat bibliografike për veprat që kanë hyrë në Bibliotekë prej 1936 deri 1959.)

Catalogue par titres. Oeuvres littéraires entrées après 1960.

(Katalogu i titullit në skeda, të vendosura në pakot katalogjike. Përmban veprat që kanë hyrë në Bibliotekë pas 1960).

Histoire de France. Oeuvre entrés depuis 1950.
Suite du catalogue systematique.

(Katalog për vepra historike që kanë hyrë në Bibliotekë pas 1950. Vazhdimi i katalogut sistematik).

Catalogue de biographia française (Katalog për biografinë franceze).

Ta cekim edhe katalogun që përmban riprodhimet fotografike të skedave të disa fondeve të vjetra, librorë që nuk kanë hyrë në katalogun e shtypur.

Që këtu t'i riprodhojmë vetëm dy skeda katalogjik (të formatit të zvogëluar) të Bibliotekës Kombëtare në Paris, nga të cilat lexuesi do të mund të fitojë njëfarë pasqyre si duken ato dhe çfarë të dhënash bibliografike përmbajnë.

21881 64
Šamić (Midhat) - Dr Midhat Šamić, Istorijski izvori Travničke hronike Ive Andrića i njihova umjetnička transpozicija. [Predgovar. Miodrag Ibrovac.] - Sarajevë, Veselin Masleša, 1962 - In. 16 (20 cm), 217 p (Ech. int. 4476-63)
[16 Y ² . 27946
Andrić (Ivo), "La Chronique de Travnik", Sources.
9644
ŠAMIC (Midhat) - Midhat Šamić,... Les Voyageurs français en Bosnie à la fin du XVIII ^e siècle et au début du XIX ^e c et le pays tel qu'ils l'ont vu... - Paris, Didies (Mesnil, impr. Firmin - Didot et Cie), 1960. - In 8 ^o (23 cm), 287 p., cartes. 25 NF. [D. L. 8996 - 60] - VIII d30 - (Etudes de littérature étrangère et comparée. 38).
[8 ^o Z. 33633 (38)
Bosnie, 18 ^e . s. (fin) - 19 ^e s. (début). Voyageur français. Témoignages. - Voyageurs français, Bosnie, 16 ^e - 19 ^e s. (début).

Veprat që i nevojiten lexuesi i kërkon me anë të reversit të llojeve dhe ngjyrave të ndryshme. (Për shembull, nëse ka gjetur emrin në gjysmën e majtë të sallës së leximit, ai i kërkon librat me anë të reverseve të verdhë, derisa reverset e ngjyrës së gjelbër i përdor nëse vendin e ka në anën e djathtë të sallës). Gjatë kësaj është jashtëzakonisht me rëndësi që të gjitha të dhënat në revers t'i përmbushë saktë dhe lexueshëm, me laps kimik, e sidomos sinjaturën e veprës (*cate*). Ja, sa për ilustrim, një revers të plotësuar:

DÉPARTEMENT DES IMPRIMÉS
BULLETIN A UTILISER
POUR LES PLACES 181 A 360

DATE : 25. 10. 71.

PLACE OCCUPÉE

325

DEMANDE

COTE : 8° 02 a³²

TOMAIISON OU ANNÉE
des périodiques et collections :

AUTEUR : Perrot G.

TITRE : Souvenirs d'un voyage...

DATE DE PUBLICATION : 1863

FORMAT : 8°

Le format doit aussi figurer dans la cote lorsqu'il précède la lettre de série.
 Il est indispensable pour les lettres L. N. O. P. T.

LECTEUR

NOM :
(en capitales)

SAMIC

ADRESSE ACTUELLE :

38, Rue de Lille

RÉPONSE DES MAGASINS

Communiqué à vous-même le :

Communiqué le :

Manque en place

Absence constatée en :

A consulter à :

Voir :

Cote à compléter

Cote à revoir

Reliure

Hors d'usage

Autres réponses :

Louvain-la-Neuve, Paris

Reversat e plotësuar (me anë të të cilëve ekziston mundësia që brenda një dite të kërkojë më së shumti dhjetë libra, dhe këtë nga tre në të njëjtën kohë) ai i hedh në “gypin pneumatik” (tube pneumatique), vrima e të cilit gjendet në mesin e zyrës së sallës së leximit (*controlle*). Veprat e kërkuara lexuesi do t’i ketë në vendin e vet 30-45 minuta pasi të hedhet reversi.

Me mbarimin e ditës i kthen në vendin e njëjtë (*controlle*) veprat e përdorura. Nëse dëshiron që disa prej tyre t’i mbajë edhe për ditën e nesërme, do ta lusë bibliotekarit që këto vepra t’ia ‘lë anash’ (*mettre de côté*). (Ai ka të drejtë të mbajë tre vëllime ose gjashtë, - nëse i lidhë me rryp - *sangle*). Gjatë kësaj i shënon, në të dy rastet, në skedën e verdhë, sinjaturat e veprave që i ka mbajtur, dhe të nesërmen, me rastin e kërimit të librave të lëna “anash”, ia dorëzon bibliotekarit atë skedën e verdhë, së bashku me kartelën e vet të lexuesit dhe kartuqin të marr në hyrje.

Në sallën për katalogë, nën sallën e leximit, pos katalogëve të cekur gjendjen edhe regjistrat e ndryshëm të periodikut, bibliografitë e shtypura të profesioneve të ndryshme, sikur edhe repertorët tjerë të ndryshëm.

Të cekim po ashtu se në *Seksionin për periodikun* mund të merren revistat ende të palidhura (*vijues* dhe, rëndom, nga viti paraprak), të gjitha vitet e gazetave, të disa përmbledhjeve etj.

Biblioteka e Muzeumit Britanik në Londër

Biblioteka e Muzeumit Britanik (*British museum*) në Londër po ashtu është njëra prej bibliotekave më të pasura në botë: “Katalogu i përgjithshëm i librave të shtypura” i fundit i fotolitografuar - që është publikuar në Londër më 1965-1968, në 263 vëllime - përmban ndërmjet pesë e gjysmë deri gjashtë milionë njësi bibliografike. Edhe ajo është e vendosur në qendër të Londrës. (W. C. I.).

Biblioteka ka disa salla leximi, dhe atë: sallën kryesore të leximit (*Reading Room*), së cilës i takon edhe salla e leximit për libra të rrallë (*North Library*); sallën e leximit për shkresat shtetërore (*State Paper Room*); sallën e leximit për hartat (*Map Room*); sallën e leximit për gazeta (*Newspaper Library Reading Room*). Për lexuesit ajo është e hapur çdo ditë pune (duke llogaritur edhe të shtunën), pos të Premtes së madhe, Kërshëndellave (dhe natën e Kërshëndellave), sikur edhe gjatë kohës së një jave, që fillon të hënën e parë në muajin maj. Orari i punës në sallën kryesore të leximit është prej orës 9 deri 17 (të hënën, të premten dhe të shtunën) ose prej 9 deri 21 (të martën, të mërkurën e të enjten).

Për punën në Bibliotekë është e domosdoshme të posedohen kartelat e lexuesit. Ato janë dylojesh: Kartelat afatgjate (*Long-period Tickets*), kohëzgjatja e së cilës rëndom është një vit, dhe kartelat afatshkurte (*Short-period Tickets*), që zgjasin deri në gjashtë ditë. Për marrjen e kartelës së lexuesit të llojit të parë lexuesi është i obliguar, krahas lutjes,

ta bashkangjesë rekomandimin me shkrim të ndonjë profesori britanik ose punëtori shkencor; derisa për kartelën afatshkurte të lexuesit rekomandimi nuk është i obligueshëm, por Drejtoria dhe Biblioteka mund ta kërkojë.

Salla kryesore e leximit (që është ndërtuar qysh në fillim të shekullit XIX (1854-1857) mund të pranojë afër 400 lexues.

Ndryshe nga Biblioteka Kombëtare në Paris, në të cilën lexuesi e merr në hyrje numrin e vendit, në Bibliotekën e Museumit Britanik ai vetë e zgjedh vendin që e dëshiron, nëse është i lirë kur të vijë në bibliotekë. Edhe në këtë bibliotekë lexuesi ka mundësi lirisht të shërbehet me doracakët e llojlojshëm që gjenden kudo në raftet (bibliografi, biografi, enciklopedi, fjalorë etj.), dhe këtë pa kurrfarë formalitetesh. (Katalogu me skeda të të gjithë doracakëve të sallës së leximit gjendet pikërisht para hyrjes në sallën e leximit). Mirëpo, librat dhe publikimet tjera ai i kërkon me anë të reverseve.

Në vetë sallën e leximit, pos doracakëve, gjenden edhe katalogët e llojlojshëm (të shtypur dhe në skeda) të librave dhe veprave, regjistrat e periodikut vijues; regjistrat e gazetave të ndryshme (nga të cilët disa janë të mikrofilmuar, sikur 'Pravda' dhe 'Izvestija' sovjetike për vitet 1917-1937; etj.

Katalogu më i rëndësishëm prej të gjithë këtyre është, gjithsesi, *Katalogu i përgjithshëm i librave (General Catalogue of Printed Books)*, i cili është katalog autorial, d.m.th. emrat e autorëve janë të futur sipas radhës alfabetike. Këta katalogë, në realitet, në skeda janë të lidhura në fletore. Specificiteti i këtij katalogu është në atë që në anën e majtë të fletores në dy shtylla janë vendosur skedat katalogjike të atyre veprave që biblioteka i ka poseduar kur katalogu është përpiluar, deri sa në anën e djathtë gjenden skedat katalogjike të veprave që kanë hyr në bibliotekë pas kësaj. Në këtë mënyrë është siguruar

‘azhuriteti’ i katalogut. Skedat katalogjike të autorëve dhe veprave që katalogu i cekur nuk i përmban, gjenden në pakot e veçanta katalogjike (*General Catalogue: Accessions* 1956 -).

Sa për ilustrim t’i riprodukojmë këtu disa skeda katalogjike. (Po i riprodukojmë po ato skeda katalogjike që tashmë i kemi riprodukur nga Biblioteka e Kongresit në Washington dhe Biblioteka Kombëtare në Paris, që lexuesi të mund t’i krahasojë dallimet në mënyrën e katalogjizimit të këtyre dy bibliotekave shkencore).

ŠAMIC (Midhat)

- Istorijски izvori Travničke hronike Ive Andrića i njihova umjetnička transpozicija. (With a French summary.) pp. 216. Sarajevo, 1962.⁰
11880. n. 22.

[sc] SERBOCROATIAN LITERATURE. History. Twentieth Century. Andrić

ANDRIĆ (Ivo)

[Travnička hronika.]

- See ŠAMIC (M.) Istorijски izvori Travničke hronike Ive Andrića i njihova umjetnička transpozicija. 1962,⁰

11880. n. 22.

ŠAMIC (Midhat)

- Les Voyageurs français en Bosnie a la fin du XVIII^e siècle et en début du XIX^e et le pays tel qu'ils l'ont vu, etc. (With maps.) pp. 285. pl. II. Paris, [1960.]⁰

[Études de littérature étrangère et comparée. no. 38.]

W.P. 938/38

BOSNIA AND HERCEGOVINA.

Reverset e Bibliotekës së Museumit Britanik, me ndihmën e të cilëve lexuesi i kërkon të gjitha librat që i nevojiten (pos doracakëve që gjenden në sallën e leximit), janë përsosur dhe janë thjeshtuar që punëtori shkencor së koti mos të humbi kohën duke plotësuar në to rubrikat e tepërta dhe keq të klasifikuara dhe të dhënat e njëjta nga dy - tri herë, siç është rasti në disa biblioteka tjera. Kështu, për shembull, në reverset për libra ka nevojë të shënohen vetëm disa (shtatë) të dhëna më të domosdoshme, edhe atë: sinjatura, emri i lexuesit, data e leximit të librit, numri i ulëses së lexuesit, emri i autorit, titulli i shkurtër i veprës dhe viti i botimit të tij. Të gjitha këto të dhëna lexuesi i shkruan vetëm një herë, pasi që letra është rregulluar ashtu që kopja i është bashkangjitur origjinalit, të shkruhet, me anë të indigos, në të njëjtën kohë. (Reversët e ngjashëm aplikohen prej para do kohe edhe në Bibliotekën Kombëtare në Paris).


Ja ekzemplarin e një reversi të plotësuar:

SHELF-MARK from the General Catalogue		Reader's Name and Initials in BLOCK CAPITALS	
012302.66.8		ŠAMIC A	
		Date	Letter and No. of Seat
		2 Aug 1967	P ₃
NAME OF AUTHOR			
Barzun J. M...			
SHORT TITLE OF WORK		DATE OF EDITION	
Modern Researcher		1957.	
IF PART OF A SERIES, specify here the name of the series and the volume or part required		FOR OFFICIAL USE ONLY	
BOOKS MUST NOT BE MARKED BOOKS MUST NOT BE REMOVED FROM THE ROOM IN WHICH THEY WERE ISSUED			SEE BACK →

Edhe në këtë bibliotekë ka reverse të llojeve dhe ngjyrave të ndryshme: reverset e bardhë (për librat), të portokalltë (për veprat muzikore) dhe të verdhit (për hartat); reverset për lexuesit me kartelat lexuese afatgjate (reverset e bardhë të rëndomtë) dhe për lexuesit me kartelat afatshkurte (reverset e bardhë mbi të cilët është shkruar TEMP, d.m.th. *temporary*), etj. Saktë dhe lexueshëm reverset e plotësuar (të kihet vëmendje sidomos në sinjaturën *shelf-mark* që përbëhet prej numrave dhe shkronjave dhe të cilën duhet ndërgjegjshëm riprodhuar) dorëzohen në sportel, në të cilin qëndron shkrimi ndriçues *Applications for Books*. Përafërsisht gjysmë deri në një orë pas dorëzimit të reversit, nëpunësi ndihmës do t'ua sjellë në vend librat e kërkuar. Numri maksimal i librave që lexuesi ka mundësi që t'i kërkojë në këtë bibliotekë gjatë një dite është dymbëdhjetë.

Para se ta lëshojë bibliotekën, lexuesi ia kthen nëpunësit të gjitha librat që gjatë një dite i ka pranuar në tavolinën në mes (*Centre Desk*), gjatë të cilës nëpunësi ia kthen reverset. Nëse dëshiron t'i mbajë disa libra, e vë në secilin prej tyre kartuqëzin (këta kartuqëza gjenden në tavolinë, në pako me shkrim: *Reserved Books*), në të cilin e shkruan emrin e vet. Të nesërmen me reverset e njëjta, në të cilët e përmirëson vetëm datën dhe, eventualisht numrin e vendit (nëse e ka ndërruar vendin), i kërkon librat në tavolinën e njëjtë.

Sistemimi i ulësve të Bibliotekës së Muzeumit Britanik



Me këtë rast sidomos duhet të ceket se Biblioteka e Muzeumit Britanik, sikur edhe Biblioteka Kombëtare në Paris, madje në masë edhe më të madhe prej të parës, posedon komoditet dhe, që sidomos është me rëndësi, është mirë e organizuar, ashtu që lexuesi i ri në të lehtë dhe shpejtë mund të gjendet.

Për shërbimin e shpejtë dhe efikas në njërin prej bibliotekave të cekura (sikur edhe në çdo bibliotekë përgjithësisht), pos njohjes së mirë të vetë bibliotekës dhe organizimit të saj, sikur edhe gjeturisë së caktuar, është e domosdoshme t'u kushtohet vëmendje edhe disa hollësive:

1. Lexuesi duhet mirë ta zotërojë alfabetin (respektivisht alfabetin cirilik): pa këtë askush nuk mundet lehtë dhe shpejtë t'i shfrytëzojë mjetet bibliotekare të punës (katalogë, bibliografite etj.). Sidomos është e domosdoshme të njihet radha e shkronjave që ne nuk ekemi (p, q, r, v, x, y, z, dhe të ngjashme.).

2. Duhet të llogarisë në radhën me të cilën janë rradhitur skedat katalogjike.

3. Paraprakisht duhet ta përcaktojë formën e saktë bu-
rimore të emrit të autorit të huaj veprën e të cilit e kërkon.

4. Është e nevojshme po ashtu të lexohen në bibliotekë shpalljet me informata të ndryshme. Nganjëherë, nëse lëshon ta lexojë vetëm ndonjë shpallje, lexuesi i paudhëzuar mund të humb jopak kohë në kërkimin dhe gjurmimin e kotë. Kështu, për shembull, në *Katalogun e Përgjithshëm* të Bibliotekës së Muzeumit Britanik në Londër shkronjat U dhe V janë trajtuar si një shkronjë, dhe kjo vërejtje është dalluar në vend të dukshëm në raftin në të cilën gjenden fletoret me fjalët që fillojnë me shkronjat e cekura ("*U and V: treated as one letters*"). Mirëpo, nëse lexuesi i paudhëzuar nuk e vëren këtë vërejtje, ai së koti do të mundohet dhe nevrkoset duke kërkuar ndonjë emër që fillon me shkronjën U ose V.

5. Ditët e para të punës në ndonjë bibliotekë duhet në masë të konsiderueshme t'ia kushtojë edhe njoftimit me organizimin dhe funksionimin e saj. Për këtë qëllim duhet, pos tjerash, të lexohen të gjitha udhëzimet deri te të cilat lexuesi mund të vijë, kurse të cilat janë në të destinuara për lexuesin. Udhëzimet e tilla i japin të gjitha bibliotekat më të mëdha botërore, dhe ato janë në dispozicion të lexuesve. Kështu Biblioteka e Muzeumit Britanik i ka botuar udhëzimet me titullin: *Notes for Readers*, kurse në Bibliotekën Kombëtare në Paris ekziston, pos tjerash, libërthi i shkurtër, me karakter informativ të cilën në edicionin *La Documentation Française Illustrée*, me titullin *La Bibliothèque Nationale*, e ka publikuar Drejtoria Franceze për Dokumentacion. (*Direction de la documentation*), dhe ai mund të blehet në shitore të bibliotekës. Qëllimit të njëjtë mund t'i shërbejë edhe *Guide du lecteur à la Bibliothèque Nationale, à la Mazarine et à l'Arsenal* (Paris, Morancé, 1930, 46 p.).

Duhet po ashtu të kontrollohen katalogët e ndryshëm (ku janë të vendosur, cili sistem i katalogjizimit në to është aplikuar e të ngj.), doracakët (cilët doracakë biblioteka i vë në dispozicion për lexuesit e vet: cilat enciklopedi, fjalorët biografikë etj., dhe ku e si janë të vendosur ata), bibliografitë dhe repertorët e ndryshëm bibliografikë, reverset e ndryshme (duke mos harruar të lexohet edhe ajo që gjendet në passhpinën e tyre) dhe përgjithësisht të gjitha mjetet e punës që ndonjë bibliotekë ia ofron lexuesit.

IV. Tubimi i lëndës

Pas zbulimit të dokumenteve dhe hartimit të bibliografisë së punës, detyra e parë që shtrohet në procesin e punimit të një punimi shkencor është tubimi i lëndës. E vërteta, këtë lëndë autori, së paku në një pjesë, tashmë e ka tubuar para se ta ketë bërë edhe zgjedhjen e temës: pa atë dokumentacion të pjesërishëm ai, në realitet, as që ka pasur mundësi ta vlerësojë përshtatshmërinë e temës për përpunimin shkencor, as ta kryejë, sipas këtyre, zgjedhjen e saj; do të duhej t'ia imponojë dikush më me përvojë të cilit problematika e caktuar i është më e njohur ose i cili, në bazë të dokumentacionit të tubuar, ka provuar përshtatshmërinë e temës. Mirëpo, tash është në pyetje tubimi sistematik, më i gjerë, sa më i plotë që të jetë e mundur i atij dokumentacioni, lënde.

Tubimi i dokumentacionit mund të fillojë me disa ide dhe hipoteza tashmë më pak apo më shumë të skicuara, të sakta ose jo të sakta për temën. Madje jorrallë ndodh që të fillohet me njëfarë qëllimi të caktuar, me ndonjë cak më preciz që ndonjë qëndrim ose pikëpamje të argumentohet, ndonjë mendim të arsyetohet. Ky qëndrim, pikëpamje, ide, nuk janë ende të sigurta: ata përbëjnë vetëm njëfarë lloji të supozimit, hipotezës së punës (respektivisht hipotezës shkencore), që do të bëhet e vërtetë vetëm me kusht që të tregohet e saktë, e verifikuar, përndryshe do të mbetet vetëm supozim, pohim, paragjykim arbitrar. Edhe hulumtuesi pikërisht për këtë qëllim nxjerr eksperimente të tilla për të cilat paraprakisht konsideron se mund t'i sjellin rezultate, fakte dhe informata të dëshirueshme. Këto hipoteza të procesit të pu-

nës shkencore kanë rëndësi jo të vogël në lëmin e hulumtimit shkencor: “shumësia e shfaqjeve është aq e madhe për çdo lëndë që synon drejt shpjegimit, e jo vetëm deskribimit, që atij mund t’i qaset me sukses pa hipotezë, të kornizuar me përdorimin e imagjinatës shkencore”. Në pajtim me këtë, hipotezat shkencore hulumtimit i japin orientim, paraqesin “orientimet kryesore” të tij. E megjithatë, hulumtuesi nuk guxon në asnjë rast të ngurrtojë që ato hipoteza shkencore t’i modifikojë, nëse është e domosdoshme, e madje edhe krejtësisht t’i lëshojë nëse në këtë e nxisin faktet, rezultatet e hulumtimit. Sepse hipoteza duhet t’u përshtatet fakteve, e jo e kundërta, faktet të përshtaten sipas hipotezës paraprakisht të shtruar. Në rastet e këtilla, pra, drejtimi i tubimit të lëndës do të jetë në masë të konsiderueshme i caktuar dhe i lehtësuar. Përkundër kësaj, kur aso ide dhe hipoteza nuk ka, tubimi në fillim është i vështirësuar dhe zhvillohet në plan të gjerrë, pa kriter më të rreptë në zgjedhjen e dokumentacionit.

Hipoteza, siç është e njohur, është me rëndësi të posaçme në shkencat eksperimentale, në të cilat më së shumti edhe vjen deri te aplikimi i metodës eksperimentale: hipoteza i shërben eksperimentuesit si ide udhëheqëse në hulumtim, ia ndriçon rrugën nëpër mbretërinë e territ dhe pa të ai mezi edhe do të mund të kryente hulumtime të frytshme dhe seleksionimin e fakteve.

Punën e vet në temë hulumtuesi e fillon rëndom me përpunimin e literaturës për lëndën: është e natyrshme, dhe e domosdoshme, që ai, para se t’i fillojë hulumtimet vetjake, të mëvetshme, të njoftohet me “gjendjen bashkëkohore të studimeve” për ndonjë problem, që ta njoftojë ‘*status questionis*’ përndryshe mund t’i ndodh që “përsëri ta zbulojë Amerikën”.⁶² Me të drejtë në rrezikun e ti-

⁶² Personalisht njoh ekspertë që, jo mjaft të informuar, patën marr si objekt të tezave të veta të doktoraturës temat që tashmë kanë qenë plotësisht mirë dhe ndërgjegjshëm të përpunuara. Pasojë e atij mosinformimi fatal ka qenë që janë detyruar ta ndërrojnë temën e disertacioneve të tyre, dhe këtë njëri prej tyre atëherë kur tezës së vet tashmë ia patë dhënë pothuaj formën përfundimtare.

llë ka tërhequr vërejtjen, pos të tjerëve, S. A. Rajnbergu: *"Kujt nuk i është e njohur që shkencëtarët, nganjëherë me shpenzimin e madh të forcave të veta emocionale, plotësisht ndershëm, mëvetshëm dhe pavarshëm, bëjnë zbulime për të cilat tashmë me shfletimin e parë kalimthi të librave rezultojnë se janë vetëm përsëritje e diçkaje që tashmë kaheerë është e njohur."*⁶³ Përveç kësaj, punimet e paraprijësve, me fjalë të tjera literatura për lëndën, do t'i ndihmojë hulumtuesit që më mirë t'i kuptojë burimet parësore, ta fitojë fotografinë më të plotë e më besnike për natyrën dhe vlerën e tyre.

Çështja e parë që kandidati duhet ta përpunojë, kur është fjala për literaturën për lëndën, janë veprat dhe shkrimet më të reja dhe më të mira nga ndonjë lëmi. Në këtë, pos arsimtarit, mund t'i shërbejnë si udhërrëfyes edhe recensionet kritike të veprave në revista. Dhe vetëm pas përpunimit të atyre veprave dhe shkrimeve të rëndësishme, fillohet me veprat dhe shkrimet tjera, më pak të rëndësishme, që, ndoshta, nuk do të jenë gjithnjë të domosdoshme në tërësi as të studiohen: do të mjaftojë, në rastin e caktuar, vetëm pjesërisht të lexohen, ose madje vetëm të shfletohen.

Duhet sidomos të ceket që përpunimi i literaturës, sidomos kur ajo është e vëllimshme dhe numëron me qindra shkrime, nuk është fare gjë e lehtë dhe mekanike, por është kjo punë në të cilën ka mjaft elemente krijuese: lexuesi ndaj literaturës që e përpunon duhet që gjithnjë të sillet aktivisht, që ndaj fakteve dhe ideve që i ndesh në të dhe eventualisht i vjel, të marrë qëndrim kritik.

Pasi është përpunuar literatura profesionale për lëndën, fillohet me hulumtimet vetjake - përpunimin e burimeve parësore.

Kuptohet, rendin e përmendur të përpunimit të dokumenteve nuk duhet kuptuar në mënyrë rigoroze, si i vetmi i mundur: në disa raste, natyra e ndonjë teme dhe

⁶³ O.c., fq. 39.

fakti që janë të domosdoshëm për përpunimin e saj, do të jenë të atillë që do të imponojnë zbrapsje më të vogël ose më të madhe nga rendi i sipërm.

Tubimi i dokumentacionit përfshin dy fazat kryesore: 1) leximin dhe kritikën e teksteve; 2) shkrimin e shënimeve. Këto dy faza (sikur ka qenë rasti edhe me etapat e hartimit të punës shkencore) reciprokisht përzihen dhe mjaft shpesh zhvillohen njëkohësisht: duke e lexuar, për shembull, ndonjë fragment të tekstit, lexuesi në të menjëherë edhe reagon me kritikën dhe formulimin e shënimit. Por, për shkak të pasqyrimin më të mirë dhe trajtimit më të themeltë, ne për secilën prej tyre do të flasim në mënyrë të veçantë.

A. Leximi dhe kritika e teksteve

Leximi, me anë të të cilit njoftohemi me përmbajtjen e shkrimeve dhe vjelim nga ato lëndën (faktet, idetë⁶⁴),

⁶⁴ Duhet bërë dallimin rigoroz ndërmjet një fakti dhe një ideje, që jorrallë ngatërrohen dhe identifikohen. Ideja është fakt që në njëfarë mënyre është interpretuar. Kjo d.m.th., e shprehur me gjuhë matematikore, ideja = fakti + interpretimi. Fakte të pastra, d.m.th. fakte të papërziera me ide, janë, për shembull, emrat e personaliteteve, titujt e veprave, datat e sigurta të ndodhjeve e të ngj. Kështu, kur themi N. N. është student i yni i gjuhës franceze, kemi cekur një fakt që lehtë provohet, që është evident. Mirëpo, nëse fjalinë e cekur e modifikojmë dhe themi: N.N. është studenti ynë më i mirë i gjuhës franceze, kemi shprehur një ide që nuk është lehtë gjithnjë të provohet, dhe e cila nuk është aq e qartë sikur fakti i sipërpërmendur. Në dokumente, e sidomos në shkrime, faktet e pastra, autentike rrallë vijnë vetvetiu. Ato pothuaj gjithnjë janë të përziera me idetë, e jorrallë janë edhe të sakatosura për këtë arsye, qoftë pa qëllim për shkak të pasioneve, paragjykimeve, pikëpamjeve a priori e të ngjashme, qoftë me qëllim, që lexuesi të bindet në atë në çka dëshiron të jetë i bindur. Hulumtuesi i papërvojë ose jokritik pranon, sipas rregullit, shumë ide dhe fakte në mënyrë jokritike, me çdo risi të gatshme, derisa hulumtuesi me përvojë dhe kritik do të dallojë, nga një anë,

paraqet proces të ndërlikuar e të rëndë, shkathtësi që njeriu e mëson dhe e arrin tërë jetën. Të përkujtojmë se sa problem shtron leximi para lexuesit të rëndomtë inteligjent i cili dëshiron që ai t'i jetë aktiv, "frytdhënës": problemit në aspekt të intensitetit të leximit të disa teksteve ose pjesëve të teksteve (më të lehta apo më të rënda), në aspekt të përsiatjes për të lexuarën, vrojtimit të planit të disa pjesëve të tekstit, dallimit të fakteve dhe ideve qenësore prej atyre joqenësore, në aspekt të llojeve të ndryshme të shënimit të tekstit që lexohet, bërjes së shënimeve të llojllojshme, skicave, planeve, etj. Saktë në këtë ka dhënë shenjë Gëte: "Ata njerëz të mirë [...] nuk dinë sa kohë e mundime është dashur që dikush të mësojë se si lexohet. Mua për këtë më janë nevojitur tetëdhjetë vjet, e as tash ende nuk mund të them se jam në cak".⁶⁵

Sikur që as për shumë aktivitete tjera intelektuale, ashtu as për shkathtësinë e leximit nuk ka ndonjëfarë normash apo recetash të përcaktuara që do të vlenin për çdokund dhe për të gjitha rastet: ajo shkathtësi varet nga faktorët e shumtë - karakterit të tekstit, arsimimit dhe shprehisë së lexuesit, afiniteteve të tij dhe temperamentit, etj. Këtu do të dëshironim të përkujtojmë në disa parime më të njohura që munden, sipas mendimit tonë, leximin ta bëjnë më aktiv, më frytdhënës, më efikas.

Në radhë të parë, është e domosdoshme që teksti i shkrimit - në tërësi dhe në hollësi - tërësisht të kuptohet, mirë të merret vesh në të çdo fragment, çdo fjali, çdo fjalë. E që të arrihet kjo, leximi duhet të bëhet ngadalë, me vëmendje, durueshëm, sidomos kur është fjala për

faktet e pakontestueshme nga të gjymtosurat dhe, nga ana tjetër, idetë e sakta nga pikëpamjet, paragjykimet e shtrembëruara e të ngjashme. Sidomos është me rëndësi që lulumtuesi mos t'i pranojë, pa frymë të mjaftueshme kritike, si të vërteta faktet që i janë të këndshme, për të cilat është i interesuar, të cilat e argumentojnë qëndrimin, hipotezën dhe teorinë e tij.

⁶⁵ J. P. Eckermann, o.c., fq. 163.

tekstet më të rënda ose për pjesët më të rënda të ndonjë teksti; dhe, sidomos, ai duhet të lidhet me përsiatjen intensive: atë që e lexon, duhet lexuesi, duke e ndërprerë për një çast leximin, ta sjellë në lidhje me përvojën dhe dijen (njohuritë) që për atë tashmë i ka, që më herët i ka fituar (në praktikën e vet jetësore, në profesion, nga librat), duke i vërtetuar vazhdimisht në vete dhe rreth vetes faktet, idetë, të vërtetat që i ofron teksti i lexuar. Kjo d.m.th., ndaj tekstit që e përpunon lexuesi duhet të ketë raport gjithnjë kritik. Ai në asnjë rast nuk guxon të lejojë që ta magjepsë autoriteti i autorit dhe që në mënyrë jokritike t'i pranojë mendimet e tij, e kjo jorrallë iu ndodh të gjithëve, sidomos lexuesve të rinj e të papërvojë, që në të shumtën e rasteve verbër i besojnë autorit që e studiojnë, kanë besim të pakufizuar në atë që ai e ekspozon. Mendimet, botëkuptimet, qëndrimet që shtrohen në tekst ai duhet që t'i "peshojë e vlerësojë", t'ia nënshtrojë analizës së gjithanshme, hulumtimit nga aspektet e ndryshme: lënda që e ofron teksti a është relevante për lëndën e tij; a e ka vjelë autori këtë lëndë nga dora e parë apo e dytë, ndoshta edhe nga dora e tretë, (kujdes të posaçëm duhet treguar ndaj dy llojeve të fundit të lëndës dhe në bazë të mendjes së shëndoshë të gjykohet për vlefshmërinë dhe vlerën e tyre); a janë vlerësimet, përgjithësimet, përfundimet e autorit - të sigurta, të privuara nga paragjykimet dhe parabindjet e ndryshme (fetare, shoqërore, politike e të tjera), me një fjalë, të atilla që lexuesi të mund të mbështetet në ta; a gëzon autori autoritet në profesionin e vet dhe ku dhe kur shkrimi i tij është publikuar (në revistën autoritative, në botim të shtëpisë botuese të renomuar ose e kundërta), etj.⁶⁶ Në bazë të

⁶⁶ Krls. Ch. H. Visian and M. J. Bernetta, English composition, fq. 122. - Për vlerat e librit nganjëherë lexuesi mund ta fitojë pasqyrën edhe sipas disa fakteve të tij të jashtme: sipas vitit të botimit, që dëfton deri diku në bashkëkohësinë e tij, që në asnjë rast nuk d.m.th. që edhe librat e vjetër, për

hulumtimit të tillë të themeltë e të ndërgjegjshëm të tekstit lexuesi konceptcionet e autorit do t'i miratojë ose refuzojë, në tërësi ose pjesërisht, duke pasur sidomos kujdes mbi atë që përfundimet e veta mos t'i nxjerrë ose gjykimet mos t'i sjellë ngutshëm, pa menduar mirë.

Vendet që eventualisht nuk i kupton, lexuesi duhet t'i lexojë përsëri dhe të mendojë për to derisa nuk i kupton ato. Aleni (Alain) në lidhje me këtë bukur ka thënë: "Kush nuk fillon me moskuptim, i tilli edhe nuk di ç'do të thotë të mendosh". Marrë në përgjithësi, një lexim nuk mjafton; sadoqoftë leximi i parë të jetë i vëmendshëm, i përmbajtur, i ndërgjegjshëm, gjatë tij rrallë do të mund të hetohen dhe zbulohen të gjitha ato ide dhe fakte interesante e të dobishme që i fsheh teksti - për këtë është i domosdoshëm ndonjë tekst të lexohet dy, tri, e edhe më shumë herë: "*Tekstin duhet përsëri ta lexosh aq herë sa pyetje kemi t'i shtrojmë; duhet, pra, të lexohet dhjetë, njëzet, njëqind herë*", - thotë hiperbolikisht një historian i dalluar.⁶⁷

Ka nevojë të jepet shenjë edhe në atë që, me rastin e tubimit të lëndës, nuk është e domosdoshme të lexohet çdo libër, shkrim, në tërësi, prej fillimit deri në fund. Librat që në rastet e tilla meritojnë të lexohen nga koper-tina në kopertinë, bëjnë pjesë në librat e rrallë. Mjafton

cilëndo qoftë disiplinë shkencore të jetë kjo, nuk mund të jenë të vlefshëm dhe më të vlefshëm se më të rinjtë; sipas titullit të librit, që shpreh, ose do të duhej të shprehë përmbajtjen dhe pikarritjen e veprës, sikur edhe vëllimin e hulumtimeve; sipas parathënies dhe hyrjes, që dëftojnë qëllimin dhe planin e veprës, karakterin e hulumtimeve, vëllimin dhe kufijt e tyre, dëftojnë në burimet që janë shfrytëzuar ose nuk kanë mund të jenë të shfrytëzuara, e të ngj.; sipas indeksit të librit, është aq i rëndësishëm për ndonjë libër saqë të rralla janë veprat që mund të jenë të privuara nga indeksi; sipas apendiksit, që përmban shpesh material majft të dobishëm dhe interesant që nuk është futur në tekst në kuptim të ngushtë; sipas bibliografisë, dobia e së cilës për lexuesin është e pavlerësueshme; sipas fusnotave, etj. (Cf. Fr. Cordasco and E. S. M. Gatner, o. c., pp. 23 - 26.)

⁶⁷ Robert Marichal, "La Critique des textes; në: L'Histoire et ses methodes, fq. 1356.

të lexohen vetëm ato pjesë që ofrojnë informacione shkencore (të dhëna, ide) për temën e caktuar. Në atë pikëpamje mund të jetë i dobishëm indeksi i emrave, përkatësisht i nocioneve dhe përmbajtja e librit, që duhet kontrolluar para të gjitha pjesëve të librit. Së këndejmi i a. q. “lexim diagonal” ose “lexim sipas diagonales”, me rastin e të cilit fluturohet mbi të gjitha ato pjesë të librit ose shkrimit që për përpunimin e temës së caktuar nuk janë me interes. Do të ishte e gabueshme së këndejmi leximin e tillë, eventualisht, ta konsiderojmë sipërfaqësor ose të pandërgjegjshëm. Ai, në realitet, i kursen lexuesit humbjen e kotë të kohës: nëse ai çdo shkrim e lexon prej fillimi deri në fund, do të shpenzonte shumë më tepër kohë për tubimin e lëndës se që është e nevojshme. E megjithatë, duhet menduar mirë se a është leximi i tillë i mjaftueshëm dhe i volitshëm.

B. Shkrimi i shënimeve

Hartimi i ndonjë punimi shkencor me vëllim më të madh as nuk mund të mendohet pa përgatitjen paraprake të shënimeve: nuk ka aso mbamendje, sado ajo të jetë prapuese dhe e sigurt, që në vete do të mund t'i ruajë dhe t'i bartë të gjitha elementet (faktet, idetë, citatet e të ngj.), të domosdoshme për hartimin e një punimi më të vëllimshëm. Saktë thotë anekdota e vjetër kineze se edhe ngjyra më e zbehtë në letër është shumë më e sigurt nga mbamendja më e mirë. Prandaj çdo punëtor shkencor duhet të bëjë me qindra e mijëra shënimesh të ndryshme para se t'i qaset shkrimit: ato do t'i shërbejnë si lëndë për hartimin e punimit.

Së këndejmi është e domosdoshme të kapërcehet teknika e punimit të shënimeve dhe shfrytëzimit të tyre:

edhe këtu, sikur edhe tjetërkund, ai që është aftësuar në këtë nuk e humbë së koti kohën dhe energjinë e vet. E vërteta, mënyra e punimit të shënimeve varet, në masë të konsiderueshme, nga vetë lënda, e sidomos, nga individualiteti (temperamenti, shprehja) i vetë hulumtuesit. E megjithatë, ndonëse as në këtë punë, sikur as në shumë të tjera, nuk mund të jepen disa rregulla që do të vlenin për të gjitha rastet, mund të shtrohen disa parime të përgjithshme që hulumtuesit të papërvojë mund t'i jenë të dobishme, së paku për kohën e parë, derisa vetvetes nuk ia ndërton sistemin vetjak të punimit të shënimeve.

Menjëherë duhet thënë se shënimet, duke e marrë parasysh përmbajtjen dhe formën e vet, mund të jenë të kategorive të ndryshme, sikur: bibliografike (për të cilat tashmë është bërë fjalë), dokumentuese, d.m.th. ato që i përkasin lëndës, temës që përpunohet, metodologjike, d.m.th. ato që kanë të bëjnë me metodën dhe teknikën e të ngj. Secila nga këto kategori sërish, nga ana e vet, mund të ndahet në lloje. Kështu, kemi parë, shënimet bibliografike mund të jenë të rëndomta dhe kritike; ato dokumentuese, duke e marrë parasysh burimin nga janë vjelë, mund të ndahen në: shënime të vjela na dora e parë (nga burimet parësore: dorëshkrimet, dokumentet arkivore, ose librat e rrallë - sipas rregullit, këto shënime janë më të vlefshmet), nga dora e dytë (nga burimet dytësore), shënimet që janë observime personale dhe kritike e të ngj. Më tej, sipas formës së vet, shënimet mund të jenë kopjet tekstuale, perifrazat, rezymetë e ndonjë teksti, e të tjera.

Kur është fjala për punimin e shënimeve të karakterit dokumentues, menjëherë del një problem që në shikim të parë duket i pazgjidhur, dhe në të cilin dëftojnë disa teoricienë.⁶⁸ Nga një anë, autori ende nuk e ka të qartë se cilat informata do t'i shënojnë në skeda, pasi që

⁶⁸ Cf. Ch. Sanders, *An Introduction to research in English literary history*, pp. 290-291.

lënda ende nuk i ka marrë konturat e sakta dhe nuk i është e njohur përmbajtja dhe forma e punimit, nga ana tjetër, përmbajtja dhe forma e punimit do të jenë të qarta dhe tema do të saktësohet vetëm kur autori të zotërojë me materialin themelor të punimit. Dalja nga ky rreth magjik është, sipas mendimit të Sandersit, në atë që lexuesi, para se të fillojë t'i marrë shënimet, lexon vetëm atë që është literaturë orientuese, dhe vetëm atëherë kur, duke iu falënderuar këtij leximi orientues, në vetëdijen e autorit më saktë dhe më qartë janë skicuar konturat e lëndës, kalohet në marrjen e shënimeve:

Dy gjëra (thotë Sandersi), duhet t'i bëjë ai që dëshiron të jetë i sigurt se shënimet që do t'i marrë do t'i jenë të dobishme. E para, ai duhet të lexojë mjaft nga ajo lëmi shkencore që synon ta hulumtojë, duke mos marrë gjatë kësaj kohe kurrfarë shënimesh tjera, pos atyre bibliografike. Kur ai të orientohet në masë të mjaftueshme, problemi do të fillojë ta marrë formën e atillë sa që ai do të mund të përcaktohet për ndonjë informatë në të cilën hasë se a është apo nuk është relevante për hulumtimin e tij, e po ashtu, nëse është relevante, cilin vend ajo do ta marrë në zgjidhjen e problemit të tij. Sa do të jetë i domosdoshëm ky lexim orientues, do të varet, kuptohet, nga ajo se në çfarë mase studenti zotëron me prapavinë e temës, sikur edhe nga natyra e vetë problemit. Pjesa më e madhe e lëndës nga ai lexim paraprak do t'i përgjigjet qëllimit të vet kur ky lexim në bazë më të gjerë të mbarohet dhe ai nuk do të ceket në vetë punimin sepse studenti do të gjejë, sigurisht, burime më autoritative për cilëndo informatë të vjelur nga leximi paraprak dhe do të ketë rast që t'i përdorë...!

Sandersi shton se kalimthi duhet të shënohen pyetjet dhe problemet që eventualisht do të dalin gjatë leximit paraprak, orientues.⁶⁹

⁶⁹ Po aty., p. 291.

Shumica e hulumtuesve, si duket, i shkruajnë shënimet (më së shpeshti citate, më rrallë rezymetë e fragmenteve dhe refleksionet vetjake) në fletore ose në fleta letre të madhësisë standarde (21x29.5). Kështu, shënimet vetëm nga një vepër mund të zënë nganjëherë pjesë të konsiderueshme të fletores ose dhjetëra arakë letër. Kjo mënyrë e bërjes së shënimeve ka anët e veta të mira dhe të këqija. Ana e mirë është ajo që në këtë rast tërë materiali nga një vepër gjendet i tubuar në një vend (në fletore ose në tabakët e letrës) dhe në këtë mënyrë lehtë ruhet dhe sërish lehtë mund të gjendet kur ka nevojë. Krahas kësaj, para përdorimit, lënda kështu e shkruar është e domosdoshme të asimilohet mirë, me të lexuar dhe të përsiatur të shumtë. Nga ana tjetër, mangësia e mënyrës së këtillë të të shënuarit të lëndës qëndron në atë se ajo është e palëvizshme, e lidhur për një vend, pothuaj e gurrëzuar, e vdekur dhe se është e pamundur të lëvizen, të transferohen pjesët e saj tjetërkund dhe të transferohet, të interpolohet lënda tjetër, shënimet në të.

Mënyra tjetër është të shkruarit e shënimeve në fisha (skeda letre). Kjo mënyrë, edhe përkundër disa mangësi-ve të veta, ka disa përparësi ndaj paraprakes: ndonëse sistemi i shënimeve në fisha kërkon rregull dhe sistematizim të madh (fishat lehtë përzihen, humben dhe në çastin e dhënë nganjëherë është shumë rëndë të gjendet ajo që është e domosdoshme), ai ka atë anën e mirë që skedat janë mjaft të lëvizshme dhe lehtë, sipas nevojës (kompozicionit, lëndës, idesë, asociacionit, etj.), lëvizen, translocohen, lidhen njëra me tjetrën, interpolohen njëra me tjetrën, e të ngj.

Të dy këto mënyra të të shkruarit të shënimeve shkathtësisht mund të kombinohen: shënimet më të vogla të shkruhen në fisha, kurse për shkrimet e vëllimit më të madh të përdoren skedat e formatit standard ose të fletores. Për këtë secili duhet vetë të vendosë dhe të zgjedhë ndonjë sistem të shkruarjes së shënimeve që i

përgjigjet shijes, temperamentit, natyrës së tij.⁷⁰ Kur përdoret fletorja, preferohet anash të lihet këndi dhe të shkruhet për çdo shënim ndonjë fjalë që shpreh përmbajtjen e saj: *keyword* (fjala çelës).

Fishat mund të jenë me madhësi të ndryshme: 7.5 x 12.5 cm; 11 x 17 cm; 12 x 8 cm; 12 x 20 cm; etj. Përdorimi i fishave të madhësisë së caktuar varet prej shumë faktorëve: në radhë të parë prej shprehive dhe shijes individuale të hulumtuesit, e në masën e caktuar edhe nga disiplina shkencore dhe tema që përpunohet. Kështu linguistët, kur e përpunojnë temën nga semantika, rëndom kanë punë me aktet e vëllimit më të vogël (fjalët e të ngj.), dhe se mund t'i shkruajnë në fishat e formatit më të vogël se sa, për shembull, historianët. Madhësia e fishës mund të varet edhe nga dorëshkrimi; atij që shkruan me shkronja të mëdha do t'i nevojitet më shumë hapësirë për ndonjë shënim se sa atij dorëshkrimi i të cilit është i imët. Në të njëjtën kohë mund të përdoren edhe fishat e madhësisë së ndryshme: disa për shënime më të vogla (për shembull, për bibliografinë), kurse të tjerat - për shënimet më të gjata (për shembull, për shënimet për temën), etj. Gjatë kësaj është me rëndësi: kur të vendosë për një madhësi, hulumtuesi duhet që atë gjithnjë dhe në mënyrë të përpiktë ta përdorë.⁷¹

Disa, për këto qëllime, shërbehen me fishat të bëra nga kartuqi,⁷² por fishat e këtilla janë të shtrenjta, dhe

⁷⁰ Për disa lloje të shënimeve do të jenë më të përshtatshëm tabakët e letrës: për lëndën arkivore, për shkrimet më të gjata nga ndonjë vepër, për letrat e të ngj. Përvoja vetjake më ka treguar se fishat janë të përshtatshme kur tubohet dokumentacioni për ndonjë temë të caktuar, derisa, përkundrazi, fletorja është më e përshtatshme për shënimet që bëhen për çdo ditë gjatë lekturës, përsiatjeve për të dhe me rastin e saj.

⁷¹ Fishat e madhësisë së ndryshme mund të porositen në shtypshkronjë; kurse mundet, thjeshtë, edhe secili për vete t'i bëjë, duke e prerë tabakun e letrës në tetë pjesë të njëjta.

⁷² Në Paris libraritë shesin fisha të cilësisë, formatit dhe ngjyrës së ndryshme.

rrallë vijnë në shprehje për fisha dokumentuese, sidomos kur është i nevojshëm një numër i madh i tyre. Mirëpo, fishat e kartuqit të madhësisë standarde (7,5 x 12,5) janë të përshtatshme për bibliografinë e punës.

Në fisha shkruhen shënimet e llojeve të ndryshme: citatet (fragmentet tekstualisht të përshkruara të tekstit), mendimet nga tekstet e parafrazuara ose të rezyмуara; mendimet dhe refleksionet vetjake që lexuesit i bien në krye gjatë përpunimit të tekstit në kontakt me mendimet dhe vrojtimit e autorit, qëndrimet dhe pohimet; vërejtjet kritike në mendimet dhe qëndrimet e ndryshme të shprehura në tekst, e të ngj. Gjatë kësaj autori duhet të kujdeset për atë që shënimin ta shkruajë sipas mundësisë në atë formë në të cilën do ta përdorë në punë: ashtu që ajo të mundet, si e tillë, jo vetëm me përmbajtje por edhe me formë sa më mirë të përshtatet në indin e tekstit.

Por pa marrë parasysh në llojin e shënimit, është me rëndësi që secili prej tyre të shkruhet në fishë të veçantë. Kjo d.m.th., është e domosdoshme që në një fishë të shkruhet vetëm një informatë shkencore, një “njësi informative” (një fakt, një e dhënë, një ide, një citat, një refleksion vetjak e të ngj.), që ka të bëjë vetëm me një problem, me një ide, me një lëndë, me një autor. Vetëm në atë rast fishat do të jenë lëvizëse, do të mund të bëhen me to translocime, permutacione dhe interpolacione të ndryshme. Për atë sistem të shënimeve në gjuhën angleze ekziston edhe sintagmë e veçantë: *The single-fact-to-a card system*.

Natyrisht, kjo rregull, siç cek Sandersi, është lehtë të vendoset dhe mësohet, por është vështirë të aplikohet; aplikimi i saj huton jo pak ekspertin e papërvojë: “Të mësohet të njihet ajo që e përbën njësinë e lëndës kërkon aftësinë e dallimit dhe, nganjëherë, një pjesë të mirë të supozimeve. Njësia e lëndës është ajo shumë informata - e qoftë ky paragraf, fjali, frazë ose fjalë - që do të qëndrojë vetvetiu në punimin e kryer shkencor dhe në të cilën kurrfarë informate tjetër, pos mbase komentit të

autorit të punimit, - nuk do të hyjë me siguri.⁷³ E në qoftë se duhet përshkruar, parafrazuar ose rezymuar fragmentin më të gjatë të tekstit, kjo mund të bëhet në disa fisha, të cilat paginohen dhe lidhen me mbërthesë.

Krahas përmbajtjes (së civateve, rezymesë, e tj.), në fishë shkruhen edhe disa të dhëna tjera të domosdoshme: titulli i temës për të cilën tubohet dokumentacioni (ai vihet menjëherë në fillim të fishës, në krye), emri i autorit dhe titulli i shkrimit që përpunohet, me të dhënat më të domosdoshme bibliografike (ato vihen rëndom në fund ose në krye). Këto të dhëna në fishën dokumentuese shkruhen në formë të shkurtuar, pasi që të dhënat e plota gjenden në fishën bibliografike. Kjo d.m.th., se nga të dhënat bibliografike mjafton të përmendet emri i autorit dhe numri i faqes; e edhe titulli nëse konsultohet me shumë shkrime të një autori. Preferohet që në fishë të shkruhet edhe titulli i kaptinës së temës të cilës fisha i përket dhe që i përgjigjet titullit të kaptinës nga plani (që të gjithë titujt e kaptinave të jenë parasysh me rastin e punimit të shënimeve. Disa preferojnë që ato të shkruhen në fishë të veçant, që gjendet gjithnjë në dorë), sikur edhe përmbajtjen e shkurtër të fishës (të shprehur me një ose me dy fjalë). Gjatë kësaj aty-këtu janë të domosdoshme disa hamendje: çfarë titulli t'i jepet shënimit, në çfarë kaptine ta vendosë, e të ngjashme.

Disa këshillojnë se me rastin e shkrimit të shënimit, të lënë në fishë margjinën prej rreth dy deri dy e gjysmë centimetra, në të cilën futen: data e punimit të shënimit (ajo mund të jetë interesante duke e marrë parasysh se dëfton evolucionin e idesë së caktuar), të dhënat eventuale më të vonshme (me datën e tyre), data e koalicionimit, referencat mbi burimet e të ngjashme.⁷⁴ Për shembull:

⁷³ Ch. Sanders, o. c., p. 293.

⁷⁴ Po aty., pp. 293 - 294.

- 67 [Praktikimi që na flet, shpreh qartë, dhe në mënyrë të qartë, vërtetë në ato ditë të dy të parë të shkruarit të fjalës, me një vlerë të paktën. Në këtë praktikë të shkrimit, në mënyrë të qartë dhe të shprehur, shprehim të gjitha eventuale të evolucionit dhe të ndryshimit (shprehje), dhe në eventuale të ndryshimit, dhe të shprehur, referencat e vlerave të tjerë - sipas shkruarit, O. c., p. 291-299.]
7. 1. 67 L. O. Dow (Principles of Note - System, p. 40-41)
10. ... it is well to have a little margin at the left of the slip or card but thing that can be put there is the date of making the note. To be able to see the sequence in one's accumulations, or thinking or organizing, is very often of great help."
- Shprehimi
: 11. 8. 67.

Pothuaj është mendim i përgjithshëm se shënimet duhet shkruar vetëm në një anë të ffishës: në atë rast, me rastin e redigjimit të dorëshkrimit, autori nuk ka nevojë që ffishën ta kthejë që të shohë çka ka shkruar në anën tjetër; ai tërë përmbajtjen e saj e ka para sysh. Përveç kësaj, ffishat atëherë mund të prehen dhe disa pjesë të tyre ta ndërrojnë vendin e të lidhen sipas përmbajtjes.⁷⁵ Përvoja ime personale vërteton pothuaj këtë mendim të gjithëpranuar: ajo më flet që, edhe pse nuk ka ndonjë gabim të madh që shënimi të përcillet edhe në shpinë të ffishës (aq më parë që përmbajtjen e saj autori pa tjetër edhe ashtu duhet që mirë ta njohë dhe ta asimilojë para se të formulojë ndonjë mendim në tekst), megjithatë kjo nuk është e përshtatshme të bëhet, dhe këtë nga arsyeja që përmbajtja e shënimit në atë rast jo vetëm që nuk është e shikueshme, por shpesh nuk është as e hetueshme. Derisa më herët i kam shkruar shënimet në të dy anët e ffishës, nganjëherë është dashur që t'i trazoj dhe hedh andej e këndej ffishat e njëjta edhe nga disa herë që,

⁷⁵ "Shkruani vetëm në një anë", këshillon Rajnberg, "sepse më vonë do të duhet të punoni me gërshërë. Tekstin e shkruar në shpinë të letrës do të duhet, më në fund, sërish ta përshtatni". (O. c., fq. 51).

pas humbjes jo të vogël të kohës dhe nevrikosjes, ta gjejë atë fishë që kam dëshiruar ta gjejë.

I rëndësishëm është edhe redigjimi i shënimeve në fisha, i cili nuk është fare punë mekanike, por kërkon aktivitetin e plotë ideor: në vend që mekanikisht të përshkruhen fragmentet e gjata të tekstit, më mirë është të bëhet përpjekje ideore që përmbajtja e fragmentit të asimilohet dhe të shënohet shkurtimisht në fishë me fjalët vetjake. Ç'do të shkruajmë në fisha në disa raste, varet nga shumë faktorë: nga karakteri i temës, nga vlera e tekstit që përpunohet, përvoja dhe shkathtësia e lexuesit, temperamentit, asociacionit dhe disponimit momental, lloji i shënimit etj. Në asnjë rast në fisha nuk guxojnë të grumbullohen gjerat e tepërta dhe hollësitë, të verifikohen fragmentet e gjata tekstuale, gjerësisht të parafrazohen ose rezymohen mendimet e autorit, të futen faktet dhe mendimet që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë me temën ose janë të gjithënjohura. Nëse kësisoj veprohet, do të duhej më vonë, me rastin e redigjimit të dorëshkrimit, të hedhet numër i madh i fishave si të tepërta. Gjithësesi se një numër të caktuar do të hedhë, me këtë duhet të pajtohet çdo autor i punimit shkencor. Fatkeqësia është, ndërkaq, në atë që me rastin e përpunimit të shkrimit dhe shkrimit të shënimeve, autori kurrë nuk e di sigurisht se çka dhe në çfarë vëllimi për të do të jetë më vonë me interes dhe e dobishme.⁷⁶ Së këndejmi disa punëtorë shkencorë konsiderojnë se duhet "bërë citate të vëllimshme nga çdo gjë që është qenësore, duke mos e kursyer në këtë punë kohën."⁷⁷

Kështu duhet vepruar sidomos në dy raste: 1) Kur deri te dokumenti nga i cili vjelet lënda është vështirë të vihet; 2) Kur është fjala për punimet e vëllimshme

⁷⁶ Shih më herët.

⁷⁷ S. A. Rajnberg, o. c., fq. 49.

shkencore. Nga arsyeja e thjeshtë që, sikur që saktë vëren Sandersi, gjithnjë është më lehtë që teksti tekstualisht i përshkruar të rezymohet ose parafrazohet me fjalët vetjake se sa e kundërta.⁷⁸ Përveç kësaj, citati tekstual është i domosdoshëm në disa raste të veçanta: kur fragmenti i tekstit është shumë i rëndësishëm, kur forma e tij paraqet vlerë të veçantë (shquhet me koncizitetin dhe gjallërinë e stilit të vet), ashtu që jo pak do të humbte nga vlerat e vet, ose mendimi do ta humbte vlerën, do të sakatohej, nëse fragmenti do të parafrazohej ose rezymohej. Ky do të jetë rast sidomos kur është fjala për shembull për definicionet, sentencat dhe maksimat (dhe përgjithësisht për formulimet koncize), vargjet, sikur edhe kur fragmenti rrjedh nga pena e ndonjë autoriteti në çështjen e caktuar, mendimi i të cilit e argumenton mendimin e autorit. Pastaj, teksti citohet tekstualisht edhe atëherë kur ideja e shprehur në të nuk është sa duhet e qartë, dykuptimëshe; nëse dëshirohet pohimi, thënia e dikujt të përgënjeshtrohet, nëse ekziston mundësia që dikush t'i kontestojë theksimet.⁷⁹ Jorrallë edhe fragmentet në gjuhën e huaj kërkojnë shkrimin tekstual - në tërësi ose në disa pjesë: me këtë është garantuar saktësia dhe autenticiteti më i madh. Tekstit të huaj tekstualisht të përshkruar menjëherë mund t'i shtohet edhe përkthimi i tij. E të tjera.

Në rastet tjera fragmentet e tekstit parafrazohen ose rezymohen me fjalët vetjake. Me fjalë të tjera, është e njohur: kur informata shkencore (ideja, fakti), e vjelur nga ndonjë burim, parafrazohet ose rezymohet me fjalitë vetjake, ajo më mirë asimilohet, bëhet pronë e autorit, bëhet fakti dhe ideja e autorit. Ky parafrazim dhe rezymim bëhet, kryesisht, në mënyrën vijuese: fragmenti që dëshirohet të parafrazohet ose rezymohet lexohet me

⁷⁸ O. c., fq. 294.

⁷⁹ Krls. H. G. Shelton, *Writing term papers and reports*, pp. 70 - 71.

kujdes, jo një herë, duke pasur kujdes gjatë kësaj në idetë dhe faktet e rëndësishme; pastaj, duke mos shikuar në tekst, përmbajtja e paragrafit parafrazohet ose rezymohet sipas mbamendjes; parafraza ose rezymeja mund të krahasohen me tekstin e shkrimit vetëm pasi përfundohen që autori të bindet se mos ka harruar diçka, apo mos e ka ndërruar, zhgënjyer idenë themelore të tekstit; e nëse autori shikon në origjinal gjatë kohës së vetë parafrazimit ose rezymimit, do t'i ekspozohet rrezikut që nga ai tekstualisht të transmetojë, të huazojë fjalët e autorit dhe kthesat frazeologjike. Përgjithësisht, tërë shënimit, e edhe parafrazës ose rezymesë së tekstit të huaj, duhet dhënë sa më shumë notë personale, të argumentohen me observime personale, mendime, pikëpamje dhe të formohen me fjalë vetjake.

Vetvetiu kuptohet se në fishë - krahas shkrimit, parafrazës, rezymesë së tekstit - duhet menjëherë të shënohen edhe refleksioni vetjak, vërejtja kritike, nëse ato shfaqen; kurrsesi kjo të shtyhet, me motivacion se edhe më vonë do t'i kujtojë: në atë rast ekziston mundësia që edhe mendimi më i mirë, vrojtimi, refleksioni pakthim të zhduken.⁸⁰ Prandaj, me të drejtë vepron S. A. Rajnberg kur përpiqet që vetes t'i sugjerojë se si e ka mbamendjen më të keqe, ndonëse ajo, sipas fjalëve të tij vetjake, ka qenë "plotësisht e mirë".⁸¹

⁸⁰ Si arsye për shënimin e ndonjë mendimi në atë çast kur ai shfaqet ceket ajo që intelektin ynë, sikur as trupin, nuk punojnë gjithnjë barabartë mirë; në pajtim me këtë, nuk është e sigurt se çasti i tillë sërisht do të shfaqet.

⁸¹ Po aty., pp. 48. - Në lidhje me këtë, preferohet të disponohet gjithnjë me fisha të zbrazëta, ose me notesin dhe lapsin: edhe i shtrirë në shtrat, edhe i ulur në karrige, edhe në shëtitje, edhe në teatër. Nëse rastësisht nuk keni me vete letër dhe laps, ngrihuni menjëherë nga karriga ose shtrati, gjeni ato dhe mendimin shkruane nëse ai shfaqet. Përkujtonu se si Miltoni i ka ngritur vajzat e veta pas gjumit, që t'ua diktojë fragmentin e Parajsës së humbur të vet, që e patë komponuar gjatë netëve të pagjumë.

Me rastin e shkruarjes së shënimeve është e domosdoshme qartë të shënohet çka kujt i përket: të shënohet me shenja të ndryshme mendimi i huaj (tekstualisht i cituar, parafrzuar, rezymuar) dhe ai personal. Përndryshe, më vonë, autori shënimet e veta dhe të huajat mund t'i ngatërrojë, dhe, duke lëshuar që këtë ta shënojë në dorëshkrim të punimit, t'u ekspozohet rrezikut dhe pakëndshmërive që të akuzohet për huazime, plagjiatë, për të cilat as që ka menduar. Jo një herë kjo i ka ndodhur nganjëherë edhe autorit me autoritet që nuk ka pasur shumë kujdes në atë pikëpamje. Të përkujtojmë këtu vetëm në rastin e Mark Carit, të cilit, në përmbledhjen e tij "*Simpatitë e mia*" (II), Jovan Skerliq i ka zbuluar një varg huazimesh nga F. de Sandovali dhe Rodai.⁸²

Nuk ka nevojë të ceket se shënimi dhe informata shkencore e përmbajtur në të, duhet të jenë të sakta dhe precize (për këtë qëllim, preferohet, për shembull, që citati të verifikohet menjëherë posa është shkruar ose më vonë), i plotë, d.m.th. që në te të jenë cekur të gjitha informatat që mund të kontribuojnë në zgjidhjen e ndonjë problemi, dhe objektive. Armiq të përjetuar të këtyre vetive janë: nxitimi, mendjelehtësia, moskujdesi dhe mosbregosja, qëllimkeqësia, paragjykimet e të gjitha llojeve. Secila nga këto veti është e pabashkuar me atributin e punëtorit të mirëfilltë shkencor. Të përkujtojmë se sa pakëndshmëri autorit mund t'i shkaktojë moskujdesi më i vogël: pa dyshim, asgjë më e bezdisshme dhe më e

⁸² Krls. Jovan Skerlić, *Pisci i knjige*, Beograd, Prosveta, 1964, IV, 78 - 80. Është interesante se autorit të njëjtë, pothuaj para fundit të karrierës së tij letrare, ia ka zbuluar huazimet nga Gizoï edhe Jovan Kršić. (Krls.: Jovan Kršić, "Povodom jedne knjižice M. Cara", *Pregled*, mars 1940, fq. 184 - 186). Unë personalisht e kryej këtë shënim në mënyrën vijuese: mendimin, vrojtimin personal e vë në kllapën e mesme (e nganjëherë krahas kësaj edhe inicialet e mia); shkrimet tekstuale i shënoj me thonjëza; përmbi mendimit të huaj, të parafrzuar ose të rezymuar me fjalët vetjake, e cek burimin (krls.:...), kurse nganjëherë këtë mendim e komizoj edhe me kllapën unazore.

mërzitshme se sërish të shkohet në bibliotekë për shkak të kontrollimit të ndonjë detaji, të dhëne të imtë – të faqes ose të datës së ndonjë shkrimi, saktësisë së ndonjë citati, e të ngjashme.

Përveç burimeve të shkruara, që janë më kryesore dhe më të shpeshta, për mësimin e fakteve dhe të ideve nuk janë të parëndësishme as burimet gojore. Jo vetëm biseda me ndonjë shkencëtar me përvojë e të njohur - që nganjëherë mund të japë këshilla dhe udhëzime të tejçmueshme për çështjet e ndryshme në lidhje me përpunimin e ndonjë teme: për përmbajtjen dhe vëllimin e saj, metodat që duhet aplikuar, për burimet e shtypura e në dorëshkrim që duhet kontrolluar, etj., - por edhe diskutimi me kolegun e profesionit të njëjtë ose të ngjashme nganjëherë mund të shpiejë në asociacione të lumtura, të rezultojë me mendime të frytshme, të sjellë zgjidhje fatlume. Përmbajtja e atij këmbimi të frytshëm të mendimeve dhe të gjitha sugjerimet e dobishme duhet, gjithqysh, të shkruhen sa më parë, brenda mundësisë qysh ditën e njëjtë kur është zhvilluar biseda. Në qoftë se në dorëshkrim e citojmë ndonjë fakt ose mendim që në këtë mënyrë, me anë gojore, e mësuam, këtë duhet në vërejtje edhe shënuar (për shembull me fjalët: “kumtesa e profesor Miodrag Ibrovacit”, e të ngjashme).

Me rastin e tubimit të dokumentacionit është e domosdoshme të kihet kujdes që të vjelet lënda. Gjatë kësaj menjëherë shtrohet pyetja: deri ku duhet të shkohet në grumbullimin e lëndës, në tubimin e shënimeve? Teoretikisht, për këtë nuk ka fund, duke e marrë parasysh shumësinë e shkrimeve dhe burimeve që rëndom ekzistojnë për ndonjë problem dhe të cilët për çdo ditë për të ose për pyetjet e ngjashme publikohen. Në praktikë, ndërkaq, çështja është diç më e thjeshtë: nëse autori ndërgjegjshëm ka gjurmuar ndaj dokumenteve, ka zbuluar dhe studiuar dokumentacionin kryesor - burimet dhe

shkrimet - për ndonjë temë, mund të jetë pothuaj i sigurt se është njoftuar me lëndën themelore që për lëndën e caktuar ekziston, dhe që, në pajtim me këtë, nuk i ka ikur asgjë thelbësore. E megjithatë, duhet tentuar që për ndonjë lëndë të grumbullohet numër sa më i madh i shënimeve. Dhe këtë nga shkaku i thjeshtë që, siç cek Sanders, në qoftë se dikush ka më shumë shënime, aq më parë ka më shumë gjasa që prej tyre të zgjedhë shënime të mira dhe të shkruajë punim të mirë.⁸³

Që të tubohet dokumentacioni i mjaftueshëm, ashtu që prej tij të mund të krijohet punim shkencor, vepra, grumbullimi i lëndës mund të zgjasë me muaj, e edhe me vite, që varet, sidomos, nga vëllimi i hulumtimeve. Së këndejmi, përpunimit të teksteve duhet qasur me sa më shumë plan dhe metodicitet, sa më sistematikisht. Nga ana tjetër, në tubimin e dokumentacionit nuk guxohet të kalohen suazat e temës. Kjo d.m.th. më mënyrë rigoroze duhet të kufizohemi në lëndën që është në lidhje me temën, të mos shkruhet ajo që del nga suaza e saj, sado qoftë kjo të jetë interesante dhe tërheqëse dhe vetvetiu e çmueshme dhe e rëndësishme.

Sa i përket veprimit gjatë përpunimit të ndonjë libri, shkrimi, sikur edhe radhës së këtyre veprimeve, ata janë të varur nga karakteri i shkrimit, dhe, edhe më tepër, nga përvoja individuale dhe shprehia e vetë lexuesit. Në vend që t'i cekë veprimet e shumëllojshme, më së miri do të jetë, dhe e gjejë si më praktike, që këtu të shtrojë, në potezat kryesorë, se si veprojnë unë gjatë përpunimit të ndonjë libri, shkrimi (duke cekur në këtë aspekt se nuk dëshiroj, natyrisht, askujt t'ia imponoj veprimet e mia si të vetmet të mira dhe të mundshme).

Kur vijë deri te ndonjë libër ose artikull që duhet ta përpunoj, së pari e shkruaj fishën bibliografike, me të

⁸³ O. c., pp. 296 - 297.

gjitha të dhënat bibliografike, nëse këtë më herët nuk e kam bërë. Nëse fishën tashmë e kam shkruar, e verifikoj, dhe, eventualisht, i plotësoj të dhënat e saj me të dhënat në libër. Pastaj, kërshërisht, e hedh shikimin në përmbajtjen e kaptinës dhe indeksit të emrave, përkatësisht nocioneve, e shfletoj librin, i lexoj kalimthi disa fragmente të tij e të ngjashme. Pas atij njoftimi të shkurtër i shënojë anash holl me laps vendet që sipas mendimit tim janë të rëndësishme dhe të cilat më vonë do t'i përpunoj (ekscerpoj, parafrazoj, rezymo) dhe prej tyre do t'i bëjë shënime. Në të njëjtën kohë i shënoj edhe numrat e faqeve ku gjenden ato vende, qoftë në faqen e parë të zbrazët të librit, qoftë në një copëz të posaçme të letrës, që do të më bëhet përkujtues dhe të cilën gjithnjë e mbajë në libër.⁸⁴ Më në fund, sërish i lexoj vendet e shënuara në libër dhe bëj shënime të llojeve të ndryshme (për të cilat tashmë është bërë fjalë). Ka nevojë sidomos të përmendet që këtë veprim të fundit (bërjen e shënimeve), me doemos e bëj pranë tavolinës, ndryshe nga veprimet paraprake, të cilat mund të bëhen edhe në karrigen me mbështetëse. Jo vetëm për atë që pranë tavolinës është më lehtë të shkruhen shënime dhe që në këtë pozitë shpirti ynë më mirë mobilizohet, por edhe për atë që në tavolinë mund t'i kem, afër duarve, pos shkrimeve që i përpunoj, edhe doracakët e ndryshëm (enciklopeditë, biografitë, fjalorët e të ngjashëm), që duhet të jenë përcjellës të përhershëm të çdo hulumtuesi: qysh në këtë fazë të hartimit të veprës është mirë që çdo e dhënë, term jo mjaft i qartë dhe jo i saktë të sqarohet, të vërtetohet, saktësohet, duke i konsultuar doracakët përkatës. Nëse

⁸⁴ Nuk duhet aspak nguruar të shënohen vrojtimit e ndryshme ose shenjat në libër, por vetëm në librin personal: vlera e saj me këtë për ne mund vetëm të rritet, duke e marrë parasysh se në të në atë rast më lehtë do ta gjejmë vendin që na intereson.

kjo nuk bëhet, atëherë më vonë mund të harrohet dhe rreptë të hakmerret.⁸⁵

⁸⁵ Ngjashëm veprojnë edhe të tjetër; për shembull, S. A. Rajnberg (O. c., fq. 47 - 48). - Nuk duhet hequr nga mendja as faktin që nganjëherë gjerat më pak të rëndësishme favorshëm ose jofavorshëm mund të ndikojnë në punim. Kështu, për shembull, përvoja ka treguar që kur bëhen shënimet nga ndonjë libër, nëse nuk janë ndriçuar barabartë faqja që e lexojmë dhe letra në të cilën shkruajmë shënimin, lehtë mund të na dhemb koka, meqë sytë duhet vazhdimisht të përshtaten herë në një dritë (të faqes), herë në dritën tjetër (të letrës). Pasoja të ngjashme dhe lodhje mund të nxisin edhe dhoma e paajrosur, lokali i ftohtë ose i ngrohur tepër, e të ngjashme. Ose, nuk është irrelevante as lexueshmëria e dorëshkrimit në shënime: shënimet e shkruara jolexueshëm kërkojnë shumë më tepër kohë, energji dhe nerva që të zgjidhet domethënia se sa shënimet e shkruara lexueshëm. Ose nëse ka të bëjë me punimin më të vëllimshëm grumbullues, për të cilin janë të nevojshme shkrimet dhe shënimet e shumta, është më praktike që fishat, të klasifikuara sipas përmbajtjes (kaptinave) të mbahen në kuti (prej kartuqi apo prej druri), në tavolinën për shkrim, se sa në ndonjë mënyrë tjetër. Vetëm nëse është në pyetje punimi më i vogël, për të cilin nuk ka nevojë numër më i madh shënimesh dhe fishash dhe shënimet dhe fishat mund të mbahen në fashikull. Ose, rekomandohet që librat, vetjakë e të huazuar, që kanë të bëjnë me temën, të mbahen në vend të posaçëm në bibliotekën personale, në raft të veçantë, duke rezervuar një pjesë të raftit për librat e përpunuar, kurse pjesën tjetër për ata që duhet përpunuar. Në këtë mënyrë jo vetëm që ka shikim më të mirë të literaturës të cilën duhet përpunuar dhe e cila tashmë është përpunuar, por as nuk do të humbet koha në kërkimin e veprave nëpër bibliotekë (e shpesh një vepër, edhe kur ajo përpunohet, nevojitet për të vërtetuar ndonjë të dhënë). E kështu me radhë.

V. Organizimi dhe sistemimi i lëndës së tubuar

Kur lënda është tubuar, - kurse ajo, gjatë punës, do të duhet ende pak a shumë të plotësohet - është mbaruar etapa e rëndësishme dhe jo e lehtë në procesin e hartimit të veprës. Atëherë kalohet në etapë të re: sistematizimin, grupëzimin, klasifikimin e lëndës së tubuar. Gjithsesi, ndarja rigoroze e këtyre dy veprimeve, etapave - tubimit të lëndës dhe sistemimit të saj - nuk është e mundur: qysh gjatë tubimit të dokumentacionit, kemi parë, autori deri diku kryen edhe sistemimin e lëndës, kyç disa shënime, respektivisht fisha, në kaptinat që më së miri u përgjigjen. Për këtë qëllim në çdo fishë e shënon titullin e kaptinës së cilës i përket fisha. Por, derisa atëherë synimi i punës ka qenë tubimi i lëndës, tash ai është në sistemimin, organizimin e saj. Krahas kësaj, tash ka të bëjë edhe me klasifikimin definitiv të lëndës së tërësishme, me pjesën më të madhe tashmë të grumbulluar.⁸⁶

⁸⁶ Marrë rigorozisht, edhe në këtë etapë (organizimi dhe sistemimi i lëndës së tubuar), mund të dallohen dy veprime të ndryshme: njëra, që është më tepër me natyrë mekanike, të jashtme, dhe tjetri, që është mental, i brendshëm. Derisa i pari përfshin sortimin e fishave, eliminimin e atyre që janë të tepërta e të ngjashme, në anën tjetër tjetri përbëhet në angazhimin mendor që lënda të asimilohet, që të dhënat tjera të ndryshme të sillen në lidhje, të krahasohen, të nëntrenditen, kundërshtohen e të ngjashme; me një fjalë, që lënda e tubuar të kundrohet në tërësi dhe nga ajo të konstruktohet punimi harmonik. Në këto dy veprime, që plotësohen në mënyrë të ndërsjellë dhe përzihen, këtu do t'i trajtojmë si tërësi unike.

Të cekim menjëherë se ekzistojnë autorë, ndër ta edhe të shquar, që e refuzojnë çdo lidhje kompozicionale: me prirje nga improvizimet, e të talentuar për to, të bartur me imagjinatë e entuziazëm, ata shkruajnë, plog-shtë dhe ngathët, atë që momentalisht u bie në mendje, që u vie në laps, *currente calamo*, duke mos çarë shumë koken për sistemimin e lëndës, për lidhjen logjike ndërmjet disa pjesëve, duke harruar, në çaste, pak a shumë, në temën e vet dhe duke bërë, me entuziazëm, digresione të ndryshme. Kështu veprojnë, për shembull, autorët e atyre *bredhjeve letrare (vagabondage litteraire)*, ose disa autorë të eseve, siç është Montenji. Por edhe në letërsi janë mjaft të paktë ata që janë plotësisht të privuar nga “disiplina ideore”, që shpërfillin strukturën kompozicionale të veprës që e krijojnë. Dhe disa prej tyre këtë edhe e cekin. Kështu, për shembull, Jan Parandovski konsideron që “pa disiplinë ideore” dhe pa kompozicion, nuk ka, në realitet, as “krijimtari të mirëfilltë”: nga kompozicioni varet jeta dhe bukuria e organizmit që autori e krijon [...], ajo i jep organizmit veçoritë e trupit të shëndoshë. Kurse të gjithë të çalët - mund të jetojnë vetëm me disa joshje, që prezentojnë atë që sytë e mirë apo intelekti i jashtëzakonshëm iu prezentojnë njerëzve me ndonjëfarë mungese fizike”. Së këndejmi, sipas mendimit të tij, gjatë shekujve “ka sunduar rregulli rigoroz i lidhjes së mendimeve dhe rendi logjik, sistematizimi dhe ruajtja e proporcionit të çdo nyjeje, kalimi mjeshtror nga një strofë në tjetrën.”⁸⁷ Kurse për Gëten kompozicioni ka qenë “vepër kreative, në të cilën hollësitë dhe tërësia janë të shkruara nga një shpirt dhe nga një pjesë, dhe të cilat janë të përshkruara me frymën e një jete”.⁸⁸

Por nëse veprat letrare, edhe krahas mungesës së kompozicionit të fortë, mund të jetojnë duke iu falënderuar “disa joshjeve të veçanta”, për veprat shkencore kjo

⁸⁷ J. Parandovski, o. c., fq. 221 dhe 228.

⁸⁸ J. P. Eckermann, o. c., fq. 178.

nuk mund të thuhet; punimi shkencor duhet të paraqesë tërësinë e rrumbullakuar, harmonike, dhe në pajtim me këtë ai duhet të ketë arkitektonikën e vet solide kompozicionale; vetëm me këtë kusht do të mund nga ajo masë kaotike dhe konfuze e fakteve dhe ideve, të tubuara nga burimet e shumta e të ndryshme dhe të shënuara në qindra dhe mijëra fisha, të krijohet vepra e tërësishme dhe koherente, siç është, sipas legjendës greke, nga koka e Jupiterit ka dalur Minerva.

Kompozicioni i një vepre shkencore, të cilin retorikët e vjetër e kanë quajtur dispozicion, është në realitet, mënyra dhe shkathtësia e sistemimit të lëndës (fakti, ideja, vrojtimet, argumentet e të ngjashme) me rendin e qartë dhe natyror, logjik dhe të bindshëm.⁸⁹ Të komponosh mirë ndonjë punim shkencor domethënë, në pajtim me këtë, të kryhet sistemim natyror dhe i qartë, i logjikshëm e i bindshëm, si brenda vetë veprës dhe pjesëve të saj më të mëdha (krereve, kaptinave, pjesëve, nën-pjesëve, paragrafëve etj.), ashtu edhe brenda pjesëve të saj më të vogla - paragrafëve (raporti reciprok dhe vendi i fjalive në paragraf dhe fjalët në fjali). Kjo d.m.th. kompozicioni i fortë, natyror dhe logjik do të arrihet nëse fjalët fuqishëm dhe logjikshëm do të lidhen reciprokisht në fjali, fjalitë në paragrafe (qëndrime), paragrafët në nënpjesë, këto sërish në pjesë, pjesët në kaptina, kaptinat në krere, krerët në tërësi më të mëdha (pjesë të mëdha, pjesë), kurse këta në libër si tërësi. Dhe nëse e gjithë kjo rrjedh natyrisht dhe konsekuentësisht njëra pas tjetrës, del njëra nga tjetra, ashtu që çdo fjalë, fjali, paragraf, nënpjesë, pjesë, etj., ka vlerën e vet funksionale, duke i kontribuar domethënies dhe strukturës së tërësisë më të madhe të cilën të gjithë së bashku e përbëjnë dhe e cila duhet të jetë unike dhe koherente. Me një fjalë, po ato veçori me të cilat duhet të shquhet, për shembull, paragrafi (uniteti,

⁸⁹ Krls. D. Momet, *Cours pratique de la composition française*, p. 96.

koherenca, kalimet natyrore e të ngjashme), duhet t'i kenë edhe tërësitë tjera më të mëdha të punimit: kaptinat, krerët, pasuset, pjesët, tërë punimi.

Së këndejmi, me rastin e organizimit dhe sistemimit të lëndës, duhet sidomos të kihet kujdes për disa çaste, prej të cilave më të rëndësishmet janë si vijon:

Përgjasimi. - Gjërat e ngjashme (idetë, faktet etj.) duhet lidhur ndërmjet vete, të tubohen në një vend. Nëse lënda përbëhet prej shumë pyetjeve, nuk guxon të flitet herë për njërin, herë për tjetrën, duke kërcyer nga njëra në tjetrën, por duhet për secilën prej tyre të diskutohet sipas njëfarë rendi të caktuar. Nga ana tjetër, nuk duhet për ndonjë gjë që paraqet tërësinë të flitet në shumë vende.

Rrjedha logjike. - Ndërmjet disa elementeve duhet gjithnjë të gjenden disa raporte logjike: kohore, shkakësore dhe rrjedhore e të tjera.

Proporioni i pjesëve. - Çdo pjesë përbërëse të veprës (kaptinës, paragrafit etj.) duhet dhënë aq hapësirë, sa faktet dhe idetë që ajo i përmbanë meritojnë sipas rëndësisë së vet.

Ekzistojnë, natyrisht, edhe momente tjera të cilat gjatë organizimit të lëndës duhet të kihen parasysh ("kalimet e pahetueshme" nga njëra pyetje në tjetrën, harmonia e pjesëve ndaj tërësisë dhe pjesëve ndër vete, etj.); për to do të bëhet fjalë më vonë.

Që kompozicioni i punimit shkencor të jetë sa më i mirë (sa më i fortë, natyror dhe logjik), kurse vetë sistemi i lëndës të rrjedhë pa vështirësi, pa përpjekje dhe pa pengesa më të mëdha, është e domosdoshme, nga një anë, që me lëndën e grumbulluar të zotërohet, të asimilohet ajo (truri që nuk e asimilon lëndën e tubuar i ngjason barkut që e qet ushqimin e papërpunuar); kurse nga ana tjetër, duhet hartuar planin e veprës.

Asimilimi i lëndës bëhet me leximin e ngadalshëm, të kujdesshëm e të shumtë të shënimeve e sidomos me përsiatje. Sigurisht, për përmbajtjen e çdo shënimi dhe për lëndën e punimit përgjithësisht, autori ka menduar

edhe më herët, sidomos me rastin e tubimit të lëndës dhe bërjes së shënimeve,⁹⁰ kurse do ta bëjë këtë edhe në të ardhmen, sepse vetëm me përsiatje intensive shpirti bëhet frytdhënës dhe në të lindin mendime dhe pikëpamje origjinale.⁹¹ Por tash në këtë veprim vëhet synimi: me përsiatje intensive lëndën e tubuar duhet lidhur me mendimet dhe pikëpamjet vetjake, të klasifikohet në sistemin ekzistues të nocioneve dhe dijes, në atë masë që mendimet dhe vërtetimet e huaja të shkrihen me mendimet dhe refleksionet vetjake në tërësinë organike. Në këtë mënyrë lënda e tubuar dhe faktet dhe mendimet e huaja nuk do t'i asfiksojnë mendimet dhe idetë vetjake, personalitetin vetjak. E në këtë rast edhe shprehja, shkrimi, do të rrjedhë më mirë: autori nuk do të ndalet në çdo hap, nuk do të zë në thumb, nuk do të mundohet rreth shprehjeve.

Sa i përket planit, çdo punim me vëllim më të madh kërkon planifikim. E vërteta, disa autorë kanë drojë nga plani, sikur edhe nga kompozicioni (këto të dyja në shumë pika preken, pajtohen): e konsiderojnë shenjë të shpirtit mesatar, gjejnë se ai e ngatërron imagjinatën, elanin, fuqinë krijuese të autorit, ia krasitë krahët dhe e pengon rrjedhën e mendimeve. Ka pasur, kurse edhe sot ka, madje shkolla të tëra që kanë konsideruar se njeriu

⁹⁰ Hulumtuesi nuk guxon të presë që hulumtimi të mbarohet dhe shënimet të tubohen, e që vetëm atëherë të fillojë t'i lexojë. Përkundrazi, qysh gjatë kohës së tubimit të lëndës është e dëshirueshme që ai në shënime më shpesh të kthehet, që t'i lexojë dhe për to të përsiasë. Në këtë mënyrë ai gjithnjë do të jetojë me lëndën e vet, për të vazhdimisht do të mendojë, dhe kështu me lëndën më mirë do të zotërojë, më mirë do ta asimilojë.

⁹¹ Kurrë nuk duhet humbur parasysh që lënda duhet pajtë të kalojë prej fishës deri në hartim nëpër tru, e jo nga fisha drejtpërdrejt në hartim. Me fjalë të tjera hartimi, shkrimi, nuk mund as të mendohen pa mendim dhe përsiatje. Sipas disave, tërë procesi i shkrimit edhe përbëhet, në realitet, prej dy veprimeve themelore: përsiatjes dhe shkrimit në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Veprimi i parë është slumë më i rëndë se sa që njeriut i duket. Saktë vëren Lexheti: "Ne duhet të lirohemi nga botëkuptimi se shkrimi është diç që mund ta kryejmë nëse për këtë, para kësaj, nuk kemi menduar gjatë dhe intensivisht. (Glenn Leggett..., Handbook, for writers..., p. 70.)

krijon spontanisht, sikur që merr frymë, dhe se mund të krijojë diç të vefshme vetëm me ndërdijen e vet, automatikisht (surrealizmi). Nuk mohojmë se në çdo akt krijues ka edhe elemente ndërdijore, sikur që nuk mohojmë as atë se ka pasur, dhe ka, mendje që plani nuk u është nevojitur që të krijojnë vepra gjeniale. Mirëpo, kjo ka qenë e mundur vetëm për një numër të vogël, dhe këtë jashtëzakonisht të talentuar, njerëz gjenialë, prej të cilëve, krahas kësaj, disa prej tyre planin e vet, në vend në letër, e kanë pasur në kokë. Të tjerët, që nuk i përkasin kësaj kategorie të autorëve, kurse ata prezentojnë shumicën, duhet që vetes t'i shtrojnë si rregull që mos të shkruajnë para se ta hartojnë dhe të përpunojnë planin e shkrimit dhe ta vënë në letër, përveç, natyrisht, nëse nuk ka të bëjë me shkrim më të shkurtër, plani i të cilit lehtë dhe mirë mund të mbahet në kokë. Ky plan nuk do ta ngatërrojë në asnjë rast imagjinatën e tyre, elanin e tyre, që do të mund të vimë në shprehje në çdo hap dhe në mënyra të ndryshme, si në hollësi ashtu edhe në tërësi. Nëse plani do të mungonte, ekspozimi i tyre do të ishte, domosdo, pa rend, i pasistemizuar, madje pak a shumë i palogjikshëm, jo i përpiktë, dhe në të nuk do të ishin të rralla mangësitë, sikur që janë: joproporcioni i pjesëve, kërcimet logjike në ekspozim, përsëritjet e të ngj. Ai që nuk shkruan sipas planit paraprakisht të hartuar, është vërejtur saktë, vargon fjalinë pas fjalisë, paragrafin pas paragrafi, pa lidhje të fortë logjike, pa rend natyror, përfërsisht po ashtu sikur që lojtari i dominos e vargon dominën pas dominos. Nga ana tjetër, plani i punës e siguron harmoninë dhe proporcionin e pjesëve, unitetin e tërësisë, shkallëshmërinë dhe logjikshmërinë e ekspozimit: çdo fjali, çdo fragment, çdo kaptinë buron nga fjalia paraprake, nga fragmenti paraprak, nga kaptina paraprake.⁹²

⁹² Domosdoshmërinë e planit e kanë theksuar shumë shkencëtarë të pranuar. Ta cekim këtu vetëm mendimin e S. A. Rajnbergut. "Edhe mua persona-

Kur është fjala për planin, është gabim të mendohet se ekziston vetëm një i vetmi plan i mirë, derisa të gjithë të tjerët janë të këqij. Plani varet nga shumë faktorë: disiplina shkencore dhe natyra e temës, vëllimi dhe karakteri i lëndës së tubuar, mundësitë krijuese, shprehitë dhe temperamentit i autorit etj. Në pajtim me këtë, çdo plan, në fund të fundit, është çështje individuale dhe varet me të madhe nga cili aspekt autori i qaset temës; e pasi që, sipas rregullit, ekzistojnë shumë mënyra të qarta së temës, ekzistojnë edhe shumë plane, shumë mënyra të organizimit, sistemimit, ekspozimit të lëndës. Autori së këndejmi duhet mirë të mendojë dhe ta zgjedhë atë plan që në rastin e dhënë, duke e marrë parasysh qëllimin e punimit dhe dokumentacionin, me të cilin disponon, ta bëjë më të përshtatshmin, më të qëlluarin. E nëse gjatë punës imponohet nevoja që plani të ndërrohet, nuk duhet ngurruar që kjo edhe të bëhet: plani nuk guxon të konsiderohet strikt, njëherë e përgjithmonë i dhënë. Aq më parë që në çdo proces krijues ka diç të pasigurt dhe të paparaparë: sado të punojë, të përpiqet, të parashohë, autori, sikur edhe artisti, marrë përgjithësisht, nuk është i sigurt se a do të “dalë” diçka, dhe çka do të delë në fund; vepra i fiton konturat e veta të sigurta, strukturën e vet të caktuar dhe fizionominë vetëm atëherë kur të shkruhet. Së këndejmi, sipas nevojës, plani disa herë ndërrohet, ndryshohet, plotësohet, e madje, nëse ka nevojë, edhe zëvendësohet me plan të ri.

lisht plotësisht më është e paqartë se si munden njerëzit të shkruajnë punim shkencor duke mos pasur para vetes plan, për të cilin paraprakisht thellë kanë menduar [...]. Për mua te përgatitja e dorëshkrimit puna kryesore është - puna në plan. Unë ulem me javë dhe muaj vetëm duke menduar dhe duke e përpunuar planin, duke e imagjinuar paraprakisht sisteminin e tërë materialit, përpikërinë e parashtrimit, kurse formulimit të drejtpërdrejtë të vetë punimit, shkrimit, mund t'i qasem vetëm pasi tërë plani i punimit, prej fillimit deri në mbarim, në të gjitha hollësitë e tij, të më bëhet plotësisht i qartë. Nëse për gjithë këtë paraprakisht thellë është menduar, atëherë vetëm ekspozimi me shkrim dhe tërë ky proces i mundimshëm bëhen relativisht të lehtë.” (O. c., fq. 78).

Plani duhet të ketë karakter funksional. Kjo do të thotë, struktura arkitektonike e tij, me pjesët, gjymtyrët e tij (krerët, kaptinat, pjesët dhe nënpjesët, etj.), dhe me raportet ndërmjet tyre, duhet ta paraqesë strukturën, arkitektonikën e vet shkrimit, me pjesët e tij dhe me raportet e tyre. Gjatë hartimit të tij duhet pasur kujdes sidomos në paralelizmin (koordinimin) dhe varësinë (subordinimin), sikur edhe në artikulimin dhe mënyrën e shënimit të disa pjesëve të planit.

Për ilustrim të këtij parimi do ta cekim këtu planin (përmbajtjen) nga vepra e K. L. Turabianit: *A Manuel for writers of term papers, theses and dissertations...*⁹³

TABLE OF CONTENTS

	Page
PREFACE	iii
LISTE OF TABLES	vii
LISTE OF ILLUSTRATIONS	xii
INTRODUCTION	1
PART I. MAN BEFORE CIVILISATION	
Chapter	
I. HOW MANKIND BEGAN AS FOOD-GATHERERS	3
Man's Earliest Ways of Living	
The Early Stone Age	
The Middle Stone Age	
II. THE EARLIEST FOOD-PRODUCERS	26
The Late Stone Age in the Nile Valley	
The Late Stone Age in Europe	
PART II. THE ORIGINS AND EARLY HISTORY OF CIVILISATION IN THE ANCIENT NEAR EAST	
III. THE STORY OF EGYPT: THE RISE OF CIVILISATION AND THE PYRAMID AGE	51
The First Union of Egypt and the Rise of Civilisation	
The Second Union of Egypt and the Pyramid Age (Thirtieth to Twenty-fifth Century B. C.)	
Art and Architecture in the Pyramid Age	
IV. THE STORY OF EGYPT: THE FEUDAL AGE AND THE EMPIRE	95
The Feudal Age	
The Founding of the Empire	
The Higher Life of the Empire	
The Decline and Fall of the Egyptian Empire	
APPENDIX	797
BIBLIOGRAPHY.....	811

⁹³ Chicago, The University of Chicago Press, 1958, p. 75. - Të shihet, në fund, edhe përmbajtja e këtij libri.

Shënimi i disa pjesëve të planit (dhe punimit) bëhet, sikur që kjo shihet deri diku edhe nga plani i dhënë, në mënyra të ndryshme, në varshmëri prej mënyrës së degëzimit dhe numrit të gjymtyrëve të vetë planit dhe punimit. Kështu, mënyra e shënimit në planin arkitektonik më të thjeshtë dhe ndarjes së tij dallon nga mënyra e shënimit të planit më të ndërlikuar. Për shembull, nëse punimi ka vetëm dy pjesë, ato mund të shënohen me shifra romake dhe arabe; në punimin prej tri pjesëve, shënimi i pjesëve të caktuara bëhet me numrat romakë, numrat arabë dhe me shkronja të vogla; pjesët e punimit katërpjesor dhe shkronja të vogla. Nëse punimi ka pesë pjesë ato shënohen me numra romakë, shkronja të mëdha, me numra arabë me pikë, me shkronja të vogla me pikë dhe numra arabë me kllapa, në punimin prej gjashtë pjesëve shënimi bëhet sikur edhe në punimin prej pesë pjesëve, me atë dallim që pjesa e gjashtë shënohet me shkronjë të vogël me kllapë; nëse punimi ka shtatë dhe tetë pjesë, këto pjesët e fundit mund të shënohen me numra të vegjël romakë me pikë (pjesa e shtatë) dhe me kllapë (pjesa e tetë), etj.

Me rastin e shënimit duhet marrë parasysh dy momente: 1) ndonjë krye, kaptinë, pjesë, nënpjesë e të tjera, duhet të ketë më së paku dy pjesë nëse dëshirohet që veçan t'i shënojë. Kjo d.m.th. njëshi romak (I) tërheq me vete edhe dyshin romak (II), njëshi arab me pikë (1.) tërheq me vete së paku dyshin arab me pikë (2.), e kështu me radhë; 2) raporti i koordinimit dhe subordinimit ndërmjet disa pjesëve të planit (dhe përmbajtjes së kaptinës) duhet të vijë në shprehje edhe në vetë strukturën e planit, përkatësisht përmbajtjes; me kyçjen e pjesëve, respektivisht gjymtyrëve subordinite, dhe me vënien paralele të pjesëve të koordinuara, përkatësisht të gjymtyrëve. Kështu, plani i ndonjë, të themi, punimi gjashtëpjesësh, grafikisht i paraqitur do ta kishte kryesisht këtë skemë:

- I.
 - A.
 - 1.
 - a.
 - 1)
 - a)
 - b)
 - c)
 - 2)
 - 3)
 - b.
 - 2.
 - 3.
 - B.
- II.

Disa shkencëtarë (në Angli, Gjermani dhe vende të tjera) shënojnë disa pjesë të punimit, pa titull, me shifra arabe. Kështu, për shembull, ndonjë punim shkencor katërpjesësh do të paraqitej me skemën vijuese:

- 2
- 2.0
- 2.1
- 2.2
- 2.21
- 2.22
- 2.23
- 2.3
- 2.31
- 2.32
- 2.321
- 2.322
- 2.323

Po ky punim katërpjesësh, i prezentuar me skemën e mëhershme, do të dukej kështu:

- II.
 - A.
 - B.
 - C.
 - 1.
 - 2.
 - 3.
 - D.
 - 1.
 - 2.
 - a.
 - b.
 - c.

E megjithatë, është e dëshirueshme që plani mos të jetë tepër i ndërlikuar, nëse tashmë nuk mund të jetë i thjeshtë, d.m.th. që në te mos të ketë ndarje të ndryshme dhe nëndarje, pjesë dhe nënpjesë, sikur që duhet të jetë edhe sa më natyror, d.m.th. që t'i përgjigjet rrjedhës natyrore të gjerave, ndodhive, shfaqjeve dhe sa më ekonomik, d.m.th., i atillë që mund të evitohen përsëritjet e panevojshme.

Pos këtyre dy planeve të tërë punimit, janë të domosdoshme planet e disa pjesëve: krerëve të tij. Këto plane hartohen rëndom para qasjes së shkrimit të kreut përkatës. Nëse punimi është i vëllimshëm, e edhe krerët janë me vëllim më të madh, mund të bëhen edhe planet e pjesëve më të vogla.

Të cekim, në fund, se të gjitha këto plane të përpunuara hollësisht dhe gjithanshëm, jo vetëm që i ndihmojnë në masë të konsiderueshme organizimit natyror dhe logjik të lëndës, por ato e lehtësojnë edhe redigjimin e

dorëshkrimit dhe, që është me rëndësi jo të vogël, i mundësojnë autorit që punimin ta shkruajë kurdo që t'i jepet rasti, madje edhe nëse nuk disponon me ndonjë kohë më të gjatë, sikur që këtë e ka cekur S. A. Rajnberg:

Me sistemin e këtillë të punës arrihet që vështirësitë e të shkruarit, “mundimet e të shprehurit”, të redukohen në masën më të vogël. Bie varshmëria prej disponimit. Nuk ka më nevojë të arsyetohemi para vetes dhe të kapemi për pengesa të vogla që e pengojnë punimin. Kështu mund të punohet kurdo dhe kudo, në çfarëdo kush-tesh. Bëhen të tepërta arsyetimet e rëndomta, që ndërmjet punëve, gjoja, të mbetet gjithsej nja gjysëm orë kohë, e a paguhet në rastin e tillë edhe të ulemi në tavolinën e shkrimit, etj.⁹⁴

⁹⁴ O. c., fq. 79.

VI. Redigjimi i dorëshkrimit

Hulumtimi shkencor në lidhje me ndonjë temë duhet të fitojë mbarimin e vet natyror në veprën, shkrimin shkencor; pa këtë mbarim ai nuk e ka arritur cakun e vet: ose nuk është mbaruar me sukses, ose ka qenë vetvetiu qëllim. Kjo d.m.th. që pas etapave të gjurmimeve për dokumentacion, tubimit dhe sistemimit të lëndës - pason etapa e re: formësimi me shkrim, redigjimi (redaktimi) i dorëshkrimit, hartimi i shkrimit. Në praktikë, as kjo etapë nuk është ndarë në mënyrë të prerë nga parapraket, por më së shpeshti rrjedh tok me to, paralelisht: qysh gjatë hulumtimit të lëndës kristalizohen idetë, ndërtohen supozimet, saktësohet kompozicioni, plani i librit. Edhe këto veprime, në realitet përgatisin dhe lehtësojnë procesin e redigjimit. Në këtë dëfton saktë H. Maru (Marrou): “Brengosja që puna të sillet në fund të suksesshëm, përpjekjet e drejtuara drejt sintezës, duhen në çdo hap ta përcjellin hulumtimin, analizën; hipoteza ndërtohet - shkallërisht - njëkohësisht me rritjen e dokumentacioni, klasifikimi i fshave është i orientuar në drejtim të planit të librit. Përndryshe, kalimi nga një etapë në tjetrën është i ngutshëm: për arsye se nuk kanë ditur që shkallërisht të përgatiten për këtë etapë të fundit, shumë hulumtues e lëshojnë hulumtimin në prag të caktit.”⁹⁵

Redigjimi i punimit është etapa më e rëndësishme, por njëkohësisht më e rëndë dhe e mundimshme në

⁹⁵ L' Histoire..., p. 1536.

procesin e hartimit të dorëshkrimit, akt krijues në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, që në asnjë rast nuk do të thotë se edhe etapat tjera nuk kanë në vete elemente krijuese. Ai nuk parashtron vetëm zotërimin solid me lëndën e tubuar dhe aftësitë e caktuara intelektuale, në masë të konsiderueshme të zhvilluara (fuqia e përqëndrimit, aftësia e përsiatjes intensive, shpirti sintetik etj.), por edhe aftësinë konsiderueshëm të zhvilluar të të shprehurit me shkrim, zotërimin me teknikën e të shkruarit. As autorët dhe shkencëtarët më të talentuar, më të mëdhenj brenda natës nuk janë bërë ata që janë, ose autorët dhe shkencëtarët e tillë, nëse edhe ekzistojnë, janë mjaft të rrallë. Por, ata në të shumtën e rasteve rrallë flasin për vështirësitë e veta, për kërkesat e rënda të rrugës, për dështimet: më tepër dëshirojnë që të tregohen me tërë lavdinë e ngadhënjimit të vet”. E megjithatë, disa prej tyre sinqerisht dhe haptas kanë folur për këto mundime të veta. Prej shumë rasteve ta cekim këtu vetëm rrëfimin e Helmbolcit (Helmholtz):

Përpunimi me shkrim i hulumtimit shkencor paraqet kryesisht punë të rëndë, së paku mua ai gjithnjë më është dukur në masën më të madhe të rëndë. Shumë pjesë të artikujve të mi i kam përshkruar nga katër deri më gjashtë herë, duke e ndërruar shpesh sistemimin e materialit dhe planin e tërësisë, para se do të bëhesha deri diku i kënaqur. Por përpunimi i këtillë i kujdesshëm paraqet dobi të madhe edhe për autorin. Ajo e nxitë që më hollësisht ta vërtetojë çdo qëndrim dhe çdo përfundim. Unë kurrë nuk kam konsideruar se hulumtimi është i gatshëm derisa ai nuk është para meje, nuk shtrihej në formën e përkryer të shkruar të ekspozuar pa zbrazëti logjike.⁹⁶

Në këtë etapë (redigjim) hulumtuesi kalon vetëm atëherë kur, sipas hamendjes së vet të sinqert, i ka mba-

⁹⁶ Cit. në: S. A. Rajuberg, o. c., fq. 75 - 76. – Për “vështirësitë e stilit” të shihet: Shtojca.

ruar etapat paraprake (hulumtuese dhe tubuese), d.m.th., kur hulumtimin e ka sjellë deri në atë shkallë që vazhdimi i tij duket i tepërt, humbje e kohës. E vërteta, gjatë vetë procesit të redigjimit mund të tregohen dhe do të tregohen, sigurisht, zbrazëti më të vogla apo më të mëdha, që do të duhej t'i plotësojë (pikërisht procesi i redigjimit i hedh shpesh ato zbrazëti në sipërfaqe, i bënë të dukshme, të prekshme), sikur që, pothuaj patjetër, do të tregohet se një pjesë e lëndës është e tepërt dhe e papërdorshme për përpunimin e temës. Duke e pasur këtë parasysh, është e domosdoshme, para se të fillohet redigjimi, themelësisht të shqyrtohet lënda e tubuar dhe në mënyrë solide ta asimilojë. Në këtë shkallë të punimit, pra, është me rëndësi që lënda e tubuar të përdoret sa më mirë që është e mundur dhe që prej saj të krijohet vepra, shkrimi më i mirë i mundshëm.

A. Pjesët e librit

Një vepër rëndom ka pjesët vijuese: titullin, parathëniën, hyrjen, përpunimin e problemit, përfundimin, bibliografinë, rezy-menë, indeksin, shtojcën (appendix-in), përmbajtjen. Të themi ndonjë fjalë për secilën prej këtyre pjesëve.

Titulli. - T'i jepet titull i përshtatshëm veprës nuk është aspak gjë e lehtë: ai duhet njëkohësisht të jetë konciz, i saktë dhe ekspresiv, d.m.th., që në formë të saktë dhe të përgjithshme ta manifestojë dhe ta shprehë në mënyrë sa më adekuate dhe sa më të plotë përmbajtjen dhe lëndën e veprës. Nga kjo del se është e domosdoshme të shmangen titujt e zvarritur, të papërcaktuar e si domos, të tillë që lexuesin mund ta lajthojnë në rrugë të shtrembër, mashtrim, e po ashtu duhet shmangur edhe

nga titujt banalë. Që të evitohen titujt tepër të gjatë, krahas titullit mund të jepet edhe nëntitulli. Formulimi i titullit kalon nganjëherë nëpër një varg metamorfozash dhe aspektesh derisa nuk e fiton formën e vet përfundimtare. Është e pëlqyeshme që të gjitha variantet eventuale të titujve të shkruhen në përkujtues, dhe, në fund, të vendoset për atë variant që duket më i përshtatshëm, më impresiv. Së këndejmi nganjëherë titulli është ai që vëhet i fundit dhe që e zëvendëson titullin e punës së deriatëhershme.

Parathënia. - Ajo, sipas rregullit, është e shkurtër dhe me karakter të përgjithshëm. Me këtë më së shumti edhe dallon nga hyrja. Në të rëndom futen shkaqet që autorin e kanë shtyer që ta shkruajë veprën, sikur edhe borxhi eventual që e ka ndaj të tjerëve - bashkëpunëtorëve në punë, kolegut më të vjetër, arsimtarit ose udhëheqësit.

Hyrja. - Kjo pjesë e punimit është më e vëllimshme se parathënia dhe në të autori e prekë deri diku edhe vetë përmbajtjen e veprës. Më së shpeshti, hyrja e zëvendëson parathënien, dhe e kundërta; rrallë në vepër gjenden edhe njëra edhe tjetra. Qëllimi është që lexuesin në njëfarë mënyre ta përgatisë, "ta kyçë" në problemet që janë objekt i veprës, që tek ai për ta të nxisë interesim. Në hyrje, sipas rregullit, shtrohen historiku i shkurtër i çështjes, lindja dhe etapat kryesore në zhvillimin dhe zgjidhjen e saj, raporti i problemit të zgjidhur kundrejt hulumtimeve të mëhershme, vëllimi dhe kufijtë e hulumtimit personal. Nëse çështja ka historikun e vet të gjatë, zhvillimin e gjerë dhe literaturën e pasur, për ekspozimin e historikut të saj do të nevojitet krye e veçantë. Pasqyra historike duhet të ketë, siç cekin disa,⁹⁷ "karakter parimor hulumtues, dhe në të është e domosdoshme të jepet analiza kritike e literaturës mbi lëndën, duke u dhënë mirënjohje autorëve dhe veprave që kanë merita për përpa-

⁹⁷ Krls.: S. A. Rajnberg, o. c., fq. 87.

rimin e dijes nga ajo lëmi shkencore, kurse duke ia nënshtruar kritikës ata autorë dhe vepra pikëpamjet e të cilëve autori nuk i pranon por i refuzon, i përgënjeshtrojnë. Në hyrje, po ashtu, autori shpjegon dhe e saktëson problemin që dëshiron ta përpunojë (duke i definuar njëkohësisht termit eventualë të përdoruar në kuptimin e ri, deri atëherë jo i rëndomtë), i shtron shkaqet që e kanë nxitur që ta përpunojë lëndën, t'i rezymojë burimet themelore të informatave, të flasë për metodën që e ka aplikuar në përpunimin e temës. Nëse autori, eventualisht, ka qenë i detyruar që për shkak të materialit befasisht të vëllimshëm ose të mangshëm, ose për disa shkaqe tjera, që temën më pak apo më shumë ta ndërrojë (ngushtojë, zgjerojë), ose të zbatojë veprime tjera metodologjike, nuk duhet që të ngurrojë që edhe këtë, në hyrje, haptazi ta thotë.

Pa marrë parasysh atë që gjendet në fillim të veprës, hyrja është ajo pjesë e punimit që shpesh shkruhet e fundit, kur vepra tashmë në tërësi është e gatshme, pasi që vetëm atëherë, më mirë dhe më plotë, mund të kundrohesh në tërësi të gjitha elementet e saj, në qoftë se ajo është shkruar më herët, do të duhet sigurisht që të korrigjohet, plotësisht dhe të përpunohet rishtazi. Paskalit i përshkruhet mendimi mendjempreht: "Gjërat e fundit që e gjejmë duke e hartuar një vepër, kjo është të dihet çka të vihet në vend të parë."⁹⁸

Përpunimi. - Në përpunimin e problemit, që paraqet strumbullarin e veprës dhe zë më së shumti hapësirë, shtrohet hollësisht dhe me dokumente lënda e tubuar (faktet, vrojtimit, idetë), me qëllim të argumentimit të tezës që është e shtruar në hyrje dhe e cila duhet të përpunohet, arsyetohet, dëshmohet. Varësisht nga vëllimi i vet, përpunimi i problemit mund të ketë më shumë pjesë (pjesa I, pjesa II, etj.), e secila prej tyre shumësi krerësh dhe kapitash, pjesësh e nënpjesësh. (Të shihet plani).

⁹⁸ Misli (Beograd, Kultura, 1965), fq. 12.

Përfundimi. - Ai paraqet pjesën mbaruese, kurorën e tërë punës, sintezën e mbarë asaj që paraprakisht është analizuar. Duke u shërbyer me maksimumin spirituoze dhe hiperbolike të Fustel de Kulanzhit (Fustel de Coulanges), për përfundimin do të mund të thuhej se ky është çast i sintezës, pas tërë një jete të analizës. Themelore që kërkohet nga përfundimi i mirë është që të rezultojë nga vetë hulumtimet e punimit, ekspozimeve dhe shkoqitjeve, që në mënyrë sintetike t'i shtrojë rezultatet e përgjithshme deri te të cilat është ardhur në bazë të hulumtimeve dhe analizave të gjata, që ta japë atë mendimin dhe gjykimin përfundimtar të cilave duhet t'u konvergjojnë të gjitha shqyrtimet dhe zbërthimet paraprake, që të shtrojë në ç'pikëpamje punimi paraqet kontribut në shkencë.

Në përfundim po ashtu mund të jepet shenja në perspektivat e problemit, në lëminë, drejtimin dhe llojin e hulumtimeve të ardhshme, në pyetjet që kanë mbetur ende që të përpunohen. Së këndejmi disa retoristë bëjnë dinstinkcionin ndërmjet përfundimit të rezymesë dhe përfundimit të perspektivës.

Që në Përfundim mos të harrojë të fusë disa qëndrime më të rëndësishme, është e preferueshme që autori, para se të fillojë ta shkruajë, ta lexojë me kujdes dhe ndërgjegjshëm tërë punimin dhe t'i shënojë pikat më të rëndësishme që duhet të hyjnë në përfundim.

Gjatë hartimit të Përfundimit autori do të ketë kujdes për atë që në të mos t'i përsërisë qëndrimet me fjalë dhe fjali të njëjta me të cilat ato janë shprehur më herët, sikur edhe për atë që me këto qëndrime të japë formulime sa më të qarta e të forta, duke iu shmangur frazave dhe emfazës së njohur.

Bibliografia. - Për të do të flitet më vonë.⁹⁹

Rezymeja (përmbledhja). - Çdo punim më i vëllimshëm dhe më i rëndësishëm ka rezymenë në njërin prej gjuhë-

⁹⁹ Shih më poshtë (VII, c.).

ve të huaja universalisht të shtrira. Te ne rezymeja rëndom hartohet në anglishte ose në frengjishte, ose në rusishte apo në gjermanishte. Ka për qëllim që opinionin e huaj shkencor ta njohë, në formë të përgjithshme, me përmbajtjen thelbësore të punimit shkencor: me mendimet e reja, përfundimet dhe rezultatet e hulumtimeve shkencore.

Rezymeja ka edhe atë anë të mirë që edhe lexuesin e vendit e njofton shkurtimisht me përmbajtjen themelore të shkrimit, ashtu që ai, kur e lexon, mund ta vlerësojë a duhet ta lexojë punimin në tërësi apo nuk duhet. Duke pasur kujdes për këtë fakt, shumë revista të huaja sjellin, përbri çdo kontributi fundamental, edhe rezymenë e atij kontributi, që e ka hartuar vetë autori në atë gjuhë në të cilën kontributi është publikuar, nëse ka të bëjë me ndonjë gjuhë të shtrirë universale.

Rezymeja përmban: emrin dhe mbiemrin e autorit (në këndin e sipërm të majtë), përkthimin e titullit (diç më poshtë, në mes) dhe përkthimin e fjalës rezyme në gjuhën e huaj të caktuar (résumé, summary, zusammenfassung, ... etj.).

Indeksi. - Çdo vepër më e vëllimshme, sipas rregullit, posedon indeksin e emrave vetjak, e jorrallë edhe indeksin tematik (indeksin e nocioneve më të rëndësishme), sidomos nëse përmbajtja e kaptinave nuk është mjaft analitike. Indeksi mund të jetë edhe i përbashkët për emrat vetjakë dhe për gjësendet.

Indeksi i emrave, gjësendeve dhe i nocioneve, në të cilin në ekzemplar të shtypur nuk shkruhen numrat e faqeve, - kjo do të bëhet vetëm me rastin e shtypjes, - i bashkangjitet dorëshkrimit. I bashkangjitur dorëshkrimit, indesi mjaft do t'ia lehtësojë botuesit hartimin e indeksit. Në të futen të gjithë emrat që përmenden në vepër, duke i kyçur emrat që paraqiten në bibliografi dhe në regjistrin e literaturës së përdorur.

Indeksi është i domosdoshëm sidomos kur njësitë bibliografike janë të radhitura sipas sistemit kronologjik.¹⁰⁰

(Për hartimin e indeksit do të ketë fjalë më vonë.¹⁰¹)

Shtojca. - Vepra mund ta ketë edhe shtojcën e vet. Në të kyçet çdo gjë që nuk është e domosdoshme në tekst, e, sipas mendimit të autorit, mund të jetë me intres të caktuar për lexuesin (sikur që, do të shohim, në vërejtjen eksplikative kyçen plotësime më të vogla për tekstin). Shtojca, në pajtim me këtë, rëndom përmban tabela të ndryshme, shembuj e formularë, fotokopje të dokumenteve të ndryshme, materialë të llojllojshëm ilustrativ e të ngjashme.

Nëse lënda që kyçet në shtojcë është tepër e vëllimshme, ajo mund të ndahet në pjesë, prej të cilave secila do të shënohet në mënyrë të veçantë: me shifra romake (I, II, etj.), me shkronja të mëdha të shtypura (A, B, etj.), ose me shifra arabe.

Përmbajtja. - Në të futen titujt e disa pjesëve të librit, me numrin përkatës të faqeve (që nuk vihen në tekstin e shkruar nëse është dedikuar për publikim): krerët, kapitlat, pjesët nënpjesët, etj. Gjatë kësaj është me rëndësi që përmbajtja të jetë e qartë dhe e mbarështruar mirë. Prandaj ajo ka, sipas rregullit, formën "shkallëzore, d.m.th. pjesët e varura të saj janë diç më të tërhequra brenda, siç ka qenë rasti edhe me planin.¹⁰² Në të ashtuquajturën përmbajtje analitike futen edhe titujt e pjesëve më të vogla të librit. (Titulli mund të ketë lidhje, për shembull, me paragrafin.) Ky lloj i përmbajtjes ka atë dobinë praktike që lexuesi lehtë mund të gjejë ndonjë pjesë të tekstit që i intereson.

¹⁰⁰ Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rrallë ndonjë libër shkencor ose profesional paraqitet pa indeks. Amerikanët, që janë njerëz praktikë dhe e çmojnë kohën, konsiderojnë që libri pa indeks nuk është "i përdorshëm" as për së afërmi në atë masë në të cilën do të ishte sikur të kishte indeks.

¹⁰¹ Shih më poshtë (IX, A.).

¹⁰² Shih më herët (V).

Përmbajtja duhet të përfshijë edhe regjistrat e ilustrimeve, hartave, statistikave e të ngjashme. Secili nga këta regjistra jepet veçan.

Përmbajtja te ne zakonisht vihet në fund të librit (sikur që është zakon te francezët); por ajo nganjëherë vihet edhe në fillim, pas parathënies (siç veprojnë amerikanët, anglezët e të tjerë).¹⁰³

Edhe te ne ngapak po tradicionalizohet, ndonëse ende shumë hulumtues të rinj po i shmangen, që autori i veprës t'u shprehë mirënjohje atyre që në njëfarë mënyre i kanë ndihmuar me çkado që punën e vet vëllimore ta sjellë në fundin e suksesshëm. Kjo mirënjohje, nëse ceket, nuk guxon të jetë as tepër e thatë as e tepruar; asgjë më e pakëndshme për lexuesin se kur lexon ndonjë fjalë miradije drejtuar atij. Nëse ka disa persona të cilëve u shprehet mirënjohja, nga formulimi i nuancuar i saj duhet qartë e saktë të shihet edhe vëllimi i ndihmës së treguar të individëve.

Mirënjohja mund të shprehet në parathënie, hyrje ose me shënim të shkurtër të veçantë.

B. Të shkruarit e tekstit

Hartimi, shkrimi i tekstit përfshinë, sipas rregullit, dy faza: 1) të shkruarit e konceptit, 2) të shkruarit e tekstit përfundimtar, të pastër. Në disa raste faza e parë mund të kapërcehet dhe të kalohet menjëherë në shkrimin e punimit në formën përfundimtare; por kjo ndodh shumë rrallë; në të shumtën kur punimet janë të shkurtra ose kur autorët janë shkrimtarë mjaft me përvojë, që, në realitet, konceptin e kanë shkruar në pjesën më të madhe në kokë.

¹⁰³ Për disa pjesë tjera të librit (fotografive etj.) do të flitet më vonë (IX).

Sipas fjalëve të K. T. Voblit, shkrimi i konceptit ka pikëpamje “konstruktive-sintetike” të punimit, derisa shkrimi i tekstit përfundimtar është me karakter “kritike-analitik”. Pikëpamja e parë gjithsesi është më e rëndësishme. Ja çka shkruan për të shkencëtari i përmendur:

Pikëpamja e parë (konstruktive-sintetike) përbëhet në të formësuarit verbal të asaj rrjedhe të mendimeve që paraqiten në fushën e vetëdijes. Rrjedha e vetëdijes zhvillohet shpejt, lapsi mezi e arrinë. Është e kuptueshme që ai që shkruan nganjëherë ndien vështirësinë ta gjejë fjalën e qëlluar, shprehjen e përshtatshme, frazën saktësisht të rumbullakuar. Me rastin e shkruarjes duhet mbajtur, ngulfatur procesin kritiko-analitik; t’i lihet liria e plotë procesit të parë [konstruktive-sintetik], duke mos u frikësuar se nuk do të përdoret fjala plotësisht e përshtatshme, kthesa e mprehtë frazeologjike.¹⁰⁴

Me fjalë të tjera, koncepti shkruhet shpejt, në flakën e inspirimit, ashtu si paraqiten në krye faktet, idetë, fjalët dhe vijën nën laps, duke mos u kujdesur për atë se a është shprehja e caktuar më e fatshme dhe më e qëlluar. E atëherë më vonë, me rastin e revisionit, vërtetohet harmonia e këtyre dhe shprehjeve të tjera.

Të vështrojmë shkurtimisht në dy fazat e cekura të shkruarjes së tekstit: të shkruarit e konceptit dhe të shkruarit e tekstit përfundimtar.

1. Koncepti

Mënyra me të cilën shkruhet koncepti është punë individuale: ai varet nga shumësia e faktorëve të ndryshëm dhe ndryshon, thënë ashtu, prej autorit te autori. Mirëpo,

¹⁰⁴ K.T. Вобльи, *Организация труда научного работника* fq. 122.

edhe këtu mund të ndahen disa veti të përbashkëta, të përgjithshme karakteristike dhe të jepen disa sugjerime që përvoja i ka vërtetuar dhe të cilat për ekspertin e ri mund të jenë me interes dhe me dobi të caktuar.

Para së gjithash, ka nevojë të përkujtohet se shkruarja e disa pjesëve të konceptit bëhet me shënime në fazën e parë dhe me planin hollësisht të përpunuar për pjesën e caktuar.¹⁰⁵ E megjithatë, nëse paraprakisht mirë e ka studiuar lëndën për fragmentin e caktuar dhe në mënyrë solide e ka asimiluar, autori nuk ka nevojë që vazhdimisht të shikojë në shënime dhe fisha. Mendimi i tij dhe mënyra e të shprehurit do të jenë aq më kondensuese, të pavarura, të drejtpërdrejta, nëse ai do të shkruajë më lirisht, duke mos shikuar gjithnjë në shënime. Ato ai mund t'i konsultojë më vonë, kur ta mbarojë redigjimin e fragmentit të cekur, që të bindet që nga shënimet nuk ka lënë ose gabimisht ka interpretuar ndonjë vend më të rëndësishëm e të ngjashme.

Në pajtim me sistemimin dhe ritmin e vet të jetës, shkruarjes së konceptit autori duhet t'i kushtojë, sipas mundësisë, disa orë çdo ditë,¹⁰⁶ në atë vend ku për atë ka më së shumti qetësi (qoftë kjo shtëpia, institucioni ose biblioteka) dhe në atë kohë kur është më i çlodhur, më i qetë dhe i disponuar për punë, nga arsyeja se kjo punë kërkon angazhim të plotë të të gjitha forcave të tij intelek-

¹⁰⁵ Planin për disa pjesë të dorëshkrimit unë e hartoj dhe e shkruaj në letër drejtpërdrejt para të shkruarit të asaj vepre dhe pasi me kujdes i kam lexuar dhe asimiluar shënimet që kanë të bëjnë me të.

¹⁰⁶ Përndryshe gjithnjë duhet të merret parasysh rëndësia e punës së ngadalshme, të durueshme, sistematike, të përditshme në përpunimin e një teme dhe në shkencë përgjithësisht. Në mënyrë sugjeruese në këtë kanë dëftuar Ft. Cordasco dhe E. Getner: "Ndonëse jetojmë në kohën kur bombat bërthamore mund t'i rriënojnë qytetet dhe qytetërimet për një çast, nuk guxojmë ta humbim parasysh faktin se ende vlen e vërteta se pikat e imta të ujit, kur gjithnjë dhe gjatë bien, do ta thellojnë shkëmbin më të fortë". (Research and report writing, p. 5.).

tuale.¹⁰⁷ Gjatë kësaj, pas mbarimit të një fragmenti më të madh apo më të vogël, janë të domosdoshëm pushimet e vogla të kohëpaskohshme: përvoja, me fjalë të tjera, ka treguar që pas pushimit prej gjithsej pesë deri dhjetë minuta autori ulet për shkruarjen e paragrafit të ri, fragmentit përgjithësisht, jo vetëm deri diku i pushuar dhe i freskuar por edhe i përgatitur: e di më mirë ç'do të shkruajë më tej.¹⁰⁸

Përvoja po ashtu mëson se nuk preferohet tepër të zhagitet shkruarja e konceptit, sikur as të ndërprehet për një kohë të gjatë: as ndërprerja e shkruarjes së punimit prej gjithsej një ose dy ditësh nuk mbetet pa ndikim te caktuar në procesin krijues. Në pajtim me këtë, kur fillon shkrimi, më mirë është të përfundohet sa më shpejtë, duke punuar në të nga disa orë në ditë dhe brenda mundësisë në të njëjtën kohë, - me këtë do të arrihen edhe uniteti dhe kompaktësia më e mirë e dorëshkrimit. Gjatë kësaj nuk ka nevojë të mundohet rreth saktësisë së të gjitha hollësive, adekuatësisë dhe rregullueshmërisë së plotë, korrektësisë gramatikore; vendet për të cilat nuk është i sigurt, ose me të cilat në ndonjë aspekt nuk është i kënaqur dhe në të cilat duhet të ndalet me rastin e revisionit të dorëshkrimit, autori mund t'i shënojë me ndonjë shenjë në tekst edhe nga anash, në marginë. Për shembull, mund të tërheq në tekst ndonjë fjali për shkak të dyshimit në saktësinë e të dhënave ose fakteve, ideve,

¹⁰⁷ Autori duhet që organizimin e punës së vet, mënyrën dhe ritmin e jetës ta adaptojë sipas mundësisë, ashtu që për shkruarje t'i mbesin disa ditë të lira - paradite, pasdite, tërë dita. Para kësaj është e nevojshme të ketë kujdes për faktin se për të shkruarit, sipas rregullit, koha më e përshtatshme është pas kryerjes së një obligimi të rëndësishëm se sa para kryerjes së obligimit: në këtë rastin e fundit ai nuk do të jetë gjithnjë i qetë, obligimi do ta shqetësojë, do ta hedhë shikimin në orë, e të ngjashme; me një fjalë, do të shkruajë me nervozë, që medoemos do të shprehet edhe në vetë cilësinë e të shkruarit.

¹⁰⁸ Disa autorë, pasi që do të shkruanin një orë ose dy, do ta luanin një parti shahu apo tenisi. Sipas polimit të tyre vetjak, ky pushim më i gjatë, relaksim, pozitivisht ka ndikuar në procesin e të shkruarit. (Kris.: G. G. Neill Wright, *Teach yourself to study*, London, English University Press, 1946, p. 134.)

vlerësimeve të cekura e të ngjashme, ose për shkak të stilizimit të keq, kurse në margjinë të qitet pikëpyetja, shkronja X e të ngjashme. Në pajtim me këtë, gjatë kohës së redigjimit të konceptit nuk kërkohen dhe nuk vërtetohen të dhënat në dorëshkrim: kjo do ta tërhiqte vëmendjen e autorit nga puna kryesore, kreative.

Po ashtu është me rëndësi të dëftohet në atë se me rastin e redigjimit të konceptit të shkruhen poshtëshënimet (fusnotat) në vetë tekstin, qoftë në kllapa, qoftë, edhe më mirë, menjëherë pas rreshtit në të cilin gjendet fjala me të cilën ka të bëjë shënimi. Në rastin e fundit, shënimi veçohet nga teksti tjetër me dy vija. Për shembull.

“E megjithatë, të merret shekulli XVII francez si plotësisht konformist dhe ortodoks, siç bëhet nganjëherë edhe sot, të mendohet ai si shekull në të cilin kanë sunduar, siç është shprehur një bashkëkohës (Somaize), vetëm *tyrannie et moinerie*,¹⁰⁹ dhe në të cilin çdo gjë i është e dëgjueshme, besnike mbretërisë dhe religjionit - d.m.th. më tepër se gjërat të simplifikohen.”

Të përmendim edhe atë se koncepti shkruhet në fletat e letrës, në asnjë rast në fletore, dhe këtë vetëm nga një anë; pastaj, se është e domosdoshme të lihet nga ana e majtë hapësirë e zbrazët (këndi ose margjina) prej disa centimetrash dhe mos të shkruhet me rreshta tepër të ngjeshur, ashtu që në koncept të mund të bëhen plotësimet e mëvonshme, korigjimet, përmirësimet. Plotësimet më të vogla në koncept shkruhen ndërmjet rreshtave dhe në margjinë, kurse më të mëdhatë në anën tjetër, të zbrazët, ose në fletë të veçantë.

Të theksojmë në fund, që gjatë shkrimit të konceptit jo pak kohë kursethet nëse, kudo që ka mundësi për këtë, nuk përshkruhet teksti nga fisha (bibliografike, dokumentare e të tjera), por ajo me mbërthesë përforcohet

¹⁰⁹ Kths. R. Piatard, o. c., p., 104.

për fletën e konceptit. Me këtë njëkohësisht zvogëlohet mundësia e gabimeve të ndryshme në përshkrim, shfaqja e të cilave është aq më se e mundshme dhe më e shpesh-të nëse ndonjë tekst më shpesh përshkruhet. Kuptohet, kjo është e mundur vetëm në rastin kur shënimet, faktet dhe idetë në ffishë janë të natyrës dhe formës së tillë, ose lehtë mund të sillen në atë formë, që teksti i ffishës natyrisht të pajtohet me tekstin e redigjuar të dorëshkrimit.

2. Teksti përfundimtar

Kur ta përfundojë konceptin e dorëshkrimit, autori, sidomos ai i papërvojë, bie jorrallë në sprovë që punimin menjëherë ta daktilografojë dhe t'ia dorëzojë redaktorit të revistës, ndërmarrjes botuese, sekretariatit të fakultetit (nëse e ka punaur tezën) e të ngjashme. Ai vepron kështu, nga një anë, për shkak se e mbyhtë dëshira, fisnike në themel, që punimi t'i botohet sa më parë, ose t'i pranohet si tezë; nga ana tjetër, ai dëshiron që dorëshkrimin sa më parë "ta heqë dorësh", pasi që, duke punuar në të me muaj ose me vite, e ka ngirë, nganjëherë deri në neveri. Krahas kësaj, përsosja e punimit parashtron dhe kërkon kualitete të caktuara që rrallë janë karakteristike për rininë: ajo që nganjëherë te ne quhet gabimisht *pedantëri*, e në realitet është ndërgjegjshmëri, akribie, d.m.th. sipas fjalëve të B. Popoviq, është ajo "saktësi dhe pastërti e përsosur në punim, përsosuri deri te hollësitë e fundit",¹¹⁰ e pa këto veçori edhe nuk ka punim shkencor në

¹¹⁰ "Članci i predavanja (Srpska književna zadruqa, 1932), fq. 81. - Akribia është njëra nga aftësitë tona më shumë të arritura se sa të lindura. Ajo kërkon gjithnjë "praninë e shpirtit, vlerën shpirtërore, vullnetin e mirë dhe karakterin e bukur". Kurse njerëzit që e kanë arritur do ta përsosin punimin e

kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Pasojë e këtij moskujdesi është që në hartimet e numrit të madh të autorëve, sidomos të rinjve, paraqiten mangësi të shumta të llojeve të ndryshme, duke filluar nga gabimet materiale deri te joadekuatësia dhe jopërsosuria e formulimeve, që kanë mundur me më shumë angazhim, kujdes dhe durim, të shmangen pa vështirësi. Duhet pasur në mendje që versioni i parë i konceptit, me sado kujdes dhe angazhim ai të jetë kryer, rrallë është i atillë që punimit nuk i është i domosdoshëm edhe një version, përkatësisht revision. Këtë fakt e kanë vërtetuar, edhe me fjalët e veta edhe me shembullin e vet, shumë autorë të dalluar të të gjithë popujve. Kështu Dima Sin ka folur se shkathtësia e autorit të dramës përbëhet në shkathtësinë e përmirësimit. (Këto fjalë në masë të konsiderueshme do të mundeshin, *mutatis mutandis*, të aplikoheshin edhe në hulumtuesin). A. Gogoli, Tolstoi, A. Fransi, Gorki dhe shumë të tjerë, i kanë përpunuar disa nga veprat e tyre nga shtatë dhe tetë herë.¹¹¹ Me një fjalë shkencëtari, sikur as letrari, nuk guxon, përkundër asaj që pohon anekdota franceze, që të kënaqet me *të mirë* nëse mund të arrijë *më mirë*.¹¹² Jashtë çdo hamendjeje është se revisioni i kryer ndërgjegjshëm do të kontribuojë jo pak në përmirësimin e cilësisë së tekstit. Saktë është thënë që, në realitet, revisioni i kujdesshëm edhe e përbënë dallimin ndërmjet shkrimit mesatar dhe të mirë;¹¹³ sikur edhe ajo se shkrimi, në realitet është të shkruajturit e sërishëm (*writing is rewriting*).

vet duke mos kursyer kohë dhe energji dhe t'ia dorëzojë redaktorit të revis-tës ose ndërmarrjes botuese vetëm kur ta punojnë si kanë mundur, ditur dhe pasur aftësi.

¹¹¹ Shih "Shtojca" (XIII, B).

¹¹² Kjo anekdotë franceze është: Le mieux est l'ennemi du bien (Më e mira është armik i të mirës). Ajo, në pajtim me këtë, në këtë rast, do të duhej të kthehej, ashtu që është: Le bien est l'ennemi du mieux (E mira është armik e më të mirës).

¹¹³ Ft. Cordasco and S. M. Gatner, o. c., p. 50.

Para se të kalojë në 'revisionin e konceptit, autori duhet që dorëshkrimin ta lë një kohë të "pushojë". Kjo është e domosdoshme nga shkak që ai vetëm me këtë kusht do të mund ta revidojë dorëshkrimin e vet me më shumë objektivitet, kriticizëm, freski: për gjykimin e ftohtë e kritik për veprën vetjake është e domosdoshme distanca kohore, që mundëson që vepra deri diku të harrohet; vetëm në atë rast mund të vijë në shprehje të plotë ai procesi 'kritiko-analitik' për të cilin tashmë është bërë fjalë. Koha që duhet të kalojë prej mbarimit të konceptit deri te revisioni i tij, varet si nga vëllimi i dorëshkrimit ashtu edhe nga afati në të cilin autori duhet ta kryejë e ta dorëzojë: Ajo, në pajtim me këtë, ndryshon rëndom prej disa ditëve, nëse është në pyetje punimi i vëllimit më të vogël, deri në disa muaj, nëse është në pyetje vepër më voluminoze. Do të ishte ideale, siç duket, kur autorin nuk do ta shpejtonte askush, ashtu që ai të mundet dy, tri dhe më shumë herë, në distanca më të gjata kohore, pa pengesa të kthehet në vepër, që ruhet në syze. Por në rastet e këtilla, që përndryshe edhe janë vështirë të realizueshme në praktikë, autorin e përgjon një rrezik tjetër: që mos ta teprojë në përsosjen e dorëshkrimit, për të cilin nuk ka fund, që me të mos të dominojë obsesioni me librin e caktuar, e që vazhdimisht mos ta lëmojë dhe mos ta përkryejë një vepër, në vend që të krijojë, përfundojë, publikojë gjithnjë të reja e më të reja.

Revisionin e tekstit autori e bën me leximin e ndër-gjegjshëm e të matur, duke pasur vëmendje gjatë kësaj në gjëra të ndryshme, - prej tërësisë deri në hollësi, prej përmbajtjes deri te drejtshkrimi; në problemet e pazgjidhura dhe vendet me pikëpyetje; në radhën e ekspozimit, unitetit dhe strukturën logjike të planit dhe proporcionit të pjesëve (a u është dhënë disa pjesëve të tekstit - krerëve, pjesëve, paragrafëve etj. - hapësira që ato e meritojnë); në kalimin ndërmjet disa pjesëve të dorëshkri-

mit - krerëve, pjesëve, paragrafëve, fjalive (ato kalime duhet të jenë, siç kemi parë, natyrore, pa kërcime logjike dhe të shënojnë përparim drejt caktit); në hyrje: a e shtron ajo qartë problemin, a e shpjegon qëllimin e shkrimit dhe metodën e punës; në paragrafe, strukturën e tyre dhe zhvillimin e ideve në to; në formulimet stilistike, rregullsinë gramatikore dhe drejtshkrimore, sidomos në vendin e adverbis (ndajfoljes) në fjali, pastaj në atë se përemrat a kanë të bëjnë qartë me fjalët e vërteta, në shenjat e pikësimit; E të tjera.

E megjithatë, detyra më e rëndësishme dhe më e rëndë e revisionit është që pamëshirshëm t'i evitojë të gjitha ato që në dorëshkrim janë të tepërta, që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë me temën, ato që më fuqishëm nuk e ndriçojnë lëndën, nuk i kontribuojnë përshtypjes së përgjithshme, sikur që duhet nga dorëshkrimi pa mëshirë të hedhen poshtë të gjitha hollësitë banale. Saktë vëren D. Marne që "tri hollësi origjinale vlejnë më tepër për vetveten se sa tri hollësi të bashkuara me hollësi mesatare."¹¹⁴ Kurse Paradovski cek se si ndonjëherë me anë të gërshërëve, d.m.th. me hedhjen e të tepërtave, lindin kompozicionet e jashtëzakonshme, vepra që ju magjepsin me lehtësi dhe natyrshmëri.¹¹⁵

Që gjatë revisionit mos të mbetet diç e papërmirësuar, më së miri është që dorëshkrimi të lexohet së paku tri herë, duke pasur vëmendjen çdo herë në gjërat tjera. Për shembull, gjatë leximit të parë - në përmbajtjen: të shqyrtohet, në mënyrë kritike, punimi, duke e pasur vëmendjen në atë se a e ka arritur qëllimin e shtruar humlumi, sikur edhe në pohimet arbitrare dhe gabimet materiale eventuale në atë aspekt; gjatë leximit të dytë - në strukturën e punimit dhe pjesëve të tij, kaptinat, paragrafët, fjalitë, pastaj në zgjedhjen e fjalëve, në adekuatësi-

¹¹⁴ D. Momet, *Cours pratique...*, p. 18.

¹¹⁵ O. c., fq. 87.

në e formulimeve stilistike dhe në korrektësinë gramatikore; gjatë leximit të tretë - në përpunimin teknik të dorëshkrimit: gabimet në daktilografim, saktësinë e poshtëshënimeve etj. Prandaj, sikur që thekson Erlih (E. Ehrlich), gjatë revisionit të tekstit të vet autori paraqitet në rolin e trefishtë, sikur: 1) kritik, 2) stilist dhe gramatikan; 3) lexues teknik dhe korrektor.¹¹⁶

Të cekim se revisioni, dhe eventualisht përpunimi i konceptit, duhet të kryhet vetëm atëherë kur koncepti është përfunduar në tërësi. Atë duhet lexuar prej fillimit deri në fund, e pastaj, eventualisht, të përpunohet. Nëse kjo do të bëhej para përfundimit të konceptit, do të mund të ndodhte, më vonë, që gjatë revisioit të sërishëm duhet të hedheshin pikërisht ato pjesë në të cilat autori, duke i përpunuar, ka shpenzuar kohë mjaft të çmueshme. Krahas kësaj, vetëm kur koncepti është në tërësi i gatshëm, në të mund të hedhet shikimi sintetik dhe të shihet, eventualisht, çka i mungon që ta bëjë tërësinë organike.

Vetëm ashtu, ngadal dhe kujdesshëm i reviduar, teksti mund të daktilografohet pastër.¹¹⁷ Por, sigurisht, edhe në revistë do të jetë e nevojshme diçka të ndërrohet: të shtohet, përmirësohet, të modifikohet.

Është e kuptueshme që ndonjë vepër mund të ketë më tepër se një koncept dhe se në secilin prej tyre mund të bëhet revision: me këtë mund vetëm të përmirësohet cilësia e veprës.

Kur është fjala për revisionin e dorëshkrimit, duhet përmendur ende se ai rëndom kërkon mjaft kohë, nganjëherë madje po aq kohë sa edhe vetë shkrimi i tij. E sa

¹¹⁶ E. Ehrlich..., o. c., p. 44.

¹¹⁷ Nuk guxon të humbet parasysli fakti se çdo gabim i shkruar, - prej atij material deri te ai drejtshkrimor - është shumë herë më i rëndë prej gabimit gojor të kategorisë së njëjtë, që ai t'i vretë sytë dhe bëhet dëshmi e qartë dhe e përhershme e moskujdesit, pamaturisë dhe mosdijes së autorit e të ngjashme. Ndodh që ndonjëri prej këtyre gabimeve ta ndjekë autorin me vite dhe se e shtrëngon si ndonjë anklë.

i përket përpjesëtimit të kohës së shpenzuar në redigjimin e dorëshkrimit dhe asaj që shpenzohet në tubimin e lëndës, ky përpjesëtim mund të lëvizë në kufijtë 1:2, 1:3, e më shumë. Kjo d.m.th., për redigjim duhet llogaritur përafërsisht gjysmën, përkatësisht të tretën e kohës së shpenzuar për tubimin e lëndës, përkatësisht, e kundërta, për tubimin e lëndës nevojitet, sipas rregullit, dy ose tri herë më shumë kohë se sa për redigjim. Ky përpjesëtim varet nga shumë faktorë: lloji i lëndës, burimet nga të cilat ajo vjelet, shkathtësia e shkrimit e të ngjashme.

Në lidhje me këtë kaptinë për redigjimin e dorëshkrimit nuk do të jetë jointerese, shpresojmë, që këtu të shtrojmë disa këshilla praktike që për të shkruarit i kanë komunikuar Barzn (Jacques Martin Barzun) dhe Graf (Henry Franklin Graff) në veprën e vet *The Modern Researcher*.¹¹⁸

1. Nuk duhet pritur që të tubohet tërë lënda, e atëherë të fillohet të shkruhet, sepse, mendojnë shkencëtarët e përmendur, asgjë nuk e përforcon inercionin më tepër se “masa e shënimeve, prej të cilave disa depërtojnë edhe në kohët e kaluara të mjegulluara. Përkundrazi, sipas mendimit të tyre, të shkruarit duhet filluar posa një pjesë e punimit në shpirtin tonë të fitojë konturat e veta më të qarta.

2. Autori nuk duhet të frikësohet të shkruajë diç që më vonë do të duhet ta ndërrojë. “Letra nuk është granit, as ju në konceptin tuaj të parë i skalisni fjalët e amshueshme në gur”, thonë ata. “Më parë do të mund të thuhej që ju krijoni materien që, në vargun e koncepteve të njëpasnjëshme, do të detyroheni ta formësoni dhe sërisht ta formësoni”.

3. Pa hamendje duhet të shkruhen ato pjesë të punimit që, siç duket, tashmë janë pjekur në kohë.

4. Kur të fillohet shkrimi, nuk duhet të ndërprehet. Vërtetimi i fakteve e të tjera lihen për më vonë, kur të bëhet revisioni.

¹¹⁸ New York, Harcourt, Brace and Co. [1957], pp. 351 - 353.

5. Nëse gjatë të shkruarit ka pengesa, duhet përsëri të lexohen dy-tri faqet paraprake dhe të shihet se “a do t’ju lëvizë “vazhdimësia e mendimeve nga pika e vdekur”. Shumë autorë, shkruajnë autorët e cekur, “e fillojnë ditën e tyre të punës me leximin e saj që e kanë shkruar ditën paraprake.” Por, sipas mendimit të tyre, ka edhe shumë mënyra tjera “të të nxemurit” në shkrim, si kur: shkruarja e një apo dy letrave, përshkrimi ose hartimi i ndonjë shënimi, futja e çfarëdo të dhënash në ditar e të ngjashme. Gjatë kësaj është me rëndësi ajo se ky akt që i paraprinë vetë shkrimit edhe vetë të jetë shkrimi, si kur edhe ajo që të jetë afatshkurtër.

6. Meqë fillimi i shkrimit është i rëndë, Barzn dhe Graf këshillojnë që me rastin e tubimit të lëndës, të kihet vëmendje edhe në “ide edhe në fakte, ose eventualisht edhe në fjalët që mund të shërbejnë si fillim i mirë”. Ata shtojnë se si nga shkak i njëjtë disa autorë ndërprejnë të shkruarit e vet jo në fund por në mes të ndonjë pjese, kështu që herën tjetër nuk e fillojnë “njëkohësisht dhe po atë ditë edhe pjesën e re”.

7) Autori nuk duhet të ngurrojë ta heqë paragrafin që gjatë leximit të sërishëm bëhet i papërshtatshëm: kjo papërshtatshmëri nuk është asgjë tjetër por shenjë se “nxemja” është kryer gjatë paragrafit të parë dhe se vetëm paragrafi vijues ka qenë, në realitet, “fillimi i vërtetë”.

8. Autori duhet të bëhet sa më parë i vetëdijshtëm për atë ç’dëshiron ai më tepër dhe ç’i përgjigjet më mirë: pena ose makina e shkrimit, letra e formatit më të madh ose më të vogël, kjo apo ajo mënyrë e organizimit dhe rregullimit të shënimeve; ai madje duhet që në vete të provojë cili lloj i rrobave dhe cila pozitë e trupit më së shumti i përgjigjen për shkrim. Në tërë këtë, mendojnë autorët e përmendur, autori do të angazhohet t’i plotësojë kërkesat dhe shijet e veta, në mënyrë që, nga një anë, mos të ketë asnjë arsye që shkrimin ta shtyjë; kurse, nga ana tjetër, që në vete t’i kultivojë dhe t’i forcojë shprehitë e “punëtorit të mirë”.

VII. Mbështetja dokumentuese e dorëshkrimit

Çdo punim shkencor duhet të mbështetet në dokumentacionin solid, që zë fill në mbështetje të fuqishme dokumentuese, që vjen në shprehje deri diku në citate, e sidomos në aparaturën e a. q. shkencore: nga një anë në shënime, në nëntekst, të quajtura poshtëshënime (respektivisht fusnota, sipas fjalës gjermane *Fussnote*), që shkruhen gjatë redigjimit të konceptit; e nga ana tjetër, mbështetja dokumentuese e dorëshkrimit manifestohet në bibliografinë përfundimtare, që hartohet kur vepra është e shkruar dhe i bashkangjitet tekstit të dorëshkrimit.

T'i themi disa fjalë për këto tre aspekte të dokumentacionit.

A. Citatet

Citatet mund të shërbejnë qoftë si ilustrim i ekspozit, që është rasti më i shpeshtë, qoftë si dëshmi, më rrallë. Këtë rolin e tyre të dytë, sipas rregullit, duhet shmangur, pasi që dëshmitë duhet të përbëhen në rend të parë nga argumentet vetjake, e jo nga mendimet e huaja. E pikërisht në këtë më së shumti edhe gabojnë fillestarët, që në vend të ideve personale, fakteve, përfundimeve, cekin, si dëshmi, mendimet dhe fjalët e ndonjë autoriteti.

Prandaj, në theksimin e mendimeve të huaja, sidomos në formë citatesh, duhet ruajtur masën e vërtetë, të

jetë i kursyeshëm dhe i përmbajtur. Hulumtuesi, me fjalë të tjera, nuk guxon kurrë ta heqë nga mendja faktin që punimi i tij duhet të jetë punimi i tij vetjak, vepra e tij vetjake dhe se në të duhet të dominojnë mendimet dhe fjalët e tij vetjake, e jo të huajat. Nëse ai rezultatet e hulumtimeve të të tjerëve, përvojat dhe dijet e huaja nuk do t'i asimilojë në mënyrë solide, e t'i shkrijë me rezultatet e hulumtimeve vetjake dhe me dituritë dhe përvojat e veta, ai do të ngjasojë në atë kompilatorin (Abbé Trublet) të cilit Volteri i ka dërguar thumba therës para dyqind vjetësh.

*Il compilait, compilait, compilait...
Et nous lassait sans jamais se lasser.*¹¹⁹

Nga kjo rezulton se citatet, nëse janë të shumtë, të grumbullaur, lehtë mund ta asfiksojnë mendimin personal të autorit, përsiatjet personale, që stilit t'ia marrin notën personale, dhe që, në vijën skajore, t'ia zvogëlojnë origjinalitetin dhe vlerën e shkrimit të autorit. Njeriu rëndom citon sipas vijës së qëndresës më të vogël: përse të angazhohet të mendojë me kokën e vet, të mundohet që mendimin ta shprehë me fjalitë e veta kur mund të shërbehet me mendimin, formulimin e huaj, të gatshëm, - rezonon ai, plotësisht natyrshëm. Së këndejmi është e kuptueshme që disa ekspertë kanë qëndrim më pak apo më shumë kritik dhe hiperkritik ndaj citimit të tepruar, "citatologjisë". Kështu Andre Shamson (Chamson), duke karikuar ngapak, pohon se si ai "që fjalimet e tij me të madhe i dekoron me citate, bartë, në të vërtetë, rrobat e poshtme të njerëzve të huaj."¹²⁰ Kur ishte fjala për hartimin e shënimeve, kemi cekur kur dhe me çfarë kushtesh duhet shkruar dhe përdorur citatet tekstuale.

Citatet, natyrisht, duhet cekur nga dora e parë. Për-

¹¹⁹ Ai ka kompiluar, kompiluar, kompiluar ...

E neve na ka lodhur, duke mos e lodhur kurrë veten.

¹²⁰ Nedeljne informativne novine, 22 gusht, 1965, fq. 21.

jashtimi nga ky rregull lejohet vetëm në rastet e veçanta, nëse burimi parësor është i papërshtatshëm. Në atë rast duhet që kjo në vërejtje qartë edhe të shihet. Nga ana tjetër, gjerat përgjithësisht të njohura nuk vijnë në shprehje për citim: nëse duhet, mjafton, të ekspozohen me fjalët vetjake, duke udhëzuar në vërejtje në burim.

Citati me përmbajtjen, formën, tonin e vet duhet të pajtohet me tekstin ashtu që me të të përbëjë unitet organik, që mos të ndihet kurrfarë çalitje gjatë kalimit nga teksti vetjak në citat dhe anasjelltas.

Nga citati, natyrisht, nuk guxojnë të lëshohen, - vetëdijshtë apo pavetëdijshtë, - vendet që pikëpamjen e autorit të cituar do ta tregonin në dritë tjetër, ose madje do ta shtrembëronin. E nëse disa fjalë, - si jointeressante, të parëndësishme, të tepërta, - lëshohen nga citati, kjo medoemos duhet të shënohet me tri pika, të vëna në kllapën e mesme,¹²¹ duke i ruajtur gjatë kësaj shenjat e pikësimit të përdorura para ose pas pjesës së lëshuar të tekstit. Nëse pas fjalëve të lëshuara (dhe tri pikave) fillon fjalia e re, pas kllapës së mesme, përkatësisht para fillimit të fjalisë së re, vihet edhe një pikë.¹²² Nëse tri pikat nuk vëhen në kllapë, sikur që kjo rëndom ndodh në gjuhën angleze, do të ishin në rastin e fundit katër pika në të gjitha. Lëshimi i tërë paragrafit, në prozë, ose tërë vargut, në poezi, shënohet me pika nëpër tërë rreshtin.¹²³ Po ashtu në kllapa të mesme duhet të vihet çdo gjë që citatit i shtohet.¹²⁴ Përndryshe, në citat përfshihen të gjitha veço-

¹²¹ Shembull: "Në botimin e dytë [...] do të duhej më përafërsisht të shpjegohen së paku edhe dy raste".

¹²² Shembull: "Në botimin e dytë [...] edhe dy raste [...]".

¹²³ Shembull:

Gjithë këto gjëra edhe një herë do të vijnë

Siç kanë qenë dhe si kanë kaluar

.....

Dhe dashurinë, të delirë, epsiore, të mirëseardhur;

(Tim Ujević)

¹²⁴ Shembull: "Shkurtimisht, këto shkenca (d.m.th. shoqërore, janë faktorë me rëndësi..."

ritë drejtshkrimore (shenjat e pikësimit dhe drejtshkrimore) dhe gabimet eventuale, pas të cilave vihet në kllapën e mesme fjala sic: [sic!]. E nëse paraqitet nevoja që, nga shkaqet e caktuara, dorëshkrimi të modernizohet, të unjësohet me drejtshkrimin e tekstit të autorit, kjo sidomos duhet të ceket në referencë ose në parathënie. Përjashtim nga kjo bëjnë shkronja fillestare në fjalën e parë të citatit dhe shenja e pikësimit në fund të fjalëve të cituara, që i adaptohen strukturës së fjalisë në të cilën janë përshtatur.¹²⁵

Nëse në citatin e huaj disa fjalë veçan dëshirohet të ceket, duhet të ceket edhe ajo kujt i takon theksimi. (Për shembull, në poshtëshënim ose në kllapa shkruhen fjalët: “Theksojmë ne, M. Sh.”; ose: “Nënvizoi, M. SH.” e të ngj.) Citati në citat shënohet, sikur që edhe në *Drejtshkrimin tonë të ri* (serbo-kroato-boshnjak, përkthyesi: N. I.) thotë me gjysëmthonjëza (“...”).

Disa citate përshtaten në vetë indin e hartimit, me thonjëza të domosdoshme në fillim dhe në fund të citatit (këto rëndom janë citatet në prozë prej më së shumti katër rreshta të shtypur, e disa prej një vargu ose më pak), derisa të tjerët, - më të gjatë se të përmendurit, - veçohen nga teksti dhe, eventualisht, tërhiqen disa milimetra (dy deri në tri shenja), e shpesh edhe e daktilografojnë pa ndërvijë. Vargjet, përveç kësaj, shkruhen në mes. Në rastet e fundit shenjat nuk janë të nevojshme.¹²⁶ Citatet e auto-

¹²⁵ Për shembull, fjalia të cilën autori i shkrimit dëshiron ta citojë në tekstin e vet është: “Shekulli shtatëmbëdhjetë është epoka më e shkëlqyeshme në historinë e letërsisë franceze”. Në atë rast, kjo pjesë e shkrimit do të dukej kështu... Saktë ka shkruar një historian yni i letërsisë se “shekulli i shtatëmbëdhjetë është epoka më e shkëlqyeshme në historinë e letërsisë franceze”, por ky shekull në të njëjtën kohë...

Sikur që mund të shihet, citati i përshtatur në tekst fillon me shkronjë të vogël, edhe pse në origjinal është shkronja e madhe, sepse gramatikisht është e lidhur me atë që i paraprinë. Ngjashëm çështja qëndron në rastin e kundërt: ndonëse në origjinal është shkronja e vogël, citati mund të fillojë me shkronjë të madhe nëse gramatikisht nuk është i lidhur për atë që i paraprinë.

¹²⁶ Shembujt:

Citati në prozë:

rëve të ndryshëm, ose nga veprat e ndryshme të autorit të njëjtë, ndahen njëri prej tjetrit me ndërvijë, derisa paragrafet dhe citatet nga vepra e njëjtë shkruhen pa ndërvijë.

Nuk ka nevojë që në mënyrë të veçantë të theksohet se citatet nuk guxojnë të jenë shumë të gjata, pos në rastet e veçanta mund të jenë më të gjata se një faqe.

Ende shtrohet pyetja: në cilën gjuhë do t'i cekim citatet? Kjo varet më së shumti nga karakteri i shkrimit dhe niveli i lexuesve të cilëve ai u është destinuar: nëse shkrimi u është drejtuar ekspertëve, kurse citatet janë shkruar në njërin prej gjuhëve universalisht të shtrira (në anglishte, rusishte, frëngjishte, gjermanishte, nganjëherë edhe në spanjollishte dhe italishte), ato mund të cekën në gjuhën origjinale; e nëse punimi i është destinuar rrethit më të gjerë të lexuesve, ose citati është në ndonjë gjuhë që nuk është universalisht e shtrirë, ai ceket në përkthim, me atë që, eventualisht (në tekstet shkencore), në poshtëshënim të ceket edhe teksti origjinal (ose e kundërta: citati në gjuhën e huaj përmendet në tekst, kurse përkthimi në vërejtje, me kllapë të mesme, duke shtuar fjalët: "Përktheu M. Sh.", "Përkthimi ynë - M. Sh." e të ngj.). Vargjet, ndërkaq, citohen gjithnjë në gjuhën origjinale (me përkthimin eventual në nëntekst). Përdorimin e gjuhës së huaj në citat mund ta imponojnë edhe disa raste të veçanta; për shembull, nëse analizohen

Predikuesi kristian i shekullit XVII, Burdalu (Bourdalous) i ka njollosur porositë e aristokratëve me këto fjalë:

Është numër i madh i personave që në tokë janë si duhet, [...] vetëm për atë arsye që të marrin tatim nga puna e huaj e nuk paguajnë kurrë tatimin e vet tjetrit: që në profesionin e vet nuk kanë punë tjetër pos të shfrytëzojnë begatitë dhe ëmbëlsitë e jetës;...

Citati në varg:

Në një poezi nga shekulli XVII është vënë në shenjë një prelat autoritativ dhe dobësia e tij ndaj femrave:

Le pasteur qui nous gouverne

Fait l'amour toute la nuit

Et traite de baliverne

Tout le blame du deduit ...

vetitë stilistike të ndonjë vepre apo të ndonjë autori të huaj, nëse komentohet ose shqyrtohet domethënia e saktë e disa shprehjeve, etj.

Sidomos duhet pasur kujdes në atë që citati i cekur saktë të riprodhohet: citati gabimisht i cekur nxitë, te autori nga i cili është marrë, zemërim të arsyeshëm, meqë e shformon mendimin e tij, i imputojnë diç që ai nuk e ka thënë. Ta kujtojmë A. Zhidin, që, i mllëfosur që disa gabimisht e citojnë, ka britur: “Njeriu do të kishte të drejtë, më duket, që kundër atyre që gabimisht e citojnë, të nisë procedurë gjyqësore.”¹²⁷

Në fund, ta tërheqim vëmendjen në një gabim në të cilin jorrallë bien fillestarët (dhe në të cilin japin shenjë Barzani dhe Grafi;¹²⁸ gjatë theksimit të citatit autori i pa nam paralajmëron përmbajtjen e tij duke e parafrazuar; pastaj pason citati tekstual (në përkthim); më në fund, autori sërisht kthehet në përmbajtjen e citatit dhe sërisht e parafrazon. Në këtë mënyrë, në të vërtetë, mendimi i njëjtë përsëritet tri herë, në pothuaj tri forma të njëjta. Nuk ka nevojë të ceket se sa ajo me këtë zvarritet, degëzohet, përtypet.

B. Poshtëshënime (Fusnotat)

Marrë në përgjithësi, në poshtëshënime, që rëndom vihen në nëntekst, në fund të faqes (së këndejmi emri), futet çdo gjë që në tekst paraqet balast, që do ta vështirësonte leximin dhe të kuptuarit e tij: referencat bibliografike, shpjegimet që janë të dobishme ose interesante, por nuk janë të domosdoshme, citatet në gjuhën e huaj në qoftë se edhe ata, përveç përkthimit, janë të domosdoshëm, e të ngjashme.

¹²⁷ A. Gide, *Journal (Pléiade)*, I. 1206

¹²⁸ O. c., p. 291.

Shënimet (fusnotat) mund të jenë trellojesh. Në llojin e parë bëjnë pjesë ato që më së shpeshti quhen fusnota dokumentare (përkatësisht burimore (*documentary footnotes*), ose referenca bibliografike (*références bibliographiques*): ato, sikur që edhe emri iu flet, shërbejnë për theksimin e të dhënave bibliografike të dokumenteve (burimeve) nga të cilat janë vjelur citatet, idetë, faktet. Këto vërejtje disa i shkruajnë në tekst, në kllapën e rrumbullakët, që nuk preferohet në punën shkencore, sepse ato, në atë rast, e rrënojnë tekstin. Në pajtim me këtë, ato mund të vendosen në tekst vetëm nëse janë shumë të shkurtëra.¹²⁹ Përndryshe vendin e kanë në fund të faqes. Llojin e dytë e përbëjnë të a.q. fusnota / shënime eksplikative (*explanatory footnotes*), që shërbejnë si shpjegim plotësues i ndonjë mendimi ose fakti që ceket në tekst: shënimi, vërejtja e këtyre, sipas bindjes së autorit, mund, të jetë me interes të caktuar për lexuesin; por ajo del deri diku nga suazat e vetë ekspozitës në tekst dhe se jepet në nëntekst. Në fusnotat e fundit mund të futen informata të llojllojshme plotësuese, llojet e ndryshme të ideve dhe fakteve: krahasimet, vërejtjet kritike, variantet e tekstit e të ngj.¹³⁰ Më në fund, lloji i tretë i fusnotave udhëzon në ndonjë burim tjetër që trajton problematikën e njëjtë apo të ngjashme, ose në pjesët tjera të burimit të njëjtë (*cross references*, referencat udhëzuese, orientuese).¹³¹

¹²⁹ Që deri diku ta shingarkojnë tekstin e vet nga shënimet, disa shkencëtarë cekin në kllapa vetëm mbiemrin e autorit, titullin e librit, numrin e blenit (eventualisht) dhe faqet; e në fund të librit japin regjistrin e librave të cituar, me të dhënat tjera të domosdoshme bibliografike për çdo vepër, duke ia shtuar edhe numrin e faqes në të cilën vepra e caktuar është cituar.

¹³⁰ Për të gjitha këto raste K. L. Turabian jep shumësi shembujsh. Krahaso veprën e saj: *A manual for writers of term papers, theses and dissertations*, p. 36.

¹³¹ Po këto vërejtje që përndihen në ndonjë libër tjetër rëndom gjenden edhe në skemat katalogjike të të gjitha bibliotekave më të mëdha, pas të dhënave të rëndomta bibliografike. Këto të dhëna për hulumtuesin janë me dobi të madhe: ato i dëftojnë në autorët tjerë që e kanë trajtuar problemin që edhe atij i intereson.

Derisa, sipas rregullit, pranohen vlera dhe dobia e shënimeve eksplikative, në anën tjetër të dy llojet tjera të shënimeve (referencat bibliografike) shpesh janë objekt i sulmeve dhe përbuzjeve: i konsiderojnë shenjë të shkrimtarit pedant, të privuar nga elani dhe imagjinata dhe në esencë të shkrimtarit të bezdisshëm. Këto sulme dhe përcmime janë, ndërkaq, në bazë, të paarsyeshme e të padrejta, duke e marrë parasysh se edhe ky lloj i shënimeve ka në punën shkencore qëllimin e vet të caktuar e të arsyeshëm. Ai kryesisht është dyllor:

1) Shënimet / fusnotat dokumentuese paraqesin garancinë e mirëfillësisë dhe të autenticitetit të disa thënieve, pohimeve, civateve, aluzioneve, fakteve, huazimeve e të ngj.: duke e udhëzuar lexuesin te dokumenti (burimi), dhe duke i mundësuar në këtë mënyrë që vetë personalisht çdo thënie ta vërtetojë, ato i japin tekstit të autorit siguri më të madhe, autoritet më të madh.

2) Ky lloj shënimesh / fusnotash i mundëson lexuesit të interesuar që, eventualisht, nga afërsia, - më hollësisht dhe më themelsisht, - të njohet me dokumentin (burimin) në të cilin thënia (citati, fakti, ideja e të ngj.) zë fill, ose e cila trajton problematikë të ngjashme. Në atë mënyrë ato paraqesin, në vijën e fundit, faktor me rëndësi në zgjerimin e diturisë dhe zhvillimin e shkencës.

Me një fjalë, shënimet dokumentuese, përkatësisht bibliografike paraqesin, nga një anë, dëshmi për përdorimin e kujdesshëm e të ndërgjegjshëm të dokumentacionit nga ana e autorit, kurse nga ana tjetër, ato ofrojnë mundësi që të tjerët jo vetëm ta vërtetojnë këtë dokumentacion (dhe me këtë ta kontrollojnë autorin), por që edhe vetë të njohet për atë që u intereson. Dhe pikërisht duke iu falënderuar poshtëshënimeve, që përbëjnë pjesën kryesore të aparatit shkencor, punimi shkencor pjesërisht edhe dallon nga punimi popullarizues-shkencor.

Punimin, natyrisht, nuk duhet ngarkuar me poshtëshënime; aq më parë që ato deri diku e kthejnë vëmend-

jen e lexuesit.¹³² Kjo d.m.th. që të vërtetat, pohimet, thëniet e qarta nuk duhet argumentuar me burime, pasi që janë të asaj natyre që lexuesi nuk ka nevojë t'i vërtetojë. Por po ashtu nuk lejohet as të bëhen huazime, të cilitdo lloj e vëllim, nga ndonjë burim duke kaluar nëpër të heshtazi. Saktë ka thënë A. Zhidi: "Nderi i një autori përbëhet në atë që mos t'i japë, si të vetat, idetë që i ka shkruar aty - këtu, te të tjerët."¹³³ Përjashtim nga ky rregull nganjëherë mund të bëhet në studimin sintetik, në librat shkollorë, nëse në fund të dorëshkrimit globalisht ceket literatura dhe dokumentacioni i përdorur.

Të shkruarit e drejtë të shënimeve dokumentuese nuk është çështje mekanike dhe në pajtim me këtë e thjeshtë dhe e lehtë, siç kanë prirje disa të mendojnë, por punë që kërkon mençuri, saktësi, akribie, sikur edhe njohjen e teknikës së shkrimit, metodave të përvetësuar të shënimit të atyre civateve / shënimeve në rastet e ndryshme të cilat janë tërë një shumësi. Edhe kjo njohje është e domosdoshme jo vetëm për atë që autori të dijë vetë drejt ta shkruajë fusnotën dhe bibliografinë, por që edhe ai lehtë të mund të gjendet në fusnotat dhe bibliografitë e autorëve të tjerë.

Në rend të parë të përkujtojmë në atë që shënimet dokumentuese (dhe, përgjithësisht, poshtëshënimet), sikur edhe fjalët në tekst me të cilat ato kanë të bëjnë, rëndom shënohen me numra arabë pa kllapa, pak të ngritur, dhe atë në tekst, pas shenjës së pikësimit, nëse ajo ekziston.¹³⁴

¹³² Për këto arsye disa i hedhin në fund të librit. Disa sërish i ndajnë shënimet bibliografike dhe eksplikative dhe këto të fundit i shkruajnë në fund të faqes (në nëntekst) me të cilat kanë të bëjnë, derisa shënimet bibliografike lihen në fund të tekstit. Në këtë rast janë të domosdoshme dy lloje të shifrave për shënimin e fusnotave: kursive - për shënimet eksplikative dhe romake (të rëndomta) - për shënimin e shënimeve bibliografike. Nëse shënimi bibliografik është i domosdoshëm brenda shënimit eksplikativ, ai vihet në kllapë të rumbullakët.

¹³³ A. Gide, *Journal*, 1942-1944. (Paris, Gallimard, 1950), p. 139.

¹³⁴ Disa janë të mendimit se numri i shënimit duhet të shkruhet para shenjës së pikësimit në qoftë se numri vihet në mes të fjalisë; kurse pas pikës nëse ai vihet në fund të fjalisë. Shembull: Është dashur patjetër të vdesë,¹⁾ ka vuajtur.²⁾

Numri vjen në fund të citatit, e jo menjëherë pas përmendjes së emrit të autorit. Ata numra mund të fillojnë në çdo faqe prej fillimit (1, 2., 3, etj. - sipas asaj sa në një faqe ka shënime); e edhe, që është edhe më praktike, ato mund të shkojnë me radhë brenda një kapitule, e nëse shkrimi është i vëllimit më të vogël, edhe brenda tërë shkrimit. Me rastin e daktilografimit të punimit, e sidomos me rastin e revizionit të tij, duhet kushtuar vëmendje në atë se a u përgjigjen numrat e shënimeve në tekst shënimeve në nëntekst.¹³⁵ Nuk është pa rëndësi as vendi në tekst ku do të vihet shenja (numri) e poshtëshënimit; më së miri është të vihet në fund të fjalisë, sepse, nëse kjo bëhet në mes të fjalisë, lexuesi bie në sprovë ta shikojë shënimin dhe me këtë ta ndërprejë fjalinë dhe mendimin.

Cilat të dhëna bibliografike nga burimi (dokumentet) do t'i cekim, varet shumë nga ajo se burimi a ceket një herë ose më shumë herë, sikur edhe se punimi a ka në fund bibliografi ose nuk ka. Nëse nuk ka bibliografi, në shënim theksohen të gjitha të dhënat e rëndomta bibliografike: emri (ose së paku shkronja e parë e tij) dhe mbiemri i autorit, titulli i veprës (i nënvizuar), numri i botimit nëse ka disa, vendi i botimit, emri i botuesit, viti i botimit, numri i blenit nëse ka disa blejë, numri i faqes (përkatësisht i faqeve).

T'i cekim disa shembuj për lloje të ndryshme të shkrimeve:¹³⁶

¹³⁵ Në rastin e parë (kur numrat fillojnë prej fillimit për çdo faqe), nëse shënimet nuk janë të shumta, disa autorë i përdorin yjëzit (ose ndonjë shenjë tjetër) në vend të numrit. Por, marrë në përgjithësi, mënyra e shënimit të poshtëshënimeve me numra, përkatësisht me yje, veçan për çdo faqe, nuk është aspak praktike: ndërrimet e vogla në tekst mund të nxisin rrëmujë dhe humbjen e kohës rreth rregullimit të shënimeve, nganjëherë edhe domosdoshmërinë që ato, ose madje edhe tërë punimi, sërish të daktilografohen.

¹³⁶ Në theksimin e shembujve për disa raste jemi udhëhequr në masë të konsiderueshme me parimet e shtuara në vepër: K. L. Turabian, *A manual...* Nga po ky libër kemi vjelur edhe ndonjë shembull.

Librat

Antun Barac,¹³⁷ Jugoslovenska književnost, Zagreb, Matica hrvatska, 1954, fq. 75.

Të gjitha të dhënat janë të ndara mes vete me presë.

A. Barac, Jugoslovenska književnost (Zagreb, Matica hrvatska, 1954), fq. 75.

Të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me botimin, d.m.th. me vendin dhe vitin e botimit, emrin e botuesit e të ngjashme, mund të vihen në kllapa të rrumbullakta.

G. Dykmans, Initiation pratique an métier d'écrire, Paris et Bruxelles, Bande, 1974, t. II, p. 225.

Vepra citohet në gjuhën me të cilën autori është shërbyer.¹³⁸

The Lottery (London: J. Watts, 1732), pp. 20-25.

¹³⁷ Disa në poshtëshënim dhe në bibliografinë përfundimtare mbiemrin e nënvizojnë me dy vija, që d.t.th. që, gjatë shtypjes, duhet radhitur me shkronja kopitale. (Të shihet kreu IX, B. 1.).

¹³⁸ Në atë rast kujdes të veçantë duhet kushtuar asaj se çka në cilën gjuhë shkruhet me shkronjë të madhe. Ja disa vërejtje:

Gjuha frënge:

Fjala e parë dhe të gjithë emrat shkruhen me shkronjë të madhe, kurse nga mbiemrat vetëm ato që janë nxjerrë nga emrat vetjakë. Shembull: Georg Müller, Arbeit am sprachlichen Ausdruck, Berlin, Wolk und Dissen, 1962, S. 32.

Gjuha frënge:

Me shkronjë të madhe shkruhen:

Në titullin e librit - fjala e parë dhe çdo emër me interes më të madh, sikur edhe epiteti që i paraprinë kësaj. Shembull: Dante, La Divine Comedie...; par: Le Tasse, La Jérusalem délivrée...

Në titull të revistës - fjala e parë dhe çdo emër dhe epitete që qëndron para emrit. Shembull: Revue de Littérature comparée...; La Libre Belgique...

Në titull të artikullit në revista dhe gazeta - vetëm fjala e parë. Shembull: M. Šamić, "La légende napoléonienne dans la littérature yougoslave", Revue de Littérature comparée (Paris), avril-juin 1958, p. 249.

Në mënyrë të ngjashme veprohet në gjuhën italiane dhe spanjolle.

Gjuha angleze:

Në tituj - fjala e parë dhe të gjitha emrat vetjakë dhe mbiemrat e nxjerrë prej tyre shkruhen me shkronjë të madhe. Shembull: George Shelton Hubbel, Writing term papers and reports...

Në gjuhën angleze ekziston edhe mënyra tjetër e të shkruarit të shkronjës së madhe në tituj: me shkronjë të madhe shkruhen fjala e parë dhe të gjithë emrat, mbiemrat, përemrat, ndajfoljet dhe foljet".

Nëse nuk është dhënë emri i autorit, shënimi fillon me titullin e veprës.

Antoine Adam, *Les Libertins au XIIe siècle*, Paris, Buchet / Chastel, s.d. [1964], p. 69.

Nëse në libër nuk është shtypur viti i botimit, kurse autori i shkrimit në ndonjë mënyrë ka mësuar për këtë, atëherë e vë ate në kllapë katrore.

Në po këtë mënyrë veprohet edhe me të dhënat tjera bibliografike: mbiemrin e autorit ose botuesit, vendin e botimit e të ngjashme. Për shembull:

[Henry Z. Blank] , “Art for it’s Own Sake”, *Magazine of New Art*, XXX (January, 1912) 85 – 90.

Emri i autorit nuk shënon në libër, por autori ka arritur ta mësojë dhe e ka inkadruar në shënim.

Sylvain Phalantée [Pierre David], *Athene assiegée*, Paris, Firmin – Didot, 1827, p. 18.

Në vepër është dhënë pseudonimi; por autori i veprës ka mësuar emrin e vërtetë të tij, të cilin e ka futur, duke e vënë në kllapë të mesme, pas pseudonimit.

G. Dykmans, *Initiation pratique au métier d’écrire*, Paris et Bruxelles, Bande, 1947, t. II, p. 225, G. Lanson, *Consells sur l’art d’écrire*, Paris, Hachette, 1894, p. 40.

Nëse ceken më shumë shkrime, ato rëndom ndahen me pikë dhe presje.

Charles H. Vivian and Bernetta M. Jackson, *English composition*, Barnes and Noble, p. 250.

Nëse veprën e kanë shkruar dy autorë, ceken emrat e të dyve.

Po ashtu veprohet edhe me tre autorë. Por në rast të më shumë se tre autorëve citohet, rëndom, vetëm emri i të parit dhe pranë tij vihet: etj. (et al.). Për shembull:

G. M. Dutcher et al. (ose: G. M. Dutcher e të tjerët), *Guide to Historical Literature* (New York: Macmillan C°, 1931, p. 50.

Sir Alan Gardiner, *Egyptian Grammar* (2d ed. rev., London, Oxford University Press, 1950), p. 250.

Vepra ka më shumë se një botim: në atë rast ceket botimi që është konsultuar.

Rudolf Maixner, *Charles Nedier et l'Illyrie* ("Etudes de littérature étrangère et comparée, N^o37; Paris, M. Didier, 1980), p. 57.

Vepra është paraqitur në ndonjë përmbledhje, emri i të cilës, sikur edhe numri i veprës, ceket.

J. H. Latané, *America as a World Power, 1897 - 1907*, Vol. XXV. (of *The American Nation: a History*, ed. A.B. Hart, 28 vols., New York; Harper and Bros, 1904-1918), p. 220.

Veprën që përbëhet prej shumë vëllimeve e ka botuar me titull të përbashkët një autor: nga ajo vepër çdo vëllim mban titull të veçantë dhe e ka shkruar autor tjetër. Në atë rast vepra citohet siç është cekur në shembullin e sipërm.

Marx - Engels - Lenjin, *Izabrana djela*, (Redaktore e botimit Nataša Tkalec, vëllimi 10, Zagreb, Naprijed, 1963 -) II (1963), 59.

Marks Karl, Fridrih Engels, *Izabrana dela u dva toma* (Beograd, Kultura, 1919-1950), II, 427.

Shënimet që kanë të bëjnë me veprat e zgjedhura ose të tërësishme ceken, rëndom, sikur në dy rastet e sipërme.

Alber Tibode, *Istorija francuske književnosti od 1789 do naših dana*, përktheu Midhat Šamić, (Sarajevo, Veselin Masleša, 1961), fq. 50.

Këtu është fjala për përkthimin dhe në atë rast rëndom ceket edhe emri i përkthyesit.

Fragmentet nga pjesët teatrore citohen në atë mënyrë që ceket numri i aktit dhe skenës (për shembull: IV, 3), derisa për pasuset nga poemat më të gjata ceken numrat e vargjeve (për shembull: vargu 58-63).

Artikujt nga revistat dhe gazetat

Të dhënat bibliografike për artikujt nga revista, që deri diku dallohen nga ato të librave, ceken më së shpeshti me këtë radhë: emri dhe mbiemri i autorit, titulli i artikullit, emri i revistës, numri i vëllimit (blenit) i shënuar gjithnjë me numër romak, data (muaji dhe viti, që rëndom ndahen me presje dhe vihen në kllapën e rrumbullakët), numri i vëllimit (nëse faqet nuk shkojnë me radhë gjatë tërë blenit), numri i faqes.

Shembujt:

Meša Selimović, "Kritičarska dosljednost Milana Bogdanovića", *Život*, (Sarajevo), XIII (prill, 1964), 5.

Dr Antun Polanšćak, "Romain Rolland", në: *Život*, (Sarajevo), prill, 1966, fq. 38.

Disa këtë mënyrë të dytë të theksimit të të dhënave bibliografike ia parashtrojnë mënyrës paraprake, pasi që ajo tregon qartë se në pyetje është artikulli nga ndonjë revistë, gazetë, përmbledhje e të ngjashme, d.m.th., fjala është për të a. q. "shkrimin e varur".

Dr Mirjana Gros, "Primena naučne istoriografije", *Politika*, 13. qershor, 1965, fq. 15.

"Kolokuiumi shkencor mbi Bribirin", *Oslobodjenje* (Sarajevo), 15. janar 1966, fq. 6.

Titulli i artikullit nga revistat ose nga gazetat nuk nënvizohet por vihet në thonjëza; kurse me vijë valore nënvizohet emri i revistës, përkatësisht i gazetës. Nëse revista dhe gazeta janë të gjithënjohura, nuk është e domosdoshme të ceket vendi i botimit; përndryshe ai mund të vihet në kllapa të rrumbullakta, sikur edhe muaji dhe viti i botimit të revistës. Nëse emri i autorit të artikullit nga revista është shënuar me iniciale, ato iniciale, duhet, brenda mundësive, të deshifrohen e të shkruhen emri e mbiemri i plotë. Për shembull: R[udolf] M[ajksner]. Deshifrimi më së shpeshti mund të bëhet sipas re-

gjistrit vjetor të bashkëpunëtorëve të revistës, respektivisht gazetës. Nëse emri i autorit të artikullit nuk është shënuar, shënimi dokumentar, sikur edhe te veprat, fillon me titullin. Kur pas numrit të blenit ceket edhe numri i vëllimit, theksimi i muajit nuk është i domosdoshëm. Po ashtu nuk është i domosdoshëm theksimi i numrit të blenit te fletat ditore, javore e të përdyjavshme.¹³⁹

Artikujt nga përmbledhjet

Svetozar Markovic, “Značenja i oblik deadjektivnih glagola složenih sa prefiksom o (i po)”, Radovi Filozofskog fakulteta (Sarajevo, 1964), fq. 60.

Fran Petre, “Izvori evropske književnosti”, në: Uvod u književnost (redaktorë: Fran Petre dhe Zdenko Škreb), Zagreb, Znanje, 1961, fq. 121.

Artikujt nga enciklopeditë

“Francusko - jugoslovenski odnosi”, Enciklopedija Jugoslavije (Zagreb, Leksikografski Zavod, 1958), III, 351.

Artikulli i panëshkruar nga enciklopedia citohet në mënyrën e sipërme. Artikulli i nënshkruar citohet me emrin e autorit të artikullit, që duhet parë ndër shkurtesat, nëse ai nuk është dhënë me nënshkrimin e plotë, e kjo rrallë ndodh. Ja një shembull:

Dr Josip Hamm, “Archiv für slavische Philologie”, Enciklopedija Jugoslavije, I, 167.

Raportet

Annual Report of [...]. June 30, 1932 (Washington: U.S. Government Printing, Office, 1993), p. 20.

¹³⁹ Kths.: Turabian, o. c., p. 19.

(Raporti vjetor në të cilin nuk është dhënë emri i hartuesit të tij).

American Medical Association, Medical Relations under Workmen's Compensation, A Report Prepared by [...] (Chicago: ..., 1933), p. 3.

(Raporti autor i të cilit është njëfarë shoqate)

Materiali nga ndonjë tubim (kongres, simpozium e të ngjashme)

Industrial Relations Research Association, Preceedings of Third Annual Meeting (Madison, Wis., 1951), p. 143.

Tezat e pabotuara

Radovan Vučković, "Naša kritika i Andrićevo književno delo" (tezë e papublikuar doktoranture, e mbrojtur në Universitetin e Sarajevës në vitin 1965, Biblioteka jugoslovenskih književnosti Filozofskog Fakulteta u Sarajevu, fq. 141.

Intervistat e papublikuara

Intervista me shefin e Katedrës së letërsive jugosllave, 15 tetor, 1966.

Dokumentet

Sa u përket dokumenteve (lëndës arkivore e të ngjashme), ato mund të jenë të llojit të nduarnduart dhe këtu është e pamundur të cekem shembujt për ta. Do të themi

vetëm që gjatë citimit të tyre duhet cekur aq të dhëna sa është e nevojshme që dokumenti lehtë të identifikohet dhe lakohet, ashtu që lexuesi i interesuar, sipas nevojës, mund ta gjejë pa vështirësi. Aty rëndom cekën të dhënat vijuese: vendi (ose qyteti), emri i institucionit, emri dhe numri i serisë së dokumentit, data dhe numri i dokumentit, numri i faqes e të ngjashme.

Ja një shembull:

Archives du Ministère des Affaires étrangères de Paris, Salonique 17, Sarajevo, 6 février, 1813, p. 5.

Në shënimet eksplikative burimi mund të ceket në dy mënyra: 1. Në tekstin e shënimit (në kllapë), për shembull: Në veprën "Istorijski izvori ...", Sarajevo, Veselin Masleša, 1962, fq. 8). N. N. shqyrton ... 2. Në fund të shënimit (në kllapë). Shembulli: Për këtë problem më hollësisht flet N. N. (Të shihet vepra Istorijski izvori..., Sarajevo, Veselin Masleša, 1962, fq. 8). ose: Për këtë problem më hollësisht flet N. N. Të shihet artikulli i tij në *Pregled*, Sarajevo, Janar - Shkurt, 1967, fq. 72. etj.

Nëse punimit shkencor i është bashkangjitur bibliografia përfundimtare, titulli i tekstit ceket në formën e shkurtër, derisa disa të dhëna tjera bibliografike plotësisht mund të lëshohen, pasi që lehtë mund të gjenden në bibliografinë e bashkangjitur. Po ashtu shkurtimisht shënohen të dhënat e veprës që citohet dy ose më shumë herë: më së shpeshti, emri dhe mbiemri i autorit, me njërin prej shkurtesave të rëndomta: o.c., artik i cit., loc. cit., ibid., e të ngjashme.¹⁴⁰ Gjatë kësaj duhet pasur kujdes në dy momentet vijuese:

¹⁴⁰ Ja shkurtesat më të shpeshta në (boshnjakishte) - kroato-serbishte: Gjuha (boshnjake - N.I.) kroato-serbishte: isp., ispor. - isporodi (krahaso); up., upor. - uporedi (krahaso); n.d. - navedeno djelo (vepra e cituar, cekur); str. - strana (faqeja); t. - tom (vëllim, ble); sv. (- svezak (fletore, vëllim, volum); knj. - knjiga (libri); etj. - to jest (domethënë, d.m.th.); i dr. - i drugo (e të tjera, etj.); i sl. - i slicno (dhe ngjashëm). I tako dalje (itd.) (e të tjera, e kështu me radhë etj.). (Të shihet Drejtshkrimi i ri.)

1) Nëse vepra ose artikulli janë cituar shumë herët, është e pëlqyeshme sërish të cekën të gjitha të dhënat e tyre kryesore, sikur që herën e parë janë cituar, në mënyrë

Gjuha latine: A. D. (anno Domini) - pas Krishtit, art. (articulus) - artikull, neu; ca (circa) - rreth; cf. (confer) - krahaso; corr. (correxit) - përmirësoi, korrigjoi, etc. (et cetera) - e të tjera; ib., ibid. (ibidem) - në vendin e njëjtë, po aty; id. (idem) - i njëjti; i.e. (id est) - d. m. th; inf., infra - nën, poshtë (udhëzon në atë që do të vijë më vonë); l.c, loc.cit. (loco-citato) - në vendin e cekur; mag. (magister) - magister (magjistër); N.B. (Nota bene) - Me konsideratë; N. N. (nomen nominandum) - filani e fisteku, ky e ky; o.c., op. cit., (opere citato) - në veprën e cekur; po aty; pass (passim) - në vende të ndryshme; P. S. (post scriptum) - post scriptum; s. a. (sine anno) - pa vit botimi; s.l. (sine loco) - pa vend botimi; sq., seq. (sequens) - faqeja vijuese; sq., seqq. (sequentes) - faqet vijuese; sic (nuk është shkurtësë) - ashtu (shënon se ashtu është edhe në origjinal, sikur edhe habi); sup. (supra) - më lartë (udhëzon në të dhënat më të hershme); s. v. (sub. voce) - te fjalët, artikulli; t. (tomus) - vëllim; vol. (volumen) - volum; v. v. (vice versa) - e kundërta.

Gjuha angleze: art., arts (article, articles) - artikull, artikujt; Bk, Bks (book, books) - libri, librat; ca (circa - about) - rreth; chap., chaps (chapter, chapters) - kapitull, kapitujt; col., cols (column, columns) - shtyllë, shtyllat; comp. (compiler) - tubues, kompilator; ed., eds (edition, editor, editions, editors) - botim, botues, botime, botuese; e. g. (exempli gratia) për shembull; f. (and the following line or page) - edhe radha ose faqeja vijuese; ff. (and the following lines or pages) - edhe radhët ose faqet vijuese; fig., figs (figure, figures) - fotografia, fotografitë; intro (introduction) - hyrje; l, ll. (line, lines) - radha, radhët; MS, MSS (manuscript, manuscripts - dorëshkrim, dorëshkrime; n. n. (no name) - pa emër; n. p. (no place of publication) - pa vend botimi; o. p. (out of print) - e shitur; p., p.p. (page, pages) - faqeja, faqet; passim (et passim) - në vende të ndryshme; Pt., Pts (part, parts) - pjesë, pjesët; q. v. (quodvide) - të shihet kjo; s. n. (sub nomine) - me emrin; s. v. (sub verbo) - nën fjalën; sec., secs (section, sections) - pjesë, pjesët; tr. (translator) - përkthyes; vol., vols (volume, volumes) - vëllim, vëllime; vs. vss. (verse, verses) - varg, vargje, e të tjera.

Gjuha franceze: art. (article) - artikull; cf. (confer) - të krahasohet; ch. (chapitre) - kreu; cie, co (compagnie) - shoqëria, shokët; col. (colonne) - shtyllë, kolonë; éd. (éditeur), edition) - botuesi, botim; ex. (exemple) - shembull; f, ff. (feuille, feuiells) - fleta, fletat; f^o, fol, (folio) - botim folio; impr. (impression, imprimerie) - shtyp, shhtypshkronja; it., ital. (italique) - kursiv; l. (ligne, livre, lettre) - radha, libri, letra (shkresa); (ll: pl.); ms, mss (manuscrit, manuscrits) - dorëshkrim, dorëshkrimet; N. (anonyme, inconnu) - anonim; n., nn. (note, notes) - vërejtje, vërejtjet; N, Nr (numro) - numri; p., pp. (page, pages) - faqeja, faqet; s.a. (sans amée) - pa vit; s.d. (sans date) - pa datë; s. l. (sans lieu) - pa vend botimi; s. t. (sans titre) - pa titull; s. l. s. d. (sans lieu ni date) - pa vend dhe datë botimi; v. (voir, volume) - shih vëllim; x (anonyme, inconnu) - anonim.

që lexuesit t'ia kursejmë përpjekjet gjatë kërkimit të tyre. Disa madje preferojnë përdorimin e shkurtesave të cekura vetëm në dy faqet (në të djathtë dhe në të majtë) e librit të hapur, ashtu që nuk ka nevojë të shfletohen fletat duke gjurmuar titullin e veprës (në librat e shtypur); ose në një faqe (në dorëshkrim të daktilografuar në makinë).

2) Kur citohen dy e më shumë shkrime të një autori, duhet pasur kujdes që të mos krijohet rrëmujë në shkurtesa: o. c., loc. cit., e të ngjashme. Në atë rast më së miri është të ceket fjala e parë (ose fjalët e para) e veprës dhe krahas kësaj të vihen tri pika. Për shembull:

G. Dykmans, *Initiation...*, p. 50.

Ekziston edhe një mënyrë e theksimit të veprës që është cituar, por jo drejtpërdrejt në shënimin paraprak. Kjo mënyrë, që është më e thjeshtë dhe po merr gjithnjë e më shumë hov, përbëhet në këtë: Nëse citohet libri, shënohen mbiemri i autorit (pa emër ose inicialet e tij), numri i vëllimit dhe faqet. Nëse nga autori i njëjtë citohen më shumë vepra, duhet të ceket edhe titulli i veprës në formën e shkurtuar. Rasti i njëjtë është me veprat dhe përmbledhjet anonime. Gjatë theksimit të revistës, shënohet emri i revistës e jo titulli. Për shembull:

G. D. H. Cole, *A Short History of the British Working Class Movement* (New York, Macmillan C, 1927), III, 125.

G. D. H. Cole, *Self - Government in Industry* (5th ed. rev., London, G. Bell and Co, Ltd., 1920), p. 42.

Cole, *A Short History...*, II, 50.

Robert A. Dahl. "Worker's Control of Industry and the British, Labor Party", *American Political Science Review*, XLI, N° 5, (October, 1947), 890-893.

Dahl, *American Political Science Review*, XLI, N° 5, 895.

Nëse burimi që citohet është dytësor, d.m.th., nëse informata vjelet nga dora e dytë, kjo duhet të shihet edhe në shënimin paraprak; në atë rast theksohen të dy

burimet: dytësor dhe parësor, nëse, natyrisht, është cekur edhe ky i fundit.

Shembull:

Charles Nodier, Jean Shogar (Paris, Gide fils et Henry Nicolle, 1818), pp. 103-104, cit. në: R. Maixner, Charles Nadier et l'Illyrie [Paris, M. Didier, 1960], p. 57.

Në qoftë se në vetë tekstin paraqiten disa nga të dhënat e rëndomta bibliografike (emri i autorit, titulli i shkrimit e të ngjashëm), ato nuk ka nevojë të theksohen edhe në poshtëshënim.

Që në poshtëshënime mos të ceken shumë herë emrat e revistave, publikimeve, gazetave, institucioneve të njëjta e të ngjashme, autori mund t'i përvetësojë për to shkurtesat, me kusht që t'i shpjegojë në njërin prej faqeve të para të punimit.¹⁴¹ Ndërkaq, në tekst emrat e theksuar ceken në formën e tyre të plotë.

Të theksojmë, në fund, se mënyra e citimit të poshtëshënimeve për librat, artikujt nga revistat dhe gazetat, enciklopeditë, dokumentet arkivore e të ngjashme ndryshon në masë të madhe prej shtypshkronjës në shtypshkronjë dhe prej autorit te autori. Autori i shqyrtimit shkencor, natyrisht, mund të përcaktohet sipas shijes dhe dëshirës së vet për ndonjërin prej atyre sistemeve duke pasur llogari, natyrisht, edhe për shtëpinë botuese, përmbledhjen e të ngjashme në të cilat paraqitet punimi, por kur tashmë për të të përcaktohet, ai atëherë duhet që këtë ta zbatojë në mënyrë të përpiktë.

¹⁴¹ Për shembull: SKG - Srpski književni glasnik; SKZ - Srpska književna zadruga; N - Nada (Sarajevo); Z - Zora (Mostar); R - Rad (Jugoslovenska akademija znanosti i umjetnosti); MH - Matica Hrvatska; LMS - Letopis Matice Srpske; NJ - Naš jezik; SAN - Srpska akademija nauka; JAZU - Jugoslovenska akademija znanosti i umjetnosti; etj. Ose publikimet e huaja: MLN - Modern Language NOTES; PMLA - Publications of the Modern Language Association; OED - Oxford English Dictionary; RLC - Revue de Littérature comparée; RES - Revue des Etudes Slaves; etj.

C. Bibliografia përfundimtare

Çdo punim më i vëllimshëm shkencor, e sidomos teza e doktoraturës ose magistraturës, duhet ta ketë bibliografinë (bibliografinë përfundimtare, ndryshe prej asaj punuese, paraprake), që i bashkangjitet tekstit.¹⁴² Bibliografia e hartuar hollësisht, saktë dhe me kriterin e domosdoshëm shkencor, mirë dhe sistematikisht e prezentuar, vetvetiu ka vlerën e vet shkencore dhe e bën veprën më të dobishme, më interesante, më tërheqëse. Së këndejmi katalogët e disa bibliotekave më të mëdha e tregojnë në mënyrë të veçantë, në skedat katalogjike, bibliografinë dhe paginacionin e saj.

Hartimi i bibliografisë kërkon prej autorit veçori të caktuara që, në masë të konsiderueshme, janë karakteristike për punën shkencore përgjithësisht dhe tipike për punëtorin, hulumtuesin shkencor: domethënia për saktësi dhe minuciozitet, durim, ndërgjegje, akribie. Dhe pikërisht bibliografia dhe mënyra me të cilën ajo është prezentuar, mund të jenë shenjë mjaft e sigurt në çfarë mase punëtori shkencor i posedon veçoritë e përmendura. Saktë thotë Rajnberg: "Regjistri i literaturës në disertacion manifeston, si pasqyrë, kulturën e përgjithshme të autorit, raportin e tij ndaj shkencës dhe ndaj punës, ndjenjën e tij të përgjegjësisë, e sidomos zellin, kujdesin, saktësinë e tij etj. Më thuani çfarë është katalogu bibliografik (regjistri) në disertacion, e do t'ju them se si sillet autori ndaj detyrave të veta shkencore-letrare, - kështu unë vetes do t'ia lejoja ta parafranoj anekdotën të njohur për të gjithë."¹⁴³

Si bazë për hartimin e bibliografisë përfundimtare shërben, natyrisht, bibliografia e punës, paraprake, që,

¹⁴² Nëse punimi është më i shkurtër, bibliografia nuk është e domosdoshme: mjaftojnë shënimet dokumentare (referencat bibliografike) në poshtëshënim.

¹⁴³ O. c., fq. 101.

duke përjetuar përmirësime, plotësime, eliminime gjatë punës, - në njëfarë mënyre tashmë është bërë përfundimtare, me atë dallim që është shkruar në skeda të posaçme (në fisha bibliografike), në vend në formë të regjistrit bibliografik në fund të librit, shkrimit.

Në bibliografinë përfundimtare futen të gjitha burimet dhe shkrimet që autori në çfarëdo mënyre i ka përdorur për punën e vet¹⁴⁴ dhe këtë, rëndom me rendin alfabetik (sipas mbiemrit të autorëve), librat, artikujt, gazetat, doracakët, etj. Prandaj as nuk kyçen veprat dhe shkrimet që autori nuk i ka lexuar, ose i ka lexuar e në to nuk ka gjetur asgjë të dobishme dhe interesante për temën e vet, as që nga regjistri bibliografik lëshohen shkrimet, si duket nganjëherë, që autori i ka konsultuar dhe përdorur, duke i vjelur më pak ose më shumë prej tyre të dhënat dhe idetë. Në regjistër kyçen edhe disa vepra të përgjithshme (enciklopeditë, doracakët biografikë, fjalorët, historitë e përgjithshme e të ngj.¹⁴⁵). Nganjëherë, krahas disa njësive bibliografike, mund të jepen edhe gjykimet të shkurtra për vlerën e tyre (për shembull: “vepër e vjetëruar”, “botim jo i plotë” e të ngjashme).

Ekzistojnë mënyra dhe kritere të ndryshme të theksimit të njësive bibliografike në regjistrin përfundimtar bibliografik dhe ata varen si prej natyrës së shkrimit, llojit të lëndës dhe burimit, ashtu edhe prej autorit dhe sistemit për të cilin ai përcaktohet. Sistemi më i shtrirë është ai alfabetik, sipas shkronjës së parë të mbiemrit të autorit. Mirëpo, nëse bibliografia është tepër e vëllimshme, ajo, sipas rregullit, ndahet në grupe (kaptina) dhe nëngrupe të ndryshme, brenda të cilave shkrimet radhiten me rendin alfabetik. Këto kaptina mund të caktohen

¹⁴⁴ Në të mund të kyçen vetëm burimet dhe shkrimet kryesore, me atë që të tjerët të cekën gjatë punimit, në poshtëshënime. Në atë rast ka të bëjë me bibliografinë selektive.

¹⁴⁵ Prej librave shkollorë cekën vetëm ata që dallohen në ndonjë aspekt, e në asnjë rast, siç ndodh nganjëherë, librat shkollorë të ndryshëm elementarë.

sipas kriterëve, sikur që janë: burimet parësore dhe dytësore, përkatësisht veprat e pabotuara (dorëshkrimet, korespondencat, ditarët e të ngjashme) dhe veprat e botuara (librat); ose: librat, artikujt (nga revistat, gazetat dhe përmbledhjet), doracakët (enciklopeditë, fjalorët etj.); ose: shkrimet që u përkasin periudhave të ndryshme kohore (grupimi sipas kronologjisë, viteve e të ngj.), e kështu me radhë. Klasifikimi varet nga karakteri i shkrimit dhe të dokumentacionit të përdorur. Gjatë kësaj është me rëndësi që në mënyrë të përpiktë të zbatohet ndonjë sistem që përvetësohet.

Bibliografia, që të jetë korrekte, duhet t'i plotësojë disa kushte themelore: *plotësia*, që varet jo vetëm nga furnizimi i bibliotekave me të cilat shërbehet hulumtuesi por edhe nga koha që ai e shpenzon dhe, sidomos, prej shkathhtësisë së tij "dhe sensit" që të zbulojë dokumente dhe shkrime relevante për punimin e tij; *saktësia*: të gjitha të dhënat e kyçura duhet të jenë të sigurta, të vërtetuara; *sistematiciteti*, bibliografia duhet të jetë e dukshme, përpikërisht e prezentuar sipas ndonjë sistemi të përvetësuar.

Në bibliografinë përfundimtare kyçen për disa njësi bibliografike kryesisht po ato të dhëna që janë në bibliografinë e punës. Meqë që për te, sikurse edhe për shkrimin e poshtëshënimeve (fusnotave) ka pasur fjalë të hollësishme,¹⁴⁶ nuk ka nevojë që këtu këtë ta përsërisim. Vetëm do të theksojmë se në bibliografinë përfundimtare njësitë fillojnë me mbiemrin e autorit (ndryshe nga fusnotat që fillojnë me emrin ose me inicialet e emrit), kurse pas mbiemrit vie emri, nganjëherë i ndarë nga mbiemri me presje ose, siç është rasti te francezët, vihet në kllapë të rrumbullakët, e pas kësaj pika (nëse ceken inicialet, atëherë pika e inicialit); disa të dhëna të njësisë së njëjtë bibliografike ndahen mes vete me pikë, e jo me presje, sikur edhe në fusnotë, vendi dhe data nuk vihen

¹⁴⁶ Shih: III B dhe VII b.

brenda kllapave sikur që nganjëherë bëhet në fusnotë, mbiemrat shtyhen për tri shenja drejt këndit të majtë, në vend që të tërhiqen, etj.

Të cekim, vetëm si shembull, disa njësi bibliografike për rastet e ndryshme të bibliografisë përfundimtare.¹⁴⁷

Burimet dorëshkrimore

Archives du Ministère des Affaires Etrangères à Paris: Correspondance consulaire et commerciale: Travnik 1 (1806 - 1810); Travnik 2 (1811-1812); Travnik 3 (1813-1815).

Wien - Haus-, Hof-, und Staatsarchiv: Konsulatarchio Travnik, fasc. 36d, 40, 41, 42, 43, 44, 45.

Burimet e publikuara

Dokumentet dhe raportet publike:

Great Britain, Hausard's Parliamentary Debates (3d series). Vols CLVIII-CLXVI. Broadview College. Annual Reports of President. 1900-1915.

Librat:

Šamić, Midhat. - Kako nastaje naučno djelo, uvodjenje u metodologiju i tehniku naučno-istraživačkog rada (opšti principi), Sarajevo, Zavod za izdavanje udžbenika SRBiH, 1968, fq. 206.

Šamić (Midhat): Kako nastaje naučno djelo. Uvodjenje u metodologiju i tehniku naučno-istraživačkog rada (opšti principi). Sarajevo, Zavod za izdavanje udžbenika, 1968, fq. 206.

¹⁴⁷ Sikur edhe te shënimit, në shënimin e njërive bibliografike udhëhiqen me parimet e shtruarat në veprën e cituar, K. L. Turabian (të shihet shënimi nr. 9), nga i cili marrim edhe ndonjë shembull.

Në të dy rastet e fundit janë nënvizuar (përkatësisht janë radhitur me kursiv), pos titullit, edhe nëntitujt. Emri është ndarë nga mbiemri me presje (ose është vënë në kllapë të rrumbullakët), kurse nga titulli me pikë dhe presje ose me dy pika. Në dy pika ose një pikë e ndajnë titullin dhe nëntitullin. Në fund është shtuar numri i faqes.

David (Pierre): *Athéne assiégée*. Paris, Firmin – Didot, 1927, In-8°, VI - 28 pp. - - - ; *De la Régence*. Paris, impr de A. Moésard et Jousset, 1842, In-8°, 31 pp.

Këtu emri është vënë në kllapën e rrumbullakët dhe i ndarë me dy pika. Nëse drejtpërdrejt citohet nga autori i njëjtë edhe ndonjë vepër tjetër, nuk nevojitet patjetër të shkruhen mbiemri dhe emri i tij sërish; mjafton të vihet vija.

Raymond, Jean-Paul [C. Ricketts], Oscar Wilde: *Recollections*. London, Nunsuch Press, 1932.

Me pseudonimin, si përgjithësisht edhe me të dhënat që mësohen më vonë, veprohet në të njëjtën mënyrë sikur edhe te poshtëshënimet, d.m.th. ata vihen në kllapën katrore.

Šamić (Midhat): *Les voyageurs français en Bosnie à la fin du 18^e siècle et au début du 19^e et le paystel qu'ils l'ont vu*. ("Études de littérature étrangère et comparée", N°38). Paris, M. Didier, 1960; 285 pp.

Në qoftë se ndonjë vepër është publikuar në koleksion, ceket emërtimi i koleksionit dhe numri i vëllimit.

Velek Rene dhe Ostin Voren: *Teorija književnosti*, Beograd, Nolit, 1955.

Kur citohen veprat me dy autorë, vetëm tek i pari shkruhet së pari mbiemri, e pastaj emri: e tek i dyti veprohet sikur edhe rëndom: më së pari emri, e pastaj mbiemri.

Artikujt nga revistat dhe gazetat:

[Blank, Henry] "Art for its own Sake", *The New York Art in America*, XXI (December, 1940), 63-67.

Joussain A. - "Introduction à la politique expérimentale", ("Uvod u eksperimentalnu politiku"), "Revue internationale de Sociologie" (Medjunarodni pregled za sociologiju) N IX - XII, sept. - dec., 1939, pp. 453-461.

Viner, Jacob "Cost Curves and Supply Curves", *Zeitschrift für National-Ökonomie*, Band III (1932), 23 ff.

Djurdjinov (dr Milan): "Poezija, zemlja bez granica", *Politika*, nr. 18994 (21 avgust, 1966), fq. 15.

Revistat dhe gazetat:

Pregled (Sarajevë). 1960-1966.

Oslobodjenje (Sarajevë), 1964.

Politika, 1938-1939.

New York Times, 1950-1954.

Le Monde, 1950-1963.

Intervistat:

Fakulteti Filozofik në Sarajevë. Intervistë me dekanin. Shtator, 1966.

Universiteti Popullor në Sarajevë. Ligjëratë e profesorit N. N., 5 maj 1966.

Siç shihet, në bibliografi rëndom futen edhe intervistat e përdorura, ligjëratat e të ngjashme.

Nuk ka nevojë që në mënyrë të veçantë të theksohet që edhe në bibliografinë përfundimtare, të dhënat për çdo njësi bibliografike, nëse dëshirohet që ato të jenë të

sakta, duhet të theksohen nga dora e parë, respektivisht nga fisha e konstatuar bibliografike.¹⁴⁸

Të cekim edhe traditën e mirë të Universitetit të Parisit që në bibliografitë e tezave të doktoraturës, krahas të dhënave tjera, ceket për librat e rrallë dhe të cilët më vështirë gjenden, sinjatura e Bibliotekës Kombëtare në Paris: kjo bëhet për shkak të referentëve (dhe lexuesve përgjithësisht), që në atë rast kanë mundësi që librin ta gjejnë më lehtë dhe më shpejtë.

¹⁴⁸ Shih: III B.

VIII. Veçoritë stilistike dhe korrektësia gramatikore

Hulumtuesi shkencor i cilitdo profesion qoftë, e sidomos i shkencave humaniste, duhet të jetë njëkohësisht autor që do të dijë të gjejë për mendimin e vet shprehje dhe formë të qëlluar, që ta shprehë qartë e saktë, thjeshtë dhe në mënyrë koncize, pa monotoni dhe klishe, po ngathtësi stilistike, pa gabime sintaksore, morfologjike dhe ortografike. Natyrisht, interesueshmëria e ekspozimit, konciziteti, gjallëria dhe forca e stilit varen në të shumtën nga talenti letrar. Sikur të të gjithë popujt, edhe të ne kanë ekzistuar shkencëtarë të mëdhenj që njëkohësisht kanë qenë edhe stilistë të shkëlqyeshëm (Jovan Cvijiq, Jovan Skerliq, Antun Barac e të tjerë). Por, nëse para hulumtuesit të rëndomtë nuk mund të shtrohen kërkesa aq të larta, d.m.th. të jetë njëkohësisht edhe shkencëtar i madh edhe stilist i shkëlqyeshëm, prej tij mundet, dhe duhet, të kërkohet dhe pritët që denjësisht të zotërojë me fjalën e shkruar, të shkruajë stilistikisht, korrekt dhe gramatikisht drejt; me një fjalë, të dijë që për përmbajtjen të gjejë formë shprehje përkatëse, sepse përmbajtja dhe forma e një shkrimi janë ngusht të lidhura mes vete dhe reciprokisht përshkohen thellë.¹⁴⁹ Ivo Andriqi në këtë rrjedhshëm ka dëftuar:

¹⁴⁹ Në atë masë ato përshkohen ndërmjet veti sa disa teoricienë i zëvendësojnë ato emërtime klasike (përmbajtje, forma) me terma të rinj, që krij-

Nuk ka stil pa përmbajtje. Nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë ajo për çka dikur është folur, madje edhe në libra shkollorë është shkruar, i a.q. stilist i mirë që pos stilit nuk ka gjë tjetër, stili i mirë me përmbajtje të ulët apo kurrfare. Stili është vetëm pjesë e dukshme apo, nëse dëshironi, pjesë e dëgjueshme e mendimit tonë apo e ndjenjës sonë. Pa to, d.m.th. pa mendime dhe ndjenja, nuk ka stil, sepse grumbulli i fjalëve që ngjason në vargun e zileve të zbrazëta, as nuk mund të quhet stil.

Dhe më tej:

“Synimi drejt përkryeshmërisë së formës shprehëse për ne është shërbimi përmbajtjes. Kurse të kryhet mirë ky shërbim, d.m.th. qartë të shprehet mendimi ynë ose ndjenja jonë, do të mundemi vetëm atëherë nëse e kemi mësuar gjubën me të cilën shkruajmë dhe shprehjen stilistike të asaj gjube. Prandaj, ka pasur të drejtë ai autor që, kur i kanë bërë vërejtje se po punon ngadalë dhe se së tepërmi po e përsosë fjalinë e vet, është përgjigjur: “Nuk po e lustroj unë fjalinë time, por mendimin tim”.¹⁵⁰

Atë që I. Andriq e tha për letërsinë, vlen në tërësi edhe për shkencën. Ndonjë punim shkencor ekziston vetëm për atë nëse lënda e papërpunuar, deri te e cila shkencëtari ka ardhur me anë të hulumtimeve, është formësuar në ndonjë shkrim, ka fituar formën, shprehjen e vet përkatëse, dhe me këtë është bërë “prodhim fundor”. Prandaj, përkryerja e formës shprehëse të ndonjë punimi nuk do të thotë, si do të mund të parashtronte dikush, dhënie e elementit të caktuar estetik punimit që është i domosdoshëm për të, por kjo është, në realitet, mjet me ndihmën e të cilit vetë vepra edhe ekziston”: të

tësisht do të thonë diç tjetër: lënda dhe struktura (duke nënkuptuar me strukturën “nacionin që përfshinë edhe përmbajtjen edhe formën nëse ato janë të organizuara për qëllime estetike”. (Krahajo: R. Velek dhe O. Voreu, Teorija književnosti, Beograd, Nolit, 1965, fq. 163).

¹⁵⁰ “Nešto o stilu i jeziku”, Stvaranje, nr. 9 - 10, 1949, fq. 322 - 323.

shkruarit dhe përkryerja e shndërrojnë lëndën e papërpunuar në “prodhim përfundimtar, të përdorshëm.”¹⁵¹

Në shkruarjen e ndonjë punimi shkencor hulumtuesi duhet ta kyçë tërë kujdesin edhe atë për dy shkaqe. I pari, vetëm në këtë mënyrë do të tregojë se rezultateve deri te të cilat ka ardhur me anë të hulumtimeve të lëndës dhe përkapjes për të u jep rëndësi: *“Kush shkruan shkencë”,* cek qartë Shopenhaueri, *“ai në vend të parë pranon se as vetë nuk u jep ndonjë rëndësi të madhe mendimeve të veta. Sepse vetëm nga bindja për vërtetësinë dhe rëndësinë e mendimeve tona rrjedh ai entuziazëm që është i nevojshëm që kudo, me këmbëngulësi të palodhshme, të klibet kujdes në të shprehurit sa më të qartë, më të bukur e më të fuqishëm të atyre mendimeve.”*¹⁵²

E pastaj, mënyra e plogshhtë dhe jokorrekte e të shkruarit paraqet në një mënyrë nënçmim të lexuesit, ofendim për të: *“Të shkruarit jokorrekt parashtron paarsimim, analfabetizëm, paedukatë dhe joelegancë letrare, kurse këto veti fare nuk na fyejnë më pak në libër se që na fyejnë në jetë”.*¹⁵³

Ky kujdes i të shkruarit vjen në shprehje në efikasitetin stilistik dhe në rregullsinë gramatikore të tekstit shkencor; dhe këtë në atë masë që edhe për këtë lloj të shkrimit krejtësisht mirë mund të aplikohet thënia e njohur e Bifonit (Buffon) se stili është vetë njeriu. Kjo do të thotë se edhe shkencëtari shkruan, në bazë, me stilin dhe gjuhën që janë karakteristike për natyrën, karakterin, temperamentin, intelektin, kulturën, afinitetin, shprehitë: mënyra e tij e të shkruarit dhe stili janë “shprehje e njeriut të atillë çfarë ai është; njeriut të kulturuar ose primitiv, të pasur ose të mjerë intelektualisht, të qartë ose konfuz, energjik ose të ngathtë, logjik dhe të rregulluar ose jo të përpiktë, të disiplinuar dhe të rregullt ose të çrregullt dhe pa përgjegjësi, etj.”¹⁵⁴

¹⁵¹ Barzun..., o. c., p. 36-37.

¹⁵² O. c., fq. 152.

¹⁵³ B. Popović, o. c., fq. 152..

¹⁵⁴ S. A. Rajuberg, o. c., fq. 108.

Kur është fjala për të shkruarit, duhet dhënë shenjë në dinstinksionin që domosdo duhet bërë ndërmjet mënyrës efektive dhe korrekte të të shkruarit, sikur edhe në rëndësinë më të madhe të të parës kundrejt të dytës. Me këtë, kuptohet, nuk mund të mohohet ose të nënçmohet vetë korrektësia e gjuhës, që është një nga komponentet e efikasitetit të silit; por, derisa korrektësia është një veçori që vetvetiu kuptohet në një shkrim (dhe ajo prandaj nuk i kontribuon vetvetiu vlerës dhe famës së autorit: vetë mungesa e saj mund ta zvogëlojë atë vlerë dhe autoritet), nga ana tjetër efikasiteti domethënë shkathtësia e ekspozimit të përpiktë dhe të qartë, të saktë e konciz, koherent, natyror dhe të thjeshtë të fakteve dhe ideve, do të thotë, të tërë kompleksit të vetive pozitive të stilit dhe gjuhës. Nga kjo shihet qartë se efikasiteti i gjuhës është veti jashtëzakonisht e rëndësishme; sipas fjalëve të Ezra Pound (Paund) “aq të rëndësishme... sa në kirurgji është e rëndësishme që nga plaga e lidhur të mënjanohen bakteret e tetanosit.”¹⁵⁵

Ti shqyrtojmë shkurtimisht disa veçori kryesore me të cilat duhet të shquhen stili dhe gjuha e një punimi shkencor.

Qartësia. - Një nga veçoritë e para dhe themelore të çdo stili shkencor është qartësia. Autori nuk shkruan për veten, dhe në pajtim me këtë nuk guxon të shkruajë ashtu që vetëm ai të dijë ç'mendon dhe ç'dëshiron të thotë, kurse lexuesi duhet ta thyejë kokën në mënyrë që këtë ta zgjidhë. Autori gjithnjë duhet ta ketë parasysh lexuesin, për të cilin në të vërtetë edhe shkruan: tërë dijen e vet për lëndën, për të cilën ka punuar me muaj, nganjëherë me vite, deri te e cila ka ardhur në bazë të hulumtimeve të gjera e të mundimshme, - me të lexuar, kundru-

¹⁵⁵ Ezra Pound, *Comment lire* (Traduit par V. Llona), Paris, Ed. de l'Herne, 1966, p. 24 - 25.

ar, përsiatur, - ai lexuesit duhet t'ia komunikojë në atë mënyrë që ky menjëherë ta kuptojë mendimin e tij, madje edhe në rastin që për lëndën të dijë mjaft pak, ose të mos dijë fare. E kjo nuk është punë e lehtë, nga shkak i thjeshtë që gjuha nuk përbëhet prej fjalëve që kanë ndonjë domethënie matematikisht të caktuar dhe të saktë. Shopenhaueri ka pasur të drejtë kur me mendjehollësi ka vërejtur se edhe mendimet udhëhiqen sipas ligjit të forcës së gravitetit, aq më parë që “shumë më lehtë kalojnë rrugën prej kokës në letër se sa prej letrës në kokë, dhe se, për këtë shkak, në këtë duhet ndihmuar me të gjitha mjetet që i kemi në disponim.”¹⁵⁶

Qartësia e pamjaftueshme e ekspozitit rrjedh më së shpeshti nga përvoja e pamjaftueshme dhe nga neglizhenca në të shkruarit, sikur edhe nga përkryeshmëria dhe mprehtësia e pamjaftueshme e mendimeve, e nganjëherë madje edhe nga dëshira dhe qëllimi më pak apo më shumë qartë të shprehur të ndonjë autori që tërë angazhimin rreth të kuptuarit të shkrimit të tij ta hedhë në vetë lexuesit (*caveat lector!*), dhe synimit të tij që me këtë të krijojë te lexuesi përshtypjen për ndonjë thellësi të veten të posaçme. Kuptohet, ky synim i tij nuk ka kurrfarë lidhje me thellësinë e mirëfilltë të mendimit dhe autorit; autori mirëfilltë i thellë jep, sipas rregullit, tërë angazhimin e vet që sado që është e mundur ta mprehë mendimin e vet dhe ta përkryejë shprehjen e vet, e me këtë sa ka mundësi lexuesit t'i kursejë përpjekje dhe angazhim të kotë rreth të kuptuarit të shkrimit të vet.

Thjeshtësia, natyrshmëria, maturia. - Stili me të cilin shkruhet shkrimi shkencor nuk guxon të jetë as pretendues, as precioz; as patetik, as emfatik, as bombastik;¹⁵⁷

¹⁵⁶ O. c., fq. 151.

¹⁵⁷ Shopenhaueri, para më shumë se njëqind vjetësh, e ka njollosur afinitetin e disa autorëve të atëhershëm gjermanë, të varfër me ide, drejt ‘stilit të fryrë, të mufatur, precioz, hiperbolik dhe akrobatik’. (O. c., fq. 115).

as panegjirik (që çdo gjë lavdëron), as diabolik (që shpif dhe mohon), as ironik (që çdo gjë përçeshë), as skeptik (që në çdo gjë dyshon), as polemist (që për çdo gjë fillon ngatërresë), as hiperkritik (që çdo gjë kritikon); as familjar, as i plogshhtë (ai sipas rregullit nuk i përgjigjet karakterit të prozës shkencore, e krahas kësaj për këtë lloj stili është i domosdoshëm talent i shprehur); as retorik, as solemn, etj. Stili më i përshtatshëm për shqyrtimin shkencor dhe për prozën shkencore marrë në përgjithësi është, në realitet, stili i thjeshtë, natyror, i matur. Mirëpo, stili i tillë nuk do të thotë edhe mungesën e ngrohtësisë, të gjallërisë, të shpirtit. Këto veçori autori mund t'i fusë edhe në shqyrtimin shkencor, me maturi e shije, në qoftë se edhe për ta dëfton talent të shprehur. Sidomos, stili i thjeshtë nuk arrihet në mënyrë të thjeshtë: ai nuk d.m.th. mungesë e angazhimit dhe e përpjekjes, sikur që këtë mendjemprehtësisht e ka theksuar Anatol Frans në një fragment të veprës së vet *Kopshti i Epikurit*, që edhe përkundër gjatësisë së tij, po e cekim këtu në tërësi.

Natyra, - e atillë së paku çfarë ne kemi mundur ta njohim, dhe në mjedis të përshtatur për jetë, - nuk na ofron asgjë që do të ishte e thjeshtë, kurse arti nuk mund të pretendojë në thjeshtësinë më të madhe se natyra. E megjithatë, ne mjaft mirë kuptohemi kur themi se stili i caktuar është i thjeshtë, kurse ndonjë tjetër nuk është. Së këndejmi do të them: nëse, duke folur saktë nuk ka stil të thjeshtë, ka stile që duken të thjeshta dhe pikërisht atyre, si duket, u përket rinia dhe ardhmëria. Na mbetet atëherë vetëm ajo të hulumtojmë atë prej nga u vjen atyre ajo jashtësi e lumtur. Dhe secili pa dyshim do të përkujtohet se ajo del jo nga ajo që ata janë më pak të pasur prej të tjerëve me elemente të ndryshme, por nga aty që ata përbëjnë tërësinë në të cilën të gjitha pjesët aq bukur janë të ngjitura sa nuk mund t'i dallojmë. Stili i mirë, në fund të fundit, është sikur kjo rrezja e dritës që më hyn

nëpër dritare derisa po e shkruaj këtë dhe e cila ia ka borxh dritën e vet bashkimit të ngushtë të shtatë ngjyra-ve nga të cilat është e përbërë. Stili i thjeshtë i ngjason dritës së bardhë. Ai është kompleks, por ai këtu nuk duket. Kjo është vetëm fotografi, kurse është e njohur se çfarë vlere të vogël kanë fotografitë kur nuk i krijon poeti. Por unë kam dashur të tregoj se si në gjuhë thjeshtësia e bukur dhe e dëshirueshme është vetëm diç e jashtme dhe se si ajo del nga organizimi i mirë dhe nga ekonomia më e madhe e fjalëve.¹⁵⁸

Konciziteti. - Kaherë është vërejtuar se njerëzit, sipas natyrës së vet dhe dobësisë së përgjithshme, janë llafazanë, me prirje për të folur, llomotitur. Këto veti të tyre vijnë në shprehje edhe në krijimtarinë shkencore: në atë gjerësinë epike me të cilën jorrallë takohemi edhe në punimet shkencore. Të vetëdijshtëm për këtë dobësinë e vet, autorët duhet të synojnë sa më tepër drejt ekonomizimit dhe koncizitetit të shprehjes, që mund të arrihet në mënyra të ndryshme:¹⁵⁹ me shmangien e tautologjive, pleonazmave, mënyrës përshkruese të rrëfimit, përdorimit racional të fjalëve dhe formave gramatikore¹⁶⁰ e të ngjashme. Përgjithësisht, gjithnjë duhet të kihet parasysh parimi që “ajo që asgjësë nuk i shërben - dëmton; ajo që

¹⁵⁸ Ngjashëm ka menduar dhe shkruar I. Andriq: “Ne kemi thënë se stili më i mirë është i thjeshti, sepse është më bindësi. Por, më duhet të shtoj menjëherë se stili i thjeshtë është edhe stili më i rëndë. Këtë e dimë të gjithë, por nuk dimë të vijmë deri te thjeshtësia, në pamje aq e thjeshtë, e në realitet aq rëndë e arritshme. Gogoli ka thënë fjalën e shkëlqyeshme: “Deri te thjeshtësia duhet rritur”. (Artikull i cit., fq. 322).

Sidomos Paskali e ka madhëruar stilin natyror: “Kur të hasim në stilin natyror, thjesht jemi të habitur dhe të magjepsur, sepse kemi pritur se do të hasim në autorin, kurse e gjejmë njeriun. Derisa ata që kanë shije të mirë dhe të cilët duke e parë një libër mendojnë ta gjejnë njeriun, bëhen të suprizuar që e gjejnë autorin...” (Misl, Beograd, Kultura, 1965, fq. 15).

¹⁵⁹ Për disa prej atyre mënyrave tashmë është bërë fjalë. (Shih: I b.)

¹⁶⁰ Për shembull, me përdorimin e konstruksioneve participuese: I udëshkuar, ai më nuk e ka bërë atë gabim.

nuk është e mirë - është e keqe.”;¹⁶¹ sikur edhe thënien e njohur të Volterit se “mbiemri është armiku më i madh i emrit, edhe pse me të pajtohet në gjini e numër”.

Nuk është pa rëndësi as *ana muzikore e gjuhës*, tonaliteti i saj: Fjalët nuk janë vetëm shenja kuptimore të gjerave, simbole, por kanë edhe vlerën e tyre tingëlluese. Që mos ta dëmtojë këtë aspekt, autori i shkrimit duhet t’i ketë parasysh disa shfaqje në pamje të imta, sikur: që mos t’i grumbullojë bashkëtinglloret e njëjta (aliteracionet); që ndonjë fjalë mos ta fillojë me zërin e fjalës para-prake (*pa rëndësi e të ngjashme*); që t’i shmanget kombinimit të tingujve që janë të rënda për shqiptim; që mos t’i grumbullojë zanoret e njëjta (hiatus); që mos t’i përsërisë fjalët e njëjta (emrat, epitetet, format foljore e të tjera, lidhësat e të ngjashme) afër njëra-tjetrës, e të tjera.

Shtrohet pyetja: Si do t’i arrijmë veçoritë e përmendura (dhe të tjera pozitive) të stilit? Në këtë pyetje, sipas mendimit tonë, më së lehti do të përgjigjemi, së paku pjesërisht, nëse do t’i shqyrtojmë tri njësi themelore stilistike: fjala, fjalia, paragrafi, sikur edhe kushtet në të cilat ato mund ta arrijnë efikasitetin dhe ekspresivitetin më të madh.

A. Zgjedhja e fjalëve

Fjalët duken aq të “rrjedhshme derisa qëndrojnë të vetmuara, të virgjëra e të papërdorura; nëse njëra ose tjetra prej tyre edhe dështon, për këtë ajo e treta flet për të dyja ato dhe flet edhe shumë më tepër se kejo. Ato janë të lidhura në vallen magjike nëpër

¹⁶¹ G. Lanson, o. c., p. 205.

të cilën rrymon ritmi i tërësisë; nëse ndonjëra prej tyre edhe është e plogshhtë, jo e shkathët ose e lodhur, ato të tjerat e tërbeqin, ashtu që prapambetja e saj nuk hetohet dhe vallja vazhdon pagabueshëm më tej.

Rast më i rëndë është kur me fjalë duhet treguar diç për vetë fjalët dhe për përdorimin e tyre në të folur. Atëherë ato menjëherë nemiten, ftohen dhe qëndrojnë si gur i vdekur, sikur kurrë nuk kanë folur, lozur as kënduar. Kur është fjala për fjalët, fjalët heshtin, derisa për të gjitha gjërat dhe shfaqjet tjera njerëzore munden, nganjëherë më pak e nganjëherë më shumë, nga diçka të thonë. Madje edhe për heshtjen.

(I. Andriq)

Fjalët janë, siç është e njohur, mediumi kryesor me anë të të cilave ia komunikojmë lexuesit faktet dhe mendimet,¹⁶² sikur që me anë të fjalëve e mësojmë pjesën më të madhe të asaj që e dimë. “Gjatë të shkruarit (thotë I. Andriq) - në çastet e lumtura, natyrisht, - fjalët vargohen vetvetiu, lidhen dhe dëbohen, lëvizin dhe transferohen, ose plotësisht fshihen derisa të gjitha nuk harmonizohen në fotografinë e vërtetë dhe të vetmen të mundur të asaj që njeriu dëshiron ta thotë. Çdo gjë duket si lojë e lehtë dhe automatike që fjalët, sipas vullnetit të vet dhe natyrës së vet, vetvetiu dhe vetë për vete e lozin. Mirëpo, nuk është ashtu, nuk është kjo lojë e shterpë e disponimit as rastit. Te fjalët, sikur edhe te drunjtë dhe bimët, dhe te çdo gjë që është e gjallë, qarkullon lëngu i padukshëm jetësor, dhe ky është ai që, sikur ndonjë diell i brendshëm, i lëvizë dhe i rrotullon, u jep ngjyrë dhe for-

¹⁶² Mendimin këtu, sikur edhe në disa vende të tjera, duhet kuptuar në kuptimin më të gjerë.

më, forcë dhe shprehje. Kurse njeriu që shkruan, ai vetëm me kujdes përcjell dhe më pak apo më shumë me shkathtësi, më pak apo më shumë fatshëm i shfrytëzon hollësitë e asaj loje të pakuptueshme e të pakapshme.

Kështu fjalët jetojnë, në realitet, me jetë të dyfishtë: edhe vetë për veten, si të tilla, edhe si shenja shprehëse në tërësinë e mendimit të njeriut që kërkon shprehjen e vet.¹⁶³

Së këndejmi është me rëndësi zgjedhja e fjalëve në hartimin me shkrim.

Kjo zgjedhje, duke folur përgjithësisht, duhet të jetë e tillë që me fjalët e zgjedhura në mënyrë më ekspresive, më efektive, mund të komunikohet ajo që dëshirohet. Zgjedhja e fjalëve varet, në pajtim me këtë, nga disa faktorë: nga lloji i shkrimit (me fjalë të tjera dhe me gjuhë tjetër i shkruhet letër mikut, artikulli gazetës, fjalimi politik, shqyrtimi shkencor etj.,¹⁶⁴ nga lexuesi për të cilin shkruhet (tjetërfare shkruhet për ekspertin, joekspertin e arsimuar, rrethin e gjerë të lexuesve më pak të arsimuar, etj.); nga rasti në të cilin shkruhet (me gjuhë tjetër shkruhet fjalimi solemn akademik, shkrimi me rastin e ndonjë ceremoniale ose ceremonialit të dikujt e të ngjashme). E të tjera.

Sa i përket zgjedhjes së fjalëve në *shkrimin shkencor*, që në këtë rast më së shumti na intereson, këtu duhet pasur kujdes në disa momente. Në radhë të parë duhet tërhequr vëmendjen në atë që të përdoren fjalët që në rastin e caktuar shprehin më së sakti atë që dëshirohet të

¹⁶³ Politika, 31. XII. 1 dhe 2. I. 1968.

¹⁶⁴ Disa retoristë anglosaksonas dallojnë, marrë në përgjithësi, tri mënyra të rrëfimit, tri kategori të stilit: formal (formal), që do t'i përgjigjej stilit "akademik", joformal (informal), që i përgjigjet përafërsisht stilit familiar, dhe, më në fund, stili vulgar (vulgate). Proza shkencore kërkon mënyrën akademike të rrëfimit, që nuk do të thotë që ndonjë shprehje, sintagmë, fjali familjare nuk mund të përdoren edhe në të, që në rrëfim të futet njëfarë spontaniteti, freski. Të tjerët sërish e ndajnë stilin në kolokuijal, i cili, sipas tonit të vet, i afrohet, - në të folur edhe në të shkruar, - stilit familjar, joformal dhe standard, i cili konsiderohet, në të shkruar e në të folur, më i pranueshëm për njeriun e arsimuar.

komunikohet. Kjo d.m.th., nga një anë, ndërmjet të gjitha sinonimeve të mundshme të ndonjë nocioni duhet zgjedhur atë më të përshtatshmin, atë që mendimeve u përgjigjet më së miri. Së këndejmi ka nevojë, këshillojnë Barzani dhe Grofi, “të hulumtohet çdo fjalë, jo një herë por shumë herë, derisa nuk bindeni se kjo është pikërisht ajo fjalë që i përgjigjet asaj që e dini dhe dëshironi a thuani.”¹⁶⁵ Kurse nga ana tjetër, nëse për nocionin e dhënë ekzistojnë disa fjalë, prej të cilave njëra saktësisht e shprehë mendimin e caktuar, derisa të tjerat, përveç kësaj, duan të thonë edhe diç tjetër, në atë rast nuk do të përdoret njëra prej këtyre fjalëve të fundit, por fjala e parë, me domethënien e vetme të mundur, të saktë. Me përdorimin e këtillë do t’i kontribuohet, në masë të konsiderueshme, qartësisë që, siç u theksua tashmë, është njëra prej cilësive themelore të shkrimit shkencor.

Por, përkundër disa simboleve tjera (numrave, formulave kimike e të ngj.) fjalët, pos vlerës së tyre përmbajtësore, domethënies së vet, kanë edhe konotacionin e vet, forcën sugjестive, vlerën asociative, ngjyrën, tingullin ndijor. Së këndejmi është me rëndësi të veçantë që ato veti të fjalëve (vlera asociative dhe ngjyra) të jenë të përshtatshme për rastin e caktuar, t’i përgjigjen në masë të plotë kontekstit. Fjalët e njëjta kanë në kontekstet e ndryshme domethënie të ndryshme. Dhe sikur që Paskali ka theksuar se “ka raste në të cilat Parisin duhet thirrur Paris, e ka edhe të atilla në të cilat duhet thirrur kryeqendër e mbretërisë,¹⁶⁶ po ashtu ka kontekste në të cilat do të mund ta përdorim këtë apo atë sinonim të ndonjë nocioni.¹⁶⁷

¹⁶⁵ Barzani..., o. c., p. 123.

¹⁶⁶ Paskali: Misli, fq. 22.

¹⁶⁷ Për shembull, në ndonjë kontekst, duke e marrë parasysh karakterin e tij (ngjyrën, tonin ndijor), do të mund të përdorim njërin nga sinonimet vijuese të fjalës ndërtesa: shtëpia, shtëpiza, godina, ndërtesa, ndërtesëza, kasolla, shpartallina, koliba, barraka, banesa, pallati, vila, kështjella, etj.

Një nga veçoritë në të cilën po ashtu duhet pasur kujdes, kur është në pyetje zgjedhja e fjalëve, është llojllojshmëria: autori duhet të ketë në vetëdijen e vet, edhe në disponim, fond të pasur të fjalëve, shprehjeve, kthesave me të cilat do të mund të shërbehet gjatë të shkruarit. Në lidhje me këtë, ai duhet të mënjanojë sidomos përsëritjen e fjalëve të njëjta, sikur edhe të formave të njëjta gramatikore, konstruksioneve dhe strukturave të fjalive afër, në largësi të shkurtër, përveç nëse ndonjë fjalë, tërësi frazeologjike, konstruksion nuk e përsërit qëllimisht, që në to më tepër të godasë me zë, t'ia tërheq vërejtjen lexuesit: stili sigurisht do të bëhet monoton nëse autori, të themi, në një paragraf disa herë e përsëritë ndonjë *tërësi* frazeologjike, e sidomos ndonjë që nuk është në frymën e gjuhës sonë (për shembull, *shumë më interesante*), ndonjë lidhëse (për shembull, lidhëzat *a, kurse ose dhe, edhe*), ndajfoljen e kohës së tashme dhe përgjithësisht ndonjë fjalë. Le t'i përsëritë autori, për shembull, vetëm disa përemra relativë afër njëri-tjetrit dhe tashmë ka krijuar fjalë të rëndë, monotone, të ngathtë. Gjithashtu, duhet shmangur përdorimit të fjalëve, konstruksioneve, frazave të vjetruara, të bëra klishe, që shumica i përdorin duke mos menduar, mekanikisht. Fjalë, sintagma, fraza të tilla ka në çdo gjuhë dhe në çdo kohë. Në gjuhën tonë dhe në kohën tonë shprehje të tilla janë për shembull: *e si pra, të jep çka ka mundësi, në mënyrë fantastike, famoze, të potencohet*, e tj. Është interesant që jo aq rrallë sintagmat e njëjta frazeologjike ndeshen, paralelisht dhe në të njëjtën kohë, në gjuhët e ndryshme (ato kalojnë nga një gjuhë në tjetrën, gati ekskluzivisht nga gjuha e shtrirë universalisht në gjuhën e shtrirë jouniversalisht), ashtu që bëhen më pak apo më shumë klishe banale edhe në një të njëjtën kohë. Ja, për shembull, disa shprehje të këtilla në gjuhën angleze e tonën: *concept* (në domethënien *notion, idea, conception*), *context* (në domethënien *connection*), *contact* (në domethënien *get in touch with*

e të ngj.), *evaluate* (në domethënien *judge* e të ngj.),¹⁶⁸ *to have an allergy, by far the most interesting*, etj. Këto shprehje kanë edhe në gjuhën tonë pandanët e vet mjaft banalë: koncepti, konteksti, të kontaktohet, të vlerësohet, të kesh alergji, shumë më interesant, etj. Rasti i njëjtë është në gjuhën franceze dhe tonën me shprehjet: *un paquet de lois* - pako ligji; *donner le feu vert* - të jepet dritë e gjelbër; etj. Në këtë dukuri qartë ka dhënë shenjë Shopenhaueri: “Shprehjet e këndshme, frazat origjinale dhe sintagmat e fatshme janë sikur edhe rrobat: nëse janë të reja, ato shkëlqejnë dhe kanë shumë efekt; por secili menjëherë fillon të bëjë po të atilla, për ç’rast për një kohë të shkurtër të bëhen krejtësisht të rëndomta dhe vullgare, ashtu që më në fund të mbeten pa kurrfarë veprimi.”¹⁶⁹

Përkundër përsëritjes monotone të fjalës, sintagmës dhe konstruksionit, autori do të përpiqet të përdorë shprehje e sintagma të freskëta e të përshtatshme, sikur edhe epitete dhe figura origjinale, nëse anon, nganjëherë, edhe stilin figurativ.

Një nga dukuritë më të shpeshta - që është karakteristike për të gjithë popujt, për shumë epoka dhe për numrin më të madh të autorëve, dhe që shkon në dëm të thjeshtësisë dhe koncizitetit të stilit, është grumbullimi, në tekst, i fjalëve: shprehjeve ekuivalente, sinonimeve, epiteteve, frazave të zëshme dhe sintagmave frazeologjike. Tërë kjo rrëke e fjalëve, ‘elokuencë’ e zbrazët jo vetëm që shpesh nuk i shton përmbajtjes së mendimit por ajo, pothuaj rregullisht, mendimeve ua topitë mprehtësinë e tyre, kurse shpesh e fsheh edhe varfërinë e tyre; sepse për ndonjë hartim nuk është me rëndësi numri i fjalëve, por pesha e mendimeve. Për këtë verbalizëm të zbrazët Ivo Andriq ka gjetur shprehje të shkëlqyeshme: “Në lidhje me këtë (d.m.th. me figurativitetin e të folu-

¹⁶⁸ Krls. Barzum..., o. c., p. 259.

¹⁶⁹ O. c., fq. 113.

rit) është edhe çështja e të a. q. pasurisë dhe ekzagjerimit të stilit. Historia e stileve letrare sikur edhe e të tjerëve – arkitekturës, mobilieve etj., - di për ato sëmundje të stilit, ku bollëku shndërrohet në varfëri, ku grumbullimi i fjalëve ngjason në shumëzimin patogjen të qelizave të sëmundja e kancerit. Ky është inflacion i fjalëve. Edhe sipas fjalëve të inflacionit, që ka më tepër, më pak vlejën dhe më pak lënë përshtypje në lexuesin. Dhe sa më shumë t'i shtojmë një fjale, me këtë e zvogëlojmë atë të parën që e kemi thënë...”¹⁷⁰

Me rëndësi është edhe ajo që autori të arrijë raport të drejtë ndaj përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve të huaja. Sot gati është bërë dukuri e përgjithshme që autori i ri shpesh përdorë në shkrimin e vet shprehje të huaja, e nganjëherë edhe lavdërohet me to. Ai që bën kështu tregon, sipas rregullit, jo vetëm varfërinë e fundit të vet të fjalorit të gjuhës amtare por edhe njëfarë fryerje, madje papjekuri, padije. Duke e gjykuar këtë dukuri të lavdërimit, nuk mendojmë ta gjykojmë çdo përdorim të fjalëve të huaja; tërheqim vëmendjen vetëm në përdorimin e matur të tyre.

Për përdorimin e fjalëve të huaja do të mund të shtrohet si parim ajo thënia e vjetër latine: *Uti, non abuti!*¹⁷¹ Kjo do të thotë, nëse për ndonjë gjë ose nocion ekziston fjala jonë, ose fjala e huaj që tashmë ka zënë rrënjë, atëherë ato edhe duhet përdorur. Përse, për shembull, të përdorim shprehjen *redukohet* = *shpjeret*, *pakësohet*, *kriticizëm (sic!)* = *kritika*, - *potenoi* = *theksoi*, *ceku* e të ngjashme, sikur që sot veprojnë disa kritikë tonë të rinj. Por, nëse në gjuhën tonë nuk ekziston fjala jonë për ndonjë nocion, ashtu që duhet të shkojmë kah përshkrimi, ose fjala e huaj është më të saktë, më e fuqishme, atëherë, gjithsesi, është më mirë të anojmë kah përdorimi i fjalës së huaj, nëse ajo në mënyrë më të qëlluar dhe më konci-

¹⁷⁰ Artikulli i cit., fq. 326 - 327.

¹⁷¹ Përdore, por mos e keqpërdor!

ze e shprehë atë që duam ta themi. Sidoqoftë, në përdorimin e fjalëve të huaja duhet pasur masë, takt, shije. Jan Parandovski mjaft rrept i ka gjykuar autorët që nuk kanë kujdes në këtë, por lavdërohen me fjalët dhe frazat e huaja. “Mbështetja e autoritetit të vet me fjalor të rëndë e të ngatërruar, ka herë ka qenë privilegj i kokave të cekta, i penave nxituese e të padije. Forma ndaj tyre sillet si njerë. Jo vetëm që i përbuzë për shkak të krenimit pretendues me fjalët e huaja, por edhe gjithnjë i tërheq në kurthin e fjalëve dhe emërtimeve që nuk i kuptojnë. Këta janë kasnecë të rënies së përgjithshme të kulturës inteligjente.”¹⁷²

Nuk është me më pak rëndësi as çështja e përdorimit të drejtë të stilit figurativ në shqyrtimin shkencor. Ndryshe nga proza artistike, që, marrë në përgjithësi, shquhet me hovin e imagjinatës, pasurinë e pamjeve dhe figurave dhe me frymëzimin poetik, për prozën shkencore karakteristik është kryesisht stili intelektual, d.m.th. përdorimi i fjalëve në domethënien e tyre të vërtetë, jofigurative. Kjo në asnjë rast, ndërkaq, nuk do të thotë se edhe në shqyrtimin shkencor nuk ka vend për stilin figurativ: figurat, metaforat, krahasimet dhe figurat tjera në stilin e thatë intelektual të shkrimit shkencor mund të fusin njëfarë llojllojshmërie dhe gjallërie, freskie dhe impresiviteti, që këndshëm veprojnë. Por vetëm me masë dhe shije: “Përdorimi i tepruar i të folurit figurativ aty ku nuk ka vend për të, për shembull në prozën shkencore, artikujt politikë, vepron artificialisht dhe jobindshëm.”¹⁷³ I dyti, figurat (metaforat e të tjera) nuk guxojnë të jenë të tepërta, vetvetiu cak.¹⁷⁴ D.m.th. ato duhet t’i kontribuojnë ndriçimit të mendimeve; nuk guxojnë të jenë të tep-

¹⁷² O. c., fq. 190.

¹⁷³ I. Andriq, art. i cit., fq. 326.

¹⁷⁴ Qysh në shek. XVII Paskali i ka gjykuar autorët “që bëjnë antiteza detyruesisht duke i lidhur fjalët” dhe i ka krahasuar me njerëzit “që bëjnë dritare të verbëra për shkak të simetrisë”. (Misi, ..., fq. 15.)

ruara, jonatyrore, të shtrira, që mendimin ta shtrembërojnë; banale dhe vulgare, ta fyejnë shijen, etj.

Por ajo që, gati marrë në përgjithësi, kurrsesi nuk ka vend në prozën shkencore janë: shprehjet familjare, kolokuiale dhe vulgare (nga i a.q. zhargon i rrugës, të folurit vagabondas e të ngj.¹⁷⁵ Duke kritikuar ngapak, Bogdan Popović saktë heton se të përdoret ndonjë fjalë familjare pavend d.m.th., përafërsisht si edhe të vihet në shkollë me fustan për fjetje.¹⁷⁶

Në analizën fundore, kriteri më i sigurt dhe më i mirë për zgjedhjen e fjalëve deri sot ka mbetur ai parim që e ka shtruar Horacie:

... Nedum sermonum stet honos et gratia vivax.

Multa renascentur quae jam cecidere, cadentque

Quae nunc sunt in honore vocabula, si volet usus,

Quem penes arbitrium est et jus et norma loquendi.¹⁷⁷

Parimit të përmendur “të përdorimit” të poetit latin të shekullit I-rë para erës sonë ia ka shtuar poeti anglez i shekullit tetëmbëdhjetë, Aleksandër Pop (Pope), edhe parimin e masës dhe shijes: “Për fjalët sikur edhe për modën, (thotë ai), vlejné rregullat e njëjta: barabartë është ekstravagante edhe ajo që është tepër e re edhe ajo që është tepër e vjetër. Mos u bëni i pari që e provoni të renë, as i fundit që të vjetrën ta lini”.¹⁷⁸

Në zgjedhjen e atyre fjalëve që më së miri i përgjigjen dhe në mënyrë më ekspresive, më efikase veprojnë

¹⁷⁵ Vetëm me mungesën e ndjenjave për gjuhën dhe mungesës së shijes mund të shpjegohet përse disa, në raportet e veta zyrtare ose në referatët të shtruar në ndonjë konferencë solemne, i përdorin, pa neveri, edhe fjalët e tilla.

¹⁷⁶ Kths., o. c., fq. 92.

¹⁷⁷ *Ars poetica*, fq. 69-72. [Larg asaj që fjalët e ruajnë gjithnjë shkëlqimin dhe nderin e vet. Do të lindin përsëri shumë fjalë që tashmë kanë rënë në harresë dhe do të shkatërrohen ato që tash janë në nder, nëse këtë do ta kërkojë përdorimi, në pushtetin e të cilit gjenden gjyqi, e drejta dhe kriteri i të folurit. Përktheu M. Sh.).

¹⁷⁸ Cit. në: B. Popović, o. c., fq. 92.

në ndonjë tekst, mund të jenë me ndihmë jo të vogël fjalorët e ndryshëm (si ata njëgjuhësorë ashtu edhe ata dygjuhësorë). Fjalorët e mirë, të mëdhenj enciklopedikë, paraqesin thesarin e vërtetë jo vetëm të thesarit leksik por edhe të dijeve më të llojlojshme: të historisë, gjeografisë, letërsisë e të tjera; me një fjalë, nga lëmi i kulturës dhe qytetërimit. Së këndejmi çdo njeri i kulturuar duhet të fitojë shprehinë që t'i konsultojë ata kurdo që dëshiron, që saktë të mësojë domethënien e ndonjë shprehjeje ose fraze, që diç të vërtetojë.¹⁷⁹

B. Struktura dhe raportet e fjalive

Fjala është njësi stilistike me anë të së cilës komunikohet mendimi (në kuptimin më të gjerë të fjalës). Cilësitë e saj kanë rëndësi të madhe, në radhë të parë struktura e saj, sikur edhe raporti dhe lidhjet e ndërsjella me fjalitë tjera.

Prej veçorive të shumta pozitive që duhet t'i ketë një fjali në hartimin shkencor, do t'i shqyrtojmë vetëm dy, që me këtë rast na duken më interesante: koherenca dhe llojlojshmëria.

Koherenca. - Fjala është koherente nëse raporti ndërmjet disa pjesëve dhe fjalëve në të është logjik: përmbajtjen e një fjalie të tillë e kupton lexuesi, rregullisht, shpejtë, pa përpjekje të mëdha dhe nuk ka nevojë që ta lexojë dy ose më shumë herë.

Gabimet kundër koherencës së fjalisë mund të jenë të llojlojshme. Këtu do t'i përmendim vetëm disa më të shpeshtat:¹⁸⁰

¹⁷⁹ Shih: XI

¹⁸⁰ Në theksimin e atyre gabimeve jemi shërbyer, në masë të konsiderueshme, me veprën: Ch. H. Vivian, and B. M. Jackson, o. c., pp. 216 - 221. Shembujt janë marrë nganjëherë nga shtypi jonë.

1) Fjalë është dykuptimëshe për shkak të asaj që qartë nuk shihet se me cilën fjalë ka të bëjë përemri (relativ, vector e të tjerë). Shembulli: *P. Iliq është njoftuar me N. Koçoviq në Beograd, ku ai ka studiuar të drejtën. - Markoviq i ka thënë Vukoviq se është i sëmurë.*

Në fjalinë e parë nuk është e qartë se me cilin personalitet ka të bëjë përemri *ai*; kurse në të dytën se me kend ka të bëjë pohimi *se është i sëmurë* - me Markoviqin apo me Vukoviqin. Në pajtim me këtë, që të fitohet fjali koherente, duhet përsëritur emrin përkatës, ose të shprehet mendimi në mënyrë tjetër, të pakontestueshme: ..., ku P. Iliq (N. Konjoviq) ka studiuar; ose: ..., ku i pari (i fundit) ka studiuar. - Markoviq i ka thënë Vukoviq se ky është i sëmurë; apo; Markoviq i është ankuar Vukoviq se është i sëmurë; apo: Markoviq i ka tërhequr vërejtjen Vukoviq se është i zbehtë, e të ngjashme.

2) Idetë paralele nuk janë shprehur me konstrukcionet paralele gramatikore. Shembulli: *Në punët e Këshillit bëjnë pjesë: përgatitja e materialit; udhëheqja e kartotekës, kryen punët e evidentimit (në vend kryerja e punëve të evidencës) Ose: Ka dëshiruar të shkojë në natyrë, që të shëtisë nëpër livadhe dhe notimin në lumë. (Fjalë koherente: ...dhe të notojë në lumë; ose: Ka dëshiruar qëndrim në natyrë, shëtitje nëpër livadhe dhe notim në lumë).*

3) Gjatë tërë fjalisë nuk është ruajtur 'pikëpamja' e njëjtë, d.m.th., subjekti i njëjtë, forma foljore (koha, gjendja), veta, numri e të ngjashme. Shembulli: *Studenti rëndom në fillim të semestrit përtacon, dhe përnjëherë gjendesh para provimit. - Erdhi në shtëpi dhe filloi menjëherë të kërkojë kudo. - Organet e shërbimit të sigurimit shpejtë i kanë kapur, por ata arrijnë të ikin nga stacioni i milicisë. Në shembullin e parë, subjekti në fjalinë e parë është në vetën e tretë, kurse në të dytën - në vetën e dytë; në shembullin e dytë dhe të tretë, fjalë e parë është në perfekt, e dyta në prezent).*

4) Ndonjë fjalë ose grup fjalësh (mbiemrat foljor, ndajfoljet e të ngj.) nuk kanë të bëjnë gramatikisht me

fjalën e parë - ata “janë pezull”. (Në gjuhën angleze konstruktionet e tilla i quajnë *dangling constructions*). Shembulli: *Duke e kryer këtë detyrë, puna tjetër e priste. – Qysh si fëmijë, babai shpesh më ka marrë në cirk.* (Gjerundivi duke kryer ka të bëjë me fjalën *puna*, sikur *puna* e ka kryer detyrën. - “*Qysh si fëmijë*” - gramatikisht ka të bëjë me babain, e jo me djalin).

5) Edhe përzierja e konstrukcioneve të ndryshme e rrënon koherencën e fjalisë. Shembulli: *Kam filluar të shkruaj vepër të re, e kur do ta mbaroj?* Në një fjali janë ngjitur dy fjali të llojeve të ndryshme: afirmative dhe pyetëse: Fjalja do të ishte koherente ose kur këto dy fjali të ndahen [*Kam filluar të shkruaj vepër të re. E kur do ta kryej?*]; ose: kur fjalja do të konstruktohet ashtu që të dy pjesët e saj të jenë të llojit të njëjtë - fjali deklarative [*Kam filluar të shkruaj vepër të re, kurse nuk di kur do ta mbaroj.*]

6) Konstruktionet jo të plota e rrënojnë po ashtu koherencën e fjalisë. Shembulli: *Ai kurrë, as që kurdoherë do ta punojë atë punë.* (Fjalja koherente: *Ai kurrë nuk ka punuar, as që kurdoherë do ta punojë atë punë.*)

7) Një prej gabimeve kundër koherencës së fjalisë lind edhe kur ndonjë fjale i jepet vend i gabueshëm në fjali. Më së shpeshti kjo ndodh me ndajfoljet: Shembulli: *Unë vetëm po dëftoj në rastet më të rëndësishme.* (Fjalja koherente është: *Unë dëftoj vetëm në rastet më të rëndësishme*).¹⁸¹

8) Lëshimi i lidhëses po ashtu mund ta bëjë fjalinë jokohërente. Shembulli: *Unë kam shkruar letër, ajo ka shëtitur nëpër qytet.* (Kjo fjali e përbërë përbëhet prej dy fjalive përbërëse, prej të cilave secila shpreh mendimin tjetërfare. Fjalja do të ishte koherente sikur të ishte: *Derisa ajo*

¹⁸¹ Nga vendi i ndajfoljes varet, shpesh, domethënia e fjalisë, sikur në shembujt vijues: Nga vendi i saj varet sidomos domethënia e fjalisë. - Nga vendi i saj sidomos varet domethënia e fjalisë. - Sidomos nga vendi i saj varet domethënia e fjalisë.

shëtitej nëpër qytet, unë kam shkruar letrën. Ose: Derisa unë kam shkruar letrën, ajo ka shëtitur nëpër qytet.)

E të tjera.

Natyrisht, në rastet kur fjalës së shkruar dëshirohet t'i jepet toni i caktuar familjar, nota kolokuiale ose e ngathtë, zbrapsjet nga norma e stilit të shkruar janë më pak ose më shumë të lejuara dhe mund të tolerohen. Këtë liri e shfrytëzojnë jo vetëm krijuesit e prozës artistike por edhe eseistët, humoristët etj. Në prozën shkencore rastet e këtilla të zbrapsjes janë të rralla dhe ata duhet veçan të jenë të arsyeshëm.

Llojlojshmëria (diversiteti). - Që t'i shmanget monotonisë së stilit, autori në fjalitë e veta kyç llojlojshmërinë. Shkrimtari i talentuar, sikur që është e njohur, këtë e bënë jovetëdijshtëm, ai i ndryshon fjalitë e veta thënë ashtu instinktivisht, duke i konstruktuar; derisa për shkrimtarin e ri, sidomos të papërvojë, është i domosdoshëm "përdorimi i vetëdijshtëm i veprimeve të caktuara metodike të ndryshimit të strukturës së fjalive dhe shmangies së monotonisë".¹⁸²

Ky ndryshim i fjalive mund t'i përkasë aspekteve të ndryshme të strukturës së tyre (për shembull, kombinimi i fjalive të përbëra me të thjeshtat), gjatësisë (kombinimi i fjalive të gjata me të shkurtat) dhe radhës së fjalëve (të ndërruarit e radhës së rëndomtë të fjalëve me inversion).

Sa i përket ndryshimit të strukturës së fjalive, duhet cekur se përdorimi i fjalive të thjeshta e paralele është karakteristike për format më pak të zhvilluara të vetëdijes (për fëmijët dhe personat më pak të arsimuar), derisa përdorimi i fjalive të përbëra parashtron tashmë zhvillimin e caktuar shpirtëror, mendimin më të plotë, duke e marrë parasysh se fjalitë e varura shënojnë, në mënyra të ndryshme edhe në masën më të vogël apo më të madhe, raportin e ndërsjellë të ideve. Duke u shërbyer me fjalitë

¹⁸² Ch. H. Vivian and B. M. Jackson, o. c., p. 228.

e përbëra të varura, autori jo vetëm që më pak i ekspozohet rrezikut që “primitivisht” të shprehet por edhe të bie në monotoni, meqë ky lloj fjalish ofron mundësi më të madhe për ndryshime. Të cekim, sa për shembull, një fjali të shkurtër si paralele, e pastaj si të varur të përbërë: *Mbrëmë në teatër nuk ka pasur dritë, e shfaqja nuk ka mundur me kohë të fillojë, dhe jemi detyruar një kohë të presim në terr. - Mbrëmë në teatër shfaqja nuk ka mundur me kohë të fillojë pasi që nuk ka pasur dritë, ashtu që jemi detyruar një kohë të presim në terr.*

Fjalitë duhet ndryshuar edhe në aspekt të gjatësisë: në mënyrë monotone, edhe bezdisshëm vepron përdorimi i përhershëm i fjalive vetëm të shkurtra ose vetëm të gjata. Gjithsesi, më së miri është të kombinohen të dy llojet, aq më parë që “diversiteti në gjatësi të fjalive mundëson diversitetin në strukturë, në harmoni me idetë që duhet komunikuar”.¹⁸³ Megjithatë, nuk duhet humbur parasysh faktin që fjalitë më të gjata, ndonëse shpesh mund të jenë shenjë e pjekurisë së autorit, nuk guxojnë të jenë tepër të gjata, të ngathta, të vrazhda, me shumë shtojca, plotësime, kufizime të ndryshme. Fjalitë e tilla e rëndojnë të kuptuarit dhe kërkojnë prej lexuesit përpjekje të konsiderueshme që t’i kuptojë. Në pajtim me këtë, natyrshmëria dhe lehtësia e të shprehurit do të arrihet po ashtu me shmangien e fjalëve tepër të gjata e të ngatërruara, në të cilat, krahas kryesores, janë grumbulluar fjalitë e shumta të varura, digresionet dhe parantezat, “hollësitë e tërthorta dhe asociacionet e rastit”; sidomos nëse këto janë, krahas kësaj, përplot me shprehje dhe nocione abstrakte. Së këndejmi fjalinë tepër të gjatë duhet ndarë në dy ose më shumë fjali, kurse të ndërlikuarën në fjali më të thjeshtë.

¹⁸³ Po aty, p. 230.

Më në fund, diversiteti i caktuar arrihet nëse ndryshon radha e fjalëve në fjali, nëse radha e rëndomtë e fjalëve dhe inversioni ndërrohen. Por, gjatë kësaj duhet pasur kujdes që ndryshimi i radhës së fjalëve mos të shkojë në dëm të qartësisë (shumë paqartësi vijnë, kemi parë, nga ndajfolja keq e vënë e të ngj.). Nga ana tjetër, duhet pasur kujdes për theksimin (emfazën). Me fjalë të tjera, siç kemi thënë, ato pjesë të fjalisë ose ato shprehje që nuk duam veçan t'i theksojnë vihen në fund, përkatësisht në fillim dhe se kjo pjesë e fjalisë ose shprehje nuk guxon të vihet në vend të gabueshëm, vetëm për atë shkak që në radhën e fjalëve të futet diversiteti i caktuar. Për shembull, në fjalinë: *Kualitetet e rëndësishme në një fjali janë koherenca dhe diversiteti* - mundemi radhën e fjalëve ta ndryshojmë në mënyra të ndryshme, në pajtim me atë ç'dëshirojmë që në te të theksojmë: *“Koherenca dhe diversiteti janë kualitete të rëndësishme në një fjali. - Në një fjali koherenca dhe diversiteti janë kualitete me rëndësi. - Në një fjali janë kualitete me rëndësi koherenca dhe diversiteti. (Në variantin e fundit më së shumti janë theksuar koherenca dhe diversiteti.*

Por, nga fjalia e marrë vetvetiu nuk është aspak më pak e rëndësishme as lidhja ndërmjet disa fjalive, që duhet të jetë e fortë, logjike, natyrore. Ajo lidhje mund të jetë e jashtme (kur fjalitë janë të lidhura ndërmjet veti me lidhëse, ndajfolje, me fjalë parentetike) dhe e brendshme (nëse ato janë të varguara pa ato shenjat e jashtme dhe të sistemuara ashtu që lexuesi lehtë mund ta kuptojë lidhshmërinë e tyre logjike). Nëse do të duhej të deklarohemi për ndonjërin prej këtyre dy mënyrave të lidhshmërive të fjalive, do të duhej të përcaktohem për të dytën: për fjalitë fort të lidhura me lidhjen e brendshme, logjike, lidhëset nuk i janë, në realitet, as të nevojshme. E megjithatë, secila nga këto dy mënyra, nëse vetëm ajo do të përdorej, shpejtë do të bëhej monotone dhe e lodhshme. Ato, në pajtim me këtë duhet kombinuar në

mënyrë të matur, duke e pasur parasysh atë parimin themelor të të shkruarit që “çdokush të shkruajë sipas temperamentit të vet, kurse stili origjinal është ai që u nënshtrohet afiniteteve të tij, por nuk ik nga parimet e organizuara metodike.”¹⁸⁴

C. Struktura dhe veçoritë e paragrafit

Paragrafi është njësi ideore që përbëhet prej një varg fjalish të lidhura në mënyrë të ndërsjellë ashtu që përbëjnë tërësi të gjerë koherente dhe shërben, njëkohësisht, si pjesë e tërësisë më të madhe (nënpjesës, pjesës, kaptinës, kreut etj.). Në pajtim me këtë, fjalitë e një paragrafi në këtë tërësi logjikisht ndërmjet veti janë të lidhura me ndonjë mendim (temë) më të gjerë, më të përgjithshme.

Siç shihet, paragrafi paraqet njësinë strukturore dhe si i tillë ai do të jetë i mirë, efikas, nëse do të jetë i fortë, “i shëndoshë” struktura e tij e brendshme.¹⁸⁵ Teorecienët e letërsisë i vënë rëndom tre kushte themelore për vlefshmërinë e një paragrafi: unitetin, koherencën dhe theksimin e përshtatshëm. Shkurtimisht të hedhim vështrimin në secilën prej këtyre veçorive:

Uniteti. - Kjo veçori përbëhet në atë që në paragraf, në fjalitë e ndryshme që e përbëjnë, prej fillimit deri në fund zhvillohet mendimi (tema) i njëjtë themelor (qendror). Me fjalë të tjera, uniteti i paragrafit do të arrihet nëse të gjitha pjesët e tij, të gjitha fjalitë, janë të orientuara drejt një teme themelore që në të zhvillohet. Ky mendim qendror duhet të jetë menjëherë i qartë dhe evident.

¹⁸⁴ D. Momet, *Cours pratique...*, p. 235.

¹⁸⁵ Kths.: Ch. H. Vivian..., o. c., p. 164.

Kjo d.m.th., në paragraf nuk guxon të ketë, nga një anë, fakte dhe mendime që dalin nga suazat e temës së tij, që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë me të (uniteti i paragrafit rrënohet posa në të futet çdo temë e re, ose pikëpamje e re), kurse në anën tjetër, në të nuk guxon të mungojnë disa fakte dhe ide që janë me rëndësi thelbësore për vetë temën e paragrafit.¹⁸⁶ Për atë kur munden dhe kur guxojnë të bëhen digresionet, kemi folur më herët.¹⁸⁷ Që të arrihet dhe zbatohet më lehtë uniteti i paragrafit, preferohet që në fillim të jepet shenjë në cakun e tij me një fjali të shkurtër, të përgjithshme ('fjalja tematike'), e cila në një mënyrë e përgatit lexuesin, duke e rezimuar përmbajtjen themelore, temën e paragrafit.¹⁸⁸ Nganjëherë, në vend në fillim, kjo mund të bëhet në fund të paragrafit.

Koherenca. - Që të jetë koherent, paragrafi medoemos duhet t'i plotësojë dy kushtet themelore: 1) Të gjitha pjesët e tij të përbëjnë tërësinë e fortë logjike, organike, d.m.th., fjalitë në të duhet të radhiten me ndonjë radhë ('logjike'), respektivisht ashtu të organizuar që ndërmejt tyre ekziston ndonjë lidhje - kronologjike, kausale, e të ngjashme; 2) Fjalitë nga të cilat është përbërë paragrafi ta përbëjnë atë tërësinë e fortë logjike, organike, të qartë dhe evidente për lexuesin. Kjo arrihet në mënyra të ndryshme: me organizimin sistematik të ideve, me kalimet e përshtatshme nga njëra ide në tjetrën, me përpikërinë e strukturës gramatikore e të ngjashme.¹⁸⁹

Theksimi. - Disa pjesëve të ndonjë paragrafi do t'u jepet aq vend dhe aq hapësirë sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme që lexuesit t'i komunikohet tërë përmbajtja, mendimi i tërësishëm i paragrafit. Kjo do të sendërtohet "me përsëritjen e fjalëve kyç ose të sintag-

¹⁸⁶ Ibid.

¹⁸⁷ Të shihet: I, b.

¹⁸⁸ Ch. H. Vivian..., o. c. p. 164.

¹⁸⁹ Po aty, pp. 167 - 176.

mave frazeologjike”, në përpjesëtim me hapësirën: disa ideve u jepet aq hapësirë sa ato, sipas rëndësisë së vet relative e meritojnë, d.m.th., në vendet më të rëndësishme më gjatë ndalemi, në vendet më pak të rëndësishme - më shkurt. Pastaj, nuk është e barabartë se në cilin vend do ta vëmë ndonjë fjalë. Kemi parë se fundi është ai vend që më së shumti tërheq vëmendjen e lexuesit dhe aty vihet diçka që dëshirohet të ceket në mënyrë të veçantë, pastaj sipas rëndësisë vjen fillimi, e vetëm atëherë vendet tjera.¹⁹⁰

Më në fund, paragrafi më fuqishëm do të veprojë nëse në të do të ketë hollësi konkrete, të cilat lexuesit do t'ia lehtësojnë marrjen e përmbajtjes, mendimet e paragrafit.¹⁹¹

Sa i përket gjatësisë së paragrafit, ajo konsiderueshëm mund të ndryshojë, që varet nga “qëllimi i paragrafit dhe metoda e zhvillimit”. E megjithatë, të theksojmë se edhe këtu, si çdokund, duhet t'u shmangemi skajshmërive: të mos ndërtohen paragrafet as shumë të shkurtra, prej një ose dy fjalive, përveç nëse ky nuk është paragraf me karakter hyrës, përfundimtar ose kalues. Paragrafet tepër të shkurtra e të shpeshta janë dëshmi e qartë e “dobësisë së sintezës”; mirëpo, paragrafet nuk guxojnë të jenë as tepër të gjatë, prej dy e më shumë faqesh, sepse paragrafët më të gjata se një faqe rregullisht ndikojnë bezdisshëm. Në rastet e arsyeshme lejohen, kuptohet, abstenimet. Gjatë kësaj gjithnjë është e domosdoshme që paragrafi të mbarohet atëherë kur të mbarohet zhvillimi i temës themelore të tij.


Por, sikur që brenda një paragrafi duhet të ekzistojë lidhshmëria e fortë e fjalive, po ashtu duhet të ekzistojë lidhja e fortë ndërmjet disa paragrafëve; në asnjë rast nuk guxohet që nga një paragraf të kalohet me shpejtësi

¹⁹⁰ Po aty, pp. 174 - 176.

¹⁹¹ Po aty, pp. 176 - 179.

në tjetrin, të flitet në ta për gjerat krejtësisht të llojlojshme duke i lidhur ato vetëm me lidhjet e jashtme - me ndonjë lidhëse, ndajfolje, fjalë parentetike - përkundër kërcimeve të qarta logjike. Me fjalë të tjera, çdo paragraf i ri paraqet një lloj shkalle, që lexuesin e shpie më tej cakut, e sjellë më afër deri te ai. Krahas kësaj, çdo paragraf d.m.th., pushim i llojit të vet: i dëfton lexuesit se me të fillon diç e re - zhvillimi i mendimit të ri, temës së re. Kalimet nga njëri paragraf në tjetrin (sikur edhe kalimet nga një fjali në tjetrën) duhet të jenë, në pajtim me këtë, succesive, sa më të logjikshme dhe natyrore. Përndryshe, autori do të ngjasojë në pijanecin që “matë” rrugën, luhatet djathtas dhe majtas, duke zënë në thua dhe duke rrëshqitur.¹⁹²

Duhet shtuar se kjo që është thënë nuk vlen vetëm për paragrafin, por edhe për njësitë më të mëdha, për shembull kaptinat: Në këtë mjaft plastikisht kanë dhënë shenjë Barzuni dhe Grafi në skemën vijuese:



¹⁹² Sado të duket vetvetiu e kuptueshme dhe e njohur që çdo paragraf i ri fillon me rresht të ri, studentët tanë në punimet e veta të diplomës jorrallë për këtë gabojnë. Kam pasur rast të lexoj punimet e diplomës prej njezet e më shumë faqe të tekstit të daktilografuar në të cilat ka pasur mjaft pak aline, kurse të gjitha njezet e sa faqe përbënin një kaptinë. Natyrisht, mungesa e tillë e sistemit më themelor të lëndës i ka bërë punimet e pakontrollueshme e të palxueshme, sado që ato përndryshe të kenë qenë interesante dhe të vlefshme.

Kurrë mos e heqni nga mendja, - thonë autorët e cekur, - se po ashtu lënda S është në lidhje me lëndën T. Nëse lajthoni deri te S 5, ju kurrë nuk do të arrini deri te T 1. Nga ana tjetër, me pak largpamësi, ju paraprakisht do të shihni që, duke mos e humbur parasysh thelbin e lëndës S dhe duke ardhur deri te lënda S 4, lehtë mund ta kapni T 1.

Kjo mjeshtri e dukshme do të veprojë ndërmjet kaptinave sikur edhe ndërmjet pjesëve të një kaptine. Gjithnjë ekziston ndonjë lëndë që mund të sillet deri në fund të kaptinës, ashtu që ajo lidhet me kaptinën vijuese, kurse ekziston edhe lënda që i përgjigjet fillimit të vërtetë të kaptinës vijuese. Kjo ndërlidhje e ndërsjellë e ideve e bënë librin të fortë, por megjithatë ajo nuk është domosdoshmërisht e nevojshme që të arrihet kjo fortësi. Nganjëherë kaptina e re do të gjejë gjurmë deri te lënda shumë më e hershme, me qëllim që t'i bëjë të qarta faktet që duhet të ekspozohen, dhe ky kërcim mbrapa fut shpesh ndryshim të caktuar në atë që përndryshe do të ishte të ecur i detyruar me hapa të nivelizuar.¹⁹³

Barzni dhe Grafi krahasojnë rrjedhën e lidhur të fakteve dhe të ideve me rrugën e bukur, të drejtë e me kthesa të lehta, nëpër të cilat lehtë dhe bukur voziteni. Nëse, ndërkaq, hasë befasisht në kthesë të rreptë, autori duhet ta marrë lexuesin për dore dhe t'ia tërheqë vërejtjen në atë kthesën e rreptë me fjalët sikur që janë: "Tash duhet të kthehemi në ...".¹⁹⁴

¹⁹³ Barzun..., o.c., p. 242.

¹⁹⁴ Po aty, p. 242 - 243.

Ç. Korrektësia gramatikore dhe drejtshkrimore

Kuptohet vetvetiu se punimi i mirë shkencor duhet të jetë drejt i shkruar në pikëpamje gramatikore dhe ortografike. Mirëpo, numri jo i vogël i punëtorëve shkencorë, dhe jo vetëm i të rinjve, sillet në shkrimet e veta, fatkeqësisht, mjaft pakujdesshëm ndaj korrektësisë gramatikore dhe drejtshkrimore, duke i konsideruar gjëra tepër të vogla dhe duke e hequr nga mendja që edhe gabimet e vogla gjuhësore, nëse janë të shumta, fyejnë shijen estetike të lexuesit dhe medoemos e zvogëlojnë autoritetin e autorit në sytë e tij. Së këndejmi është e domosdoshme që çdonjëri që shkruan, ose që ka për qëllim të shkruajë, në mënyrë solide ta mësojë gramatikën dhe drejtshkrimin e gjuhës në të cilën shkruan.

Sa varet nganjëherë qartësia e tekstit të shkruar prej “gjërave të vogla” në dukje tregon, përveç tjerash, përdorimi i shenjave të pikësimit: me shenjat e pikësimit nuancohen domethëniet e disa fjalëve, grumbullit të fjalëve dhe fjalive dhe qëllimi i tyre është të kuptuarit më i mirë, “të paraqiturit më i qartë i asaj që dëshirohet të thuhet”.¹⁹⁵ Natyrisht, te shenjat e pikësimit të çdo gjuhe ka tradita, konvencione, rregulla të caktuara. E megjithatë, kur të gjitha ato tradita dhe rregulla plotësohen, mbeten edhe shumë raste ku vënia e ndonjë shenje të pikësimit varet prej vetë autorit, - mendimit të tij dhe derdhjes së mendimeve, ndjenjes së tij dhe derdhjes së ndjenjave, - ashtu që interpunksioni bëhet, në realitet, shkathtësia që ndihmon të menduarit dhe të kuptuarit më të qartë, përveç asaj që në njëfarë mënyre i ndihmon edhe sytë e lexuesit. Së këndejmi, nganjëherë një presje e lëshuar ose gabimisht e përdorur fjalisë mund t’i japë domethënie

¹⁹⁵ Novi pravopis, fq. 92.

krejt tjetër. Të cekim këtu, sa për ilustrim, vetëm disa shembuj të përdorimit të kësaj shenje të pikësimit, të marrë afër, me qëllim që këtyre, së paku deri diku, t'u tregojmë se si edhe ato gjëra "të vogla" mund të kenë nganjëherë rëndësinë e vet dhe se si hulumtuesi edhe për to duhet të ketë durim, këmbëngulje, vullnet.

1) *Vajza ime, që e studion muzikën, është mjaft e zënë. - Vajza ime që e studion muzikën është mjaft e zënë.*

Në shembullin e parë nënkuptohet se kam vetëm një vajzë dhe se ajo studion muzikën; në të dytin - se kam dy ose më shumë vajza dhe se flas për atë që e studion muzikën.

Në rastet e këtilla të përdorimit të presjes para përmrit lidhor, mund të shtrohet rregulli vijues: Nëse fjalia është restriktive (d.m.th., e atillë që e kufizon domethënien, nocionin e fjalës me të cilën ka të bëjë), sikur në shembullin e dytë, ajo nuk ndahet me presje; përndryshe, nëse ajo nuk është restriktive por eksplikative, d.m.th., nëse paraqet vetëm shtojcë plotësuese, koment përbri fjalës me të cilën ka të bëjë, ndahet me presje.¹⁹⁶

2) *Njohja ose, më mirë, të kuptuarit e atyre termave studimin e bënë më të lehtë. - Njohja ose më mirë të kuptuarit e atyre termave ...*

Siç shihet, nëse para dhe pas fjalëve *më mirë* vihet presja, ndajfolja ka të bëjë me tërë fjalinë; nëse presja nuk vihet, fjala *më mirë* bëhet mbiemër dhe e përcakton më afërsisht emrin.

3) *Ivo Andriq posedon dy veçori mjaft të rëndësishme: talentin dhe disiplinën, ai këto veçori të vetat i ka shprehur tashmë në punimet e veta të para letrare.*

Nganjëherë autori i ndanë fjalitë gabimisht me presje, ndonëse lidhja e tyre e ndërsjellë është e atillë që në

¹⁹⁶ Krls. artikullin tonë: "Upotreba zapete pred relativnom rečenicom", Pitanje savremenog književnog jezika, (Sarajevë, 1949, I, 1, fq. 174 e më tej.

vend të presjes më mirë do të vinte ndonjë shenjë tjetër të pikësimit: pikëpresja, pika, dy pika e të ngjashme. Interpunkcioni më korrekt do të ishte në shembullin e sipërm: *I. Andriqi posedon dy veçori mjaft të rëndësishme: talentin dhe disiplinën; ai ato veçori të vetat...* - Ose: *I. A. posedon dy veçori mjaft të rëndësishme: talentin dhe disiplinën. Ai ato veçori të vetat...*

4) *Shumë studentë heqin dorë nga provimet. Pasi që fillojnë vonë që për ta të përgatiten.* - *Nuk ka ardhur sot në punë. Sepse befasisht është dashur të udhëtojë.* - *Tre mjekë francezë kanë situar shpërblimin Nobel të këtij viti për medicinë. Përveç tjerash, për punën e tyre në ekzaminimin e kancerit.*

Këto, në realitet, nuk janë fjali të plota por fragmente të fjalive, që, sipas rregullit, duhet shmangur në prozën shkencore. Në qoftë se autori me këto fragmente dëshiron të arrijë efekt të veçantë, ose në qoftë se në pyetje është përshkrimi, portretimi i personalitetit e të ngjashme, fragmentet e fjalive janë të lejueshme. Përndryshe, duhet ose grupin e fjalëve t'ia bashkangjesim fjalisë të cilës, në realitet, edhe i takon, ose nga fragmenti i fjalisë të bëhet fjali e plotë. Në pajtim me këtë, fjalitë e sipërme do të mund të ishin: *Shumë studentë heqin dorë nga provimet, pasi që fillojnë vonë për ta të përgatiten.* Ose: *Shumë studentë heqin dorë nga provimet: ata fillojnë vonë që për ta të përgatiten, e të ngj.* - *Sot nuk ka ardhur në punë, sepse befasisht është dashur të udhëtojë.* Ose: *Sot nuk ka ardhur në punë: është dashur befasisht të udhëtojë, e të ngj.* - *Tre mjekë francezë kanë situar shpërblimin Nobel të këtij viti për medicinë, përveç tjerash, për punën e tyre në ekzaminimin e kancerit.* Ose: *Tre mjekë francezë kanë situar shpërblimin Nobel të këtij viti. Me këtë mirënjohje të lartë janë dekoruar, përveç tjerash, për punën e tyre në ekzaminimin e kancerit, e të ngj.*

Ja një shembull për përdorimin e keq të shenjës së pikësimit: *dy pikave:*

Në romanin *Princesha nga Klevi* është një skenë e rëndësishme: zonja de Shartr i pranon burrit të vet, zotëriut de Shartr, se dashuron tjetrin, vojvodën de Nemur. Skena ndodh në një pavijon. Në të, i fshehur, merr pjesë edhe vojvoda de Nemur...

Këtu, sikur që shihet, gabimisht është shënuar raporti ndërmjet paralajmërimit të “skenës së rëndësishme” dhe asaj që pason pas saj. Dy pikat, sipas asaj siç janë vënë, kanë të bëjnë vetëm me një fjali, ajo që vjen drejtpërdrejt pas dy pikave (“zonja de Shartr i pranon... se dashuron... vojvodën de Nemur”), derisa ato, në realitet, kanë të bëjnë jo vetëm me fjalinë e cekur por me tërë vargun e fjalive që pasojnë pas saj. Në pajtim me këtë, logjike do të ishte që pas dy pikave të fillojë paragraf i ri:

Në romanin *Princesha nga Klevi* ekziston një skenë e rëndësishme:

Zonja de Shartr i pranon burrit të vet, zotëriut de Shartr, se dashuron tjetrin, vojvodën de Nemur. Skena ndodh në një pavijon. Në të, i fshehur, merr pjesë edhe vojvoda de Nemur...

Nganjëherë në fjalinë e gjatë të përbërë mjafton të ndahen me vija disa pjesë, që fjalia e madhe, e paqartë të bëhet menjëherë, në shikim të parë, e qartë. Për shembull:

Vepra e Andriqit, që është rritur si rezultat i përpjekjes së thellë ideore dhe intelektuale, njëkohësisht është edhe ndërmarrje e madhe kritike. Për këtë arsye në këtë çast të apologjive të përgjithshme të kriticizmit është dashur të tërhiqen shumë njerëz që ta verifikojnë natyrën e tij, që në prozën e ngjeshur të Andriqit të tipit modern intelektual, [-] në të cilën fshihen kufijt ndërmjet poezisë, tregimit, eseut, historisë dhe shënimit, dhe çdo gjë shkrihet në një tërësi, çdo gjë bëhet zbulim mbi jetën dhe botën, [-] kërkojnë dhe shqyrtojnë domethënien e pikëpamjeve të tij mbi artin, si në tekstet e pastra beletristike, ashtu edhe në ato të karakterit eseist dhe kritik.

Të dëftojmë edhe në dy hollësi nga lëmi i drejtshkrimit, në të cilat, sipas rregullit, nuk ka kujdes i mjaftueshëm, dhe të cilat, në realitet, nuk janë përpunuar dhe saktësuar as në *Drejtshkrimin tonë të ri*: në përdorimin e shkurtesave dhe në shkrimin e numrave në tekstin e shqyrtimit shkencor.

Sa u përket shkurtesave, duhet theksuar që, - ndryshe nga përdorimi i tyre në poshtëshënime dhe në bibliografi, - ato duhet sa më shumë të shmangen në vetë tekstin (me përjashtim të disave prej tyre, sikur: z., zon., dr., prof. - krahas emrave, e të ngj.). Kështu duhet shkruar: Ai jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (e jo në SHBA); ose: Arriti të hënën, me 7 prill të vitit 1966 (e jo: të hën., me 7 pr. të vit. 1966), e të ngjashme.

Në pikëpamje të numrave, mund të vihet si rregull i përgjithshëm që edhe ata në tekst duhet të shkruhen me shkronja. Sidomos duhet shmangur shkrimin e numrave me shifra në fillim të fjalisë. Në pajtim me këtë, në atë rast ka nevojë ose fjalia të riformulohet, ose numri të shkruhet me shkronja. Marrë në përgjithësi, janë të rralla rastet kur në tekst numrat shkruhen me shifra, siç janë: data (26 prill 1966), numrat e shtëpive të rrugëve (Mareshal Titos 80/III), orët e ditës (në ora 12,30), numrat decimalë (5,75), përqindjet (10%), numrat e krerëve dhe faqeve të librit (në kreun IV, faqja 8) etj.¹⁹⁷

Në shkrimet shkencore në masë të konsiderueshme janë standardizuar edhe mënyrat e përdorimit të llojeve të ndryshme të numrave - romakë (të mëdhenj e të vegjël) dhe arabë. Kështu, me numrat e mëdhenj romakë shënohen: numrat e vëllimeve, kaptinat e librave, të pjesëve, numrat e akteve, e të ngj.; e me numrat arabë shkruhen: numrat e faqeve, rreshtave, shtyllave e të ngj.; me numrat

¹⁹⁷ Kths. Turabian, o.c., pp. 8-9.

e vegjël romakë (i, ii, iii, iv, v, vi, etj.); krerët e librave, faqet e parathënies (ose hyrjes), skenat në shfaqje etj.

D. Mënyrat e arritjes së stilit dhe gjuhës së mirë

Që dikush ta arrijë shkathtësinë e të shprehurit të gjallë e të freskët, stilin origjinal vetjak dhe gjuhën e bukur, është e domosdoshme të japë në këtë shumë përpjekje dhe energji. Ndjenja për gjuhë, fjalor të pasur, stil të mirë janë pjesë përbërëse të kulturës së përgjithshme dhe rezultat i të lexuarit shumëvjeçar të shkrimtarëve, të stilistëve të mirë dhe përpjekjeve dhe orvatjeve të përhershme që të shkruhet qartë e fuqishëm.

Ekzistojnë shumë rrugë dhe mënyra që shpiejnë drejt arritjes së stilit dhe gjuhës së mirë, zotërimit me teknikën e të shkruarit. Ne këtu, shkurt, do të vështrojmë tri që na duken më praktike:

E para prej tyre, që përvoja shumë herë e ka vërtetuar, është leximi i stilistëve të mirë, të vendit e të huaj: ata do t'i ndihmojnë lexuesit jo vetëm ta zgjerojë rrethin e ideve, ta pasurojë dijen e vet dhe të arrijë arsimim të përgjithshëm më solid, që më plotë dhe më harmonikisht ta zhvillojë personalitetin e vet, të gjitha veçoritë dhe dhuntitë e tij, të fitojë njohje më të gjithanshme e më të thellë të personalitetit të vet, njeriut dhe jetës përgjithësisht, por edhe ta zhvillojë ndjenjën e vet për stërhollimin stilistik dhe gjuhësor, ta pasurojë fjalorin e vet dhe ta përkryejë fjalinë e vet. Sidomos është frytdhënës preokupimi më i gjatë me ndonjë autor të madh, shoqërimi i përhershëm me të, e sidomos studimi i mënyrës së tij të të shkruarit (kompozicionit të veprave të tij, strukturës së kaptinës, pjesës, paragrafit dhe fjalive, zgjedhjes së fjalë-

ve etj.). Përveç tjerash, ky preokupim do të lërë gjurmë më të dukshme, do të ndikojë edhe në mënyrën e të shprehurit me shkrim (sikur edhe me gojë) të lexuesit. Marrë në përgjithësi, artistët e mëdhenj të fjalës së letërsisë sonë dhe të huaj, të lashtë dhe të re, do t'i ndihmojnë lexuesit të kujdesshëm e studioz që të fitojë pasqyrë më të qartë për ato "cilësi të bukura e komplekse që e ndërtojnë stilin dhe quhen stil", dhe që ato cilësi të bukura, sa ka mundësi, t'i kultivojë edhe në vete, në stilin dhe gjuhën e vet. Një teoricien letrar (A. Albalati) shkon aq larg saqë leximit i përshkruan fuqi çudibërëse dhe e konsideron bazë të shkathtësisë së shkrimit:

A dëshironi të dini a do të keni talent? Lexoni. Librat do t'ju thonë. Po shkruani, por sakaq u penguat. Lexoni. Librat do t'ua kthejnë frymëzimin. Lexoni kur të doni të shkruani. Lexoni kur më nuk mund të shkruani. Talenti nuk është asgjë tjetër veçse asimilim. Duhet lexuar atë që të tjerët e kanë shkruar që të shkruani vetë, që edhe neve të tjerët të na lexojnë. Leximi e eviton thatësinë, i aktivizon aftësitë, e çliron nga gëzhoja intelektin dhe i jep hov imagjinatës... Leximi është fshehtësi e madhe. Ai mëson për çdo gjë, nga drejtshkrimi deri te formulimi i fjalive.¹⁹⁸

Përkthimi nga gjuhët e huaja në gjuhën amtare po ashtu mund të jetë i dobishëm për zhvillimin e aftësive për të shprehurit me shkrim. Duke synuar që në mënyrë sa më besnike dhe sa më bukur në frymën e gjuhës amtare ta përcjellë mendimin (në kuptimin më të gjerë të fjalës) nga ndonjë gjuhë e huaj në të veten, përkthyesi përpiket që për mendimin e huaj të gjejë shprehje dhe formulim sa më të qëlluar në gjuhën vendëse; ai përsiat për domethënien e çdo fjale, e vërteton dhe e matë "fuqinë bartëse" të saj dhe me këtë i kthjellon dhe mpreh nocionet që disa fjalë i shënojnë dhe e njofton thesarin

¹⁹⁸ *L'Art d'écrire*, XVI^e éd., Paris, A. Colin, 1910, pp. 20-21. (cit. në: Dykmaus, o.c., I, 263.

dhe mundësitë shprehëse të gjuhës amtare. Krahas kësaj, që është me rëndësi të veçantë, ai në mbamendjen e vet krijon vetëdijen e vet, fond të të gjitha fjalëve dhe të sintagmave frazeologjike me të cilat e pasuron fjalorin e vet dhe të cilin lehtë mund ta përdorë më vonë, kur të shkruajë punim origjinal, t'i shprehë mendimet vetjake. Së këndejmi hulumtuesve të rinj, dhe autorëve përgjithësisht, duhet porositur ngrohtësisht përkthimin me shkrim nga ndonjë gjuhë e huaj në atë amtare, si ushtrim të shkëlqyeshëm në të shprehur. Duke e njohur, në bazë të përvojës vetjake, dobinë e përkthimit, A. Zhidi ka konsideruar se çdo letrar duhet, në jetën e vet, të përkthejë nga ndonjë gjuhë e huaj së paku një vepër.

Mënyra e fundit, por jo më së paku efikase që të arrihet shkathtësia e të shprehurit me shkrim është, gjithsesi, vetë shkrimi. Ky shkrim, natyrisht, mund të ketë aspekte të ndryshme, si: ritregimi, parafrazimi, rezymimi i pasuseve nga shkrimi që lexohet; hartimi i vrojtimeve dhe refleksioneve vetjake; mbajtja e ditarit, shkrimi i hartimeve dhe shkrimeve të ndryshme, etj. Çështja, pra, është shumë e thjeshtë: duhet shkruar sa më shumë, sa më shpesh, sa më llojlojshëm dhe, sidomos, sa më me kujdes. Kjo do të thotë se ajo që shkruhet është e domosdoshme durueshëm dhe palodhshëm, në mënyrë stiliste dhe gjuhësore, të përsoset dhe të përmirësohet: të lëshohen shprehjet ose grupet e shprehjeve, të ndërrohen disa fjalë dhe sintagma frazeologjike me të tjera, të rrumbullakohen dhe riformulohen fjalitë, sërish të redigjohen faqet e tëra, nëse kanë nevojë, etj. Me fjalë të tjera, me rastin e revizionit stilistik dhe gjuhësor të dorëshkrimit të përpiqemi jo vetëm të mënjanojmë gabimet dhe kërcimet logjike, por edhe që sa më përgjithësisht të shprehet mendimi (dhe për këtë qëllim duhet hedhur fjalët e tepërta - përsëritjet, tautologjitë, pleonazmat); që të arrihet formulimi sa më i saktë dhe të evitohen papër-

caktueshmëritë; që ndonjë mendim sa më gjallërisht dhe freskët të shprehet duke iu shmangur kthesave të klisheizuara, frazave banale, llojeve gjithfare të klisheve; që fjalitë dhe paragrafet të jenë sa më bukur të formuluar dhe sa më koherente e harmonike, që të evitohen gabimet gramatikore e drejtshkrimore dhe joharmonizimet, etj. Në këtë mënyrë shumë artistë të dalluar të fjalës tekstin e vet, të shkruar në flakën e frymëzimit e kanë reviduar e përkryer në aspektin gjuhësor dhe stilistik dhe atë atëherë kur ai mirë “ftohej”. Ja këshilla e njërit prej tyre:

Shkruani më shpejt ose më ngadalë, më gjallë ose më kujdesshëm, si ju shpie mendimi dhe ju bartë ndjenja dhe mos u ndalni pa nevojë dhe mos e shkëputni magjinë e çastit frymëzues, që mbase kurrë nuk do të kthehet. Shkruani pa konsideratë të mjerë dhe pa turp të rrejshëm, me sinqeritet modest të vetë natyrës, me papërkulshmërinë e arsyes së ndritshme. Shkruani dhe dini se nga oqeani i kohës u është dhuruar një çast dhe në të mendimi, fotografia ose fjala e cila, e atillë çfarë është, më kurrë as juve as tjetrit nuk do t’ju paraqitet. Shkruani lirisht dhe thjesht sikur po merrni frymë. Por...

Por, kur të kalojë ai çast, që është i pastër, i çmueshëm, i rrufeshëm dhe i pashpjegueshëm si çast i frytëzimit, dhe kur të gjendemi para dorëshkrimit tuaj që tash e ka fituar vendin e vet në këtë botën tonë në të cilën, përkundër të gjitha konflikteve dhe parëndësive, sundojnë dhe duhet të sundojnë rendi e arsyeja dhe përgjegjësitë e shumëfishta, atëherë afrojuuni pa dashuri të verbër prindërore, ftohtë dhe papërkulshëm rreptë, duke mos e vajtuar as atë as veten, duke mos kursyer fuqi as kohë. Lakojeni çdo fjali nga dhjetë herë nëpër gjunjë, ndaluni te çdo fjalë me tërë peshën, hulumtojeni “kapacitetin” e saj, sepse prej atyre fjalëve të brishta dhe fjalive të dobëta duhet të ndërtohet ura që pahetueshëm kurse pagabueshëm do ta përcjell lexuesin mbi greminën e absurdit dhe pavetëdijes stihike në tokën e jetës dhe të realitetit, të cilën ju për të dhe për të gjithë njerëzit arritët ta tregoni. Hulumtojeni frazën tuaj edhe me sy edhe me veshë, lajeni gojën me të, siç bënë përdorësi i verës të cilën dëshiron ta blejë. Shqiptojeni padëgjueshëm, me gjys-

mëzëri dhe zëshëm, edhe pesë edhe dhjetë herë (mos numëroni) në disponime të ndryshme dhe në kohë të ndryshme të ditës. Mendoni për të para gjumit dhe natën kur të zgjoheni e kur t'u del gjumi. (Ç'ka më të mirë e më të mençur në çka njeriu do të mund ta përdorë pagjumësinë e vet?) Pyetuni se njerëzit e gjuhës suaj në një çast të caktuar të jetës së vet a do ta shqiptonin njëmend frazën tuaj dhe do ta pranonin si të veten. Shqiptojeni edhe në emrin e tyre dhe hulumtoni se a është besnike dhe e arsyeshme, a i mungon ndonjë gjë apo ndoshta është e stërngarkuar. Edhe kur të gjeni se çdo gjë është si duhet dhe të përcaktoni se jeni të kënaqur me punën tuaj, mos u ndalni, vetëm atëherë mosni, sepse në jetën e shkrimtarit nuk ka asgjë më të rrezikshme e më të pasigurt nga ajo kënaqësi me vetveten. Ajo është këshilltar i keq dhe udhërrëfyes i poshtër që shumë sosh i ka shpjerë në drejtim të gabuar. Mos harroni as për një çast se vepra juaj duhet që lexuesin edhe ta ngrisë edhe ta kënaqë, kurse ju jeni autor dhe se vetëm në kënaqësinë e lexuesit keni të drejtë ta kërkoni tuajën ose, edhe më mirë dhe më saktë, se me kënaqësinë tuaj fare nuk ka të bëjë. Kini parasysh se ju jeni kasnac i të vërtetës. Nëpërmjet jush realiteti njerëzor i madh e i ndërlikuar i dërgon porositë e veta. Ajo ju ka veçuar prej njerëzve tjerë me atë (dhe vetëm me atë!) ju ka besuar dërgatë të rëndësishme që njerëzve të gjuhës suaj t'ia shtroni para syve fotografinë dhe domethënien, zhvillimin dhe drejtimin e njëmendësisë së caktuar të cilën ata vetëm nëpërmjet veprës artistike në tërësi mund ta vështrojnë dhe plotësisht ta kuptojnë.¹⁹⁹

Me një fjalë, që dikush të mësojë mirë të shkruajë, ai duhet, nga një anë, të lexojë dhe t'i studiojë veprat e autorëve të dalluar, kurse nga ana tjetër, që vetë të shkruajë, të ushtrojë në të shkruar. Me lexim të kujdesshëm e studioz të autorëve të mëdhenj dhe me ushtrim në të shkruar, kanë arritur nivel të lartë të efikasitetit të stilit dhe gjuhës së vet shumë shkrimtarë të dalluar të popujve të ndryshëm dhe kohëve të ndryshme. Që këtu, ndërmjet aq shumë shembujve të shumtë, ta cekim vetëm shembullin

¹⁹⁹ I. Andrić, *Beleške za pisca*, Mladost, (Beograd), juli-avg., 1947, fq. 3-4.

e Stivensonit (Stevenson), i cili, si ka folur vetë, “ka jetuar me fjalët” dhe ka shkruar vetëm “për të ushtruar”:

Tërë kohën e fëmijërisë dhe të djalërisë sime unë kam qenë i njohur si shembull përtaci, dhe si të tillë drejt meje kanë bërë me gisht; e megjithatë, unë gjithnjë kam qenë i preokupuar me qëllimin tim vetjak: të mësoj të shkruaj. Gjithnjë në xhep kam bartur dy libra: njërin nga i cili kam lexuar, tjetrin që në të të shkruaj. Kur kam shëtitur shpirti më është preokupuar rreth asaj se si që me fjalë të përshtatshme ta shpreh atë që e kam parë; kur kam qëndruar anësh rrugës, unë ose kam lexuar, ose, me penë e me ndonjë libër të botimit të lirë në dorë, kam shënuar skenat e zeza ose përmendsh i kam mësuar disa intervale të papërkryera. Kështu kam jetuar me fjalët. Kurse ajo që atëherë e kam shkruar nuk ka qenë për përdorim të mëvonshëm. Këtë e kam shkruar vetëdijshtëm për të ushtruar.²⁰⁰

Në pajtim me këtë, maksima “Të shkruash e të studiosh, të studiosh e të shkruash” - do të mund të merret si mënyra më efikase e përkryerjes së stilit dhe të gjuhës, dhe atë duhet ta kenë përherë parasysht ata që dëshirojnë ta arrijnë synimin e sipërm.

²⁰⁰ Cituar në: E. Fr. Allen, *How to write and speak effective english* (New York, 1966), p. 34.

IX. Përpunimi teknik dhe shtypja e dorëshkrimit

A. Përpunimi teknik

Me rëndësi të madhe është edhe përpunimi teknik i dorëshkrimit, mënyra me të cilën ai është paraqitur. Ndonëse në shikim të parë kjo shumicës nuk i duket ashtu, është jokontestuese se pamja e jashtme mund t'i kontribuojë vlerës së dorëshkrimit, sikur që këtë vlerë mundet edhe ta zvogëlojë. Nganjëherë, për shkak të përpunimit të dobët teknik, dorëshkrimi me përmbajtje të çmueshme, i pasur me ide dhe konkluzione origjinale, mund të lë përshtypje të keqe. Saktë vëren Radosllav N. Horvat se dorëshkrimi është “manifestim i vlerës së veprës artistike ose shkencore.”²⁰¹ “Soliditeti i punimit shkencor, temperamentit, karakteri dhe niveli kulturor i autorit manifestohen në çdo dorëshkrim. Saktësia, qëndresa në punë dhe rregullshmëria janë kushtet kryesore të punimit solid shkencor, kurse tërë kjo manifestohet në dorëshkrim.”²⁰²

²⁰¹ Od rukopisa do knjige (Zagreb, Jugoslovenska akademija znanosti i umjetnosti, 1952), fq 15.

²⁰² Po aty - Një dijetar tjetër në këtë është edhe më kategorik: “E tillë është psikologjia e recensentit, oponentit, redaktorit, e madje edhe lexuesve mesatarë: dorëshkrimi i ndyrë, i njollosur dhe i çrregulluar, i cili nganjëherë mund të jetë edhe me pamje jo të njerëzishme, në vend, tashmë, me pamjen e vet, krijon mosdisponim ndaj vetes dhe nxitë qëndrim negativ ndaj autorit”. (Rajnborg, o. c., 119).

Nga tërë kjo rezulton se duhet kushtuar vëmendje të madhe edhe aspektit teknik të dorëshkrimit, të përgatitet dorëshkrimi mirë, ndërgjegjshëm, ashtu që çdo lexues, në vend të parë redaktori dhe radhitësi, në të lehtë mund të gjenden e të lëvizin. Dorëshkrimi i përgatitur mirë teknikisht paraqet kusht me rëndësi që ai të shtypet edhe mirë.

E tash të shohim se si duhet të duket dorëshkrimi i përgatitur në mënyrë solide.

Në rend të parë, ai duhet të jetë i gatshëm, si në tërësi ashtu edhe në hollësi, para se të fillohet të daktilografohet. Nëse kështu nuk veprohet, ekziston rreziku që punimi mos të rrumbullakohet në tërësi unike, sepse autori mund ta kundrojë veprën në totalitetin e saj vetëm atëherë kur ta mbarojë në tërësi. Nëse nuk e mbaron, mund të ndodhë të jetë i detyruar që disa pjesë t'i daktilografojë nga dy e më shumë herë, që paraqet humbje të kohës. Marrë në përgjithësi, dorëshkrimi duhet të jetë aq i plotë dhe përfundimtar që në të autori nuk ka më shumë gjë të ndërrojë, shtojë, lëshojë; ose së paku duhet mjaft pak të ndërrojë, dhe këtë, në raste të jashtëzakonshme.²⁰³ Në atë aspekt autori i sotshëm i dorëshkrimit gjendet në pozitë krejtësisht tjetër nga ajo e autorit të shekullit të kaluar, kur autorëve të mëdhenj korrekturat e shtypura u kanë shërbyer vetëm si bazë dhe pikë nisëtare për përpunime të reja të veprës. T'i përkujtojmë vetëm korrekturat e Balzakit:

Mbi tekstin e radhitur harqet shtrihen, ujëzit i lëshojnë cepat e vet në të gjitha anët, nga çdo anë burojnë vijat dhe vijëzat, që të fitohen në margjinat e gjera, ku krijohen skena

²⁰³ Vetëm në një rast lejohet "korrektura autoriale", dhe atë kur dorëshkrimi një kohë ka qëndruar, e autori, në ndërkohë, ka ardhur deri te njohjet e reja, deri te literatura e re. Por, nëse përmirësohet janë më të vëllimshme, më së miri është dorëshkrimi të tërhiqet e të përkryhet.

* Viteve të fundit ky proces i punës kryhet me kompjuter. Shumë procese kryhen më lehtë, më shpejtë dhe në mënyrë shumë më efektive. (Përkthyesi).

të reja, të futen figura të reja, kurse nga atributi një dhe i vetëm hapet horizonti për ndonjë veçori të re në karakter, i cili me këtë befas zhvillohet.²⁰⁴

Dorëshkrimi, natyrisht, është e domosdoshme të daktilografohet me makinë shkrimi*, me ndërvizë që më vonë të mund të futen përmirësimet eventuale, e edhe për shkak të lexueshmërisë më të mirë. Daktilografohet vetëm në një anë të fletës, sepse sikur kjo të bëhej në të dy faqet, mund të ndodhë që radhitësi ndonjë faqe ta kapërcejë, të harrojë ta radhisë. Në anën e majtë lihet margjinë (skaj) e zbrazët prej tre deri katër centimetra për përmirësimet eventuale më të vogla të autorit dhe gjatë kësaj kihet kujdes edhe për lidhjen e dorëshkrimit, nëse është në pyetje teza. Margjina e sipërme dhe e poshtme duhen po ashtu të jenë rreth tre centimetra, derisa margjina e djathtë duhet të jetë konsiderueshëm më e ngushtë. Në faqet ku fillon kapitulli e re lihet margjina e sipërme me madhësi 8 - 10 cm.

Me rastin e daktilografimit, fjalët ndahen njëra prej tjetrës me një distancë makine (*space*), kurse fjalitë - me dy distanca. Hapësira ndërmjet titullit të kapitullit dhe të tekstit duhet të jetë së paku tri distanca makine. Çdo paragraf i ri tërhiqet prej pesë deri tetë distanca.

Për daktilografim më e përshtatshme është letra e bardhë e makinës; jo vetëm për atë që ajo duket më bukur, por edhe për atë që në të teksti lexohet më lehtë. Ajo është me format standard (210 x 297), që të ne është standardizuar, dhe në një faqe të saj mund të kyçen përafërsisht 2600 - 2800 shenja. Sipas një faqeje lehtë mund të llogaritet edhe numri i tabakëve autorialë të dorëshkrimit;²⁰⁵ numri i faqeve shumëzohet me numrin 2600 (për-

²⁰⁴ J. Parandovski, o.c., fq. 208.

²⁰⁵ Ndërmarrjet tona botuese, siç është e njohur, paguajnë honoratin sipas tabakut autorial që ka 30.000 shenja.

katësisht 2800) dhe pjesëtohet me 30.000.²⁰⁶ Po ashtu lehtë mund të përcaktohet edhe sa faqe të ndonjë edicioni do të përfshijë dorëshkrimi: vetëm duhet llogaritur numrin e shenjave në një faqe të edicionit (të revistës, përmbledhjes, koleksionit e të ngj.), dhe këtë, ashtu që numri i shenjave në një radhë (duke llogaritur si shenjë edhe distancat ndërmjet shkronajve) do të shumëzohet me numrin e radhëve.

Më së miri është që autori vetë ta shtypë dorëshkrimin e vet, - nëse, natyrisht, di dhe ka kohë për këtë, kurse do të duhej këtë ta dijë çdo punëtor shkencor; dhe madje që në shtypje të përshtatet atë që në makinë të mund ta hartojë edhe konceptin. Në atë rast, siç dëfton përvoja, dorëshkrimi do të jetë jo vetëm më korrekt dhe më i pastër por edhe më i përkryer; me rastin e daktilografimit autori vende-vende do ta përmirësojë dhe përkryejë, sepse disa gabime dhe jonivelizime në të vetëm atëherë hetohen.²⁰⁷ Nëse, ndërkaq, dorëshkrimin e shtyp daktilografi, autori do t'i kushtojë kujdes të veçantë në dy gjëra. E para, ai duhet t'ia jep daktilografit tekstin sa më të pastër, ashtu që ky në të të mund të gjendet pa vështirësi. Në atë rast emrat e huaj dhe termat teknike është e preferueshme të shkruhen mjaft lexueshëm (më së miri me shkronja shtypi): vetëm me atë kusht daktilografi do të mund t'i lexojë dhe shkruajë drejt. Para shkruarjes autori gabimet eventuale do t'i përmirësojë drejt mbi fjalën e caktuar ose, edhe më mirë, në marginë (duke shënuar me shenjë se me cilën fjalë dhe me cilin vend ka të bëjë përmirësimi). Udhëzimet eventuale drejt-

²⁰⁶ Kđhs. R. N. Horvat, o.c., fq. 15.

²⁰⁷ Ka punëtorë të dalluar shkencorë që e kanë zotëruar teknikën e të shkruarit në makinë në atë masë që edhe konceptet e punimeve të veta i daktilografojnë. Rajnbergu, për shembull, sipas pranimit vetjak, i shkruan me dorë vetëm "vendet më të rënda ose fjalitë [...] në copën e letres dhe vetëm atëherë i futë në tekstin e pastër". (O. c., fq. 78).

tuar daktilografit, sikur edhe udhëzimet destinuar radhitësit, i shkruhen në skajin e pastër dhe rrumbullakohen. E dyta, tekstin e daktilografuar vetë autori duhet ta kontrollojë durueshëm, ndërgjegjshëm, maturisht, dhe jo vetëm një herë, sepse ai është, e jo daktilografi, përgjegjës për çdo gabim dhe lëshim eventual në daktilografim. E megjithatë, sadoqoftë me kujdes që ta daktilografojë tekstin daktilografi, dhe sadoqoftë me maturi dhe ndërgjegjshëm që ne pastaj ta kontrollojmë, numër më i vogël apo më i madh gabimesh syrit tonë do t'i ikin. Së këndejmi është e dëshirueshme që dorëshkrimin e shtypur ta lexojë edhe dikush tjetër para redaktorit dhe radhitësit.²⁰⁸

Korrigjimet dhe shtesat në tekstin e shkruar të dorëshkrimit bëhen në dy mënyra: 1) me dorë, nëse janë më pak e më të rralla, në atë mënyrë që vendi i gabuar fshihet me vijë horizontale dhe mbi të, ose në kënd të zbrazët, krahas shenjës obligative, në rregull dhe lexueshëm shkruhet fjala ose grupi i fjalëve ashtu si duhet; 2) me makinë shkrimi, nëse përmirësimet janë më të vëllimshme, dhe në atë rast në letër të veçantë, në gjerësi të faqes, shtypet vendi i përmirësuar, kurse skeda ngjitet në skajin e majtë ose në skajin e poshtëm të zbrazët. Shtesat, fragmentet e interpeluara e të ngjashme disa i shkruajnë edhe në shpinë të fletës paraprahe. Vendet e përmirësuara, të shkruara në margjinë ose në skedë të veçantë,

²⁰⁸ Ky kontrollues sigurisht do të hetojë disa gabime në daktilografim dhe, sigurisht do të vërejë edhe ndonjë lëshim tjetër, më pak apo më shumë të rëndësishëm. Me fjalë të tjera, duke punuar gjatë në veprën e vet, autori megjithëatë që gjendet në të masë të konsiderueshme jetësohet, dhe se tërë kjo i duket e thjeshtë dhe e qartë, ashtu që vetë nuk ka mundësi të hetojë ndonjë gabim material, kërcim logjik, formulim jopreciz ose jo të plotë, paqartësi. Kuptohet, edhe më e dobishme është t'i jepet dorëshkrimi i daktilografuar ndonjë ekspertit që ta lexojë e t'ia komunikojë autorit, haptazi dhe sinqerisht, por me qëllim të mirë, vërejtjet e veta kritike, të cilat autori, në atë rast, do t'i kuptojë si vërejtje e këshilla miqësore, bashkëpunim i mirëpritur, dhe t'i presë me mirënjohje.

duhet, kuptohet, qartë të shënohen me shenja të dukshme dhe të kuptueshme. Për ndërhyrjet dhe shtesat përdoren kryesisht shenjat e njëjta sikur në korrekturë, me rastin e shtypjes.²⁰⁹

Nëse përmirësimet në ndonjë faqe janë më të shumta, faqja sërish shtypet, duke pasur kujdes gjatë kësaj që radha e fundit të vijë, sipas mundësisë, deri në fund.²¹⁰ Nëse nuk arrihet deri në fund, në zbrazëtinë e radhës tërhiqet vija: _____.

Është me rëndësi të kihet vëmendje edhe në titujt, respektivisht nëntitujt e pjesëve të ndryshme të dorëshkrimit (kaptinat, pjesët, nënpjesët, etj.). Titujt e rangut të njëjtë duhet të shkruhen dhe shënohen në mënyrë të njëjtë: titulli i shkruar në mes ose në anën e majtë, me shkronja të vogla ose të mëdha, i nënvizuar me një ose me dy vija, me ngjyra, me laps të kuq ose të kaltër e të ngj.²¹¹ Lexuesit (redaktorit, radhitësit e tj.) kështu menjëherë do t'i bëhet e qartë "arkitektonika" e dorëshkrimit, d.m.th. lidhjet e ndërsjella të pjesëve të tij (nënrenditja dhe bashkërenditja). Vëmendje të veçantë duhet kushtuar anës estetike të titullit: nëse titulli është më i gjatë, është e domosdoshme të shkruhet në dy ose më shumë rreshta, në ndërvijë, dhe këtë 'në formë të piramidës së kthyer'. Teksti (ose nëntitulli) shkruhet në distancën e tretë prej titullit, etj.²¹² E gjithë kjo duhet të vijë po ashtu në shprehje në dorëshkrimin e shtypur, me anë të llojeve të ndryshme të shkronjave.

²⁰⁹ Të shihet më poshtë: IX, B, 2.

²¹⁰ Për këtë shkak, nga shkaqet praktike, disa këshillojnë që teksti të daktilografohet në fletë më të vogla, për shembull, në çerekun e tabakut të letrës.

²¹¹ Për shembull, K.L. Turabian jep, - për nëntitujt pesë rangime të ndryshme, skemën vijuese: a) titulli në mes, i nënvizuar; b) titulli në mes, i panënvizuar; c) titulli në anën e majtë, i nënvizuar; ç) titulli në anën e majtë, i panënvizuar; d) titulli paragrafik (d.m.th., titulli i tërhequr në paragraf, me pikë dhe vizë pas tij), i nënvizuar (o. c., pp. 4-5).

²¹² Kths. Turabian, o.c., fq. 66.

Arkitektonika e dorëshkrimit duhet patjetër të shihet edhe në përmbajtje. Titujt e kaptinave, sikur edhe titujt e parathënies dhe përfundimit, shkruhen me shkronja kapitale. E nëse ka edhe nëntituj, nënrenditja e tyre duhet të shënohet me tërheqjen nga e djathta, me madhësi më të vogël të shkronjave dhe me hapësirën ndërmjet radhëve. Nga ana tjetër, ndërmjet titujve të krerëve dhe ndërmjet titujve dhe nëntitujve të krerëve, duhet të ekzistojë ndërviza, derisa nëntitujt shkruhen pa ndërvizë.²¹³

Në dorëshkrimin e shkruar në makinë tërë ajo që duhet të shtypet me kursiv nënvizohet me vijë valore.²¹⁴ Këta janë titujt e librave, nëse ata sipas vëllimit janë aq të mëdhenj që të lidhen rëndom në vëllim të veçantë, edhe emërtimet e publikimeve (revistave, gazetave, përmbledhjeve), pastaj fjalët nga teksti që theksohen në mënyrë të veçantë²¹⁵ ose në mënyrë të veçantë shënohen, d.m.th., fjalët të përdorura, “si gjëra vetvetiu”,²¹⁶ fjalët e huaja që nuk janë standardizuar (për shembull, sintagma *grosso modo*) e të ngjashme. E nëse në tekstin e nënvizuar me vijë valore, d.m.th., në tekstin që duhet shtypur me kursiv, dëshirohet ndonjë fjalë të ceket veçan, ajo duhet në dorëshkrimin e shtypur me makinë veçan edhe të shënohet. Në ekzemplarin e shtypur fjala e tillë, në vend me kursiv, radhitet me shkronja të rëndomta. Sa u përket titujve të shkrimeve më të vogla, që për shkak të vëllimit të tyre tepër të vogël nuk publikohen në vëllime të veçanta, por së bashku me shkrimet tjera të ngjashme (poezitë, novelat, shqyrtimet, artikujt dhe analizat në revista dhe publikime, krijimet në prozë dhe në vargje në

²¹³ Të shihet, në kreun V, mostra nga vepra: Turabian, o. c., p. 75.

²¹⁴ Në Francë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në disa vende të tjera, fjalët që duhet radhitur me kursiv nënvizohen me vijë të rëndomtë, e jo me valore, si te ne.

²¹⁵ Shembull: Ai nuk e ka quajtur të urtë, por filozof.

²¹⁶ Shembull: O ëslhtë pashirmël!

antologji, kaptinat në libra e të ngjashme), ato botuesit anglezë dhe amerikanë i vënë në thonjëza.²¹⁷ Botuesit francezë, ndërkaq, nuk bëjnë, sipas rregullit, dallim ndërmjet titullit të veprës dhe artikullit, por të gjitha i shkruajnë me kursiv (përkatësisht i nënvizojnë në dorëshkrim). Për ne më tepër është përpunuar dhe përkryer, e në pajtim me këtë edhe është më e pranueshme, mënyra anglo-sanksone e distinguimit dhe shënimit të titujve të librave dhe të artikujve.

Citatet shtypen në makinë në dy mënyra. Citatet e shkurtra - në ndërvizë dhe futen në tekstin e autorit.²¹⁸ Gjatë kësaj shënohet, qartë e dukshme, kujt i përket citati. Citatet më të mëdha (rëndom më të gjata se katër rradhë) daktilografohen më së shpeshti jashtë tekstit të autorit, dhe këtë pa ndërvizë (e munden edhe me ndërvizë), e nganjëherë edhe tërhiqen në të djathtë, përafërsisht prej gjysmë deri një centimetër. (Kjo sidomos nëse daktilografohen me ndërvizë.) Duke e marrë parasysh

²¹⁷ Turabian i numëron hollësisht të gjitha llojet e materialit të botuar, titujt e të cilit duhet nënvizuar (përkatësisht të radhiten me kursiv) ose të vihen në thonjëza. Ja për këtë dy fragmente nga libri i tij:

Të nënvizohen duhen titujt e librave, pamfleteve, buletineve, publikimeve periodike (magazinave dhe revistave), gazetave, vjetarëve, pjesëve teatrore, filmave, simfonive dhe operave, sikur edhe këngëve, eseve, ligjëratave, fjali-meve kishtarë, materialeve të kongresit dhe raporteve kur paraqiten si publikime të veçanta. Nëse vëllimet e veçanta të ndonjë veprë kanë tituj, edhe ata tituj duhet nënvizuar, sikur edhe titullin e tërë veprës." (O. c., p. 21).

Në thonjëza duhet vënë "titujt e kërërëve dhe ndarjeve tjera të librit; nëndarjet e publikacioneve të tëra, sikur që janë artikujt në fletat periodike; esetë, këngët, ligjëratat, fjalimet kishtarë, etj., të publikuara si pjesë të tërësisë (përmbledhjes); titujt serikë të programit radio-televiziv, kompozicioneve të shkurtra muzikore; veprat e papublikuara siç janë raportet, ligjëratat, procesverbalet origjinale, tezat, të shtypura në makinë ose të shumëzuara. Por duhet pasur kujdes në atë që, nëse vepra e shumëzuar ... që publikohet si publikacion i veçantë mbanë vulën e botuesit, titulli duhet të nënvizohet". (O. c., p. 21)

²¹⁸ Në dorëshkrimin e shtypur këto citate radhiten me shkronjat e njëjta sikur edhe teksti i autorit. - Të shihet më lartë, VII a.

atë se këto citate në një mënyrë janë të dalluara, nuk është e domosdoshme të vihen nën thonjëza.²¹⁹

Në lidhje me citatet, problem të caktuar paraqet vendi i thonjzave kur ato gjenden me pikën ose presjen. Disa shtypshkronja të mëdha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga aspekti estetik, e vënë gjithnjë pikën ose presjen para mbarimit të thonjzave, pa marrë parasysh se a është kjo në pajtim me logjikën, kuptimin. Kështu, K. L. Turabian shkruan: “Pikat dhe presjet duhet vënë brenda thonjzave, madje edhe atëherë kur thonjëzat shënojnë vetëm një shkronjë ose numër”.²²⁰ Neve na duket se gjatë kësaj kuptimi dhe logjika janë më të rëndësishme se sa estetika, dhe se në pajtim me këtë në rastet e tilla duhet pasur kujdes për atë se a kërkon kuptimi që thonjëzat të vihen para apo pas pikës, respektivisht pas presjes, ose përkundrazi. Kështu në shembullin: E kam lexuar novelën e Andriqit “Elefanti i vezirit”, – pikën duhet vënë pas thonjzave: E kam lexuar ... “Elefanti i vezirit”. amerikanët do ta shkruanin këtë fjali kështu: E kam lexuar novelën e Andriqit “Elefanti i vezirit.” Mirëpo, logjika dhe kuptimi i fjalisë kërkojnë që thonjëzat të vihen pas pikës në shembullin: Ai ka shkruar: “E kam lexuar *Kronikën e Travnikut* për dy ditë.”

Të cekim në lidhje me citatet, edhe këtë se gjatë përshkrimit, sadoqoftë ai kujdeshëm i kryer, jorrallë lëshohen gabimet. Së këndejmi është mirë në ekzemplarin e daktilografuar citatet të nivelizohen me burimin. Për këtë qëllim është praktike që dorëshkrimi i daktilografuar të dërgohet në bibliotekë dhe verifikimi të bëhet në të.

²¹⁹ Në udhëzimet radhitësit dhe radaktorit teknik do të theksojmë që citatet që nuk janë futur në tekst t'i radhisë me shkrim për një apo dy shkallë më të vogla nga shkrimet me të cilat radhitet teksti tjetër (për shembull, me borgis ose petit, nëse teksti është shtypur me gammond) dhe, eventualisht, që t'i tërheqë për një apo dy cicerë.

²²⁰ O. c., p. 8.

Shënimet (më saktë, poshtëshënimet, fusnotat), si dokumentare (burimore), ashtu edhe eksplikative, daktilografohen po ashtu në dy mënyra:

E para: në fleta të veçanta, të formatit të njëjtë sikur edhe për daktilografimin e tekstit, dhe këto fleta, të shënuara me shifra romake, ose me numra arabë dhe shkronja të vogla (15a, 15b), i bashkangjiten tekstit të dorëshkrimit. Nëse dorëshkrimi është me vëllim më të madh dhe ka më shumë krerë, shënimet shkruhen më së shpejti për çdo krye dhe bashkangjiten pas saj.

E dyta, shënimet mund të daktilografohen edhe në fletëza më të vogla të letrës, të gjerësisë së njëjtë sikur edhe letra në të cilën daktilografohet teksti, dhe ato fletëza pastaj, me vërejtjet përkatëse për çdo faqe, ngjiten në fund të asaj faqeje.

Ekziston edhe një mënyrë e daktilografimit të poshtëshënimeve: nën tekstin me të cilin kanë të bëjnë, d.m.th., në fund të faqeve përkatëse. Kjo është mënyra më e mirë, sepse ajo lexuesit dhe radhitësit i mundëson që menjëherë ta gjejë shënimin, por njëkohësisht është edhe më e rënda: problemi qëndron në atë se si të përshtaten që të gjitha shënimet përkatëse dhe të vendosen në faqen gjegjëse.²²¹

²²¹ Që këtë ta lehtësojë, K.L. Turabiani për këtë qëllim porositë fletën udhëheqëse "guide sheet" veçan të përgatitur. Ajo bëhet në mënyrën vijuese: Merrret letra, me gjatësi të njëjtë sikur ajo në të cilën shkruhet teksti, por rreth 1 1/1 cm (1/2 inça) më të gjerë. Në të matet këndi i sipërm dhe i poshtëm i zbrazët sikur në tekst. Pastaj në këndin e djathtë vihen numrat (1, 2, etj.), prej vijës së parë deri te e fundit e tekstit.

"Fleta udhëheqëse" e përmendur përdoret në mënyrën vijuese: Ajo radhitet me fletat tjera (së bashku me indigë), ashtu që vihet nën fletën e fundit të kopjes dhe që këndi i djathtë të duket. Kur vihet deri te fjala e parë që i kërkohet poshtëshënimin, llogaritet sa radhë për të nevojiten. Kështu njëjtë vepron me vërejtjet tjera në atë faqe të tekstit, duke mos harruar të shtojë edhe një radhë si largesë ndërmjet shënimeve. Numri i përgjithshëm i radhëve të nevojshme për të gjitha shënimet në faqen e caktuar, dy më shumë (si distancë ndërmjet tekstit dhe shënimeve), refuzohet nga numri i përgjithshëm i radhëve. Kjo duket tepër e ndërlikuar, por kur të bëhet shprehur, pohon autori, shkon lehtë "sipas planit".

Mirëpo, gjithsesi më thjeshtë është që shënimet të shkruhen në fletë të veçanta.

Që, ndërkaq, t'i shmangemi llogaritjes së bezdisshme që kjo mënyra e fundit e tërheq, disa i daktilografojnë shënimet, sikur edhe shtojcat, në shpinën e faqes paraprake.

Nëse ndonjë shënim është tepër i gjatë, mund të përcillet edhe në faqen vijuese, dhe gjatë kësaj është e dëshirueshme që ai të ndërpritet me mbarimin e fjalisë; nëse vërejtjet janë tepër të shkurtra, në një radhë mund të shkruhen nga dy ose tri, me kusht që të dyjat, ose që të trija, të vihen në një rend, e që largësia ndërmjet tyre të jetë së paku tri shenja.

Teksti dhe poshtëshënimi ndahen me vijë të gjatë 1 1/2 - 2 centimetër, dhe këtë një distancë nën tekst, e dy distanca mbi shënim, d.m.th., shënimi fillon dy distanca nën vijë.

Radha e parë e çdo poshtëshënimi tërhiqet kryesisht po aq sa edhe paragrafi, d.m.th., 5 deri 8 distanca.

Poshtëshënimet daktilografohen pa ndërviza, kurse largesa ndërmjet tyre duhet të jetë një ndërvizë (dy distanca). Pas numrit të shënimit rëndom nuk vihet kurrfarë shenje e pikësimit te ne (por mundet, në nëntekst, të vihet edhe pika, siç bëjnë shtypshkronjat franceze), as nuk lihet distancë.

Edhe numrat e shënimeve, në tekst dhe në fund të faqes, shënohen, siç kemi parë, ose me numrat rendorë: me radhë për tërë shkrimin, nëse ky është me vëllim më të vogël, ose me radhë për disa krerë, nëse shkrimi është me vëllim më të madh. Radhitësi do t'i radhisë shënimet me shkrim diç më të imët, për një apo dy shkallë, në fund të faqeve përkatëse dhe do të shënohen me numrat e sipërm thyesorë.

Në shënime përdoren shkurtesat e rëndomta (tonat e ndërkombëtare); o. c., v. c. etj., sikur edhe shkurtesat që autori i përvetëson për titujt e disa revistave, publikimeve, institucioneve etj., që shpesh përmenden, derisa në tekst, siç kemi parë, nuk shkurtohen fjalët. (Për

shembull: SKG = Srpski književni glasnik.) Nuk ka nevojë të theksohet që shkurtesat duhet të harmonizohen gjatë tërë tekstit, sikur edhe që duhet në fillim të dorëshkrimit të jepet shpjegimi i shkurtesave.

Sa i përket “prezentimit” të bibliografisë, edhe aty janë disa veprime dhe rregulla të standardizuara, sikur që njësitë bibliografike të daktilografohen pa ndërvizë, e që ndërmjet veti të ndahen me ndërvizë; që anotacioni eventual i njërive bibliografike të shkruhet po ashtu pa ndërvizë dhe se ky anotacion për çdo njësi bibliografike të fillojë në vijën e re nën atë njësi bibliografike; që mbiemri i autorit në ndonjë mënyrë të dallohet: qoftë me zgjatje (katër deri tetë shenja makine), qoftë me daktilografimin e mbiemrit me shkronja kapitale, qoftë me të dy këto mënyra, e të ngjashme.

Përndryshe, bibliografia (literatura), me të gjitha të dhënat, ceket si është standardizuar (për çka tashmë kemi bërë fjalë, kurse për këtë do të ketë fjalë edhe pak më vonë) në fund të librit.

Nuk janë pa interes as mënyrat e ndryshme të shënimit të pjesëve të librit. Kështu, nëse vepra është me vëllim më të madh, e ka shumë pjesë, më së miri është numrat e atyre pjesëve të shkruhen me shkronja (Pjesa e parë, Pjesa e dytë) dhe atë në fletë të veçantë, së bashku me titullin e atij libri. Në atë rast, për çdo krye shkruhet fjala *kreu* dhe i shtohet numri përkatës i shkruar me numra romakë (për shembull: Kreu I, Kreu II, etj.); derisa në punimet me vëllim më të vogël fjala *kreu* mund të lëshohet dhe në vend të saj të shkruhen vetëm shifrat romake: I, II, etj., krahas titullit të kreut (për shembull: I. Udhëtarët në shekullin XVII). Disa pjesë të tekstit, përkatësisht kaptinat, mund të shënohen vetëm me numra romakë, pa titull. Nëse hyrja është më e gjatë, edhe ajo mund të shënohet si kaptinë e parë (I. Hyrja); përndryshe, hyrja nuk shënohet me numër (me numra shënohen

vetëm pjesët më të mëdha të tekstit). Pjesa hyrëse e punimit (d.m.th., parathënia dhe përmbajtja, nëse kjo vihet në fillim) shënohet me numra të vegjël romakë, dhe atë në këndin e poshtëm të faqes, derisa shënimi me numrat arabë, në këndin e sipërm të fletës, fillon pas kësaj, d.m.th., prej hyrjes.

Shënimi i faqeve me numra (paginacioni) bëhet në mbarim të punimit, kur dorëshkrimi tashmë krejtësisht është daktilografuar. Gjatë kësaj në faqen e parë rëndom nuk shkruhet numri, por shënimi bëhet duke filluar nga faqja e dytë. Nëse jepet rasti që disa faqe të futen më vonë, ato duhet të shënohen me shkronja a, b, c, etj., të cilat i shtohen numrit (për shembull: 8a, 8b, 8c), duke mos harruar të njoftohet me këtë radhitësi. Kjo më së miri është të bëhet në fund të faqes paraprake, d.m.th., në këtë rast të faqes 9. Në mënyrë të ngjashme shënohen edhe shënimet e interpoluara: 1a, 1b, 8c, etj.; por ato duhet të shmangen sa më shumë që është e mundur.

Fotografitë (dhe materiali tjetër grafik) futen në tekst, e jo në fund të librit. Gjatë kësaj, nëse dorëshkrimi nuk është destinuar për shtyp (sikur kur dorëzohet teza), duhet të ngjiten në fleta të pastra të veçanta, pasi janë shkruar paraprakisht, legjendat e fotografive në makinë. E nëse dorëshkrimi është përgatitur për shyp, edhe në libër duhet riprodhuar fotografitë dhe vizatimet (tabelat). Ato nuk ngjiten në faqet e dorëshkrimit, por krahas tij bashkangjiten me pliko. Në çdo fotografi ose vizatim duhet vënë numrin rendor, kurse numri i njëjtë shkruhet edhe në dorëshkrim, në atë faqe ku fotografinë ose vizatimin duhet vënë. Nuk guxojnë të mungojnë as përshkrimet (legjendat) e fotografive ose vizatimeve: "Pranë çdo fotografie ose vizatimi duhet ta bashkangjesim përshkrimin ose legjendën, dhe këtë në fletë të veçantë të dorëshkrimit me titull, "Legjendat krahas ilustrimeve". Krahas çdo legjende do ta shkruajmë numrin e fotografive.

Numrin e njëjtë dhe legjendën do ta shkruajmë edhe në shpinë të fotografisë ose vizatimit. Kur krahas dorëshkrimit ta shtypim edhe *résumé*-në në gjuhë të huaj, duhet edhe legjendën ta vëmë në dy gjuhë.²²²

Nuk është i parëndësishëm as vendi i fotografive dhe materialet tjera: ato duhet dhënë, brenda mundësisë, menjëherë pas përmendjes së tyre të parë, dhe këtë pas përfundimit të paragrafit në të cilën fotografia përmendet për herë të parë; por në asnjë rast ato nuk bën të futen pas dy ose më shumë faqesh.

Vepra më e vëllimshme duhet të ketë, sipas rregullit, indeksin e emrave të personave, e - nëse është e domosdoshme, - edhe indeksin e gjësendeve dhe nocioneve. Në librin e shtypur indeksi hartohet vetëm atëherë kur bëhet thyerja e librit dhe paginacioni i tij bëhet, andaj, përfundimtar. Hartimi i indeksit bëhet në mënyrën vijuese: vepra lexohet me radhë, faqe pas faqe; në skedat e letrës (fisha të vogla) shënohet çdo emër (përkatësisht, për indeksin e nocioneve, çdo fjalë më e rëndësishme) që përmendet, me numrin përkatës të faqes; emrat, atëherë, radhiten me radhën alfabetike dhe me numrat rritës të faqeve, e ato në fund, të daktilografuara, dërgohen në shtypshkronjë.²²³ Nëse ndonjë emër (ose për indeksin e nocioneve ndonjë fjalë më e rëndësishme) përmendet shumë herë, do të shënohet në mënyrë të veçantë (me

²²² R. Horvat, o. c., fq. 28.

²²³ Ja edhe se si mund të hartohet indeksi: Në tabakun e madh të letrës, në krye, horizontalisht shkruhen shkronjat me radhën alfabetike dhe secila prej tyre ndahet prej të tjerave me vijë vertikale. Ashtu sikur me rastin e leximit të dorëshkrimit të shtypur haset në ndonjë emër, ashtu ai shkruhet në rubrikën përkatëse, me numra të caktuar të faqeve në të cilat ai paraqitet. Kur teksti lexohet deri në fund dhe shkruhen të gjithë emrat që gjenden në të, prehen emrat / me faqet përkatëse të faqeve, sipas vijës vertikale dhe horizontale, dhe ato radhiten sipas rendit alfabetik dhe shkruhen në makinë. - Të cekim se kjo mënyrë është më e shpejtë dhe më e thjeshtë në rast se nuk ka tepër emra në tekst (përkatësisht faqet në të cilat ato paraqiten), ashtu që të gjitha, me numrat e faqeve, mund të vihen në një tabak letre.

kursiv, përkatësisht, në tekstin e daktilografuar, me vijë valore ose të rëndomtë, ose me yll) numri i faqes ku më gjerësisht flitet për personin ose nocionin e caktuar.

Përmbajtja daktilografohet ashtu që në të vijë në shprehje të plotë raporti ndërmjet disa pjesëve të rendit të ndryshëm: pjesës, kaptinës, kreut etj. Përmbajtja rëndom vihet në fund të veprës; por disa, që përndryshe është më e natyrshme, e vënë në fillim, rëndom pas parathënies. Përbri përmbajtjes vjen eventualisht edhe regjistri i tabelave dhe ilustrimeve.

Shkrimi me vëllim më të madh apo më të vogël nuk nënshkruhet, as në fund nuk shkruhet emri i mbiemri i autorit të shkrimit: mjafton emri e mbiemri i autorit të shkruhet në faqen ballore të veprës, respektivisht në krye të faqes së parë të artikullit, në këndin e majtë të sipërm.

Faqja ballore, që shkruhet me shkronja kapitale (me distancat e domosdoshme), nuk guxon të ngarkohet me tekst tjetër dhe me tituj të ndryshëm të autorit: ajo detyrimisht përmban emrin e mbiemrin e autorit, titullin e punimit dhe vitin, e nëse ka të bëjë me tezën, edhe emrin e fakultetit. Rrallë madje në anën e jashtme ballore shkruhet edhe shkalla shkencore e doktorit. Kjo mund të bëhet në faqen e brendshme ballore. Titujt tjerë (prof., prof, i univer. e të ngj.) mund të qiten, eventualisht, në faqen ballore të librave shkollorë dhe doracakëve universitarë.

Dorëshkrimi që jepet në shtyp nuk duhet të lidhet, sepse kështu i lehtësohet puna radhitësit, derisa teza (e doktoraturës ose magistraturës) dorëzohet obligativisht e lidhur.

Në fund, medoemos duhet të ceket se autori ndërmarrjes botuese duhet t'i dorëzojë, së bashku me dorëshkrimin e përgatitur për shtyp, edhe shënimet e veta dhe shpjegimet më të domosdoshme në lidhje me shtypjen e dorëshkrimit. Në ato shpjegime, të destinuara redaktorit teknik dhe radhitësit, autori do të japë udhëzime

të shkurtra për përdorimin e llojeve të ndryshme të shkrimeve, për mënyrën e radhitjes dhe shënimit të poshtëshënimeve, për radhitjen e titujve e të ngjashme. E pastaj, gjatë tërë kohës së shtypjes së dorëshkrimit, ai duhet të jetë në kontakt dhe të bashkëpunojë me redaktorin teknik dhe radhitësin.

Të gjitha shënimet e drejtuara radhitësit (dhe të cilat, normalisht, nuk shtypen) duhet që në mënyrë të domosdoshme të shënohen. Kjo rëndom bëhet me rrumbullakësim; kurse disa i vënë edhe në kllapë të dyfishtë të rrumbullakët: (()). Ato mund të shkruhen edhe me laps me ngjyrë të veçantë. Për shembull, e shkruajmë me laps të kaltër, ose e vëmë në kllapë (të njëfishtë ose të dyfishtë) shënimin: *Vëmendje, radhitësit! Shënimet të radhiten në fund të tekstit me të cilin kanë të bëjnë! Fjalët e nënvizuara me vijë të rëndomtë të radhiten me kursiv!*

Ka edhe disa pyetje për të cilat do të mund të kihet kujdes gjatë përpunimit teknik të dorëshkrimit, si për shembull: që titujt e krerëve duhet të shkruhen me shkronja të mëdha dhe të nënvizohen, eventualisht, me laps të kuq ose të kaltër, kurse nëntitujt, nëse ekzistojnë, daktilografohen menjëherë nën tituj, gjithnjë me të njëjtën largësi dhe nënvizohen me laps të rëndomtë ose me ngjyrë; që faqen e daktilografuar duhet lexuar derisa ende është në makinë se përndryshe, kur ajo të nxirret, çdonjëra kopje do të duhej veç e veç të përmirësohet, gjë që merr shumë kohë; që për vete të ndahet kopja e dorëshkrimit, plotësisht identike me ekzemplarën e dorëzuar; që në fund të dorëshkrimit të shkruhet fjala 'fund', e të tjera. Por këto gjëra janë vetvetiu të kuptueshme dhe në to nuk do të ndalemi. Do të dëshironim, në fund, të cekim vetëm edhe dy gjëra:

1. Para se dorëshkrimin e vet ta "lëshojë nga dora", d.m.th. para se ta dorëzojë në ndërmarrjen botuese ose redaktorit të revistës, përkatësisht sekretariatit të fakultetit

nëse ky është dorëshkrim i tezës, autori duhet mjaft kujdesshëm, në mënyrë të matur dhe ndërgjegjshëm ta lexojë shumë herë, i vetëdijshëm që në dorëshkrimin e shtypur nuk mund dhe nuk bën të fusë kurrfarë përmirësime të mëvonshme, të ashtuquajtura “korigjime autoriale”.

2. Autori nuk bën ta shpërfillë faktin që përpunimi teknik i dorëshkrimit kërkon shumë angazhim, energji e sidomos kohë. Në këtë, jorrallë, autorët, sidomos autorët e tezave, mashtrohen e, të shtrënguar me afate, e kryejnë përpunimin teknik me nguti. Pasojat e atij nxitimi janë gabimet e ndryshme, duke i kyçur edhe ato materiale, të cilat ata me më shumë kujdes dhe me më shumë kohë lehtë do t'i evitonin.

Të përmendim edhe se dorëshkrimi për shtyp nuk duhet patjetër, siç është rasti me disertacionin e doktoraturës ose magjistraturës, të jetë krejtësisht i pastër, në të mund të kryhen përmirësimet e ndryshme, plotësimet, shlyerjet e të ngjashme; natyrisht, me kusht që çdo gjë të jetë e qartë dhe e kuptueshme për radhitësin.

B. Shtypja e dorëshkrimit

Punimi shkencor konsiderohet i mbaruar kur është shtypur: vetëm pas publikimit ai bëhet i përshtatshëm për të gjithë lexuesit e interesuar, pronë e opinionit shkencor, pronë kulturore e vendit dhe pronë e përgjithshme e njerëzisë; dhe që atëherë, dhe vetëm atëherë, i është mundësuar opinionit shkencor që për punimin të sjellë vlerësimin e vet. Punimi i papublikuar, që vajton në syzen e autorit, nuk kryen kurrfarë roli. Së këndejmi edhe pikërisht duhet përmbajtur asaj parullës së Faradejit, që e kemi vënë si moto për këtë punim tonin - *To*

work, to finish, to publish - Të punosh, të përfundosh, të publikosh. Nga shkak i njëjtë është e dëshirueshme që edhe tezat, sidomos ato të doktoraturës, të shtypen, së paku pas mbrojtjes, e edhe më mirë para saj, siç është këtu rasti në disa vende.

Që vepra, - në të cilën autori bën aq përpjekje, energji, vetëmohim, - me formën e vet të bëhet manifestim besnik i përmbajtjes, autori duhet jo vetëm t'ia dorëzojë botuesit dorëshkrimin e përgatitur ndërgjegjshëm dhe me rregull por edhe ta përcjellë shtypjen e tij, që intimisht të bashkëpunojë me redaktorin teknik dhe radhitësin. Vetëm me këtë bashkëpunim të ngushtë vepra do të shtypet në mënyrën që kënaq. Përndryshe, nëse ai këtë, për çfarëdo arsye, nuk e bën, - përvoja këtë shumë herë e ka vërtetuar, - në vepër mund "të përvidhen" gabime të tmerrshme, të palejueshme.²²⁴ Së këndejmi, çdo punëtor shkencor dhe ekspert duhet t'i njohë, së paku në veprimet themelore, teknikën tipografike, parimet themelore të procesit të shtypjes së librit. Vetëm në atë mënyrë ai do të mund që me sukses të bashkëpunojë me redaktorin teknik dhe radhitësin dhe do të mundësojë që vepra t'i publikohet pa të meta serioze të shtypit. Për këtë qëllim do të duhej që ai jo vetëm ndërgjegjshëm të studiojë ndonjë doracak tipografik, çfarë ka te të gjithë popujt por edhe te ne,²²⁵ por edhe të vizitojë ndonjë

²²⁴ Më kujtohet se si në një shkrim timin për V. Hygonë radhitësi gabimisht ka radhitur, kurse korrektori ka lëshuar ta përmirësojë sintagmën gabimisht të shkruar *demi austriak* (austrijski bik), sepse është dashur të jetë *demi asturik* (asturijski bik); ose se si lektori, "për shkak të harmonizimit", në një përkthim timin nga gjuha franceze i ka ndërruar gjithkund fjalët (Vijetmin, vjetminez) me fjalët *Vjetnam, vjetnamez*. Sikur mos të kisha intervenuar me rastin e revisionit në të dy tekstet, do të duhej më vonë që të skuqem para lexuesve.

²²⁵ I rekomandojmë lexuesit të interesuar dy doracakët tanë të këtij lloji, me të cilët edhe ne jemi shërbyer gjatë të shkruarit të kësaj kapitule, dhe atë: Radoslav N. Horvat, "Od rukopisa do knjiga", Zagreb, bot. i JAZU, 1952, fq. 62 - XXXII; Nikola Pijuković, Štamparstvo u teoriji i praksi, botimi i

shtypshkronjë më të madhe dhe të njoftohet me organizimin e saj, aparaturën e saj, me funksionimin e disa shërbimeve të saj dhe me të gjitha fazat e procesit të shtypjes.

Këtu do të ndalemi shkurtimisht në disa çështje elementare në lidhje me këtë.

1. Llojet e shkrimeve dhe përdorimi i tyre

Shkronjat tipografike (të shtypit) janë me madhësi dhe lloje të ndryshme. Madhësia e tyre shprehet me pika tipografike (një pikë tipografike që paraqet njësinë për matjen e shkronjave tipografike, është 0,3759 mm), kurse instrumenti për matjen e shkronjave quhet tipometër (vegël e gjatë 30 cm dhe e ndarë në 798 pika). Sipas madhësisë, d.m.th., numrit të pikave tipometrike, ka lloje të ndryshme të shkronjave tipografike, përkatësisht shkrime. Emërtimet për ato shkronja dhe shkrime nuk janë të njëjta në të gjitha vendet prandaj ato pikërisht për këtë edhe shënohen me pika.

Për shtypjen e shkrimeve shkencore në përdorim më të shpeshtë janë shkrimet vijuese tipografike: *petit*, që është tetë pikë (emërtimi rrjedh nga fjala franceze *petit* që d.m.th., i vogël; *borgis* - nëntë pikë (rrjedh nga fjala franceze *bourgeois*, që shënon emrin e vendit: Bourgeois); *garamond* - dhjetë pikë (sipas emrit Claude Garamond, 1480-1561); *cicero* - dymbëdhjetë pikë (emërtimi rrjedh prej asaj që me këto shkronja janë shtypur shkresat e Ciceronit në shekullin XV). Shkronjat më të vogla se petiti janë: *minjon* - shtatë pikë (sipas fjalës franceze *mignon* - i dashur); *nonparel* - gjashtë pikë (sipas fjalës franceze *non-*

dytë i plotësuar dhe i përmitësuar, Beograd, Udruženje grafičkili preduzeća Jugoslavije (1956), fq. 692.

pareille = shkronja që nuk ngjason në...); *biser* (perl), *diamant* dhe *brilant* - pesë, katër dhe tri pikë (sipas fjalëve franceze: *perle*, *diamant* dhe *brillant*); ndërsa më të mëdha se ciceri janë: *i mesmi* - katërmëdhjetë pikë (emërtimi vjen prej aty që kjo shkronjë dikur, në nismat e para të mjeshtrisë tipografike, kur janë përdorur gjithsej shtatë lloje shkrimesh, ka qenë e mesmja); *tertia* - gjashtëmbëdhjetë pikë (emërtimi: nga fjala latine *tertia*, d.m.th., i treti me radhë prej së larti), *ciceri i dyfishhtë* - njëzet e katër pikë, etj.²²⁶

Gjerësia dhe lartësia e shkronjave përcaktohen me *cicer* (1 cicer është dymbëdhjetë pikë, d.m.th., 4,51 mm), e përjashtimisht me *konkordanca* (1 konkordancë - 4 cicerë, d.m.th., 48 pikë, përkatësisht 18,04 mm).

Për radhitjen e librave rëndom përdoren: për tekstin - garmond ose borgis; për nëntekst (d.m.th., për poshtëshënimet - petit dhe, më shpesh, nonparel. Cicero shërben më së shpeshti për tekstet populërizuese, d.m.th., tekstet e destinuara për lexuesin më pak të arsimuar. Për titujt e kaptinave në libra përdoren, ndërkaq, shkallët më të mëdha të shkrimit: *verzal* etj.

Për theksim kemi në disponim mënyrat e ndryshme të të shkruarit dhe llojeve të shkrimit: shpacionimi (rrallimi), kursivi, shkrimi gjysmë i yndyrshëm dhe i yndyrshëm.

Mënyra më e përshtatshme për theksim është shkrimi kursiv. Me të mund të radhiten edhe pjesët e shkurtra

²²⁶ Krls.: N. Pijuković, o.c., fq. 38-41. - Ja emërtimi për shkronjat e njëjta në disa gjuhë të tjera:

Gjuha franceze: Diamant (3 pikë), Perle (4 p.), Sedanaise (4 1/2 p.), Parisienne (5 pikë), Nonpareille (6 p.), Mignonne (7 p.), Petit-texte (7 1/2 p.), Petit-Romain (9 p.), Philosophie (10 p.), Cicero (11 p.), Saint - Augustin (12, ose 13 p.); Gros-Txte (14 p.), Gros-romain (15 ose 16 p.).

Gjuha gjermane: Brilliant (3 p.), Diamant (4 p.), Perla (5 p.), Nonpareille (6 p.), Kolonel (7 p.), Petit (8, p.), Borgis (9 p.), Karpus (10 p.), Cicelo (12 p.), Mittel (14 p.), Tertia (16. p.).

Gjuha italiane: Diamante (3), Perla (4), Parigina (5), Nonpariglia (6), Mignone (7), Testina (8), Gagliarda (9), Garamone (10), Lettute (12), Silvio (14), Testo (16).

Gjuha angleze: brilliant, diamand, pearl, ruby, nonpareil, emerald, mittion, brevier, bourgeois, long primer, small pica, pica, English, great primes, canon.

të tekstit (për shembull, një fjalë) sikur edhe pjesët më të gjata (tërë paragrafi ose parathënia).²²⁷

Shpacionimi është i përshtatshëm vetëm kur duhet theksuar një fjalë ose dy. Tekstet më të gjata, nëse janë të rralluara, lënë përshtypje të shkapërderdhjes dhe rëndë lexohen, pos asaj që nuk duken bukur.²²⁸

Me shkrim gjysmë të yndyrshëm dhe plotësisht të yndyrshëm radhiten fjalët që autori dëshiron t'i theksojë me tepër se që mund ta bëjë kursivi.²²⁹

Nëse në një faqe ka më shumë vende në tekst që duhet radhitur me kursiv, ose të shpacionuara, ose me shkrim të yndyrshëm e të ngjashme, atëherë në krye të faqes mund të tërhiqet vija përkatëse dhe pranë saj të shkruhet emërtimi i shkrimit (për shembull: — kursiv), kurse vendet e caktuara në tekst nënvizohen me vijë përkatëse (valore, të rëndomtë etj.).²³⁰

Shkrimi kapital është “shkrimi me figurat e njëjta sikur që janë shkronjat e mëdha fillestare, por me madhësinë e figurës është i barabartë me shkronjat e shkur-

²²⁷ Në dorëshkrim, këto fjalë nënvizohen, siç kemi parë, me vijë valore ose të rëndomtë te ne, përkatësisht me vijë të rëndomtë në vendet tjera, ose shënohen në mënyrë të posaçme.

²²⁸ Fjalët që radhitësi duhet t'i radhisë në mënyrë shpacionuese nënvizohen, kemi parë, me vijë të rëndomtë te ne, përkatësisht me vijë të ndërprerë në vendet tjera.

²²⁹ Në dorëshkrim, fjalët e tilla i shënojmë te ne: me një vijë të trashë ose me dy të holla (për shkrimin gjysmë të yndyrshëm) ose me vijë të kuqe (për shkrimin plotësisht të yndyrshëm). Në vendet tjera fjalët e tilla nënvizohen me vijë valore.

²³⁰ Me rastin e përgatitjes së dorëshkrimit për shtyp nuk është e domosdoshme të shënohet shkrimi me të cilin duhet të radhiten disa pjesë të tekstit: redaktori teknik dhe radhitësi këtë e kuptojnë më mirë, nga arsyeja e përvojës që e kanë, dhe ata këtë edhe do ta bëjnë. E megjithatë, duhet t'u tërhiqet vëmendja, nëse dëshirojmë që disa pjesë të tekstit të radhiten me shkrim më të vogël ose më të madh nga pjesët tjera, dhe atë me shënim të shkurtër anash, si: “shkrim i tipit më të vogël”, “madhësi më të vogël” e të ngjashme. Mirëpo, medoemos duhet shënuar ato fjalë ose pjesë të tekstit që sidomos duhet të theksohen: kursiv, shpacionim, yndyrshëm ose gjysmëyndyrshëm, kapital, shkronja më të mëdha e të ngj.

tëra të shkronjave të vogla.²³¹ Ai shërben po ashtu për theksim. Me të nganjëherë shkruhen edhe mbiemrat e autorëve (për shembull, në bibliografi, në fund të librit, në poshtëshënimet e nëntekstit, në nënshkrimet e artikujve të gazetave, në veprat teatrale - emrat e personave, e të ngj.). Sipas mendimit të disa teoricienëve tipografikë, shkrimi kapital "lë përshtypje veçanërisht të mirë e të ngrohtë."²³²

Shkronjat versale (të mëdha) përdoren për shkruarjen e titullit, shkronjës fillestare të emrave vetjakë e të tjerë që shkruhen me shkronjë të madhe fillestare, sikur edhe për shkruarjen e shkronjës fillestare të fjalës me të cilën fillon fjalia.

Të cekim tash, sa për ilustrim, tekstet e shkruara me lloje të ndryshme të shkrimit.²³³

Për shtypjen e librave përdoret radhitja garmond (dhjetë pikë). Në atë rast citatet jashtë tekstit do të radhiten me radhitje borgis (nëntë pikë), kurse poshtëshënimet - me radhitje petit (tetë pikë).

Nëse dëshirojmë që radhitja e veprës të bëhet më e ngjeshur, do ta radhisim me borgis (nëntë pikë). Në këtë rast citatet jashtë tekstit dhe pjesët tjera më pak të rëndësishme do të radhiten me petit (tetë pikë), kurse poshtëshënimet me nonparel (gjashtë pikë).

Radhitja petit është më e vogël se radhitja borgis dhe radhitja garmond.

Radhitjen nonparel e përbëjnë shkronjat e zinta [prej gjashtë pikësh].

Për theksimin e ndonjë pjese të tekstit, sidomos për titujt e veprave, rëndom përdoret kursivi.

Theksimi mund të arrihet edhe në atë mënyrë që teksti do të radhitet me shpacionim.

²³¹ N. Pijuković, o.c., fq. 67.

²³² Po aty, fq. 69.

²³³ Kths.: R. N. Horvat, o.c., fq. 42-43.

Nëse ndonjë pjesë të tekstit që është radhitur me shkrim të rëndomtë dëshirojmë ta theksojmë, mund ta radhisim po ashtu gjysmëyndyrshëm.

Emrat e autorëve, kur i citojmë në poshtëshënime, në bibliografi, e madje edhe në tekst, radhiten me shkronjat kapitale:

PIJUKOVIĆ NIKOLLA, HORVAT RADOSLLAV etj.

Mirëpo titujt e kaptinave në libra radhiten më së shpeshti me shkronja versale: ZGJEDHJA E TEMËS, HARTIMI I PUNIMIT SHKENCOR.

Për titujt dhe nëntitujt përdoren nganjëherë edhe shkronjat më të mëdha: **cicero** (dymbëdhjetë pikë), **të mesme** (katërbëdhjetë pikë), **tertia** (gjashtëmbëdhjetë pikë), **text** (njëzet pikë).

Për titujt nganjëherë përdoret edhe radhitja e yndyrshme.

Ti përmendim edhe disa lloje më të rëndësishme të a.q. *materiali i verbër*. Me këtë emërtim shënohet materiali që radhitësi e përdorë gjatë radhitjes, por ai në shtypje nuk shihet. Llojet më të rëndësishme të tij janë: *përjashtimi* (materiali i verbër me të cilin radhitësi shërbehet për përcaktimin e largësive ndërmjet fjalëve: ■ ■ ■ ■, etj.), *katërshja* (materiali i verbër për plotësimin e zbrazëtive ndërmjet radhëve: ■ ■ ■ ■ etj.); *ndërvënia* (materiali i verbër që shërben për përcaktimin e distancave ndërmjet radhëve: ■ ■ ■ ■ etj.).

Korrektura dhe shtypja

Që të evitohen gabimet e shtypit, kryhet korrektura e shkrimit të radhitur. Ajo, sipas rregullit, ka disa etapa: 1) korrektura që kryhet në tekst të radhitur në shtylla (shpallta) të gjata; 2) korrektura e radhitjes së sistematizuar në faqe, d.m.th., në radhitjen e thyer (revisioni); 3) korrektura që sërish kryhet në revisionin e përmirësuar (superevisioni). Çdo punëtor shkencor duhet vetes t'ia shtrojë rregullin: të mos lejojë që t'i botohet vepra, e as artikulli, sipas mundësisë, e që ai vetë paraprakisht nuk e ka kontrolluar dhe korrigjuar, në cilëndo prej etapave të përmendura, e më së miri me rastin e revisionit.²³⁴


Gjatë kryerjes së korrekturës së dytë, preferohet të verifikohet së pari, me të krahasuar, se a janë kryer të gjitha përmirësimet nga korrektura e parë, duke e lexuar gjatë kësaj gjithnjë tërë rreshtin në të cilin gjendet gabimi, e pastaj të kontrollohet edhe një herë tërë teksti. Në fund vijnë *imprimatur*-i dhe, eventualisht, *errata*, d.m.th.,

²³⁴ Disa shtypshkronja në Francë kanë traditë të mirë që autorit t'i japin tre ekzemplarë të revisionit prej të cilëve ky ua beson dy ekzemplarë bashkëpunëtorëve dhe miqve të vet, që secili për vete ta kryejë korrekturën, derisa të tretin e mbanë për vete dhe në të vetë e bënë korrekturën. Në fund, autori i përcjell përmirësimet e bashkëpunëtorëve të vet në ekzemplarë të vet. Në këtë mënyrë në veprën e shtypur vështirë mund të përvidhet ndonjë gabim. Nëse kësaj i shtohet edhe ajo se shtypshkronjat më të mëdha në Francë posedojnë kuadër të mirë profesional tipografik, lehtë kuptohet, përse është mjaft i vogël numri i gabimeve tipografike në publikimet e disa shtëpive botuese franceze (sikur edhe të disa të tjera të huaja).

gabimet që, krahas tërë vëmendjes, janë përvjedhur në veprën e shtypur.

Përmirësimet shkruhen në rreshtin e njëjtë, në këndin e pastër, nëse nuk ka shumë përmirësime vetëm në këndin e djathtë, nëse ka më shumë - në të dy këndet, dhe atë gabimet nga gjysma e parë (majtas e shtypit përmirësohen në këndin e majtë, derisa gabimet nga gjysma e dytë (djathtas) përmirësohen në këndin e djathtë. Por në asnjë rast nuk bën të përdoren dy shenja të njëjta për përmirësime në rreshtin e njëjtë, sepse mund të krijohet huti.

Çdo përmirësim duhet shënuar me shenjë - lexueshëm dhe qartë, si në vendin që përmirësohet ashtu edhe në kënd. Më së miri është që kjo të bëhet me laps të kuq; Në këtë mënyrë përmirësimet vërehen më mirë dhe, në të njëjtën kohë, fitohet pasqyrë më e mirë për sasinë e gabimeve. Ja shenjat më të shpeshta për përmirësime:²³⁵



(Kur ndonjë paragraf më i gjatë dëshirohet të ndërprehet dhe të fillohet i riu me fjalinë që përbën pjesën për-

²³⁵ Kthsh.: N. Pijuković, o.c., fq. 93-94.

bërëse të atij paragrafi, para kësaj fjalië vihet shenja \lrcorner ; deri sa dy paragrafë bashkohen me një me shenjën — .)²³⁶

Në mjeshtrinë tipografike janë standardizuar disa shprehje latine, që çdo autor duhet t'i njohë, sikur: *deleatur* (të "rrënohet", d.m.th., të fshihet), *imprimatur* (të shtypet), e të ngjashme. Kurse në përdorim janë edhe disa shkurtesa ndërkombëtare.²³⁷

Korrektura, duke e marrë parasysh rëndësinë e saj të madhe, duhet të kryhet në qetësi, pa nxitim, brenda mundësive në lokal të veçantë ku ekzistojnë kushte sa më të mira për përqëndrim, duke u ruajtur sidomos nga ajo shprehi, në të cilën shpesh bien autorët kur e bëjnë korrekturën, që tekstin e vet ta lexojnë përmendsh. Gjatë kësaj është e domosdoshme të posedosh doracakë të ndryshëm: drejtshkrimin, fjalorët, enciklopeditë e të ngjashme, për shkak të përmirësimeve eventuale të gabimeve materiale që do të përvidhen dhe vërehen. Që punimi të jetë i cilësisë së mirë, korrekturën nuk bën ta punojmë një kohë të gjatë pa ndërprerje. Disa janë të mendimit që korrektori, "nëse dëshiron që punën e vet ta

²³⁶ Në gjuhët tjera shumë shenja janë të njëjta sikur edhe te ne, por gjatë përdorimit të tyre aty-këtu ekzistojnë edhe abstenimet. Kështu në korrekturën angleze jepet, pos shenjës, edhe fjala e rëndomtë ose shkronja e saj fillestare, kurse disa shenja edhe dallohen. Për shembull: *stet* (le të mbetet), *lc* (lower case type = shkronjë e vogël); *sc* (small capital = shkronjë e vogël kapitale), *rom* (roman type = shkronjë romake), *rf* (wrong fount), *caps* (capital letters), etj. Në korrekturën franceze, që të shënohet në shkronjën e gabueshme, rëndom përdoren shenjat vijuese: \lrcorner \lrcorner \lrcorner \lrcorner \lrcorner etj. Ose, fjalën e nënvizuar me një vijë (—) në korrekturën franceze duhet radhitur me kursiv (*caractères italiques*); me dy vija (=) - me shkronja të vogla kapitale (*petites capitales*); me tri vija (=) - me shkronja të mëdha (*majuscules*); me vijë gjarpërore (~) - me shkronja të yndyrshme (*caractères gras*); me vijë të ndërprerë (- - - -) - në mënyrë shpacionuese (*caractères espacés*), etj.

²³⁷ Të shihet VII b, shën. 18.

kryejë saktë e ndërgjegjshëm, duhet ta ndërprejë pas dy orësh së paku një orë”.²³⁸

Sa për ilustrim po e cekim fotokopjen e një ekzemplari të korrekturës në gjuhën tonë.²³⁹

Kur është fjala për shtypjen e dorëshkrimit, duhet cekur se ekzistojnë dy lloje kryesore të makinave për radhitje: linotip (linotype) dhe monotip (monotype). Në linotip radhitet tërë rreshti, kuse monotipi e shkrinë çdo shkronjë në mënyrë të veçantë. Në rastin e dytë më lehtë arrihet saktësia më e madhe e shkrimit të shtypur: me rastin e bërjes së korrekturës, radhitësi përmirëson vetëm shkronjën gabimisht të shkrirë, derisa në linotip, duke e radhitur sërish tërë rreshtin, mund të bëjë gabime të reja.

Shtypja bëhet në tabakët e letrës të formatit dhe cilësisë së llojllojshme. Ekziston një varg i tërë lloje letrash të cilësisë më të mirë apo më të keqe, duke filluar prej të a.q. letër japoneze, deri te letra e thjeshtë (e zezë dhe e vrazhdë), në të cilën shtypen formularët e rëndomtë. Me thyerjen (lakimin) e tabakut fitohen formate të ndryshme të librave të shtypur: *folio* (2°), d.m.th. tabaku i thyer në dy gjysma: 35 cm; *kuart* (4°), d.m.th., folio i thyer në dy gjysma, respektivisht tabaku i thyer në katërsh: 25-35 cm; *oktav* (8°), d.m.th., kuarti i thyer deri 25 cm; *gjashtëmbëdhjetësgja* (16°), d.m.th., oktavi i thyer etj. Librat nga lëmi i letërsisë artistike shtypen rëndom në oktav, kurse proza shkencore në oktav diç më të madhe (oktava e madhe).

Nëse është paraparë që vepra të shtypet në ndonjë përmbledhje ose në ndonjë publikim, është e natyrshme që autori duhet t'u përshtatet veprimeve teknike të asaj

²³⁸ R. Horvat, o.c., fq. 21.




²³⁹ Shih: fq. 239-242. - Këtë shembull po e marrim nga vepra e N. Pijuković, o.c., fq. 94-95.




përmbledhjeje, përkatësisht publikimi dhe në pajtim me këtë duhet studiuar me vëmendje veprimet e tyre teknike.


Të përmendim, në fund, se parulla (*motto*) nëse ekziston, të shtypet “diç më ngushtë prej gjysmës së gjerësisë së veprës së radhitur”, rëndom me shkrim kursiv, dhe këtë në faqe të veçantë në libra, kurse nën titull ose kaptinë në artikuj.²⁴⁰

²⁴⁰ Kths.: N. Pijuković, o.c., fq. 104.

Shenjat dhe shembujt e përmirësimeve


Nëse disa fjalë ose fjali duhet ndërruar me shkrim *kursiv*, gjysmë të zi ose të zi ato fjalë ose fjali në letër në mënyrë të caktuar nënvizohen. Për shkrimin kursiv fjalët nënvizohen me vijë gjarpërore , për gjysmë të zi me vijë të drejtë , kurse të zi me dy vija të drejta . Në pjesën e bardhë tërhiqen vijat e formës së njëjtë dhe pranë tyre shkruhet me cilin lloj të shkrimit duhet ndërruar këtë.

 kursiv
 gj. i zi
 i zi




Nëse ndonjë fjalë duhet shpacionuar tërhiqet vija horizontale . Në pjesën e bardhë po ashtu tërhiqet vija horizontale, e mbi të kryqas edhe disa vijëza vertikale.

Nëse ndonjë fjalë pa nevojë është shpacionuar, ajo nënvizohet me formë harku (kllapave të shtrira), që do të thotë që shkronjat të bashkohen njëra pranë tjetrës.







Kur ndërmjet fjalëve nuk është lënë distancë, por ato janë bashkuar në një, ndërmjet shkronjave ku duhet ndarë vihet shenja  e shenja e njëjtë vihet edhe në pjesën e bardhë të letrës.



Ndërmjet fjalive të ndara me distanca shumë të vogla vihet shenja  që do të thotë që distancën duhet rritur. Shenja e njëjtë vihet edhe në pjesën e bardhë të letrës. Nëse midis fjalëve distanca është tepër e gjerë, në distancë dhe në pjesën e bardhë vihet shenja . Me shenjat  e njëjtë shënohen kur në një rresht janë joproporcionale distancat ndërmjet disa fjalëve.





Kur në rresht, për shkak të ndonjë çrregullimi disa shkronja ose të gjitha fjalët nuk janë në vijë të drejtë me të tjerat, në letrën e shkruar duhet tërhequr vijat e drejta nën dhe mbi shkronjat ose fjalët e çrregulluara. Në pjesën e bardhë të letrës tërhiqen dy vija paralele.

Në vend në dorëshkrim fjalët jolexueshëm të shkruara, radhitësi në radhitjen e rrotullon (bllokon) ose radhitë përafërsisht aq shkronjat sa hapësirë do të mund të zinte fjala e paqartë. Në letrën e shkruar kjo shënohet me , kurse në pjesën e bardhë pos vijës së formës së njëjtë lexueshëm shënohet fjala.

Nëse shkronjat me ngjyrë të stërngopur japin pamje të ndytë, në letrën e shkruar nën to vihet nga një pikë, kurse në pjesën e bardhë të letrës shenja e këtillë. [Nëse rreshti i parë në fillim të pasusit të ri nuk është tërhequr para fjalës filluese të atij pasusi vihet kjo shenjë, e po kjo edhe në pjesën e bardhë të letrës.

Nëse në distancë ndërmjet fjalëve paraqitet e paqartë, ai edhe në letrën e shkruar edhe në pjesën e bardhë shënohet me këtë shenjë.

Nëse radhitjen është dashur vazhduar në rreshtin e njëjtë pas fjalisë së mbaruar paraprake, atëherë para fjalës fillestare të asaj fjalie tërhiqet vija deri pas fjalës së fundit të rreshtit paraprak. Në pjesën e bardhë vihet shenja.

Nëse fillimi i ndonjë pasusi është tërhequr, e nuk është dashur të tërhiqet në hapësirën e tërhequr dhe në pjesën e bardhë vihet kjo shenjë. [Në kundërshtim me këtë, kur ndonjë pasus është dashur të fillohet me rresht të ri, të tërhequr, atëherë para fjalës fillestare të këtij pasusi dhe në pjesën e bardhë vëhet kjo shenjë.

Nëse ndërmjet rreshtave të radhitjes së shpacionuar nuk është vënë ndërvizë ndërmjet atyre rreshtave,

tërhiqet vija me brinjët e ndara në pjesën e bardhë në formë të këndit të mprehtë. Nëse rreshtat janë të ndarë panevojshëm, vija e njëjtë në pjesën e bardhë mbaron në formën e shigjetëzës.

Nëse korrektori gjatë leximit të korrekturave ndonjë fjalë e shënon si të ~~gabim~~, e më vonë bindet se drejt është radhitur, atëherë në letrën e shkruar nën atë fjalë vihet rreshti i pikave si shenjë që mbetet sië është radhitur, kurse në pjesën e bardhë të letrës përmirësimin gabimisht të shkruar e anulon duke e fshirë.

~~gabimisht~~

Në radhitje shkronja gabimisht e radhitur shënohet me shenjë të rëndomtë. Nëse në një rresht ka më tepër gabime të shkronjave, secili gabim shënohet me shenjë tjetërfare. Për çdo gabim të shënuar, vihet në pjesën e bardhë të letrës shenja e njëjtë, kurse pranë tij i shkruhen shkronjat me të cilat ato të gabuarat duhet të ndërrohen.

te lu

Shkronjat e dëmtuara në letër vetëm një herë nënvizohen, e në pjesën e bardhë të letrës ato shkruhen dhe po ashtu nënvizohen.

n

Në fjalë shkronja e radhitur e ndonjë tipi tjetër të shkrimit, në letër të shkruar dy herë nënvizohet, e në pjesën e bardhë të letrës ajo shkruhet dhe dy herë nënvizohet.

d
sa

Nëse në ndonjë fjalë është lëshuar ndonjë shkronjë, shkronjën paraprake ose vijuese duhet shënuar me një prej shenjave të rëndomta, e në pjesën e bardhë të letrës me shenjën e njëjtë të shkruhen shkronjat e fshira dhe ajo që në radhitje mungon.

ja lo

Kur në \checkmark është lëshuar një \checkmark , atëherë ndërmjet fjalëve, ku duhet kryer ndërhyrjen vihet shenja \checkmark , kurse në pjesën e bardhë të letrës pranë shenjës së njëjtë, lexueshëm shkruhen fjalët e lëshuara. Nëse në radhitje


vjali vjalë

është lëshuar një fjali më e madhe ose një pasus më i madh, kjo në korrekturë nuk shkruhet, por në atë vend vihet shenja ✓, kurse në pjesën e bardhë, me shenjën e njëjtë, vihet shënimi shih dorëshkrimin.


✓ shih
dorëshkrimin

Nëse në radhitje ndonjë fjalë vetëm pjesërisht ~~gabimisht~~ është radhitur, atëherë prej shkronjës së parë deri te e fundit gabimisht të radhitur shënohen me këtë shenjë ~~HHH~~, e në pjesën e bardhë krahas shenjës së njëjtë shkruhet pjesa e asaj fjale.

HHH gabimisht

Për shkronjat e pështjellura në fjalë; ose fjalët në fjali të pështjelluara, vija tërhiqet në formë të  të shtrirë që me lakimin e vet rreth atyre shkronjave ose fjalëve, qartë të tregojë se si ato duhet ndërruar vendet.

gabuar

Nëse në fjalë të gjitha shkronjat janë ~~gabuar~~, tërë fjala fshihet me shenjën , kurse në pjesën e bardhë, me shenjën e formës së njëjtë, fjala shkruhet saktë.


1, 2, 3, 4

Nëse disa fjalë të radhitura duhet radhitur tjetërfare, atëherë në letër ato numrat ² ⁴ ³ ¹ fjalë mbi reshtorë qartë shënojnë se si ato fjalë sipas radhës duhet të pasojnë! Në pjesën e bardhë të letrës shkruhen vetëm ata numra.



✓✓
✓✓

Shkronja e shkruara për ~~vija~~ ^{vija} ose gjysmë të për ~~vija~~ ^{vija} bysura shënohet me një shenjë të rëndomtë, kurse në pjesën e bardhë me atë shenjë vihet edhe shenja që d.m.th., se shkronjat e shënuara duhet vetëm të kthehen drejt.

1 ✓

Në fjalët e përbëra rrokja apo shkronja e tepërt shënohet me një shenjë të rëndomtë, ndërsa në pjesën e bardhë të letrës vihet shenja , që d.m.th. se rrokja e tillë duhet të hiqet.



Fjala ose shumë fjalë dy herë të radhitura fshihen me shenjën , kurse në pjesën e bardhë pranë asaj shenje vihet edhe shenja . Me shenjën e njëjtë shënohet edhe kur duhet tërë fjalitë ose pasuset të hiqen nga radhitja.

X. Mbrojtja e tezës

Para se të kalojmë në disa çështje në lidhje me mbrojtjen e tezës, shkurtimisht të ndalemi vetëm në çështjen e ngjashmërisë dhe dallimit ndërmjet tezës së magistraturës dhe doktoraturës. Është e njohur, me fjalë të tjera, se edhe njëri edhe tjetri disertacion janë punime të pavarura shkencore, se që të dy posedojnë (përkatësisht duhet të posedojnë), në pajtim me këtë, karakter shkencor-hulumtues, dhe se autori edhe i njërit edhe i tjetrit duhet të tregojë se zotëron me metodologjinë e hulumtimit shkencor dhe të dijë që mëvetësisht t'i përpunojë problemet nga disiplina dhe fusha e caktuar shkencore. Nga ana tjetër, ndërmejt tezës së magistraturës dhe doktoraturës ekziston dallim jo i vogël. E para ka për objekt, sipas rregullit, ndonjë problem më të ngushtë e më të lehtë, për përpunimin e së cilës nuk është i domosdoshëm hulumtimi më i gjerë, e në pajtim me këtë edhe hulumtimi edhe hartimi zgjasin më shkurtë, ndërsa edhe vëllimi është më i vogël. Teza e doktoraturës, ndërkaq, rëndom përpunon problem më serioz, më të rëndësishëm, më të rëndë, kërkon hulumtime më të gjera e më të gjata, vjen deri te rezultatet më të rëndësishme shkencore dhe duhet të jetë më shkathtësisht e komponuar dhe më diturisht e shkruar, ashtu që paraqet, në kuptim të drejtë, kontribut të rëndësishëm, origjinal shkencës. Kjo nuk do të thotë se edhe teza e magistraturës, ndonëse pakushtimisht nuk i shtrohet kjo kërkesë,

nuk mund të jetë po ashtu kontribut i rëndësishëm njohurive, shkencës. Kandidati, në pajtim me këtë, është dashur që tashmë ta ketë mësuar mjeshtrinë shkencore dhe të ketë arritur përvojë të caktuar shkencore. Së këndejmi pikërisht ligji i ri për doktoraturën edhe e vë si kusht që kandidati ta ketë magjistraturën ose punime të publikuara shkencore.

Çdo tezë patjetër, siç është e njohur, duhet që para komisionit botërisht të mbrohet. Mbrojtja publike e tezës paraqet akt solemn dhe datë me rëndësi jo vetëm në jetën e kandidatit por edhe të tërë fakultetit. Kjo mbrojtje publike të ne përbëhet prej disa etapave: 1) Leximin e të dhënave të përgjithshme për kandidatin dhe referatit që përmbanë vlerësimin e tezës; 2) ekspozenë e kandidatit për punimin në tezën; 3) mendimet, vërejtjet kritike dhe pyetjet e disa anëtarëve të komisionit për mbrojtjen e tezës dhe përgjigjet e kandidatit në ato vërejtje dhe pyetje. Shkurtimisht ta vështrojmë secilën nga këto çështje.

A. Vlerësimi i tezës

Sa i përket vlerësimin kritik (recensionit) të tezës, përkatësisht, marrë përgjithësisht, të ndonjë punimi shkencor, që duhet të sjellë vlerësimin për punimin, i thekson veçoritë pozitive dhe mangësitë e tij si dhe rëndësinë e tij, ai, sipas mendimit tonë, pos hyrjes së shkurtër dhe përfundimit të shkurtër, duhet t'i ketë edhe dy pjesë kryesore: a) përshkrimin e vetë tezës; b) vlerësimin kritik të saj.

Në hyrje, krahas të dhënave të përgjithshme për tezën (titulli, vëllimi, karakteri e të ngj.), ka nevojë të jepet shenjë edhe në atë se a është përpunuar dhe në çfarë ma-

se është përpunuar problemi i hulumtimit, sikur edhe çfarë vendi ai zë në lëmin që i përket, nga i cili është marrë.

Qëllimi i përshkrimit është që lexuesin, përkatësisht dëgjuesin, ta njoftojë me përmbajtjen e tezës, së paku në poteza kryesorë, nga arsyeja se ky nuk ka rast dhe mundësi që personalisht të njoftohet me vetë tezën, që në tërësi ta lexojë. Autori i referatit (recensori) këtë do ta arrijë më së lehti nëse më pak apo më shumë hollësisht e përshkruan, e përfolë, i rezymon disa pjesë të tezës me radhë, si janë shtruar ato në dorëshkrim: hyrja, përpunimi, përfundimi, bibliografia, etj. Në këtë pjesë të referatit pra, kryesisht do të dominojnë përshkrimi dhe predikimi, që nuk do të thotë, natyrisht, se edhe këtu nuk ka vend për diskutim, kritikë, vlerësim e të ngjashme.

Shumë më me rëndësi është pjesa e dytë e referatit, që përmbanë vështrimin kritik, vlerësimin e tezës në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.²⁴¹ Ky vështrim kritik (vlerësimi, recension) duhet t'i përfshijë të gjitha pyetjet më thelbësore të tezës, me vëmendje të veçantë në veçoritë pozitive dhe mangësitë e saj. Vlerësimi kritik i tezës, - d.m.th., elementeve të cilave duhet t'u qasemi në mënyrë kritike, - varet, natyrisht, si prej karakterit të vetë tezës dhe autorit të saj, ashtu edhe prej natyrës dhe ngjashmërisë së vetë recensentit. E megjithatë, edhe këtu, duke i përgjithësuar, mund të veçohen disa pyetje më thelbësore, që recensenti duhet t'i marrë parasysh, që t'i shqyrtojë, ndriçojë, nëse dëshiron të sjellë aq-sa gjykim të plotë e objektiv mbi tezën. Siç mund të hetohet nga ekspozenë i mëherëshëm, ato pyetje mund të shpjerren kryesisht në vijuesen:

Karakteri i temës. - Në recension duhet të vështrojmë, në pika kryesore, çështjen se sa me fat është zgjedhur tema; cili është qëllimi i saj; në çfarë mase ajo është e për-

²⁴¹ Ato dy vepra, kuptohet, mund të bashkohen (sikur që disa edhe bëjnë): duke e njoftuar lexuesin me përmbajtjen e disa pjesëve të tezës, në të njëjtën kohë jepet edhe vlerësimi kritik i atyre pjesëve.

shtatshme dhe hulumtuese; sa është bashkëkohore, interesante, e rëndësishme, origjinale, e re, e pahulumtuar ose jo mjaft e hulumtuar; e rëndë (komplekse) ose e lehtë; sipas vëllimit mirë e matur (as shumë e ngushtë as shumë e gjerë); pastaj, sa është afiniteti i kandidatit ndaj temës; sa është kuptuar ajo; si dhe sa është përgjigjur në të, d.m.th., në çfarë mase është sendërtuar qëllimi që kandidati ia ka shtruar vetes, etj.

Vëllimi dhe cilësia e lëndës. - Si një nga elementet më të rëndësishme që hyjnë në përbërjen e tezës është lënda, nga e cila ajo, në realitet, edhe është përbërë. Së këndejmi është e domosdoshme të qasemi në referat në atë lëndë - vëllimi i saj dhe cilësia e saj. Sa i përket vëllimit, aty, në rend të parë, shtrohet pyetja se a është gjetur e tubuar tërë lënda që është e domosdoshme për përpunimin solid të temës, përkatësisht a janë shfrytëzuar e vjelur të gjitha burimet e domosdoshme (duke e kyçur edhe literaturën) ndërgjegjshëm. Cilësia e lëndës, pos tjerash, varet më së shumti nga ajo se cilat burime kandidati i ka shfrytëzuar: burimet parësore (në pajtim me llojin dhe natyrën e tezës), që sjellin, sipas rregullit, lëndë të panjohur, të re; ose dytësore, e madje edhe të dorës së tretë, që rëndom ofrojnë vetëm lëndën e njohur, shpesh edhe të përtypur. Sepse, siç është e njohur, nga cilësia e lëndës dhe nga eksploatimi i burimeve varet, në masë të konsiderueshme, originaliteti i tezës.

Nuk është më me pak rëndësi as pyetja se si autori i tezës ka zotëruar me lëndën e tubuar, si e ka asimiluar, sikur as ajo se si ai atë lëndë e ka përpunuar, analizuar dhe interpretuar. Nga interpretimi i autorit dhe nga qëndrimi i tij kritik ndaj lëndës së tubuar varet, në vijën skajore, cilësia e gjykimit dhe përfundimit të tij, e në pajtim me këtë edhe cilësia e vetë tezës.

Metoda shkencore. - Në recension është e domosdoshme të vështrohet edhe në metodën që autori e ka apliku-

ar në hulumtimin e vet dhe përpunimin e temës: në çfarë mase kjo metodë është e qëlluar për natyrën dhe karakterin e problemit; sa elemente risie ka ajo dhe në çka konsiston ajo, apo edhe kjo metodë është e vjetëruar; a janë aplikuar edhe disa veprime teknike dhe mjete të reja, deri atëherë të panjohura (vegla, aparate, e të ngjashme). E të tjera.

Organizimi dhe sistemimi i lëndës. - Në këtë pjesë të recensionit duhet dhënë mendimin për planin (kompozicionin) e tezës: a është plani i qartë dhe i kuptueshëm, ose i paqartë e konfuz; a janë idetë dhe faktet në mënyrë solide ndër veti të lidhura dhe a rrjedh ekspozeu natyrisht, sipas ndonjë rendi logjik, ose në të ka jorrafshira, “kërcime” logjike e të ngjashme; a është përfillë përpjesëtimi i disa pjesëve të tezës, në pajtim me rëndësinë e materies që ato pjesë e trajtojnë; a shquhet teza me reliefitet, etj.

Rezultatet e hulumtimit. - Kjo pjesë e vlerësimit përfshin vështrimin në rezultatet e arritura gjatë hulumtimeve. Duhet përcaktuar se a ka sjellë hulumtimi deri te rezultatet meritore shkencore për vëmendje (njohuri dhe qëndrime të reja, përgjithësime të reja, ligje, norma) dhe çfarë janë ato rezultate. Me fjalë të tjera, duhet dëftuar në atë se në çfarë mase teza e hartuar paraqet kontribut të çmueshëm në lëmin e caktuar shkencor dhe të shkencës.

Fizjonomia e tezës. - Ky aspekt i vlerësimit përmban pyetjet siç janë: a ka teza e prezentuar karakterin dhe pjesët e domosdoshme të një teze, duke filluar nga parathënia e hyrja deri te përfundimi dhe indeksi, dhe çfarë është kualiteti i secilës nga ato pjesë; si janë zhvilluar në to faktet dhe idetë e të ngjashme.

Mbështetja dokumentare. - Në lidhje me këtë ka nevojë të sillen mendimi dhe gjykimi: për zgjedhjen, vlefshmërinë dhe saktësinë e citateve; për cilësinë e poshtëshënimeve; për bibliografinë e bashkangjitur (për qartësinë dhe përpikshmërinë e saj, për saktësinë dhe plotninë e

saj, etj.); për sigurinë e të dhënave të ndryshme dhe saktësinë e pohimeve të ndryshme, e të ngjashme.

Efikasiteti stilistik dhe korrektësia gramatikore. - Në recension është e domosdoshme të vështrohet në mënyrë kritike edhe në stilin e tezës, mënyrën e komunikimit të fakteve, vrojtimeve, mendimeve. Në lidhje me këtë, duhet vlerësuar edhe për atë se a posedon punimi i autorit veçoritë e domosdoshme stilistike e gjuhësore, që janë karakteristike për prozën shkencore: qartësinë, saktësinë, thjeshtësinë, natyrshmërinë. Nga këto veçori, sipas mendimit tonë, më të rëndësishme janë vijueset:

1) Struktura e pjesëve më të mëdha dhe më të vogla (pjesëve, kaptinave, paragrafeve, fjalive); a shquhet çdo pjesë dhe kaptinë me unitet, d.m.th., a e posedojnë temën unike që shkallërisht zhvillohet, ose faktet dhe idetë në të janë hedhur pa rend; a posedon çdo paragraf idenë e përcaktuar qartë të shprehur (temën) dhe a i kontribuon çdo fjali zhvillimit, përparimit të asaj ideje (teme), a është konstruktuar çdo fjali mirë dhe korrekt; çfarë janë kalimet ndërmjet disa pjesëve, kaptinave, paragrafëve, fjalive, etj.

2) Zgjedhja e fjalëve: a është përdorur çdo fjalë në mënyrë të përshtatshme dhe të qëlluar; a është ajo e qartë dhe e saktë; a ka në punim fjalë që janë në modë; a ka fjalë të tepërta, d.m.th., të atilla që nuk i shtojnë asgjë domethënies paraprake dhe jehojnë bosh; a janë të drejta format e disa fjalëve; a është e qartë se me cilat fjalë kanë të bëjnë përemrat (vetorë, lidhorë); a janë figurat e përdorura të ndryshme dhe a i kontribuojnë të shprehurit më të gjallë e më të relievshëm të mendimeve, ose ato janë qëllim vetvetiu dhe të panatyrshme, ndoshta edhe groteske, e të ngjashme; a ka shprehje familjare, provincializma, vullgarizma e të ngjashme.

3) TONI: a i është përshtatur toni lëndës, lexuesit, vendit (akademik ose familjar, i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë ose i artificializuar, përplot zvarritje); a është toni i

matur ose i rritur, i entuziazmuar, i tepruar, me përdorimin pak a shumë të shpeshtë të shprehjeve siç janë: fantastik, i shkëlqyeshëm, i jashtëzakonshëm e të ngjashme.

4) Drejtshkrimi: a janë aplikuar konsekuentësisht në punim të gjitha rregullat e drejtshkrimit që janë në përdorim (në aspekt të shkronjave të mëdha e të vogla, të ndryshimit të disa zërave, shenjave të pikësimit etj).

Ana teknike e dorëshkrimit. - Edhe kjo pikë përfshin po ashtu një sërë pyetjesh të ndryshme, duke filluar nga aplikimi i përpiktë i sistemit të caktuar të përvetësuar dhe veprimeve teknike në shënimin dhe daktilografimin e tekstit, titullit dhe nëntitullit, citatit, poshtëshënimeve, njërive bibliografike e të ngjashme, deri te përmirësimi i kujdesshëm, i ndërgjegjshëm i gabimeve të ndryshme në daktilografim.

Përfundimi. - Në pjesën përfundimtare të recensionit është e nevojshme ta vështrojmë tezën si tërësi, të përkujtohet në cilësitë dhe lëshimet e saj, dhe, veçanërisht, në rezultatet deri te të cilat ka ardhur kandidati në bazë të hulumtimeve të veta, në rëndësinë e tezës, d.m.th., të thuhet a paraqet teza kontribut të çmueshëm dhe origjinal për shkencën ose lëminë e caktuar shkencore.

Siç shihet, ne kemi cekur, me njëfarë rendi, një varg pyetjesh për të cilat kemi konsideruar se meritojnë vëmendjen e recensentit gjatë vlerësimit të tezës. E megjithatë, kjo në asnjë rast nuk do të thotë që, me rastin e vlerësimit të ndonjë teze të magistraturës ose të doktoraturës, duhet vetëm dhe gjithnjë të vështrojmë në pyetjet e cekura, e as, edhe më pak, se këtë duhet bërë me rendin e sipërm. A do t'i kushtojë dikush kujdes më të vogël apo më të madh, ose nuk do t'i kushtojë kurrfarë kujdesi ndonjëherë prej pyetjeve të sipërme dhe cilat do të jenë ato pyetje si dhe me çfarë rendi ato do të shqyrtohen – i gjithë kjo varet nga rasti i caktuar konkret dhe botëkuptimi i vetë recensentit.

B. Ekspozeu i kandidatit

Ekspozeu i kandidatit duhet të paraqesë tërësinë e rrumbullakuar. Kjo do të thotë, kandidati, në afatin kohor që e ka në disponim (rreth tridhjetë minuta) duhet shkurtimisht t'i ekspozojë, t'i ndriçojë e arsyetojë qëndrimet themelore të tezës së vet, të japë pasqyrë të qartë për tërë punën e vet të publikuar: për qëllimin dhe vëllimin e hulumtimeve të veta; për veprimet metodologjike që në hulumtime i ka aplikuar; për rezultatet deri te të cilat në bazë të tyre ka ardhur. Gjatë kësaj ai duhet ta kapë problemin në thelb, duke mos hyrë në hollësi dhe duke mos theksuar të dhëna të parëndësishme. Kandidati sidomos duhet t'i kushtojë kujdes proporcionit të pjesëve të ekspozeut të vet, - që mos të ndodhë, sikur që nganjëherë ndodh, që hyrja të jetë tepër e gjatë, në dëm të përpunimit të problemit, ose që përfundimi të lëshohet, e të ngjashme; në lidhshmërinë e ideve, sepse ekspozeu duhet të rrjedhë logjikisht dhe natyrshëm; në bindshmërinë e argumenteve, saktësinë e të dhënave, mënyrën e të shprehurit. Por nuk duhet heshtur as vështirësitë eventuale që kanë dalë gjatë hartimit, sikur as mangësitë për të cilat kandidati është i vetëdijshëm.

Sa i përket vetë mënyrës së ekspozeut, ajo do të varret, në rend të parë, nga ajo se a është ekspozeu me gojë apo me shkrim: ekspozeu me gojë dallon në thelb, sipas karakterit të vet, nga hartimi me shkrim. Derisa për hartimin me shkrim është karakteristike, sipas rregullit, logjikshmëria dhe sistematizimi rigoroz, saktësia dhe konciziteti, madje edhe kur është shkruar me fjali më të ndërlikuara të përbëra, për ekspozeun gojor janë karakteristike disa veçori tjera: spontaniteti dhe elokuenca e të shprehurit, konstruktionet më të thjeshta e më të shkurt-ra të fjalëve, fjalori i të folurit e të ngj. Në ato dallime

ndërmjet fjalës së shkruar e të folur ka dhënë shenjë, pos tjerësh, edhe S. A. Rajnberg:

Kush nuk ka kujdes mbi specificitetin e të shkruarit dhe fjalës (folëse), i tilli seriozisht gabon. Punimi që është hartuar për shtyp duhet të përpunohet për ligjërim. I lexuar ashtu si është shkruar, ai rëndom duket i rëndë, i madh, i thatë dhe jo mjaft ekspresiv. Dhe e kundërta, - shpesh fjalimi i shkëlqyeshëm, që i ka entuziazmuar dëgjuesit, i ka frymëzuar dhe ka zgjuar tek ata mendimet dhe ndjenjat mundet, - i lexuar si stenogram, - ta humbë fuqinë e vet tërheqëse dhe të përngjasojë jo mjaft logjikisht i konstruktuar, jo i rrafshhtë dhe me përsëritjet e palejueshme, që në formën e shkruar duken pikërisht të paimponueshme dhe përplot mangësi tjera.²⁴²

Nëse prej kandidatit kërkohet që ekspozeu i tij të jetë me gojë, ai këtë ekspozueun e vet duhet ta përgatisë ndërgjegjshëm. Kjo nuk d.m.th., që duhet ta shkruajë në tërësi: shpesh mjafton që kandidati të vë në letër "përkujtuesin", d.m.th., planin pak a shumë të përpunuar të ligjëratës, që do t'i përfshijë idetë dhe faktet kryesore në formë të shkurtuar. E pastaj, ai duhet që të ushtrohet në ekspozim, ta mbajë një lloj "të provës gjenerale". Por edhe ekspozueun e vet të shkruar kandidati duhet ta lexojë, para mbrojtjes, dy deri tri herë: vetëm në atë rast leximi do të jetë i rrjedhshëm. Asgjë më e pakëndshme dhe e mundimshme se sa kur dikush shkrimin vetjak, fjalinë e shkruar, e lexon dobët, jokuptueshëm, joshprehimisht, duke u ndalur në çdo fjali dhe duke zënë në thua.

Pa marrë parasysh a është ekspozeu i kandidatit me gojë ose ai e lexon atë, ai duhet të kujdeset në diksionin e vet. Kjo d.m.th., se duhet mirë t'i artikulojë, drejt dhe qartë t'i shqiptojë të gjitha zërat, duke mos e përbirë asnjë prej tyre, ta përshtasë tempin e ekspozeut të vet,

²⁴² O. c., fq. 130.

ashtu që ai mos të jetë as tepër i shpejtë as tepër i ngadalshëm, që të godet me zë në fjalët, t'i intonojë si dhe sa duhet, etj. Është e njohur që nganjëherë mungesa e vetëm njërit prej këtyre elementeve, për shembull artikulli i keq, mund të japë fotografi të keqe për kandidatin, të shërbejë si dëshmi mjaft e sigurt për kulturën dhe arsimimin e tij të përgjithshëm të pamjaftueshëm.

Vetvetiu kuptohet se në të dy rastet kandidati duhet që, drejtpërdrejt para fillimit të mbrojtjes, personalisht të bindet se a janë të gjitha shënimet e tij, sikur edhe dokumentacioni tjetër i domosdoshëm, në numër dhe a janë të sistematizuara sipas radhës që ai e ka zgjedhur. Me rastin e ekspozimit nuk bën gjithnjë të shikojë vetëm në shënimet e veta, duke mos shikuar dhe duke mos hetuar asgjë tjetër dhe askend tjetër. Madje edhe kur ekspozeun e vet e lexon, duhet, herë pas here, t'i heqë sytë prej shënimeve dhe ta hedhë shikimin në auditorin dhe në komisionin: vetëm në atë mënyrë ai do të ketë mundësi që me ta ta vendosë kontaktin e domosdoshëm.

C. Vërejtjet kritike dhe pyetjet e referentëve

Anëtarët e komisionit para të cilëve teza mbrohet, duke dhënë vlerësimin kritik të punimit dhe duke treguar në veçori të tij pozitive dhe mangësitë, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë sqarime në lidhje me qëndrimet e ndryshme të kandidatit, thëniet, mendimet, pohimet. Natyrisht, pyetjet dhe vërejtjet e disa referentëve varen nga shumë faktorë dhe çdo rasti konkret, dhe ato nuk mund të përgjithësohen. E megjithatë, mund të thuhet se ato më së shpeshti kanë të bëjnë me disa probleme që janë me rëndësi më thelbësore për përpunimin e temës së

caktuar, sikur që janë, për shembull, pyetjet: a është përfshirë me hulumtime tërë problematika dhe lënda e nevojshme dhe a janë përfshirë, eventualisht, disa probleme dhe lëndë të tepërta, d.m.th., a ka dalur kandidati nga suaza e temës; a është dhe si është, studiuar dhe asimiluar tërë literatura e domosdoshme për lëndën; çfarë veprimesh metodologjike janë aplikuar për përpunimin e temës; a është i mirë përpjesëtimi i pjesëve (hapësira destinuar disa problemeve dhe disa pjesëve të tezës: hyrjes, përpunimit, përfundimit e të ngjashme); sa janë të bazuara, të vlefshme, përfundimet që janë marrë; a ka në tezë pohime e vlerësime arbitrare e kategorike, d.m.th., jo mjaft të arsyetuara, sikur edhe pasaktësi në theksimin e disa të dhënave, fakteve, citateve e të ngj.; çfarë janë poshtëshënimet dhe bibliografia (sistemi i përvetësuar i prezentimit të bibliografisë, lëshimet eventuale, të dhënat jo të sakta e të ngj.); a është sendërtuar adekuatësia e formulimeve dhe shprehjeve; korrektësia gramatikore dhe drejtshkrimore; përpunimi teknik i tezës, e kështu me radhë. Me një fjalë, këto janë pyetje për të cilat tashmë është bërë fjalë në kaptinën për vlerësimin e tezës, sikur edhe, përgjithësisht, për rrjedhën e tërë punës sonë.

Është i natyrshëm, dhe i kuptueshëm, hutimi i caktuar i disa kandidatëve para mbrojtjes dhe gjatë mbrojtjes. Shkolla e këtij hutimi varet nga temperamentit dhe emotivitetit i kandidatit. Por, sado të ketë prirje për hutim, kandidati nuk bën së tepërmi t'u lëshohet emocioneve të veta, sepse një gjë e tillë do të mundej, në masë të konsiderueshme, t'ia paralizojë punën e mendjes, asociacionin e ideve, maturinë dhe gatishmërinë që në vërejtjet dhe pyetjet e shtruar të gjejë përgjigje të drejtë, të bindshme. Kandidati duhet t'i mbrojtë idetë dhe qëndrimet që i ka shtruar në tezë, e jo heshtazi t'i pranojë vërejtjet kritike të anëtarëve të komisionit. Mbrojtja do të përbëhej herë në arsyetimin e qëndrimit që e ka ma-

rrë, herë në zhvillimin e ndonjë qëndrimi dhe mendimi nga teza, herë në shpjegimin përse diç është kyçur ose diç nuk është kyçur, e të ngj. Marrë në përgjithësi, kandidati duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin që ai, pas disa vjetëve të punës së durueshme e të ndërgjegjshme në temë, e njehë lëndën më mirë se kushdo qoftë tjetër dhe së këndejmi, ai në përgjigjet e veta nuk bën të manifestojë modestinë dhe zemërbutësinë e tepruar; por kjo njohje e lëndës, nga ana tjetër, nuk i jep as të drejtë që kundruall vërejtjeve kritike dhe kundërshtimeve me vend të referentëve të sillet jodurueshëm, apo madje egërsisht. Sikur në rastet e shumta në jetë, edhe këtu më të mira janë mesi dhe matura: të mbrohen qëndrimet dhe mendimet e veta vendosmërisht, guximshëm, por korrekt; kurse gabimet dhe lëshimet eventuale të pranohen haptazi dhe ndershëm.

XI. Doracakët

Siç është e njohur, doracakët shpesh paraqesin vep-
ra kapitale dhe fundamentale dhe janë rezultat i përpjek-
jeve të mëdha të një ekipe, më të vogël apo shumë të nu-
mërt, kombëtare apo ndërkombëtare. Së këndejmi vlera
e tyre e tejçmueshme si burim i informatave: ata përm-
bajnë pasuri të mëdha shpirtërore të popujve të qytetë-
ruar në disiplinat dhe lëmenjtë e ndryshëm shkencorë.
Saktë është thënë për ta se “përqëndrojnë në një libër in-
formata e shkapërderdhura nëpër mijëra vëllime”, dhe se
janë ‘biblioteka në miniaturë’, “çelësa që hapin dyert e
diturisë së grumbulluar gjatë shekujve”.²⁴³ Dhe, së kën-
dejmi dobia e tyre e madhe jo vetëm për shkencëtarin
dhe ekspertin, duhet pakusht t’i njohin së paku më të
rëndësishmet prej tyre nëse dëshirojnë që me sukses të
merren me punë shkencore e profesionale, por ata janë
me dobi të konsiderueshme edhe për lexuesin e rëndom-
të, që shpesh edhe nuk parandien se çfarë pasurishë
fshehen në ta dhe të çfarë ndihme ata mund të jenë në
punën dhe jetën e tij të përditshme;²⁴⁴ me kusht, naty-
risht, që për ta të dijë dhe që me ta të mundet diturisht
të shërbehet, d.m.th., të dijë se ku dhe si do të gjejë ndo-
një informatë që në rastin e caktuar i intereson.

²⁴³ Hutschins Margaret, A.S. Johnson, M.S. William, *Guide to the Use of Libraries...*, 5th. ed. rev., New York, 1936, p. 63.

²⁴⁴ Kths.: M. Hutschins, o.c., p. 63.

Menjëherë shtrohet pyetja: ç'janë në realitet doracakët, - ato libra që përmbajnë në vete, sikur edhe bibliotekat, thesar të dijes?

Doracakë (*reference books, livres de référence*) rëndom i quajmë veprat që ofrojnë një varg informatash për degën dhe lëminë e caktuar shkencore, dhe të cilat, sipas rregullit, nuk i lexojmë prej kapakut në kapak, siç veprojmë me disa libra, por iu afrohem kur dëshirojmë të vijmë deri te ndonjë informatë që në çastin e caktuar na intereson. Rolin e njëjtë mund ta luajnë, natyrisht, edhe disa vepra tjera kapitale nga fushat e ndryshme: historia politike ose kulturore, historia e artit, letërsisë etj.

Doracakët mund të jenë të llojeve të ndryshme, sikur:

Enciklopeditë. - Ato ofrojnë dituri themelore e të sistemuara për disa çështje, "sintezën e aktiviteteve njerëzore dhe të arriturat e tyre në çastin e dhënë"; por ato, krahas kësaj, shpesh japin edhe bibliografinë themelore orientuese për lëndën e caktuar.

Enciklopeditë mund të jenë: të përgjithshme dhe profesionale, universale dhe kombëtare, laike dhe religjioze, etj.

Fjalorët biografikë. - Ata paraqesin plotësimin për enciklopeditë e përgjithshme dhe shpesh janë të çmueshëm për identifikimin e disa personaliteteve më pak të njohura që enciklopeditë e përgjithshme rrallë i përmendin, e nëse edhe i përmendin, për ta ofrojnë të dhëna të pakta. Dobia e këtij lloj doracaku është edhe në atë që ata, sikur edhe doracakët enciklopedikë, sjellin rëndom, në fund të artikujve, bibliografinë themelore për personalitetin.

Disa doracakë biografikë janë të karakterit universal, d.m.th. përfshijnë jetëshkrimet e personaliteteve të popujve të ndryshëm dhe të kohëve të ndryshme; e të tjerët kufizohen në një vend, në një periudhë, në një kategori personalitetesh (artistët, shkencëtarët e të ngj.).

Para se të vendosë se cilin doracak biografik do ta konsultojë, lexuesi duhet t'i shqyrtojë disa fakte në lidhje

me personalitetin e caktuar, si: koha në të cilën ky personalitet ka jetuar, cilit komb i përket, e kështu me radhë. Ai duhet paraprakisht të vlerësojë se cili nga fjalorët biografikë mund t'i ofrojë informatat e domosdoshme për personalitetin e përmendur, duke pasur parasysh periudhën kohore që fjalori e përfshinë, vitin e tij të botimit, karakterin e fjalorit (universal apo kombëtar) etj.

Bibliografia. - Bibliografi quajmë regjistrin, fletën e veprave e shkrimeve për ndonjë autor (bibliografia autoriale) ose lëndë (bibliografia e lëndës). Secila nga këto dy kategori mund të jetë rrjedhëse (edhe pse është në rrjedhë të botimit, d.m.th., paraqitet rregullisht, në distanca të caktuara kohore), retrospektive (nëse përfshinë të gjitha shkrimet për një autor ose lëndë), e pjesërisht dhe selektive (nëse përfshinë vetëm një pjesë të shkrimit, sipas kriterëve të caktuara - kronologjik, gjeografik, kualitativ e të ngj.). Pos kësaj, bibliografite mund të jenë të përgjithshme dhe profesionale, universale dhe kombëtare. Në ta bëjnë pjesë edhe repertorët e ndryshëm bibliografikë dhe indekset e librave, revistave, gazetave; artikujt nga revista dhe gazeta; dorëshkrime, letra, dokumentet zyrtare ose jozyrtare. Instrumente të rëndësishme bibliografike paraqesin edhe katalogët (në skeda, të shtypur etj.) të bibliotekave më të mëdha, e kështu me radhë.

Fjalorët. - Fjalorët, sidomos të gjuhës amtare, janë përcjellës të rëndësishëm jetësorë të një shkencëtari dhe, përgjithësisht, të shkrimtari: ata i përdorin, çdo ditë e çdo çast, që të mësojnë ose të vërtetojnë domethënien e ndonjë shprehjeje ose sintagme frazeologjike, drejtshkrimin e ndonjë fjale, shqiptimin e saj të drejtë e të ngjashme. Sipas mendimit të disave, fjalori paraqet "doracakun kryesor në polisën hulumtuese, ose thënë më mirë, në tavolinën e tij, doracak me të cilin ai duhet të shërbehet më shpesh se që nevojitet, që të bindet se fjalët që i njeh 'shkëlqyeshëm'

nuk janë në realitet fjalë që ai i njeh shkëlqyeshëm”.²⁴⁵ Të vetëdijshtëm për ndihmën e shumëfishtë që fjalorët mund ta dëftojmë, disa autorë, - Makoli (Macaulay), Emersoni, V. Hygo e të tjerë, - nuk i kanë konsultuar vetëm që të mësojnë domethënien e ndonjë fjale të panjohur por kanë bërë traditë që t’i lexojnë në kohë të lirë, si ndonjë roman. Disa prej tyre madje për çdo vit lexonin ndonjëfarë fjalori të ri, sikur që nganjëherë njerëzit e devotshëm e kanë lexuar çdo vit Biblën ose Kur’anin.

Të cekim se është e dëshirueshme që fjalori me të cilin shërbehemi të japë shembuj: është e njohur thënia se fjalori pa shembuj në realitet është skelet i rëndomtë. (*Un dictionnaire sans exemples est un squelette.*)

Ekzistojnë fjalorë të llojeve të ndryshme: njëgjihësorë dhe dygjihësorë; fjalorë të civateve; fjalorë për shqiptim (të emrave ose fjalëve), e kështu me radhë.

Që hulumtuesit, ekspertët, lexuesit e zakonshëm me sukses të mund të shërbehën me doracakët e ndryshëm, është e domosdoshme: 1) që mirë t’i njohin; 2) që të jenë të denjë që t’i përdorin ata; 3) që ta dinë ortografinë e saktë të fjalës ose emrit që e kërkojnë në doracak.

Sa i përket kërkesës së parë, lexuesi më së shpejti do të njoftohet për doracakët me të cilët disponon një bibliotekë ose institucion, nëse ditët e para të qëndrimit të vet në të ia kushton, përveç tjerash, shëtitjes, “zbulimit” të doracakëve që biblioteka ua lë në dispozicion lexuesve. Në aspekt të kushtit të dytë, e para që lexuesi duhet ta bëjë kur duhet që të shërbehët me ndonjë doracak të ri, për të deri atëherë të panjohur, është ajo që këtë doracak ta njoftojë për së afërmi, ta studiojë duke e lexuar parathënien e tij, shpjegimet e ndryshme dhe udhëzimet për përdorimin e tij, që rëndom jepen në fillim të vëllimit të parë. Ky njoftim, madje edhe kur është, siç ndodh shpesh, i shkurtër dhe kalim-

²⁴⁵ Barzun..., o.c., p. 251.

thi, nuk do të jetë pa interes: ai paraqet, në realitet, çelës për të kuptuarit e doracakut dhe për shfrytëzimit e tij dhe ai lexuesit konsiderueshëm mund t'ia kursejë kohën. Gjatë njoftimit të dorëshkrimit, lexuesi do ta ketë vëmendjen si domos në disa fakte, sikur: cilat lloje të informatave i përmban doracak; kur është publikuar ai; kush është hartues, botues, kush janë bashkëpunëtorë dhe në çfarë mase mund të mbështetet në ta; çfarë është sistemimi i informatave në doracak; a është dhënë, përbri artikujve informativë, edhe bibliografia, etj. Më në fund, nëse nuk dëshiron që së koti ta humbi kohën, lexuesi saktë duhet ta njohë mënyrën e shkruarjes së disa fjalëve dhe emrat e personaliteteve për të cilët kërkon informata, jorrallë edhe përkatësinë e tyre kombëtare, e të ngjashme.²⁴⁶

Marrë në përgjithësi, kur është fjala për doracakët, duhet përkujtuar atë këshillën që ua ka dhënë një shkençëtar, në vitin 1922, studentëve të tij:

Studenti i mirë duhet t'i njohë ata doracakë të domosdoshëm, ai duhet t'i përdorë ata, që t'i shikojë gjatë, që të miqësohet me ta dhe që mos ta harrojë faktin që, në biblioteka sikur edhe në jetë, forma e vetme e miqësisë reale e frytdhënëse është ajo që nuk kufizohet në lidhjet formale, por është ndërtuar në kontaktin personal dhe takimet e shpeshta.²⁴⁷

²⁴⁶ Nga përkatësia kombëtare e ndonjë personaliteti varet nganjëherë se në cilën enciklopedi kombëtare ose fjalor biografik duhet ta kërkojmë informatën. E kjo nuk është gjithnjë çështje e thjeshtë: për shembull, nuk është gjithnjë lehtë të dallohen emrat e francezëve, belgëve dhe zvicëranëve ose emrat e anglezëve, amerikanëve dhe kanadezëve, e të ngjashme.

²⁴⁷ A. Morize, *Problems and Methods of literary history*, Boston, Gjou and company, 1922, p. 36.

Përfundimi

Pasi që e ekspozuam gjenezën, procesin e hartimit të një vepre shkencore, në të gjitha etapat e saj kryesore, prej zgjedhjes së temës deri te shtypja e dorëshkrimit, përkatësisht mbrojtja e tezës, do të dëshironim, në përfundim, të cekim katër momente:

1. Të gjitha etapat në procesin e krijimit dhe të hartimit të një vepre shkencore, për të cilat në këtë libër ka pasur fjalë, mund të grupohen dhe të sistemohen *grosso modo* në katër veprime, operacione themelore, me të cilat duhet të zotërojë ai që dëshiron të zotërojë me metodologjinë dhe teknikën e punës shkencore. Me fjalë të tjera, ai duhet të dijë: 1) *Të zbulojë*, d.m.th., të vijë deri te burimi nga i cili do t'i vjelë informatat relevante shkencore, duke u shërbyer gjatë kësaj me instrumente të ndryshme të punës: aparaturë, libra, bibliografi, etj. 2) *Të gjykojë e përfundojë drejt*, d.m.th., në mënyrë kritike t'u qaset fakteve e sidomos ideve që i vjelë nga dokumentet e ndryshme, sikur edhe, prej tyre dhe në bazë të tyre, të nxirren përfundime të drejta, të vlefshme; 3) *Ta organizojë lëndën, informatat e tubuara*, d.m.th., të sistemohen sipas ndonjë kriteriumi, sistemi, plani, rendi, kompozicioni, e të ngj.; 4) *Të prezantojë*, d.m.th., të shtrohen informatat shkencore, faktet, idetë, përfundimet e të ngjashme në formën e drejtë e efikase gjuhësore-stilistike dhe të përkryera teknikisht.

2. Nuk bën të humbet parasysh fakti se nuk ka shkrim të vlefshëm pa mendim të vlefshëm; çdo vepre,

shkrimi duhet t'i paraprijë, pak a shumë, përsiatja e gjatë dhe intensive.

3. Sugjerimet, këshillat, qëndrimet e shtruar në këtë libër nuk duhet kuptuar në mënyrë rigoroze, si çfarë dogmash të cilave duhet verbërisht t'u përmbahemi, si i dehuri gardhit, duke mos u zbrapsur prej tyre aspak, por duhet të merren si udhëheqës për aksion, punë dhe si motiv për përsiatje. Nuk duhet të entuziazmohemi me ide që në përpunimin e ndonjë problemi shkencor ekzistojnë disa receta që, kur të aplikohen, sjellin deri te rezultatet e dëshiruara, te shkrimi, vepra: përpunimi i një problemi shkencor, hartimi i një shkrimi, veprë, është punë dhe proces i ndërlikuar, i gjatë dhe i mundimshëm, detyrë e rëndë.

4. Me ndihmën e këtij dhe doracakëve tjerë, sikur edhe në bazë të leximit të kujdesshëm dhe studimit të shkrimeve dhe veprave shkencore nga ndonjë lëmi, si gjatë punës ashtu edhe në procesin e punës, secili vetë duhet të ndërtojë metoda vetjake dhe teknike të përpunimit të problemeve shkencore, të hartimit të shkrimit dhe veprës shkencore.

XII. Literatura e shfrytëzuar

1. Almack John Conrad. - *Research and Thesis writig*, Boston, Houghton Mifflin Co. (1930), XVII - 310 pp.
2. Barzun Jacques and Henry Graff. - *The Modern reseacher*. New York, Harcourt, 1957, XIII - 386 pp.
3. Braibant Charles - *Le métier d'écrivain*, Paris, ed. Corea, 1951, 429 pp.
4. Dow Earle Vilbur. - *Principles of a Note - System for Historical Studies*, New York, The Century Co; 1924, VI - 124 pp.
5. Dukmans Gommaire - *Initiation pratique au métier d'écrire. Paris et Bruxelles*, ed. Baude, 2 vol. (I: 363 pp.; II: 306 pp.).
6. Eckermann Johann Peter. - *Razgovori s Getbeom*. Izbor. Zagreb, Zora, 1950, str. 218.
7. Ehrilich Eugene and Daniel Murphy. - *Writing and researching term papers and reports*. New York; Bentam Books, 1964, VIII - 149. pp.
8. Frank Otto, - *Ratschläge für schriftliche Arbeiten, Vorträge und Veröffentlichungen*. Stuttgart, Dorotheen - Verlag, 1954, s. 136.
9. Gatner Elliot S. M. and Francesco Cordasoo. - *Research and Report writing*. New York, Barnes and Noble, 1964, 142 pp.
10. Good Carter Victor. - *The Methodology of educational Research*. New York, D. Appleton-Centuru Co, (1936), XXI - 882 pp.

11. *L'Histoire et ses Méthodes, sous la direction de Charles Samaran.* Paris, Bibliothèque de la Pléiade, 1961, 1773 pp.
12. Horvat N. Radoslav. - *Od rukopisa do knjige.* Grafičko-tehnički priručnik, Zagreb, izd. JAZU, 1952, str. 62 + XXXII kontribute.
13. Hubbell George Shelton. - *Writing term papers and reports,* New York., Barnes and Noble, 1964, 164 pp.
14. Hutchins Margaret... - *Guide to the Use of Libraries,* 5th edition revised, New York, 1936, XII – 252 pp.
15. Kunze Horst. - *Wissenschaftliches Arbeiten.* 2. durch. Aufl. Berlin, Akademie – Verlag, 1959, S. 38.
16. Lanson Gustave. - *Conseils sur l'art d'écrire.* Paris, Hachette, 1894, 250 pp.
17. Legget Glen, C. David Mead and William Charvat. - *Handbooke for writers.* New York, Prentice Hall, 1953.
18. Malclés Louise-Noëlle. - *Mannuel de Bibliographie.* Paris, Presses Universitaires de France, 1963, 328 pp.
19. Marnet Daniel. - *Comment préparer et rédiger une dissertation pour la licence és lettres.* Paris., Boivin, 1939, 125 pp.
20. Marnet Daniel. - *Cours pratique de composition français,* Pris, Larousse, 1934, 280 pp.
21. Parandovski (Parandowski) Jan. - *Albemija reči.* Nga polonishtja përktheu Svetozar Nikolić, Beograd, Kultura, 1964, str. 313.
22. Petrović, dr. Ljubomir. - *Tehnika stila. Osnovni pojmovi.* Beograd, Geca Kon, 1937, str. 189.
23. Pijuković Nikola. - *Štamparstvo u teoriji i praksi,* Botimi i dytë i plotësuar dhe i përmirësuar, Beograd, Udruženje grafičkih preduzeća Jugoslavije, sekcija za NR Srbiju, (1956), str. 692.
24. Popović Bogdan, - *Iz teorije književnosti,* Beograd, 1910, str. 198.
25. Rajnberg S. A. - *Metodika i tehnika naučnog rada.* Nga rusishtja përktheu Djordje Moskijević, Beograd, Medicinska knjiga, 1948, str. 164.

26. (С. А. Рейнберг - *Как работать над медицинскою диссертацией*. III изд. Москва, Педгиз, 1945.)

27. Sanders Chauncey. – *An introduction to research in English Literary history*, New York, The Macmillan Comp., 1952. VII + 423 pp.

28. Шевяков Лев Дмитриевич. - *Как работать над диссертацией*. 4. изд. Москва, Издательство Академий наук СССР, 1960, стр. 34.

29. Šopenhauer Artur, - *O pisanju i stilu*. Përktheu Milan Vujaklija, Beograd, Enciklopedijska biblioteka, br. 1-2, str. 175.

30. Turabian Kate L. – *A manuel for writers of term papers theses and disertation*. Chicago, The University of Chicago Press, 1958, (seventh impressions), 82 pp.

31. Unwin Stanley. – *The Truth about Publishing*, 6th ed. London, George Allen and Unwin, 1950, 352 pp.

32. Van Stenberghen Fernand. – *Directives pour la confescion d'une monographie scientifique*, 3e ed. Louvain (Publications universitaires) – Paris (Edition Beatrice Nauwelaerts), 1961, 90 pp.

33. Вольй К. Т. Ы *Организация п̄руга научно-го работничка*. Б. М.. Акад. наук УССР, 1943, стр. 158.

34. Vivian H. Charles and Bernetta M. Jackson – *English composition*, Third printing, New York, Barnes and Noble, 1963, 451 pp.

35. Wright G. G. Neill. – *Teach yuorself to study*, 2nd. Ed. London, The English University Press, 1946, 233 pp.

XIII. SHTOJCA*

A. Disa refleksione mbi procesin krijues dhe krijuesin

1.

Krijuesit e ndryshëm krijojnë në mënyra të ndryshme. Por, sipas mënyrës së krijimit, ata, grosso modo, mund të klasifikohen në dy grupe kryesore kundërshtuese. Disa e krijojnë veprën e vet pothuaj “nga një pjesë” dhe në tërësi; të tjerët këtë e bëjnë me intervale dhe në etapa. Kështu poetët apo eseistët, që i përkasin grupit të parë, pas përgatitjeve të shkurtëra apo të gjata, ‘bartjes’ së shkurtër apo të gjatë dhe pjekjes, e shkruajnë poezinë ose eseun shpejt, me një frymë dhe më vonë, në poezinë apo eseun e krijuar, kanë shumë pak të ndryshojnë; kurse ata që bëjnë pjesë në tipin e dytë të krijuesve i shkruajnë shkrimet e veta poetike dhe kritike ngadal, duke i përpunuar nga disa herë dhe duke i përsosur shkallërisht, gjatë kohë, derisa nuk e fitojnë formën e vet përfundimtare. Te të parët, vepra vërshon sikur uji nga ndonjë burar artesian; te të dytët, ajo rrjedh dhe rritet pak e ngapak, sikur ndonjë lumë i vogël që, duke pranuar shkallë-

* Duke e marrë parasysh afërsinë e lëndës dhe të problematikës së trajtuar, e kemi konsideruar të nevojshme që këtu t'i fusim dy artikuj të mi të shtypur, prej të cilëve njëri është publikuar në Odjek (1. II. 1966), kurse tjetri në Život (shator, 1965).

risht ujin nga degët e veta, rritet në lumë të madh e të gjerë. Andre Zhid, sipas pranimet vetjak, ka shkruar tërë aktin e fundit të Saulës së vet për një ditë, kurse Zhan Zhiradu me një frymë, për dy apo tri javë, ka mund të shkruajë tërë veprën e vëllimshme, në të cilën nuk ka pasur nevojë të fshijë ose të shtojë, thënë ashtu, një të vetmen fjalë. Nga ana tjetër, Gogoli e Tolstoji i kanë përpunuar e përskruar dorëshkrimet e veta nga disa herë. Mocarti ka kompozuar disa nga veprat e veta më të mira, - simfonitë, kuartetet, tërë skenat operistike - për një kohë të shkurtër, për gjithsej disa ditë, dhe ua ka dhënë menjëherë formën përfundimtare që edhe sot e kanë; kurse Bethoveni në veprat e veta (sikur edhe Zhan-Zhak Ruso me të tija) është munduar dhe ka punuar nganjëherë me vite, derisa vepra nga konceptacionet e mjegulluara dhe konturat e paqarta që i ka pasur në fillim nuk e ka pasur formën e vet të përkryer e përfundimtare që e ka sot.

Ndërmjet këtyre dy tipave të kundërt të krijuesve ekziston, kuptohet, gradacion, varg i tërë, tipash të mesëm, prej të cilëve disa janë, në një anë të gradacionit, më afër tipit të parë, kurse të tjerët, në anën tjetër, janë më afër tipit tjetër të krijuesit.

Kur vepra, ndërkaq, njëherë tashmë është krijuar, është krejtësisht irelevante se cili tip e ka krijuar dhe në cilën mënyrë e për sa kohë ajo është krijuar, - kjo pakujt i intereson: ajo që është me rëndësi dhe që çdokujt i intereson është cilësia, vlera e veprës.

2.

Vepra letrare ose shkencore bëhet e tillë, e merr atë kualifikimin e vet, vetëm atëherë kur është krijuar, shkruar. Deri në atë çast, derisa përfundimisht nuk është vënë në letër, ajo “qëndron pezull në ajër”. Edhe krijuesi

letrar apo shkencor, sadoqoftë të punojë në të e të përpiqet, nuk di se a do të “dalë” diç nga ajo dhe çka, çfarë vepër do të dalë. Sepse vepra krijohet, në vijën skajore, si rezultat i forcave dhe fuqive të vetëdijshme dhe të ndërdojshme të krijuesit, që bashkërisht veprojnë në drejtim të njëjtë ose të kundërt: përzihen, ndërdojshen, kryqohen, fërkohen. As vetëdija as ndërdojshja nuk e krijojnë vetvetiu veprën: nuk ka aso vepër, në çfarëdo mase ajo të jetë fryt i mendimit dhe vullnetit të autorit, në krijimin dhe thesarin e së cilës nuk ka pasur pjesë edhe aktiviteti i ndërdojshes.

Mirëfillësinë e këtij qëndrimi e vërteton deri diku edhe shembulli i Anri Poenkaresë. Ky matematikan i famshëm ka punuar zellshëm, mundimshëm dhe gjatë kohë, por pa rezultat dhe sukses, në zgjidhjen e një problemi të rëndë matematikor. I ngopur me të, ai e ka braktisur. Pas një kohe të caktuar, atëherë kur ai këtë më së paku e ka shpresuar (derisa ecte rrugës), mendimi menjëherë shndriti, sikur rrufeja, dhe zgjidhja është gjetur. Këtë shfaqje e ka shpjeguar shkencëtari francez me faktin se ndërdojshja ka marrë gjurmimin për zgjidhjen e problemit atë çast kur vetëdija e ka braktisur, kur tashmë kish pushuar që në këtë të punojë. Në lidhje me këtë, ai ka dëftuar edhe në rrethanat nën të cilat kjo ka mundur dhe mund të ndodhë: puna e ndërdojshes është e mundur vetëm me kusht që asaj t'i paraprijë periudha e punës së vetëdijshme.

Që më lehtë ta shpjegojë dhe në mënyrë plastike ta tregojë këtë shfaqje, Poenkare e ka krahasuar - në mënyrë të përgjithshme dhe të vrazhdë, - procesin krijues me lëvizjen dhe punën e atomeve të Epikurit. Derisa shpirti pushon, edhe atomet pushojnë, pezullojnë për muri. Faza e parë e punës së vetëdijshme i mobilizon, i heq nga muri dhe i vë në lëvizje. Kurse lëvizja e tyre nuk do të pushojë as pas pushimit të punës së vetëdijshme: ata edhe më tej do të lëvizin dhe ndërmjet veti do të vijnë

në kontakt, do të hyjnë në kombinime të ndryshme, prej të cilave disa do të jenë të lumtura, frytdhënëse. E megjithatë, thekson shkencëtari, nga kjo fazë e punës së ndër-dijshme nuk mund të priten zgjidhjet, rezultatet e gatshme: që të mund të nxirren përfundimet, të merren vendimet, dhe të rezymohen, janë të domosdoshme “disiplina, vëmendja, vullneti dhe në pajtim me këtë, puna e vetëdijshme”. Kjo do të thotë se është e domosdoshme edhe faza e re e aktivitetit të vetëdijshëm, që pason pas fazës së punës së ndër-dijshme, inspirimit.

3.

Është e vërtetë e vjetër dhe e njohur se asgjë e madhe nuk është krijuar pa zellë dhe angazhim të madh: çdo vepër e rëndësishme, mirëfilltë e frymëzuar artistike apo shkencore është fryt jo vetëm i talentit, frymëzimit, vrullit krijues, por edhe i punës intensive, i zellshmërisë së përhershme, i angazhimit të jashtëzakonshëm, “ngulmësisë së egër”. Ajo që rëndom quhet frymëzim dhe për çka romantikët kanë krijuar tërë mitin, që shpjeret, në realitet, në një lloj të vetësugjestionit dhe halucionacionit (krijuesi, sipas tyre, e përgjon “zërin” që ia dikton vepërën, është vetëm çast i luciditetit, që nganjëherë shkëlqen befasisht, - papritur dhe shkurt, - si rrezja e diellit ndërmjet reve dhe sjell me vete ndonjë ide të frytshme, mendim origjinal, zgjidhje të fatshme të ndonjë problemi. Çastet e tilla janë shfaqje mjaft e rrallë dhe paraqiten, sipas rregullit, pas fazës së punës së vetëdijshme, të përsiatjes intensive për problemin. Në këtë edhe qëndron domethënia e thellë e asaj maksime të Petar Iliq Çajkovskit se frymëzimi “lind nga puna dhe gjatë kohës së punës”.

Së këndejmi në çastet e frymëzimit nuk duhet pritur duarkryq (pritja e tillë nuk do të ishte gjë tjetër pos arsy-

etim për mospunë dhe përtaci), por duhet të krijohet dhe të nxitet: me përpjekje të vullnetshme, me kontroll të vetëdijshtëm, me punë të përhershme, të rregullt, metodike. Të vetëdijshtëm për këtë, shumë krijues të dalluar këtë edhe e kanë bërë. Për Floberin frymëzimi përbëhej në atë që të “ulet pranë tavolinës së punës çdo ditë në kohën e njëjtë”. Stendali jo pak është ankuar që ka humbur shumë vite duke e pritur frymëzimin: “Qysh në vitin 1806 nuk kam filluar të shkruaj duke pritur që në vete ta ndiej gjenium. Sikur rreth vitit 1795 të kem pasur rast që për qëllimet e mia letrare të bisedoj me ndonjë njeri të mençur dhe sikur ai të më kishte thënë: “Shkruaj çdo ditë obligativisht së paku dy orë pa marrë parasysh në gjenium”, së koti nuk do t’i humbja dhjetë vjet të jetës në pritjen e kotë të frymëzimit”. Kurse Gëte, dinakërisht dhe ‘prekshëm’, veten e ka përkujtuar se duhet ta përfundojë pjesën e dytë të Faustit: për këtë qëllim ai e ka lidhur tërë pjesën e dytë të këtij libri, në mënyrë që vazhdimisht ta ketë para syve si diç të ‘prekshme’, dhe në vendin ku është dashur të vijë pjesa e katërt, e cila ende nuk ishte, ka vënë fleta të bardha të letrës, që ajo që është e gatshme ta joshë dhe nxisë që të kryhet edhe ajo që ende duhet bërë. “Gjërat e tilla të prekshme”, - sipas fjalëve të tij, - “kanë domethënie më të madhe se sa që njeriu do të mendonte”, e për këtë arsye gjërave shpirtërore duhet dalë në ndihmë me çfarëdo shkathtësi”.

4.

Puna krijuese në masë të konsiderueshme parashtron abstenim nga jeta. Shumë artistë dhe shkencëtarë të dalluar ishin asketë të vërtetë shpirtërorë. Përveç kualiteteve tjera të veta, ata e kishin të zhvilluar në shkallë të lartë edhe shprehinë e përpjekjeve të vazhdueshme, të

punës së mundimshme, të durimit. Me këto kushte gjëja e vetme e mundur ka qenë produktiviteti i tyre i frytshëm dhe i llojlojshëm dhe pjekja e domosdoshme e fryteve të tyre. Gëte, në pleqërinë e thellë (atëherë ka pasur shtatëdhjetë e pesë vjet), është ankuar se si gjatë tërë jetës së vet “asnjë ditë as natë nuk ka pushuar, as s’është çlodhur”, por “gjithnjë ka synuar, ka kërkuar dhe ka punuar” si dhe sa ka mundur, dhe jetën e vet, jo pa arsye, e ka krahasuar me “rrokullisjen e amshueshme të gurit të cilin gjithnjë rishtazi duhej ngritur”. Dhe, që gjatë kohës së punës të mos llastrohet (të bie në “ndonjë gjendje pasive të këndshme”, si fliste vetë), në kabinetin e vet të punës nuk ka pasur as divan: ulej gjithnjë në “tavolinën e vet të vogël prej druri”, të cilës vetëm nga fundi i jetës “ia ka shtuar mbështetësen për kokë”. Kurse Plinije i Moçmi çdo çast të jetës së vet e ka shfrytëzuar për punë dhe studime: nuk e ka bërë këtë vetëm atëherë kur është larë në banjo; por posa ka dalë nga aty, dhe derisa ende e fshinin dhe e fërkonin, ka kërkuar që diç t’i lexohet ndonjë libër ose e diktonte ndonjë gjë.

5.

Çdo gjë e rëndësishme dhe e madhe krijohet, në të shumtën e rasteve, ngadalë dhe shkallërisht, sikur katedrala gotike dhe lindet me dhembje e mundime, sikur fëmijë. Duhet që njeriu vetëm ta hedhë syrin në punëtorinë e një artisti, autori, shkencëtari, e që në këtë së paku deri diku të bindet. Sukseset dhe dështimet, ngritjet dhe rëniet, mallëngjimet dhe dëshpërimet, euforitë dhe rras kapitjet, forcimi dhe dobësimi i vullnetit, ngjallja dhe rënia e interesit, lëniet e punës dhe kthimet punës, synimet drejt cakut dhe abstenimi nga caku, - të gjitha këto janë, pothuaj, përcjellëse të rregullta të një ndërmarrjeje më të

vëllimshme krijuese, tërë kjo “përmbush historinë e krijimit të çdo veprë më të madhe”.

Henri Milerit shpesh i binte ndër mend mendimi që një ditë të shkruajë një libër të madh vetëm për një paragraf të vogël, të marrë veçant dhe të gatshëm, prej njërës nga veprat e tij (sikur që vetë ka deklaruar në një tekst të vetin, që këtu po e ndjekim pothuaj fjalëpërfjalshëm): librin për zanafillën e këtij paragrafi, për gjenezën e tij, metamorfozën e tij, lindjen e tij, për kohën që kaloi ndërmjet lindjes së idesë dhe shënimit të saj, për kohën që ishte e nevojshme që asaj t’i jepet formë e shkruar [...], për idetë që autorit në ndërkohë i janë paraqitur derisa e ka shkruar paragrafin, ditën e caktuar të javës, për gjendjen e shëndetit, për tendosjen e nervave të tij, për ndërprerjet që janë krijuar, për ato që do të pasonin me vullnetin e tij vetjak dhe për ato në të cilat ai ishte i detyruar, për llojlojshmërinë e nduarnduarta të shprehjeve që i paraqiteshin gjatë procesit të shkrimit, për ndërriemet, për vendin ku e ka braktisur dorëshkrimin dhe, duke u kthyer tek ai, plotësisht e ka ndërruar rrjedhën zanafillore të mendimit, ose për vendin ku e lëshonte dorëshkrimin, me qëllim që në atë vend përsëri të kthehet dhe të vazhdojë pas kohës së caktuar. Por këtë më kurrë nuk e ka bërë, as nuk është kthyer dhe vazhduar rrjedhën zanafillore të mendimit jovetëdijshtë, pas disa librave tjerë, kur kujtimi për ato tashmë plotësisht është zhdukur.

6.

Një veçori me rëndësi dhe vlerë të madhe, të cilën çdo krijues, - artist, letrar, shkencëtar, - duhet që në vete ta kultivojë dhe në shkallë të lartë ta zhvillojë, është durimi. Kjo veçori përbëhet jo vetëm në atë që ndonjë prob-

lem me durim të përpunohet, gjithanshëm të provohet, por edhe të shtyhet publikimi i tij së paku për një kohë, që vepra të lihet që pak 'të pushojë' dhe 'të vijë'.

Në këtë veçori të domosdoshme të shkencëtarëve ka dhënë shenjë edhe Pasteri: "Të besohet se kemi gjetur ndonjë fakt të rëndësishëm shkencor, të synohet ethshëm drejt asaj që ta botojmë, kurse me ditë, javë e nganjëherë me vite të luftohet me veten, të përmbahemi dhe të përpiqemi t'i rrënojmë eksperimentet tona vetjake, dhe të publikohet zbulimi ynë vetëm atëherë kur i kemi vjelur të gjitha hipotezat kundërshtuese - pa dyshim, kjo është detyrë e madhe".

7.

Pikërisht në fillim të karrierës së vet, shkencëtari duhet të jetë i vetëdijshëm për shkurtësinë e jetës dhe kufizueshmërinë e kohës që e ka në disponim për krijim. Së këndejmi ai nuk guxon të gabojë, që nuk është aq e rrallë te hulumtuesit e zjarrtë, që vazhdimisht të hulumtojnë, kurse ta shtyjë trajtësimin dhe publikimin e rezultateve të hulumtimeve të veta; ose ta thellojë, ta zgjerojë dhe ta përkryejë një problem, një vepër, në vend që t'i hulumtojë problemet e reja e më të reja, dhe të krijojë, shkruajë, publikojë gjithnjë vepra të reja e më të reja. Shumë shkencëtarë eminentë, që nuk e përfillën këtë fakt, i ka befasuar vdekja në vazhden e hulumtimeve të veta dhe ua ka prerë fillin: si rezultat i një karriere shkencore të përmbushur me punë dhe aktivitet, shkencëtari pas vetes ka lënë disa vepra e shkrime të rëndësishme, kurse plotni shënimesh, shkrimesh, skicash, punimesh të papërfunduara.

Këshilla: Të punosh, të përfundosh, të publikosh (To work, to finish, to publish), - sikur që këtë ka herë e ka thënë Faradeji.

8.

Rrallë që ndonjë krijues nuk i është ekspozuar veprimi të forcave dhe tendencave të ndryshme të kundërta, që e tërheqin në njërin ose në anën tjetër, e shtyjnë në njërin apo në drejtimin tjetër. Por dy grupe të atyre forcave dhe tendencave janë me rëndësi të veçantë. Nga një anë krijuesi është pjesëz e organizmit shoqëror, qenie shoqërore, dhe si i tillë ai nuk guxon të tërhiqet, të ikë nga jeta, të izolohet nga shoqëria, të mbyllet në kështjellën prej eshtrave të elefantit ose të shndërrohet në “mi të madh biblioteke”, njeriu “i hapur tërësisht për të gjitha emocionet dhe përvojat njerëzore”, ai duhet të marrë pjesë në jetën shoqërore, të luftojë për zhvillimin dhe përparimin e njeriut dhe të shoqërisë. Nga ana tjetër, ai është krijues, - shkencëtar, letrar, artist, - dhe si i tillë i përket shkencës, letërsisë dhe artit, që e kërkon “njeriun komplet”, tërë qenien e tij fizike dhe shpirtërore, tërë kohën dhe jetën e tij. Si njësi shoqërore, ai është copëtuar me obligimet dhe detyrat e ndryshme të vogla ose të mëdha, që i marrin kohën e çmueshme, shpenzojnë forcën dhe energjinë, i rrënojnë nervat dhe shëndetin, krijojnë jetë të bujshme dhe gjumë jo të qetë, nxisin pasione negative dhe dëshpërime. Si krijues, ai synon nga kontemplacioni dhe meditimi, nga qetësia shpirtërore (“olimpike”), që të vetmit i mundësojnë përqëndrimin e domosdoshëm dhe orientimin e aktivitetit të shkencëtarit ose të artistit në drejtimin e caktuar, drejt ndonjë caku të saktë krijues, drejt zgjidhjes së ndonjë problemi konkret krijues. Aleate e tij e madhe dhe e rëndësishme në atë punë, në realizimin e atyre obligimeve dhe punës së krijuesit, është vetmia, “nëna e përsosurisë”, ajo “që ka vigjiluar gjatë komponimit të tercinit të *Komedisë hyjnore*”; ajo të cilës “Horacie ia ka borxh shkëlqimin e diamantit të strofës së vet, kurse Gëten e ka frymëzuar (sic!) për

pjesën e dytë të *Faustit* të vet”; ajo që e ka “shkolluar sensin e Floberit për ritmin e prozës së re franceze dhe dhomën e punës së Dikensit e ka banuar me masën e pavdekshme të figurave të njerëzve”; ajo për të cilën Mickjevići inspirativisht ka kënduar:

*Oj, vetmi! Në ty zhytem sikur në ujë,
Duke ikur nga vapa e përditshme e jetës;
Dhe kënaqem në flladin e pastër e të freskët,
Të kristaleve tua të paarritshme!*

Tërë urtësia e shkencëtarëve dhe artistëve përbëhet në atë që në ndonjë mënyrë ta pajtojnë veprimin e atyre forcave dhe tendencave të kundërta, të gjejnë, të vënë ndërmjet tyre baraspeshën: t’i plotësojnë obligimet e veta të qytetarit, duke mos u shurdhuar dhe duke mos gabuar ndaj obligimeve të krijuesit dhe t’i plotësojnë obligimet e veta të krijuesit, duke mos u shurdhuar dhe duke mos gabuar ndaj obligimeve të qytetarit.

9.

Shkencëtari i unifikon në vete dy veçori që janë kundërthënëse dhe veprojnë në drejtim të kundërt. Një është fuqia e simpatisë, aftësia e entuziazmit, mallëngjimit: kjo aftësi ia lehtëson hyrjen më të thellë e më intime në problemet që e mendojnë, dhe zgjidhjen e tyre. Veçoria tjetër është fryma kritike, që, në realitet, është fryma shkencore: kjo aftësi ia lehtëson gjykimin kritik, zbulimin e mashtrimit dhe gënjeshtërisë, zbulimin e të vërtetës, drejt të cilës synon çdo shkencë. Duke e marrë parasysh temperamentin e vet, punëtori shkencor është i talentuar shumë a pak me njërin apo me tjetrën prej këtyre veçorive; por ai duhet së paku në një masë të caktuar,

ta ketë edhe një të tjetër. Përndryshe, nëse e ka vetëm të parën, pa të dytën, do t'i mungojë kriticiziteti dhe lehtë do të bie në mashtrim, do të bëjë mëkat; e nëse e ka vetëm të dytën, pa të parën, do t'i mungon fuqia e simpatisë, aftësia e entuziazmit, dhe do të bie në hiperkriticizitet, skepticizëm, joproduktivitet.

10.

Shkencëtari sot duhet të jetë në diçka specialist: të gjitha shkencat tashmë aq janë zhvilluar, sa është e mundur të gjendet dhe t'i shtohet thesari të pasur shkencor diç e re, sado modeste të jetë ajo, vetëm me kusht që deri në hollësi të zotërohet ndonjë fushë e ngushtë shkencore dhe metodologjia e saj, që ajo të njoftohet gjerë, thellë, gjithanshëm, ashtu për afërsisht si e ka njohur, sipas fjalëve të *Viktor Hygosë, Krazimodo* kishën e Shën Mërisë në Paris.

Nga ana tjetër, krahas këtij arsimimit specialistik, ai duhet të ketë arsimim humanist dhe filozofik, kulturë të përgjithshme: në gjykimet, mendimet, qëndrimet, veprat e tij, do të vijnë në shprehje, medoemos, jo vetëm arsimimi profesional por edhe kultura e tij e përgjithshme (pasuria e tij dhe kufijt e tij), sikur edhe pikëpamjet e tij të përgjithshme për njeriun, jetën, botën.

Shkencëtari, në pajtim me këtë, nuk guxon të shtanget në profesionin e vet, që të kënaqet vetëm me njohjen e degës së vet shkencore, që të kufizohet vetëm në leximin e asaj që do të jetë me interes të drejtpërdrejtë për kryerjen e punës, mjeshtrisë: me kulturën e përgjithshme ai duhet ta pasurojë frymën e vet dhe t'i zgjerojë horizontet e veta shpirtërore. Shkurtimisht, duhet të synojë drejt asaj të dijë “*çdo gjë nga diçka dhe diç nga çdo gjë*”.

11.

Mbi komercializimin, turrin drejt parasë, “banakizimin” e punëtorëve shkencorë do të mund të thuhet, kryesisht, po ajo që Jan Parandovski e ka thënë për mangësitë e njëjta të letrarëve: *“Paraja është këshilltar mjaft i keq. Kur vetëm njëherë futet në punën krijuese, ai në të futë tërë dinamikën e vet, përpiqet me të gjitha format që ta shndërrojë në një produksion të vazhdueshëm e të vëllimshëm, kthen nga e rështira dhe e bukura, kurse nxitë në të lehtën dhe vullgaren”*.

12.

Përparësitë e punës së ashtuquajtur ekipore ndaj punës individuale janë të shumëfishta; por tri na duken më kryesoret:

1) Sintezën më të gjerë, tërësinë më të madhe mund ta realizojë vetëm grupi i shkencëtarëve. Për individin kjo pothuajse është e pamundur nga shkak i natyrës teknike dhe praktike. Sot, në kohën e zhvillimit të veçantë të të gjitha shkencave, degëve dhe disiplinave shkencore, për një njeri është e pamundur të dijë çdo gjë që nevojitet, të përfshihet tërë disiplina; e pastaj, individi nuk ka mundësi t’i kryejë të gjitha ato veprime paraprake dhe përgatitore që janë të domosdoshme për realizimin e sintezës më të gjerë, tërësisë më të madhe.

2) Ekipi është, ose së paku do të duhet të jetë, grup homogjen që i tubon njerëzit me pikëpamje dhe ide të përbashkëta, kurse shpesh edhe të shkollës e metodës së njëjtë. Së këndejmi ndërmjet disa anëtarëve të ekipit ekzistojnë mundësitë e gjera të këmbimit të ideve, pikëpamjeve, përvojave.

3) Të talentuar me aftësi të ndryshme, anëtarët e një ekipi plotësohen dhe përmirësohen në mënyrë të ndër-

sjellë dhe më gjithanshëm mund të vërejnë, më mirë ta përfshijnë dhe më themeltë ta përpunojnë ndonjë problem më të gjerë.

Nga kjo, ndërkaq, nuk duhet në asnjë mënyrë të nxirret përfundim se puna individuale, e cila në të kaluarën jo aq të hershme ishte edhe puna e vetme, e ka humbur rëndësinë e vet dhe *raison d'être*, dhe se, në pajtim me këtë, duhet braktisur dhe zëvendësuar me punë ekipore. Përkundrazi, puna e tillë, së cilës njerëzia i ka borxh çdo gjë që deri para sa kohësh është krijuar në shkencë, ka vendin e vet të rëndësishëm në të gjitha vendet, duke i kyçur edhe më të zhvilluarat, kur është fjala për hulumtimet shkencore. Duke iu falënderuar disa anëve dhe përparësive të saj (homogjeniteti më i madh i konceptcionit dhe koherenca e kompozicionit, organizimi më i lehtë dhe realizimi më i lehtë e të ngj.), ajo fatshëm plotësohet dhe lidhet me punën ekipore. Ky i fundit është i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për realizimin e ndërmarrjeve (“projekteve”) më të mëdha e më të ndërlikuara shkencore, derisa i pari është i përshtatshëm për realizimin e ndërmarrjeve shkencore më të vogla dhe më pak komplekse (“të imta”).

13.

Shopenhaueri dallon tre lloje shkrimtarësh: 1) disa (që janë më të shumtë) shkruajnë duke mos menduar: sipas mbamendjes, kujtesës, ata përshkruajnë “drejtpërdrejt nga librat e huaj”; 2) të dytët (që janë të shpeshtë) mendojnë derisa shkruajnë, ata “mendojnë që të mund të shkruajnë”; 3) të tjerët (me numër më të vogël) kanë menduar para se të kenë filluar të shkruajnë: ata lexuesve do t’u komunikojnë ndonjë përvojë që e kanë arritur, ndonjë përjetim që e kanë përjetuar, ndonjë ide deri te e

cila kanë ardhur me të menduar. Autori i mirëfilltë sy-
non t'i përkasë kategorisë së fundit.

B. Çka kanë krijuar dhe çka kanë menduar për procesin krijues disa autorë të dalluar francezë

Didëro me të drejtë ka theksuar se si në vepër autori
kyç pjesën më të mirë, më të çmueshme të vetes, të per-
sonalitetit të vet, se si ia falë çastet e veta më të bukura,
momentet më të mira të jetës së vet, mendimet e veta më
të mrekullueshme dhe ndjenjat më të bukura të zemrës së
vet; pasi kjo vepër është fryt “i edukimit dhe arsimimit të
autorit, studimeve të tij, të netëve të pafjetura të tij, të ko-
hës së tij të lirë, të hulumtimeve të tij, të kundërimeve të
tij” (264).²⁴⁸ Është e kuptueshme, në pajtim me këtë, që
shumë autorë francezë, më pak apo më shumë të dalluar,
sikur edhe autarët e të gjithë popujve tjerë, marrë përgji-
thësisht, kanë menduar, kanë folur, kanë shkruar për aktin
dhe procesin krijues, për zanatin dhe thirrjen e shkrimtarit
përgjithësisht. Disa prej tyre na kanë lënë dëshmi për këtë
interesim dhe përsiatjet e tyre - në kujtimet, letërkëmbi-
min, bisedat, shënimet e veta. Këtu do të dëshironim të
komunikojmë disa prej atyre dëshmimeve për aspektet dhe
anët e ndryshme të procesit krijues dhe zejes së shkrimta-

²⁴⁸ Për këtë shkrim është shfrytëzuar materiali nga përmbledhja interesante
e dokumenteve të cilën, me titull *Le Métier d'écrivain* (Zeja e shkrimit), e bo-
toi letrari dhe drejtori i atëhershëm e Arkivit Kombëtar në Paris Sharl Bre-
ban (Charles Braibant) në përmbledhjen “Les grandes professions fran-
çaises”, të cilën e redakton vetë (Paris, Ed. Corréa, 1951). Në shkrim herë
pas here janë cituar edhe titujt e veprave nga të cilat është vjelë materiali,
por gjithnjë janë theksuar faqet (numrat në kllapa) nga përmbledhja e
Brebantit, në të cilën lexuesi mund të gjejë të dhënat e zakonshme bibliogra-
fike për veprën nga e cila janë marrë fragmentet.

rit, me shpresë se ato, ende në masë të konsiderueshme aktuale, do të jenë me interes dhe dobi edhe për lexuesin dhe shkrimtarin e sotshëm, sidomos atë të riun.

1. Motivet dhe synimet e të shkruarit

Përse shkrimtarët shkruajnë, përse i komunikojnë mendimet dhe përjetimet e veta, i sajojnë veprat letrare? Motivet dhe shkaqet që i nxisin në këtë janë të shumta e të llojlojshme dhe ato jorrallë ndryshojnë edhe te po i njëjti shkrimtar gjatë jetës së tij dhe në pajtim me botëkuptimet në periudhat e ndryshme të jetës së tij.

Disa, sipas pranimit vetjak, kanë shkruar, si Pol Valeri, “nga dobësia” (38), ose të “fusin rend” në personalitetin e vet (Leon - Pol Farg, 39), ose “që të shkruajnë më mirë” (Maks Zhakob, 39), ose, si Floberi, nga kënaqësia që kanë gjetur në të shkruarit. Floberi në të shkruarit aq është kënaqur që, në jetën e tij të qetë e të njëtrajtshme, fjalitë, sipas fjalëve të tij vetjake, kanë paraqitur përjetim, kurse metaforat - lule (36).

Shkrimtarët tjerë francezë, ndërkaq, në shkrim i kanë nxitur motivet e larta. Anatol Frans ka dëshiruar që fjalën e shkruar ta vejë në shërbim të idealit dhe aksionit - që të veprojë te njerëzit: “Përse shkruhet”, - ka thënë ai, - “nëse jo që të veprohet, udhëhiqet me shpirtit, nga shkaqet politike, më në fund” (34). Andre Zhid, sipas pranimit vetjak, ka shkruar *Frytet e reja* (Nouvelles nourritures) që ndonjë fëmijë gjashtëmbëdhjetëvjeçar, me të i ngjashëm në atë kohë, të gjejë përgjigje në pyetjet që e kanë preokupuar (35). Pol Klodel - që t’i këndojë “veprat e njerëzve”, ashtu që çdokush në vargjet e tij t’i gjejë “ato gjëra të njohura për të, sikur udhëtari që nga largësia ndien kënaqësi

duke e njohur shtëpinë e vet, stacionin hekurudhor, komunën”. (39); kurse sipas Romen Rolanit, “kur njeriu në vete ndien diç të fuqishme e të madhe, ai atë duhet edhe ta dëftojë, e me çfarëdo çmimi, madje edhe atëherë kur është i sigurt në atë se nuk do të kuptohet”. (35).

Më në fund, për disa shkrimtarë, sipas mendimit të Pol Burzheut (124), shkrimi identifikohet me vetë jetën. Pasi për ta realiteti është i “dhembshëm”, “i shfrytëzon”, “shtyp”, edhe shpirti i tyre nuk gjenë në të “atë me çka do ta zbuste etjen e vet për emocionet e larta e intensive”, ata i kapen shkrimit, qëllimi i vetëm i të cilit është: *“me fjalitë vetjake ta ngjallë varrën e brendshme të sensibilitetit të vet...; ata kërkojnë prej fjalëve dhe prej magjisë së artit atë që lindorët e arrijnë me hashish”*. (124). Në këtë grup të shkrimtarëve bën pjesë, përveç të tjerëve, sipas mendimit të Pol Burzheut, edhe shkrimtari i njohur i *Memoareve*, Sen-Simoni: *“Duke u tërhequr nga pallati dhe përplot vrerë, ai i ka shkruar me dorëshkrimin e tij të madh fletat e mëdha të Memoareve të veta, që të bëhet, duke iu falënderuar magjisë së prozës vetjake dhe në ato orë të punës, burrështetas, i cili ka mundur vetëm atëherë kështu të bëhet... Ju ka gjykuar ministrave dhe ambasadorëve. I ka shtruar shkaqet e thella të turpit publik. Ka paraparë katastrofa të pashmangshme. Ka zbuluar kalbësinë e poltronerisë dhe ka lakuriqësuar shpirtrat e kalbur të oborrtarëve”*.

2. Pasioni i autorit me veprën

Atë çast kur te autori të kristalizohet koncepti për ndonjë vepër, ai me të pak a shumë zotëron, dominon aq sa e ka të përhershme; ai për lëndën e saj vazhdimisht mendon, jo vetëm ditën, gjatë kohës së zgjuar, por edhe natën, nëpër ëndrra; tërë jetën e vet e adapton duke

e pasur parasysh veprën e cila duhet ta fitojë formën e vet; dhe këtë nganjëherë e bënë në atë masë sa e humbë mjaft personalitetin e vet zanafillor, autentik, dhe e fiton tjetrën, ‘atë që i përshtatet asaj vepre’, si ka thënë njëherë A. Zhid (117). Me fjalë të tjera, autori shpesh është i “pasionuar” me veprën që e krijon, ai jeton, si thotë Charl Breban, nën pasionin e tij dhe nën tiraninë e figurave të tij: *“Romanshkruesi i mirëfilltë bëhet menjëherë sakrificë e atyre njerëzve dhe atyre grave që i ka nxjerrë nga bota reale. Ata e përcjellin hap pas hapi, e ndjekin dhe e bezdisin - në të gjitha trotuaret e të gjitha qyteteve, në të gjitha rrugët e të gjitha territoreve. Ai jeton me ta, bisedon me ta, i do ose i urrenë, ata shfaqërinë e tij e kanë kapëruar. Ai është kryqëzuar, është ndarë në të katra ndërmjet tyre dhe qarqeve familjare, zyrtare, politike që u përket dhe në të cilat kethehet posa i lëshon”*. (158).

Një gjendje te tillë të autorit të pasionuar me veprën e vet e ka përshkruar, në bazë të përvojës personale, në mënyrë plastike dhe impulsive, një autor francez i shekullit XVIII, Marmonteli (*Memoaret*, 173): *“Kënaqësia se imagjinoj fabulën time, brengosja rreth përshtatjes, zhvillimit të saj, interesimi që tek unë zgjohet kur unë filloj t’i imagjinoj situatat dhe skenat, - tërë këto më ka pasionuar dhe më ka ndarë prej personalitetit tim, deri aty sa kam besuar në tërë atë që rrëfëhet për pasionet ekstatike. Në shpirt më ka qëndruar një barrë, vështirë kam marrë frymë, më ngacmonte kollitja e vështirë, e mezi këtë edhe e kam vërejtur. Më kanë ardhur, kanë folur për hallin tim; unë jam përgjigjur sikur ai që është i preokupuar me diç tjetër: kam menduar për Belizarin. Pagjumësia, që deri atëherë për mua ka qenë aq e vështirë, nuk i ka pasur më ato pakëndshmëri, ato vështirësi që vijnë nga brenga. I kam kaluar netët, sikur edhe ditët, duke ëndërruar për përjetimet e heroit tim”*.

3. Botëkuptimet mbi frymëzimin

Kur është fjala për frymëzimin, te disa autorë të dalluar francezë ekzistojnë dallime të mëdha në botëkuptime. Sidomos këto botëkuptime janë disparente dhe kundërshtuese te autorët romantikë e të tjerë.

Romantikët kanë krijuar mit për frymëzimin si një dhuratë për gjenin të dhënë nga Zoti, që e çliron autorin, thënë ashtu plotësisht, nga përpjekjet, angazhimi, puna. Poetit gjenial (dhe shkrimtarit përgjithësisht), sipas mendimit të tyre, u vie në ndihmë gjithnjë “Muza”, dhe pa atë “të zgjedhurën nga qielli” çdo përpjekje e tij do të jetë e kotë: ai pa të nuk mund të krijojë asgjë të vlefshme e të çmueshme. Poeti duhet vetëm t’i drejtohet Muzës, t’i dorëzohet e t’i jepet, nëse dëshiron të krijojë vepër me vlerë permanente. Alfred de Vinji gjendjen e tij të jashtëzakonshme shpirtërore të frymëzimit të vet e ka krahasuar në të njëjtën kohë me fatin, deliriumin, epshmërinë dhe ekstazën, dhe ka konsideruar që ai i kapërcen të gjitha këto gjendje shpirtërore: *“Tek unë, (thotë ai) ..., ka diç më të fuqishme që më nxitë në shkrim - fati i frymëzimit, deliriumi, që konsiderueshëm e kapërcen deliriumin fizik që na del në kraharrorin e një gruaje. Epshëria shpirtërore zgjatë më shumë... Ekstaza shpirtërore e kapërcen atë fizike...”* (126).

Përkundër këtyre nocioneve ngapak nebuloze dhe pikëpamjeve naive të poetëve romantikë, disa autorë dhe poetë të mëvonshëm të dalluar francezë kanë pasur koncepte më reale dhe botëkuptime më realiste për frymëzimin si bashkudhëtarë, “motër” e punës së përditshme. Ashtu, Charl Bodleri e ka krahasuar punën e përditshme, sistematike me “ushqimin e bollëkshëm të rregullt” dhe ka cekur se vetëm ushqimi i tillë edhe është i nevojshëm për poetët frytdhënës. Frymëzimi dhe puna e përdit-

shme, sipas mendimit të tij, në asnjë rast nuk përjashtohen, sikur që nuk përjashtohen “as të gjitha kundërtitë që e përbëjnë natyrën. Frymëzimi është i dëgjueshëm, sikur uria, tretja, ëndrra. Ekziston, pa dyshim, në shpirtin njerëzor një lloj mekanike qiellore, së cilës njeriu nuk duhet t’i turpërohet, por ai duhet nga ajo të “nxjerrë fitimin më të lartë, sikur që këtë e bëjnë mjekët nga mekanika e trupit...” (96). Kurse Floberi madje ka tërhequr vërejtjen në rreziqet të cilave shkrimtari u ekspozohet “ai lloj i etheve që e quajnë frymëzim”. Gjendjen e tillë të vet shpirtërore, - kur ka qenë “fuqishëm i opsionuar”, - kur balli i ka qitur flakë, mendimet i rridhnin, fjalitë vetvetiu i vinin dhe lëmueshëm shkonin, - ai e ka quajtur “ballo të maskuar të imagjinatës”. Dhe duke i njohur mirë pasojat e orgjive të tilla të veta shpirtërore, gjatë kohës së cilave ka mundur që pa pushim të punojë gjatë tërë natës (vdekja në zemër, molisja, pikëpamjet e gabuara, rrëfimet e marrëzive, e të ngjashme), ai atyre me kujdes u është shmangur dhe ka konsideruar se çdo gjë duhet punuar “ftohtë, ngadalë”. (97)

Koncepcionet e ngjashme për frymëzimin i ka pasur edhe Andre Zhid, i cili për raportin dhe përshkrimin e frymëzimit dhe punës, ka lënë një faqe vërtet të shkëlqyeshme, të paharrueshme (në një artikull të botuar në gazetën *Figaro littéraire* më 31 korrik 1948, me titull: *Reflexions sur la poésie française*): “Arti fillon me rezistencë, rezistencën e kapërcyer dhe mashtrohet ai poet që mendon se do të shkëlqejë pa përpjekje. Nuk ka kryevepër njerëzore që nuk është arritur me angazhim. Madje edhe atëherë kur duket se poema mbinë nga shumësia, kjo shumësi fshehtë akumulimin e fshehtë të energjisë. Autorët romantikë (dhe kjo është vërejtja më serioze që ne ua drejtojmë) e kanë bërë të dashur një lloj të besimit të mjegulluar në frymëzimin, që gjoja i ka çliruar prej punës; një zënie besë mburravece në pagabueshmërinë e gjeniut, përbuzje e pamatur ndaj durimit dhe përpjekjes. Ata dashamirësisht i dorëzoheshin “Muzës”;

kjo d.t.th.: pa atë të deleguare qielli, unë do të isha askush dhe asgjë; por kjo është ajo që na vjen në vizitë; kjo është ajo që flet me gojën time; unë nuk kam çka të angazhohem. Përkundër kësaj, unë me kënaqësi përkujtoj në atë barcoletën e Floberit: *“Frymëzimi përbëhet në atë që njeriu të ulet në tavolinën e punës çdo ditë në kohën e njëjtë”*. Ajo Muzë e poetëve romantikë, me të cilën Mise zhvillon dialog në *Netët (Nuits)* e veta, na duket sot e zhveshkur njëjtë ashtu sikur edhe muza e Kerubinit në portretin e Engrit (Ingres). A ka në pamje diç më të lehtë, më pak e natyrshme, se një fabulë e La Fontenit? Në realitet, a ka diç që është shtjelluar me më shumë shkathtësi, e arritur me më shumë përpjekje? Është bërë kjo në atë masë sa që humbet çdo gjurmë e përpjekjes. Por Lamaritini nuk i ka dashur fabulat e La Fontenit. *Por as Hygoja nuk i ka çmuar shumë*”. (102-103).

Mirëpo, shkrimtarët që nuk kanë qenë romantistë, - as më të moçmit as më të rinjtë, - nuk e mohojnë mundësinë që frymëzimi të shfaqet edhe befasisht, dhe kjo vepër buron, “fillon” vrullshëm, me forcën elementare. E këtillë ajo i është shfaqur Zhan-Zhak Rusosë kur - duke shkuar ta vizitojë Didronë, që është venitur në fortifikatën Vensen (Vincennes) për shkak të *Shkresës mbi të verbërit* - shikimi i ra në një lajm në fletën *Mercur de France*, të cilën e ka shfletuar: se Akademia në Dizhon ka paraqitur konkurs për temën *“A i kanë kontribuar shkencat dhe arti pastrimit të karakterit?”* Dhe atëherë në të, si thotë, shkrepin ideja për veprën *Shqyrtimi mbi shkencat dhe artin (Discours sur les sciences et les arts)*: *“Përnjëherë ndiej se si shpirti më është ndritur me një mijë drita; grumbulli i ideve të gjalla janë paraqitur tek ai njëkohësisht fuqishëm dhe rrëmujsbëm, dhe kejo tek unë ka nxitur tollori të pashprehur; ndiej se si më ka kapluar marramendja e ngjashme me dehshtëmërinë. Të rraburrit e fuqishëm të zemrës ma ka shtrënguar, fryrë kraharorin; duke mos mundur më shumë të marr frymë duke ecur, rrëzohem nën një dru në aveni,*

dhe aty kaloi një gjysmë ore në atë rrëmujë që duke u ngritur kam vërejtur se si tërë pjesa e përparme e kapaçës sime është lagur nga lotët, duke mos ndier se i kam derdhur...” (69-70).

Përshtypje të ngjashme, shumë të fuqishme, ka bërë edhe tek Rishar Bllok-u (Block), lajmi i publikuar në gazetën *L’Avenir de Vienne*, për atë se si një fis kurd “ka bërë sulm natën në një fshat grek në Anadoll, e ka plaçkitur, pastaj është larguar në male”. Ky lajm, - shumë i shkurtër (gjithsej prej tre rreshtave) dhe i pavërtetuar, - ka bërë “përshtypje të jashtëzakonshme” në këtë shkrimtar francez përparimtar, që përndryshe kurrë para kësaj nuk është interesuar për kurdët dhe grekët anadollas. Duke u gjetur në gjendjen që ngjason në dehje ose halucinacion, R. Bllok ka marrë një fletë letre dhe filloi të shkruajë roman, për të cilin më herët kurrë as nuk ka menduar dhe i cili do ta mbajë titullin *La Nuit Kurde*. Nuk është më pak interesant as rrëfimi i Pol Valer për atë se si ai, me rastin e vizitës së rastit një zyreje, duke i shkruar disa të dhëna të parëndësishme, fitoi menjëherë motivim, frymëzim momental që ta shkruajë poemën: “Kanë rrjedhur fjalët, ritmet, vargjet dhe tërë kejo ka mbaruar me poemën, motivi i së cilës, muzika, ngashënjimet, të gjitha, do të burojnë nga ndodhia materiale nga e cila nuk do të mbetet as gjurmë në poemë. Cila kritikë do të mund edhe të dyshonte në gjenezën e këtillë të poemës?”

Për Andrea Zhid, i cili ka provuar ta shpjegojë këtë lloj të frymëzimit, “shpërthimet e këtilla arteziane” janë në realitet “rezultat i përgatitjeve të gjata të ndërdijshme” (71). Kështu ai, thotë, e ka shkruar “tërë aktin e fundit të Saulit për një ditë”. Kurse i ka ndodhur që të marrë të shkruajë “në vagon, metro, në karriget e kejit ose bulevardit, në kënde të rrugëve”, dhe këto kanë qenë, sipas mendimit të tij, faqet e tij më të mira, “mirëfillësisht dhe amshueshëm të frymëzuara”. Në to “një fjalë vargobej pas tjetrës, buronte njëra pas tjetrës”. Gjvatë kësaj ai në vete ka përjetuar diç sikur entuziazëm fizik. E për fjalitë ashtu të shkruara më vonë kanë qenë të

nevojshme vetëm përmirësimet shumë të vogla: vetëm lidhja e ndërsjellë e disa pjesëve ka shkaktuar mundime të caktuara dhe ka kërkuar *“përpyekje të mëdha të shpirtit”* (71).

4. Kënaqësitë dhe vështirësitë e të shkruarit

Vepra letrare, me çfarëdo përpjesëtimesh modeste të jetë, nëse pakontestueshëm paraqet vlerë artistike, u sjellë lexuesve kënaqësi të jashtëzakonshme, i ofron këndje të rrallë. Të vetëdijshtëm për këtë, shumë autorë francezë kanë dëftuar në virtytet e shumëllojshme pozitive të letërsisë. Por Prevo-Paradol (Prevost-Paradol) i ka kënduar himnin e vërtetë: *“Të jeshë shëndoshë, pra, letërsi e dashur, ngushëlluesja e shtrenjtë dhe e fuqishme! Prej kur raca jonë ka filluar ta shpojë atë që di dhe mendon, ti e ke shndritur botën me mirësitë tua; por më e madhja prej të gjithave është paqja që t’i mund ta fusish në shpirtat tanë. Ti ngjason me ato burimet e kthjellta, të fshehura gjithsej dy hapa prej rrugës, nën slladin e freskët; kush nuk të njeh, vazhdon ecjen me hapa të qetë, ose i rraskapitur rrëzohet në rrugë. Kush të njeh, nimfë mësuese e mirë, të ngarend ty, e freskon fytyrën tënde të përflakur, i lanë duart e djegura dhe e rinon në vete zemrën tënde. Ti je amshueshëm e bukur, amshueshëm e pastër, e mëshirshme për atë kush të afrohet, besnike ndaj atij kush të do. Ti na dhuron pushim, e nëse munde mi që të të adhurojmë me shpirt mirënjohës dhe me shpirt të arsyeshëm, t’i i shton pushimit edhe diç lavdi. Le të ngrihet nga varri dhe le të të akuzojë ai që ti e ke mashtruar (181)”*.

Por shkrimtari me veprën e vet nuk i ka sjellë gëzim vetëm lexuesit, por, duke e shkruar, ia ka krijuar edhe vetes. Me të vërtetë, disa shkrimtarë në të shkruar kanë përjetuar kënaqësi të thellë, eufori të mirëfilltë. Që këtu ta përmendim vetëm Floberin, i cili objektin për të cilin

ka shkruar, e ka krahasuar me gruan e dashur, para së cilës, *“kur ajo të lëshojë pe, dridhnu dhe frikësohuni”* dhe përjetoni ndonjë *“tmerr epshtdjellës”* (126). Duke shkruar, ai ka ndier se si prej tij *“herë pas here mugullon diç e thellë dhe jashtëzakonisht epshtdjellëse, sikur ejakulimi i shpirtit”*. (127). Nganjëherë prej gëzimit i ka rrahur zemra: aq është gëzuar duke shkruar sa është detyruar ta merrë faculetën e t'i fshijë lotët të cilat i rridhnin vijë nëpër fytyrë. *“Vetë jam llastuar duke shkruar (thotë ai), shkëlqyeshëm jam kënaqur - edhe në emocionin që e ka nxitur mendimi, edhe në fjalinë që e ka shprehur atë, edhe në kënaqësinë që e kam gjetur”*. (180).

Përkundër këtyre, ka shumë më tepër shkrimtarë francezë që kanë përjetuar vështirësi të vërteta të shkrimit. Sidomos *Letërkëmbimi (Correspondence)* i Floberit është përplot me vende në të cilat autori i *Zonjës Bovari* ankohehet në vështirësitë e shkrimit - “abceset” dhe “vështirësitë vdekëse” të stilit. G. Floberi artin e ka quajtur greminë të paarritur dhe ka thënë se ne jemi tepër të vegjël që të zbresim në të. Ai jo rrallë qajej: “Se si pena është lopatë e rëndë dhe se mendimi, kur me të duhet të thellojë, rrjedh rëndë!” Dhe jorrallë ka rënë gati në dëshpërim: çastet e vërteta të kapitjes janë paraqitur tek ai kur shkrimi nuk i shkonte për dore, kur ngadalë përparohej, kur ai duhej të mundohej në redigjimin e ndonjë fragmenti. Kurse këto çaste kanë qenë të shpeshta, sidomos me rastin e shkrimit të *Zonjës Bovari*. Ka ndodhur kështu që për një javë të shkruajë gjithsej një apo dy faqe për të cilat nuk ka mund madje të thotë as atë se a kanë qenë të mira. Kurse në prill të vitit 1852, duke e redigjuar veprën e njëjtë, ka shkruar gjithsej njëzet e pesë faqe për gjashtë javë, ndonëse, sipas pranimit vetjak, ka mbetur nganjëherë pranë tavolinës së punës thellë natën, deri në orën tre, e edhe deri në orën pesë të mëngjesit. Për ato faqe ai përveç tjerash thotë: *“... aq kam punuar në to, aq i kam përshkruar, ndërruar, ndryshuar, që momentalisht asgjë nuk kup-*

toj...”. Edhe sikur të mos kishte sukses të shprehet si ka dëshiruar, kur shprehja i ikte nga pena, “kur, duke i shkarravitur faqet e gjata, ka zbuluar se nuk ka hartuar asnjë fjali të vlefshme”, hedhej në kanape dhe shtrihej “i topitur në ndonjë baltinë të brendshme venitëse”. Por edhe përveç kësaj, ai punën e vet e ka dashur “me dashurinë frenetike e të shtrembëruar, sikur që ndonjë asket e dëshiron qimen e ashpër që e kruan barkun”, si ka thënë vetë ai (179). Kurse me vështirësitë e të shkruarit, të cilat, sipas dëshmisë së miqve të vet, shpesh vetë i ka stërmadhuar, madje është krenuar: “Ka dëshiruar t’i tregojë, - shkruan miku i tij Maksim di Kan (Maxime du Camp), - ato faqe përplot shkarravitje, me të cilat edhe vetë me vështirësi të madhe gjendej ... Ka rënkuar, fyrrë, është zemëruar duke punuar, ka britur: Ah! Sikur bukëpjekësit kur e përziejnë brumin; ka qenë ky më parë një punëtor fizik, që është djersitur nën ngarkesën e punës, se sa shkrimtari që mbanë penën në dorë...”. (130).

Përveç Floberit, dëshmi të shumta për këto vështirësi të lindjes së të shkruarit na kanë lënë edhe shkrimtarë të tjerë të dalluar francezë. T’i përmendim këtu së paku disa prej tyre:

Duke u ankuar se disa vargje më të rëndomta i kanë kushtuar më së shumti angazhim dhe mundim (duke e marrë parasysh atë se stili i lehtë dhe natyror në realitet është rezultat i përpjekjeve të mëdha dhe vështirësive të kapërcyera), Boalo ka theksuar se shkrimtari me angazhimin dhe punën e vet duhet t’ia kursejë angazhimin dhe punën lexuesit (158 - 159). Kurse Monteskie është ankuar se si në libërthin të cilin për tri orë secili do ta lexojë, ka dhënë angazhim të madh dhe se për këtë arsye i janë zbardhur flokët (232).

Janë të njohura dhe mjaft interesante edhe vështirësitë e Zhan-Zhak Rusosë, për të cilat ai ka folur në *Rrëfimet (Confessions)* e veta. “Me këtë ngadalësi të mendimit dhe gjallëri të ndjenjave nuk karakterizohem vetëm në bisedë, por edhe

kur jam vetëm dhe punoj. Mendimet më rregullohen në kokë jashtëzakonisht vështirë: rrjedhin padëgjueshëm, gufojnë aq sa më mallëngjejnë, nxejnë, më nxisin të rraburit e zemrës; dhe midis tërë atij mallëngjimi, nuk shoh asgjë të qartë, nuk mundem as një fjalë ta shkruaj, dubet të pres. Pabëtueshëm, kjo paretati e madhe heshtet, kaosi rregullohet, çdo gjë vjen në vendin e vet, por ngadalë dhe pas përzierjes së gjatë e të tollovitur ... Prej aty del vështirësia skajore që e ndiej kur shkruaj. Dorëshkrimet e mia, të shlyera, të shkarravitura, të ngatërruara, të palexueshëm, dëshmojnë për vështirësitë që m'i kanë dhënë. Nuk ka asnjë që nuk jam detyruar ta përshkruaj katër - pesë herë para se ta jap në shtyp. Kurrë nuk kam mundur të hartoj diç me penë në dorë pranë tavolinës dhe me letër para vetes: shkruaj në kokë gjatë kohës së shetitjes, në mesin e shkëmbinjve dhe pyjere, natën në shtrat gjatë kohës së pagjumësisë; mund të mendoni me çfarë ngadalësie, sidomos pasi në pyetje është njeriu plotësisht i privuar nga çdo mbamendje verbale dhe i cili në jetë nuk ka mund të mbajë mend as gjashtë vargje menjëherë. Ndonjë periudhë fjalie e kam përmbysur e kthyer në kokë nga pesë-gjashtë herë para se ta vë në letër. Prej aty rrjedh edhe ajo se më shumë kam sukses në veprat që kërkojnë punë të ngulshme se sa në ato për të cilat është e nevojshme njëfarë lehtësie, sikur që janë letrat, gjini në të cilën kurrë nuk kam mund ta qëlloj tonin dhe të cilat për mua kanë qenë mundim i vërtetë. Nuk mund të shkruaj letër edhe për imtësinë më të vogël e që ajo mos të nxisë tek unë lodhje që zgjatë me orë, ose, nëse dua të shkruaj pandërprerje atë që më bie ndër mend, nuk di as ku të filloj as përfundoj; mezi që mund ta kuptoj kush kur ta lexojë” (159-160).

Shkrimi i ka shkaktuar vështirësi të caktuara edhe Ipolit Tenit (Hippolyte Taine): sipas pranimet vetjak, ai në shkrim ka bërë “përpjekje të madhe”, kurse shpesh “pas dy ose tre orësh, herë-herë edhe një”, është dashur, i lodhur, që të pushojë të shkruajë pasi që më nuk ka mund, as dy mendime t'i lidhë”. Ai konsideron se për këtë shkak disa bashkëkohës të tij e kanë shpallur mënyrën e tij të shkruarit “të mërzitshme” dhe e kanë kra-

hasuar me “kafenë tepër të koncentruar, shumë të fortë, të idhët” (163). Emil Zola ka dëshiruar të krijojë dramën e krijimit të Klod Lantjeni (Claude Lantien), ta “fotografojë luftën e artistit kundër natyrës, mundimet e krijimit të veprës artistike, përpjekjet e gjakut dhe lotëve që të jepet mishi i vet, që të krijohet jeta...”. “Me një fjalë, (ka thënë ai), unë këtu do ta rrëfej jetën time intime krijuese, atë lindjen e amshueshme, aq të dhembshme; por unë lëndën do ta rris me dramën e Klod Lantjenit, i cili kurrë nuk është i kënaqur, i cili bie në dëshpërim që gjeniu nuk mund t’i jetë i frytshëm dhe i cili më në fund mbytet para veprës së vet të porealizuar. Ky nuk do të jetë ndonjë i paaftë, por krijues i ambicieve tepër të mëdha, që dëshiron në bazë të vë tërë natyrën dhe i cili për këtë do të vdesë”. (143-144).

Duhet po ashtu të ceket se shkrimtarët kyçen në përjetimet dhe pësimet e heronjëve të vet, aq sa kjo i tretë fizikisht dhe psikikisht. Kështu Romen Rolani i pranon Luj Zhijeut (Giller), në vitin 1911, se çdo vëllim i Zhan Kristofit i ka sjellë “shumë flokë të thinjura”: “Të gjitha krizat e heroit tim më kanë tronditur mua aq sa edhe atë, më shumë se atë: sepse trupi im është më pak i fuqishëm” (154).

Punën në ndonjë vepër e bënë edhe më të rëndë fakti që, - si thekson Pol Klodel, - *“përvoja e arritur nuk i shërben asgjësë; çdo vepër e re shtron probleme të reja, para të cilave njeriu ndjen tërë pasigurinë dhe të gjitha vështirësitë e një filletari, e krahas kësaj edhe njëfarë lehtësie tradhtare, të cilën duhet ngadhënjyer brutalisht”* (166).

Madje edhe vepra e mbaruar, me sukses e realizuar, nxitë të disa shkrimtarë dhembshuri dhe gjendje shpirtërore të llojit të veçantë. Kështu Pol Valeri është ankuar që autorit i është hequr ajo përshtypja dhe përjetimi i thellë momental që e ndien lexuesi para veprës së krijuar: “Medet!, (thotë ai), në atë veprën që e kam krijuar,

veprën për të cilën thonë se është e shkëlqyeshme, që i prek në shpirt njerëzit rreth meje, veprën për të cilën po flitet, e cila po ngrihet në yje, bukuritë e së cilës po humtohen, i vetmi unë më nuk po kënaqem! Tek unë për të ka zënë fill mendimi i parë, dhe unë i kam studiuar dhe realizuar të gjitha pjesët e saj. Por kontributi momental i tërësisë, shoku, zbulimi, lindja më në fund e tërë veprës, emocioni kompleks, - e tërë kjo mua më është privuar, tërë kjo u përket njerëzve që e kanë njoftuar atë vepër, që nuk kanë jetuar me të, të cilëve u janë të panjohura kontestet, duartrokitjet, neveritë, rastësitë..., por të cilët e shohin vetëm si një mendim madhështor përnjëherë të realizuar. Unë, gur mbi gur, kam ngritur në bjeshkë masën, të cilën përnjëherë e kam lëshuar mbi ta. Mua më janë nevojitur pesë vjet, dhjetë vjet, që atë masë, pjesëz-pjesëz ta shtresoj, kurse ata e pranojnë goditjen përnjëherë, momentalisht”. (147-148).

Disa shkrimtarë madje kanë ndier njëfarë lloj neverie, gërditje mbi veprën e vet të kryer, së cilës, derisa e kanë krijuar, për disa vjet i janë përkushtuar, duke u angazhuar, me shumë ambicie dhe rreptësi, që ta krijojnë sa më të mirë e më të përkryer. Këtë gjendje shpirtërore të neverisë, së cilës ia lëshon vendin gjendja e mëparshme e dehshmërisë, e kanë përshkruar impresivisht, përveç të tjerëve, vëllezërit Gonkur: “Romani ynë *Letrarët (Les Hommes de lettres)* është përfunduar. Ka mbetur vetëm edhe ta përshkruajmë. Habi, në letërsi, vepra e krijuar nuk është më e lidhur për zemër. Veprën që më nuk e mbani me vete, që më nuk e ushqeni, ju bëhet, thënë ashtu, e huaj. Sipas librit vetjak juve ju përshkon njëfarë indiferentiteti, njëfarë ligështie, pothuaj njëfarë neverie. Kjo ka qenë përshtypja jonë gjatë të gjitha këtyre ditëve të fundit”. (146-147).

5. Kushtet e volitshme për punë dhe metodat e ndryshme të të shkruarit

Kushtet në të cilat disa shkrimtarë kanë mundur më së miri të punojnë dhe krijojnë, pak a shumë, janë të ndryshme. Për disa, koha më e përshtatshme për punë, për shembull, ishte mëngjesi, përkatësisht paraditja, dhe së këndejmi janë zgjuar herët në mëngjes (Benzhamen Konstan dhe Lamartin në ora pesë, Stendal dhe Mishle në ora gjashtë), derisa të tjerët kanë pasur shprehi të punojnë natën. Alfred de Vinji që ankuar në këtë “shprehi të kobshme” të vetes, që e ka arritur qysh prej fëmijërisë së vet të hershme, por të kota edhe kanë qenë përpjekjet e tij që ta heq shprehinë. Disa kanë sinjalizuar në shëtitjet e përditshme, si kusht i domosdoshëm i kondicionit të mirë për punë. Dyma Sin ka rekomanduar, përveç shtatë orë gjumë, nga dy orë lëvizje të përditshme, deri sa Montenj dhe Ruso gjatë kohës së shëtitjes kanë menduar dhe krijuar më intenzivisht. “Shpirti im nuk punon nëse këmbët e mia nuk e nxisin”, - ka shkruar Montenj. Balzak ka këshilluar maturinë në ushqim, duke dëftuar në “luftërat e përditshme” që organizmi i njeriut duhet t’i zhvillojë “me rastin e një shujtje” dhe duke theksuar se “njeriu ambicioz hanë pak, i mençuri është i matur, kurse ai i ndieshmi neveritet prej ngopësisë” (55). Sipas Vinjit, “burim i frymëzimit” ka qenë vetëm vetmia, kurse sipas Bodlerit - kotësia. Për vëllezërit Gonkur, ndërkaq, kusht i rëndësishëm, i domosdoshëm i shkrimit, i pjekjes shpirtërore, i krijimit të çdo gjëje të madhe dhe dramatike ka qenë qetësia e brendshme. Paretat shpirtërore - emocionet - “janë të kundërta me të pjekurit e librave”, - thonë ata, dhe, sipas mendimit të tyre, ata që jetojnë me jetë të plotë, që shpenzohen në epshet jetëso-

re, nuk do të krijojnë vepra të mëdha, për të cilat janë të nevojshme “ditët e rëndomta, të qeta, të heshtura, gjendja borgjeze e tërë qenies, matura vendase”.

Por sikur që shkrimtarët ndërmjet veti dallojnë në aspekt të çasteve më të përshtatshme dhe kushteve më të mira për punë, ata dallojnë edhe duke e marrë parasysh metodën e punës, mënyrën e të shkruarit të tyre.

Disa, - në numër të vogël -, shkruajnë pa seleksionim dhe zgjedhje të madhe: e vënë, më së pari, në letër çdo gjë që u bie në mend dhe u vie nën penë, që mos t'u “ikë” asgjë; pastaj, duke përshkruar, krasitin dhe lëshojnë atë që ju duket e panevojshme dhe e tepërt. Alfons Dode, për shembull, ka shkruar faqe të tëra “me një frymë”, duke hedhur në letër, pa kujdes dhe zgjedhje të mëdha, mendimet dhe vërtetimet e veta. Faqet kështu të shkruara i ka reviduar dhe përmirësuar së pari gruaja e tij, e pastaj ai vetë. Më në fund, gjithë atë ai e ka përshkruar në letër të pastër, duke ndier gjatë kësaj, siç është shprehur vetë, po atë kënaqësi që e ndien nxënësi kur në detyrën përfundimtare disa vende i rregullon, i plotëson, i përkryen. - Mënyrën të këtillë të të shkruarit Bodler e ka konsideruar “keqpërdorim të kohës dhe talentit të vet” dhe e ka gjykuar: “Të mbulohet pëlhura (si e kanë quajtur disa këtë mënyrë të punës) nuk d.t.th. të përmbushet me ngjyra, por të hedhen në të shtresa të holla të ngjyrës, të sistemohen masat në tone të lehta e të tejdukshme”. Edhe atij ai ia ka kundërvënë mënyrën e dytë, sipas mendimit të tij më të mirë e më efikas: Atij që i ka paraprirë periudha e të përsiaturit të gjatë: “Që të shkruajmë shpejtë”, thotë ai, “ka nevojë që të kemi menduar një kohë të gjatë; që me vete ta kemi bartur lëndën kudo - në shëtitje, në banjë, në restorant, dhe pothuaj edhe te dashnorja jonë”. (95).

Disa shkrimtarë kështu edhe kanë punuar: ata çdo fjalie të vet, para se ta kenë vënë në letër, ia jepnin në

kokë pak a shumë formën përfundimtare, ashtu që më vonë rrallë nga diçka do të duhej të shtojnë ose të përmi-
rësojnë. Zhan Zhirodu, për shembull, me muaj të tërë
nuk e merrte as pendën në dorë, por vetëm mendonte
për lëndën e veprës së vet, e atëherë përnjëherë e kaplon-
te dëshira pasionuese, e pashmangshme për të shkruarit:
“Një mëngjes të bukur” do të ulej pranë tavolinës dhe do
të shkruante nga dy ose tri javë. Rezultati ka qenë dorësh-
krimi i veprës së re, thënë ashtu, pa asnjë fjalë të shlyer
ose të fshirë, të shkruar me atë dorëshkrimin e tij karakte-
ristik “të bukur, të shpejtë, ngapak femëror”. (61-62).

Gjatë kësaj duhet pasur parasysh se mendimi nuk
rrjedh pandërprerë dhe lëmueshëm: atij, sikur trupit dhe
jetës, i janë të domosdoshme ndërprerjet, ndalimet, pu-
shimet. “Mendimi, (thotë P. Klodel), troket sikur truri
dhe zemra. Aparati ynë ideor në gjendje tendosjeje e
zbrazjeje nuk jep vijë të pandërprerë; ai prodhon me
shkëndija, me dridhje, masën e logjikshme të mendime-
ve, mbamendjeve, botëkuptimeve, nocioneve; pastaj
zbutet para se shpirti, në gjendjen e vetëdijshe, të sen-
dërtohet në aktin e ri krijues (73).

Te disa shkrimtarë shkrimit i paraprinë një varg vep-
rimesh tjera, “operacionesh” përgatitore. Alfons Dode
kishte për traditë të grumbullojë në fletore (që për disa
dhjetëvjeçarë ka grumbulluar shumësi të tëra) vrojttime
dhe mendime, nganjëherë në formë mjaft koncize, dhe
ato vrojttime dhe mendime, që e kanë përkujtuar në ndo-
një gjest, intonacion e të ngjashme, ai më vonë sipas ne-
vojës i ka zhvilluar. Kurse është i njohur teksti në të cilin
Bifon (Buffon) flet për domosdoshmërinë e planit para
se t’i qasemi shkrimit. “Në mungesë të planit, për shkak se
nuk ka menduar mjaft për lëndën, ndonjë njeri me shpirt gjendet
në telashe dhe nuk di prej ku dhe nga të fillojë të shkruajë. Atij i
kalojnë në të njëjtën kohë nëpër vetëdije shumësi mendimesh; e pasi
që as nuk i ka krabasuar as nënshkruar, asgjë nuk e përcakton

që disa t'ia paraprijë disa të tjerave; ai, pra, gjendet në hamendje; por kur ta krijojë planin, kur njëherë t'i tubojë dhe rregullojë të gjitha mendimet qenësore për lëndën e tij, ai lehtë do ta vërejë çastin kur dubet ta marrë penën në dorë; do të ndiejë kur fryti shpirtëror t'i piqet dhe do të nxitojë që ta zhvillojë, dhe në të shkruar madje do të ndiejë vetëm kënaqësi". (105-106).

Numër i madh i shkrimtarëve francezë ka dëftuar edhe në domosdoshmërinë e kundrimit të kujdesshëm e të gjatë dhe zhvillimit të talentit kundruës të shkrimtarit: Me të shkrimtari zbulon "aspektin e çështjes që nuk e ka hetuar dhe shprehur askush para tij, - siç thotë Mopasan. Kurse ky aspekt i pazbuluar i çështjeve ekziston në çdo gjë: "Në çdo gjë ka diç (thotë ai) të pabulumtuar, sepse ne jemi mësuar që të shërbebemi me sytë tanë vetëm duke e përkujtuar atë që të tjerët para nesh e kanë menduar për dukurinë që po e kundrujmë. Gjëja më e vogël përmban diç të panjohur. Ta gjejmë atë..." (76). Në lidhje me këtë, Flober bindshëm e ka këshilluar Mopasanin: "Kur të kaloni ... para ndonjë bakallxhiu që është ulur para dyerve, para ndonjë shtëpiruajtësi që pi duhan me llullë, para ndonjë stacioni fijakerist, dëftojeni atë bakallxhiun dhe atë shtëpiruajtësin, pozën e tyre, tërë jashtësinë e tyre fizike, që përmban në të njëjtën kohë tërë natyrën e tyre shpirtërore, të shprehur me ndonjë fotografi të shkathtë, ashtu që unë mos t'i përziej me ndonjë bakallxhi ose shtëpiruajtës tjetër, dhe më dëftoni, vetëm me një fjalë, me çka ndonjë kalë fijakeri nuk ngjason me pesëdhjetë kuaj tjerë që ecin trok pas tij ose para tij". (77).

Nuk duhet hequr jashtë mendjes as faktin se në çdo proces krijues ka edhe elemente të pavetëdijes. Pol Valer thekson se shkrimtarit, derisa kërkon fjalën që ta shprehë ndonjë mendim, i paraqitet nganjëherë mendimi krejtësisht tjetër. Sipas mendimit të tij, shkrimtari i mirëfilltë do ta shfrytëzojë atë rrethanë të fatshme, që e bënë më të pushtetshëm, madje më të thellë, dhe do ta lë rrjedhën e vet më të hershme të mendimeve në dobi të mendimit të ri. Shefi i Shkollës surrealiste, Andre Breton, ka shkruar

në këtë aspekt deri aty që në procesin krijues letrar ka mohuar çdo pjesëmarrje të elementit të vetëdijshëm. Në *Manifestin e parë surrealist (Premier Manifeste surréaliste, 1924)*, ai ka shkruar: “*Shkruani shpejtë, qoftë në shikim të parë edhe mos ditsbi për çka, dhe atë mjaft shpejtë në mënyrë që mos të mbani mend e të bini në sprovë që ta lexoni atë që e keni shkruar. Fjalja e parë do të vijë vetvetiu ...*” (74).

Të cekim edhe mendimin e dy shkrimtarëve bashkëkohorë francezë mbi metodën e shkrimit që ata e kanë aplikuar. E para vjen prej penës së Aleksandër Arnu (Arnoux): “*Unë nuk kam metoda. Idetë, përshtypjet, kujtimet ngjizen, trajtësohen pak nga pak në tërësi. Ndërdija ose gjysmëndërdija punojnë. Unë jetoj, dëgjoj, lexoj, kujtohem, imagjinoj së koti. Nxjerr, jetoj me hap, shëtitjet e gjata nëpër Paris ose nëpër fusha. Ritmi i ecjes vepron si një varg goditjesh në ndonjë barrë në çrregullësi. Në fund e tëra rregullohet. Një ditë krijohet një lloj i dedublimit. Një unë, edhe për vetë mua pothuaj e panjohur, e vë në letër veprën, që më vonë e lexoj me habi të madhe. A po krijoj në hare apo në dhembje - nuk di. Ndiej njëfarë topitje, sikur mediu mi që zgjohet nga transi, e kur vepra është e përfunduar, njëfarë nevojë të jashtëzakonshme për aktivitet fizik*”. (133).

Mendimi tjetër buron prej Filip Supo (Philippe Soupault), që prezenton, sikur edhe mendimi i Arnuit, përgjigje në një anketë që e ka organizuar Gaston Pikar (Picard), me titull: “*Non écrivains définis par eux-mêmes*”, në vitin 1925:

“*Librat e mi linden, kurse unë për këtë nuk jam as i vetëdijshëm. Një ditë hetoj me habi se përherë mendoj për një të njëjtën gjë. Për të mendoj gjithnjë shumë e më shumë dhe më në fund vërej se ky është objekti i librit tim të ardhshëm. Atë çast duhet të filloj ta shkruaj. Nuk mund të dal nga ky rreth. Si luzma e këryesve, me mijëra hollësi, mijëra mendime sulmojnë në trurin tim të mjerë; dhe unë i shënoj, mundohem rreth tyre, përpiqem që edhe t'i harroj, pastaj shkruaj mjaft shpejtë dhe me njëfarë kënaqësie. Dhembja vjen atëherë kur ma dërgojnë korrekturën. Shkurtoj, shtoj, përmirësoj, rregulloj, pastaj copëtoj. Janë çaste të mundimsh-*

me këto. Solemnisht deklaroj: "Mjaft më me të gjitha këto! Nuk dëshiroj më të shkruaj romane". Përsëri shkruaj, rregulloj, kontrollon tekstin. E përpunon "në dhembje" tërë atë lakrishten time".

6. Domosdoshmëria e punës së ngulshme dhe përkryeshmërisë

Çdo shkrimtar bartë në vete thesar më të vogël ose më të madh të mendimeve dhe përjetimeve, që me padurim dëshiron t'i komunikojë. (Së këndejmi ai pohimi i Pol Valerit që gjeniu paraqet "padurim të gjatë".) Ato mendime dhe ato përjetime, ka cekur Romen Rolan (100), rrjedhin nganjëherë me fuqinë elementare, ashtu që duke e shkruar një vepër, shkrimtari dëshiron që sa më parë ta shohë fundin dhe ta fillojë tjetrën. Për këtë shkrimtarit medoemos i duhet durim. Pa të nuk mund të krijohet asgjë e mirë dhe e çmueshme: ai i vetmi i mundëson shkrimtarit që veprën që e ka filluar ta përfundojë me sukses, përkundër "etheve të padurimit" të vet. Kurse rruga që shpie prej fillimit të ndonjë vepre deri në përfundimin e saj të suksesshëm, ka cekur Charl Pegi, - është e gjatë dhe e vështirë dhe atë shkrimtari duhet ta kalojë që të vijë deri te caku, sikur që një alpinisti i duhet të kalojë rrugë të gjatë e të mundimshme që të ngjitet në majë të ndonjë bjeshke. Shkrimtari në këtë jorrallë edhe mashtrohet: në shikim të parë i duket se cakun e ka para duarve, se tërë veprën e mbanë në dorë, *in cava manu*, sikur që alpinistit ndonjë bjeshkë e largët nganjëherë i duket afër, para duarve. Mirëpo, vetëm kur niset shtegut, e heton realitetin: "kthesat, dredhat, tokat".

Së këndejmi shkrimtarët e vërtetë, dhe krijuesit përgjithësisht, kanë qenë dhe është dashur të jenë punëtorë

të mëdhenj, krijues të zellshëm, lexues të pasionuar: kanë kaluar, sikur bleta në koshere, pjesën më të madhe të ditës, të javës, muajit, vitit në dhomën e vet të punës, bibliotekës ose kabinetit, “in angello cum libello”, ndërmyet imagjinatës dhe realitetit, mendimeve dhe ëndrrave - në lexim, mendim dhe shkrim. Qysh Di Bele i Vjetër (Joachim du Bellay), në shek. XVI ka theksuar domosdoshmërinë e punës së përhershme dhe përpjekjeve të vazhdueshme për shkrimtarin që dëshiron “të jetojë në kujtesën e pasardhësve”: “i vdekur për veten”, ai duhet patjetër “që të djersitet dhe dridhet...; dhe, sikur që poetët tanë të pallatit pinë, hanë dhe flenë deri në pikë të qejfit, t’i durojë urinë, etjen dhe vigjilimet e gjata...”(40). Është e njohur po ashtu që Volteri dhe mikësja (e bashkëpunëtorja) e tij, zonja de Shatle (Marquise de Chatelet) kanë qenë punëtorë të pasionuar (59). Volteri ka punuar tërë ditën dhe kushdo që i vinte, e takonte pranë tavolinës së shkrimit. Punën e ndërprente vetëm “për gjysmëçerek ore”, që t’i bëjë vizitë të shkurtër zonjës de Grafiñji (Madame de Grafiñny) dhe ka biseduar me të. As atëherë fare nuk është ulur dhe çdoherë ankohej “se si kjo është e tmerrshme sa kohë njeriu humb në bisedë” dhe “se si më së shumti se çdo gjë shpenzon kohën”. E sa i përket zonjës de Shatle, ajo i ka kaluar netët “pothuaj pa përjashtim në punë, deri në ora pesë dhe shtatë të mëngjesit”, kurse ngrihej, madje edhe atëherë, “në ora nëntë ose dhjetë”, ashtu që përgjithësisht nuk ka fjetur më shumë se dy orë në ditë. Sent-Bev në secilin prej fejtoneve të tij periodik, - *Bisedave të të hënave*, - ka punuar nga shtatë ditë të tëra pa pushim: “Të hënën rreth drekës”, i ka shkruar ai Bodlerit, “unë e ngrë kokën dhe marr frymë një orë përafërsisht; e pastaj dritarëza prap lëshohet dhe unë mbes në birucë shtatë ditë” (362). - Më në fund Balzaku, kur e detyronin rrethanat, ka ditur që në punë ta kalojë tërë ditën duke mos dalur nga njëzet e katër orë

nga kabineti dhe duke pirë vetëm kafe. Krahas kësaj, nëse frymëzimi nuk i vinte ashtu si ka dëshiruar, ai, që ta “aktivizojë” trurin e vet, i ka zbatuar këpucët, i vente “këmbët e zbatuara në mermerin e ftohtë të vatrës së oxhakut” (61). E kështu me radhë.

Sa i përket përkryerjes, përsosjes së ndonjë vepre - për këtë nuk ka fund, sipas mendimit të shumë letrarëve të dalluar francezë. Për Pol Valerin, për shembull, “një poemë kurrë nuk është e përfunduar, - atë gjithnjë e përfundon ndonjë ndodhi. Kjo d.m.th., se atë publikut ia jep: lodhja, kërkesa e botuesit, motivimi i poemës tjetër; por kurrë vetëm gjendja e veprës (nëse autori nuk është i marrë) nuk dëfton se në të nuk do të ishte e mundur edhe me tej të punohet, diç t'i shtohet, të merret si aproksimacion i parë ose fillim i hulumtimeve të reja” (115). Edhe ai konsideron se ndonjë shkrimtar do të mundej pakufishëm që të kthehet në veprën e vet dhe të merret me tërë jetën e vet. Sepse “përkryeshmëria - kjo është puna!”

E megjithatë, ndonëse numri i madh i shkrimtarëve e thekson nevojën e punës së përhershme, të përditshme, disa dëftojnë edhe në fatkeqësitë e punës së tepruar, “rrezikshmërinë e përpjekjeve kontinuitive”. Kështu, sipas mendimit të Zhan Preva (Jean Prévost) “në një vepër së cilës i kushtohet kujdes i plotë nuk mund të punohet dobishëm më tepër se dy deri tri orë në ditë, e madje nuk është e mundur të punohet as aq çdo ditë”. Shkrimi kërkon “kokë mjaft të freskët”, kurse puna e tepruar sjell rezultate të dobëta. “Kush e shkruan një faqe me qëllim që në të pastaj të gjitha t'i ndërrojë, i tilli nuk i kushton kurrfarë kujdesi...” (101).

Por nuk ekzistojnë vetëm mundësitë e pakufishme të përkryerjes së një vepre, por përkryhet edhe mënyra e të shkruarit e një shkrimtari, madje edhe në vitet e mëdha: “Bifon, në moshën e tij 78 vjeçare, ka folur se si “çdo ditë ka mësuar të shkruaj”, pasi që në veprat e tij të

fundit ka pasur shumë më tepër përsosuri sesa në të parat”, dhe, derisa me kërkesën e tij ia lexonin veprat e tij, në to përherë ka gjetur mendime që do të duhej ndërruar ose diç t’u shtohet. (208).

7. Qartësia dhe natyrësia e të shprehurit

Disa shkrimtarë të dalluar francezë kanë folur edhe për mënyrën e të shprehurit, sikur edhe për veçoritë e tij, në rend të parë për qartësinë dhe natyrshmërinë.

Flober ka dëftuar në lidhjen e ngushtë, varshmërinë e ndërsjellë dhe përshtatjen e mënyrës së të shprehurit dhe mënyrës së mendimit: “Nëse mendimin e keni të dobët”, i ka shkruar ai Fedoit (Ernest Feydeau), “ju kurrrë nuk do të shkruani fuqishëm” (217).

Ngjashëm ka menduar edhe Renani, i cili ka konsideruar që “mendimi i fuqishëm dhe i vërtetë gjithnjë ka sukses që të shprehet në mënyrë origjinale”, derisa “vetëm mendimi i rrejshëm dhe i dobët krijon vepra shprehimisht dobët të shkruara” (116).

Numër i konsiderueshëm shkrimtarësh ka cekur nevojën e mënyrës së natyrshme të të shprehurit. Montenj ka shkruar: “Të folurit që unë e dua është të folurit e thjeshtë e natyror, si i shkruar ashtu edhe i folur, të folurit me zemër dhe i thukët, i shkurtë dhe i ngjeshur ... (të folurit që është) larg artificialitetit..” (201). Kurse Paskal: “Kur shohim stilin natyror, befasohemi dhe entuziazmohemi, sepse kemi shpresuar ta shohim autorin, kurse kemi gjetur njeriun”. (201). Stendal, sikur edhe Zhid, e ka konsideruar stil më të mirë atë që në vete nuk tërheq kujdesin dhe nga i cili më së qarti mugullon mendimi që e shpreh” (212). Dhe, duke e shkruar *Manastirin kartuzian*

parmian, ka lexuar çdo mëngjes nga dy-tri faqe të *Kodit qytetar*, në mënyrë që gjithnjë të jetë i natyrshëm” (202).

Disa kanë folur për rëndësinë dhe rolin e fjalës së vërtetë, të përshtatshme në mënyrën e të shprehurit. Gi de Mopasan (në parathënien e romanit të *Pierre et Jean*) ka shkruar: “Çfarëdo të jetë mendimi që dëshirojmë ta shprehim, ekziston vetëm një fjalë që ajo të shprehet, vetëm një folje që në të ta frymëzojmë jetën dhe vetëm një mbiemër që ta përcaktojmë më afërsisht. Ka nevojë, pra, të kërkohet derisa nuk e gjejmë atë fjalë, atë folje, atë mbiemër dhe kurrë mos të kënaqemi me afërsinë” (77). - Andre Zhid ka theksuar se fjala nuk guxon “kurrë t’i paraprijë mendimit”, por e kundërta, që “mendimi ta bëjë fjalën të domosdoshme”: “Fjala duhet të jetë e paevitueshme, e pamungueshme, e po kjo vlenë për fjalinë, për tërë veprën”, sikur edhe për “tërë jetën e artistit”: vokacioni i tij duhet të jetë i paevitueshëm, që ai nuk mundet e të mos shkruajë” (194-195). Në vendin tjetër (116), autori i njëjtë flet se si shpesh ka pritur që në frymën e tij të sajohet fjalia që ta shkruajë, derisa, sipas mendimit të tij, më mirë mbase do të ishte që fjalia të kapet për skajin që më herët vjen te dora, - për koke ose për bishti, - duke mos e njohur në atë çast pjesën tjetër të fjalisë”, e kur të tërhiqet fundi, pjesa tjetër vetë do të vijë”. (116)

8. Vështirësitë e thirrjes së shkrimtarit

Shumë shkrimtarë francezë kanë pasur mendim të lartë për thirrjen e vet të shkrimtarit, ata e kanë dashur dhe lavdëruar. Por, si duket, më të shpeshtë kanë qenë ata që e kanë konsideruar barrë dhe nganjëherë i kanë drejtuar madje edhe fjalë blasfemuese. Prudoni (P. J. Proudhon) këtë thirrje e ka quajtur “rrëqethëse” (142),

kurse Sent-Bev e ka krahasuar me takëmin e kalit, i cili gërvisht e godet (141). Alfred de Vinji dëfton në 'fatalitetin' e karrierës letrare "që në të pozita kurrë definitivisht nuk është arritur" dhe siguruar": emri i shkrimtarit, me paraqitjen e çdo vepre të re, "sërish vihet në short", "qet kuturu me zar"; çdo vepër e re paraqet "pothuajse ndonjë fillim". Shkrimtari nxjerr nga gjithë kjo përfundimin e përgjithshëm: "Karriera letrare nuk është kurrfarë karriere". (148-149)

Sidomos, sipas disave, kjo thirrje është e rëndë për një fillestar, i cili duhet patjetër të ballafaqohet me pakëndshmëritë, në rend të parë me përfilljen e redaktorit dhe lexuesve. Romon Rolan i shkruan mikut të vet Luj Zhije në janar të vitit 1902: *"Unë i njoh pakëndshmëritë për të cilat flitni. Pas kthimit tim nga Roma, duke vendosur që mos të ligjëroj por të jetoj nga pena, kam propozuar në fillim ... shumë fletushkave që t'ua dërgoj recensionet e solemniteteve: asnjë prej tyre nuk m'u përgjigj. Menjëherë pas ardhjes në Paris u përpoqa ta shkruaj për një revistë një artikull për Mocartin; dhe, sigurisht, nëse artikujt e mi të paradokshëm për Betovenin dhe për Vagnerin diç vlejné, artikulli për Mocartin nuk ka qenë aspak më i keq (një ditë sërish e kam lexuar); madje është dashur që ai të hasë në interes më të gjallë pasi që vinte nga pena e një të riu. G. Mono (Mond) më ka propozuar që ai t'ia ofrojë ndonjë fletushke; dhe pasi që ky bamirës më tepër është shërbyes se sa i gjindshëm, ka arritur aq sa e ka pranuar vetëm një fletushkëz destinuar zonjushave (ia kam harruar emrin), që e ka redaktuar Zhil Simon. E edhe kjo nuk ka qenë pa kushte. Sekretari i fletushkës më ka shkruar se si duhet që artikullin tim ta shkurttoj në gjysmë dhe se do të ishte mirë që në fund të flas për Gunonë (Gounod), pasi që Guno ka qenë mik i Simonit, dhe se kjo do t'i shkaktojë kënaqësi Zhil Simonit. - U flakërova nga millesi kur e pranova këtë letër ... Sa ditë, net kam kaluar duke pritur në përgjigjet e auditorit, drejtorit, lektorit, herë-herë prej qëllimmirëve, më së shpeshti qëllimkëqijve, gjithnjë mospërfillëse ..."* (150-151).

E megjithatë, duket se vëllezërit Gonkur në lëkurën e vet më së miri i kanë ndier mjerimet e thirrjes së shkrimtarit dhe i kanë pasqyruar fuqishëm në *Ditarin* e tyre (142-143): *“Çfarë është jeta - ajo jeta e shkrimtarit! Në momente, unë e mallkoj dhe e urrej. Ato ditë kur emocionet të ngarendin njëri pas tjetrit te ju! Ato kodra të shpresave që rriten dhe rrënohen! Ai vargim i amshueshëm i iluzioneve dhe dëshpërimeve! Ato orë të amshuesisë kur njeriu pret pa kurrfarë shprese! Ato çaste të shqetësimit, sikur sonte, kur e hulumtoni fatin e librit tuaj në raftet e librarive dhe kur ju brenë ndonjë shtrëngesë, për ju e panjohur, para vitrinës në të cilën nuk është ekspozuar libri! Më në fund, gjithë ajo kapsallitje e mendimit dhe ndjenjave tuaja - gjithë kejo ju rrabë, ju pështjell, ju rrokullisë, sikur valët - të përmbyturin.”*

Elaboration d'un ouvrage scientifique

Le présent livre, intitulé *ELABORATION D'UN OUVRAGE SCIENTIFIQUE*, est destiné à tous les jeunes spécialistes qui veulent être initiés au travail de recherche scientifique, et plus particulièrement aux étudiants de 3^e cycle et aux candidats au doctorat qui préparent une thèse.

Il y est question des principes essentiels de la méthodologie et de la technique du travail scientifique. En suivant, du début à la fin, le processus d'élaboration d'un ouvrage scientifique, l'auteur, M. Šamić, en traite toutes les étapes importantes, et un chapitre est consacré à chacune d'elles. Ces chapitres ont pour titre: Le choix du sujet, A la recherche de la documentation, Le rassemblement des matériaux, L'organisation et la disposition des matériaux rassemblés, La rédaction du manuscrit, La base documentaire du manuscrit, La soutenance d'une thèse. L'exposé de chaque étape est accompagné de quantité d'exemples et de conseils pratiques. A la fin du livre, après la bibliographie, on a imprimé, en annexe, deux études de l'auteur relatives au processus de création et au créateur.

L'auteur a pris pour base de ce livre à la fois son expérience personnelle et celle des autres: il a, en effet, consulté une bibliographie étendue, qu'on trouvera à la fin.

Ce livre a trouvé un bon accueil chez les lecteurs auxquels il est destiné, comme en témoignent ses cinq éditions dans un court laps de temps, ainsi que de nombreux comptes rendus parus dans les revues et les journaux yougoslaves.

Summary

The book "How To Write A Research Paper ..." is primarily intended for the graduate students who are obliged to write their M. A. and Ph. D. theses, as well as for any young researcher who is in need of an introduction into research work.

General principles of methodology and research technique are presented in the book. Following the process of creation of a research work from the beginning to its completion, the author discusses all the important phases of the process. Each phase is given in a separate chapter. They are as follows: selection of topic, search for documentation, collecting of material, organization and arranging of the material, manuscript correcting, documentary basis for the manuscript, stylistic properties and grammatical correctness of the paper, technical set up, printing, and if it is a thesis, the defence of it.

Description of each phase is supplemented with quite a number of examples and figures as well as with numerous practical suggestions. At the end of the book, along with bibliography, two previous author's works dealing with the researcher and his writing are included in the appendix.

The book, which is the result of the present author's experience, as well as the result of the experience of many others (extensive bibliography used in the process of the writing of the book is attached), has had a

warm reception from the readers it was intended for. The book has been re-printed five times in a relatively short period of time and has obtained a number of favourable reviews in Yugoslav professional journals, periodicals and dailies.

Treguesi i emrave

A

Adam (Antoine), 162
Alain, 102
Albalat, 211
Almack (John Conrad),
24, 26, 27, 48, 63, 267
Andrić (Ivo), 85
Arnoux (Aleksandre),
301

B

Balzak (Honore de), 68,
217, 297, 303
Barac (Antun), 161, 178
Barzun (Jacques –
Martin), 149, 180,
203, 204, 263, 267
Bellay (Joachindu), 303
Bihalji - Merin (Oto), 77
Blank (Henry Z.), 162,
176
Block (Richard), 290
Bogdanović (Milan),
164
Braibant (Charles), 267

Breton (Andre), 300
Buffon, 180, 299

C

Camp (Maxime du), 293
Car (Marko), 114
Chamson (Andre), 152
Chatelet (Maquise de),
303
Cordaso (Francesco),
267

Ç

Çajkovski (Petar Ilić),
273

D

Dahl (Robert A.), 169
David (Pierre), 162, 175
Dewey (Mellvill), 62
Djordjević (Slobodan),
73
Djurdjinov (Milan), 176
Dow (Earle Wilbur),
267
Dubić (Slavoljub), 16

Dutcher (G. M.), 162
Dykmans (Gommaire),
42, 161, 162, 169

E

Eckermann (Johann
Peter), 267
Ehrlich (Eygene), 148
Engels, 163

F

Fargue (Leon-Paul), 284
Feydeau (Ernest), 305
Frank (Otto), 267
Fustel (de Coulanges),
136

G

Garamond (Claude),
234
Gardiner (Alan), 163
Gattner (Elliot S. M.),
267
Gide (Andre), 64
Good Carter (Victor),
267
Gorki, 145
Gounod, 307
Graf (Henry Franklin),
149, 150
Graffigny (Madame de),
303
Gross (Mirjana), 164

H

Hamm (Josip), 165
Helmboltz, 132
Horacie, 193, 278
Horvat (Radislav N.),
216, 233, 238, 268
Hubbelle (George
Shelton), 268
Hugo (Victor), 280
Hutschins (Margaret),
268

I

Ibrovac (Miodrag), 74,
75, 78, 85, 115
Ingres, 289

J

Jackson (Bernetta M.),
162, 269
Jacob (Max), 284
James (William), 33
Joussain (A.), 176

K

Knight (Frank K.), 76
Kuntze (Horst), 268

L

Lanson (Gustave), 36,
52, 162, 185, 268
Leggett(Glen), 268
Lenjin, 163
Lundberg (George A.),
27

M

- Maixner (Rudolf), 77,
163, 170
Malcles (Louise-Noëlle),
268
Marković (Svetozar),
165
Marrou (H.), 131
Marx, 163
Mead (C.David), 268
Miller (Henry), 276
Mornet (Daniel), 73
Mozart, 271, 307
Murphy (Daniel), 267

N

- Nodier (Charles), 170

P

- Petre (Fran), 78
Petrović (Ljubomir),
268
Picard (Gaston), 301
Pijuković (Nikola), 238,
268
Plinije Stariji, 275
Polanščak (dr Antun),
164
Pope (Alexandre), 193
Popovic (Bogdan), 17,
32, 36, 76, 193, 268
Pound (Ezra), 181
Prevost (Jean), 304
Prevost-Paradol, 291
Proudhon (P.J.), 306

- Putanec (Valentin), 77

R

- Raymond (Jean-Paul),
175
Richelieu, 81
Roland (Romain), 164

S

- Sainte-Beuve, 303, 307
Saint-Simon, 285
Samaran (Charles), 268
Sanders (Chauncey),
269
Sandoval (E. de), 114
Schneider (Marcel), 76
Schopenhauer (Arthur),
269
Selimović (Meša), 164
Somaize, 143
Soupault (Philippe), 301
Spasić (Aleksandar), 73
Stevenson, 215

Sh

- Šamić (dr Midhat), 65,
77, 78, 85, 90, 161,
163, 174, 175, 309
Shakespeare, 41
Shelton, 112, 161, 268
Škerlić (Jovan), 114, 178
Škreb (Zdenko), 78, 165

T

Taine (Hippolyte), 294
 Tautović (Radojica), 76
 Tkalec (Natasa), 163
 Trubaian (Kate), 269
 Trublet (Abbe), 152

U

Unwin (Stanley), 269

V

Valery (Paul), 284, 295,
 302, 304
 Van Steenberghen
 (Fernand), 269
 Vigny (Alfred de), 287,
 297, 307
 Viner (Jacob), 176

Vivian (Charles H.),
 162, 269

Vobleč (K. T.), 140, 269

Vučković (Radovan),
 166

Z

Zola (Emile), 295

W

Warren (Austin), 73

Wellek (Rene), 73

Wilde (Oscar), 175

Wright (Neill), 269

Ш

Шевяков (Lev
 Dimitrievi~), 269

Pasthënia e botuesit

Prej Gutenbergut deri te mileniumi i tretë

Hyrje

Si datë e fillimit të tipografisë (shtypit) moderne merret data 1450, në të cilën Johannes Gutenberg, në qytetin Mainz, e përfundoi shtypjen e Biblës së vet me 42 rreshta. Ky vit, pikërisht për këtë arsye, merret edhe si përfundim i mesjetës dhe fillim i kohës së re.²⁴⁹

Epoka e re fillon me aksesin e pakufizuar të të dhënave të cilin e mundësoi revolucioni medial i Gutenbergut. Kësaj epoke tash i kanoset epoka tjetër, e informatikës, në të cilën dominon procesi i digjitalizimit. Informatat e digjitalizuara që qarkullojnë në rrjetin komunikues, hapin rrugë në ardhmërinë jo fortë të qartë, të përcjellë me shtresime sociale dhe teknike, e cila sot, ende, është vështirë të parashihet në të gjitha hollësitë.

Gutenbergu nuk e “shpiku” makinën tipografike, si kjo që përdoret sot, për çka shpeshherë pohohet dhe shkruhet. Gutenbergu e futi teknikën e renditjes së shkronjave të lëvizshme individuale prej plumbi të destinuara për përdorim më të gjatë. “Shpikja” e tij e dytë

²⁴⁹ Pasthënia është marrë nga botimi i fundit i librit Midhat Samic, *Kako nastaje naučno djelo*, botimi IP *Svjelost*, Sarajevë, 2003, fq 173 - 181.

është shkelësi i rrushit (dhe bi-kartolerike) i përshtatur për nevojat e shtypit, me shtojcën e kornizës mbuluese me cipë, petë elastike (timjan). Gutenbergu sipas natyrës së gjërave ishte edhe botuesi i parë (në kuptimin modern), sepse krahas nocionit shtypja e librit domosdo paraqitet edhe nocioni i tirazhit, që do të thotë se libri nuk mund të shitet derisa nuk dihet numri i ekzemplarëve në të cilët është shtypur. Kurse shtypi i librit është proces që vazhdon.

Nuk do të gabojmë nëse konfirmojmë se mjeshtri Gutenberg nuk ishte vetëm “artist i librit”, por në të njëjtën kohë edhe teknik gjenial, risimtar dhe njeri afa-rist, me në fjalë tekniku i parë informatik i botës. E thënë me gjuhën e sotme, Gutenbergu ka krijuar *harduer* brilant, kurse *softueri* përkatës është zhvilluar dhe është depozituar në vetëdijen e bashkëpunëtorëve dhe pasuesve të tij; ndër ta me talentin dhe shkathtësinë e vet veprojnë skalitësi, shkrirësi i shkronjave, radhitësi dhe makinisti. Kurse veprimtarinë librare, pa të cilën shumëzimi i librave nuk do të kishte kuptim, sot do të mund ta quanim përkrahje logjistike.

Me kompjuterët, së pari me futjen e fotoradhitjes dhe digjitalizimin e reproduksionit në ngjyra, e pastaj edhe me aplikimin gjithnjë e më të gjerë të edicionit tavolinor, përgjithmonë dhe nga rrënjët ndryshon natyra dhe struktura e veprimtarisë botuese dhe grafike. Ndërron edhe vendi i punës së çdo punëtori në zinxhir të prodhimit, nga vendi ku sajohet teksti dhe fotografia e deri te shumëzimi. Koncepti i veprimtarisë botuese tavolinore dhe i zyrës, mundëson kryerjen edhe të punëve që deri tash kanë mundur të kryhen vetëm në hapësirat e mëdha prodhuese. Makinën radhitëse të shtypit dhe shtypësin tipografik e rrezikojnë teknologjia e re, teknologjia në të cilën procesi i përgjithshëm i veprimtarisë botuese është kompjuterizuar.

Veprimtaria botuese ka të bëjë me shumëzimin e informacionit në trajtë të tekstit dhe të fotografisë në të shumtën e rasteve në letër: libri, broshura, trakti, informata afariste, skripti, gazeta, revista, magazina e ilustruar, botimet reviale. Dy prodhime tipike, libri dhe gazeta, kanë procedim teknologjik krejt tjetërfare dhe për industrinë tipografike nuk mund të flitet në mënyrë të thjeshtësuar. Libri shkruhet me vite dhe nga ajo ka dobi me vite, por edhe përgatitja dhe shtypi zgjasin disa javë. Gazetat, edhe pse kanë sasi të barabartë shenjash/shkronjash, si edhe libri mesatar, shkruhen për disa orë, shtypen për disa orë, kurse lexohen (përdoren) vetëm disa dhjetëra minuta. Tirazhi i gazetave në kushtet tona është edhe njëqind herë më i madh se tirazhi i librit. Gazetat në këtë shekull kanë përcaktuar zhvillimin e teknikës grafike. Prandaj, është e kuptueshme se kompjuterët së pari kanë filluar të aplikohen në industrinë e gazetave për radhitjen e tekstit. Sot gjenden në të gjitha repartet grafike, kurse plotësisht janë familjarizuar në punët e përgatitjes dhe tekstit.

Konceptin e veprimtarisë botuese të tavolinës e ka propozuar në vitin 1985 Paul Brained nga korporata Aldus, kurse zhvillimit të tij me të madhe i kanë kontribuar punët e përbashkëta të Apple-it, Linotype-s dhe ITC-ut. Apple i ka ofruar tregut kompjuter të shkëlqyeshëm Macintosh, kurse më vonë edhe printerin laser, kurse në formën Adobe që zhvilluar softueri solid i cili ka mundësuar zhvillimin e aksesit të ri të përgatitjes, përpunimit dhe shtypjes së tekstit. Ngjarje me rëndësi ka qenë përpunimi i tekstit. Këtu kompjuterët janë përzier në punët e rezervuara për korporatat e radhitësve grafikë. Ngjarja e dytë që mund të quhet revolucion kompjuterik në veprimtarinë botuese është *Desk Top Publishing*. Interesi për veprimtarinë botuese të tavolinës është i madh dhe mjaft i gjerë sipas distancës: prej pronarit të kompjuterit në shtëpi dhe i të punësuarve në

zyre deri te shkollat, fakultetet dhe institucionet e tjera, përgjithësisht të tërë botës afariste.

Veprimtaria botuese e tavolinës është temë e cila është interesante aq më tepër se çdo ditë sjellë lajme të ndryshme lidhur me softuerin dhe harduerin. Me hyrjen e kompjuterit në fushën e grafikës – së pari në shkrimin e tekstit, e më vonë edhe në përpunimin e fotografisë – ka filluar krijimi i programeve dhe i përkrahjes teknike që është mirëpritur edhe nëpër shtypshkronja.

1. Koncepti i programit për trajtësimin e tekstit

Njëri nga programet aplikative më së shpeshti i përdorura është programi për përpunimin e tekstit. Shumica e përdoruesve të kompjuterëve e përdorë kompjuterin që ndonjë tekst ta përgatisë në kompjuter, ta formësojë në pajtim me kërkesat e tij dhe ta depozitojë për përdorim të sërishëm eventual.

1.1. Regjistrimi i tekstit

Programi standard i kompjuterëve të sotëm është programi për regjistrimin dhe trajtësimin e tekstit. Ky program është konceptuar si program për formimin e faqeve në trajtën në të cilën duhet të paraqiten në shtypës (printer). Për këtë arsye, në program janë komponuar dy pjesë - pjesa për regjistrim dhe përmirësim të tekstit dhe operacionet me pjesët e tekstit – kopjimi, fshirja, rivendosja etj., - dhe pjesa për formatizimin e tekstit, respektivisht sjellja e tekstit në trajtën e dëshiruar. Për këtë pjesë

zakonisht çdo program për regjistrimin e tekstit ka komanda të caktuara të cilat janë përkufizuar me vegla apo me taste funksionale, kurse mund të shihen në ekran vetëm me përzgjedhjen e funksionit përkatës.

Regjistrimi i tekstit kryhet me një program nga grupi i *Word processing*-ut. Shkrimi mund të jetë tre llojesh: përshkrim nga dorëshkrimi i pastër, shkrimi direkt në kompjuter apo përpunimi i tekstit më herët të regjistruar të përgatitur në kompjuter. Gjatë regjistrimit të tekstit dallojnë mënyrat e radhitjes: teksti regjistrohet (futet) nëpërmjet tastierës dhe nuk mbahet llogari për rregullimin e tij, ose qysh e kërkon përkufizimin e llojit të alfabetit (shkrimit), madhësinë e shenjave të shkronjave, gjerësinë e shtyllave dhe të veprimeve të tjera tipografike.

Shkrimi në kompjuter është në njëfarë mënyre si edhe shkrimi në makinën e shkrimit. Tastiera, sa i përket vetë shkronjave, e ka sistemin identik si edhe makina e shkrimit. Këtu shkronjat në vend të letrës paraqiten në ekran. Në ekran e kemi treguesin – kursorin, i cili e pozicionon vendin ku do të vijë shkronja vijuese e shtypur. Teksti në ekran mund të lëvizet poshtë, lartë, majtas, djathtas. Përnjëherë në “dritaren” e ekranit mund të shihen edhe deri në 2000 shenja të lexueshme në punën standarde. Teksti mund të shtypet në letër nëse me kompjuterin është i lidhur shtypësi. Programi për përpunimin e tekstit – procesori i tekstit, i posedon pjesët ndihmëse që shkrimi i tekstit të bëhet punë e këndshme. Nëse duhet diç të shtohet, të ndërhyhet, sërish mund të rregullohet hapësira ashtu që shkronjat sipas dëshirës mund të vendosen ndërmjet fjalëve, rreshtave, faqeve, kurse gjatë kësaj teksti automatikisht risistemohet. Kalimi në rresht të ri është krejtësisht i automatizuar (ose mund të bëhet) dhe për këtë nuk duhet të kujdesemi veçanërisht si në punën me makinë shkrimi. Rrafshimi i shtyllave dhe ndarja e fjalëve mund të zhvillohet gjatë shkrimit, por

edhe gjatë dërgimit të tekstit në shkrimin e “formës përfundimtare”. Programi për shkrimin e tekstit në kompjuter kujdeset edhe për kalimin në faqen tjetër. Teksti i shkruar një herë në kompjuter, mund të shkruhet eksperimentalisht dhe të korrigohet, pastaj mund t’i ndërrohet formati, lloji dhe madhësia e shkronjave dhe ato sërish të shkruhen dhe kështu në pafundësi shumë herë, e që gjatë kësaj teksti nuk ka më nevojë të daktilografohet. Pra mund “të përpunohet” nëpër tekstin e vjetër dhe sërish të korrigohet, tipografisht të rirregullohet dhe “të përsoset” në trajtë e re. Në ndonjë tekst më të hershëm mund të ndahet (kufizohet, bllokohet) një pjesë dhe të përcillet në dokument të cilin pikërisht e shkruajmë.

Programet për përpunimin e tekstit mundësojnë ndarjen e ekranit në pjesë (dritare) sipas dëshirës, të cilat mund të palohen në disa nivele. Çdo dritares i caktohet destinimi: dritarja për regjistrimin e tekstit, dritarja për kopjimin e tekstit, dritarja për tekstin e formatizuar, dritarja për vizatim, dritarja për shenja të veçanta. Përcjellja e aktivitetit nga një dritare në tjetrën bëhet më së shpejti me anë të miut (maus). Përmbajtja e një dritareje mund të përcillet në dritaren tjetër; gjatë kësaj, aktiviteti i përcjelljes së pjesës së tekstit nga një dritare në tjetrën mund të përcillet në ekran. Po ashtu, mundemi grupin e teksteve (datoteka) ta kopjojmë nga një bibliotekë në tjetrën. Dritaret mund të sajohen dhe të fshihen gjatë cilësdo fazë të punës.

Kërkimi është funksion i veçantë i procesorit të tekstit dhe kjo nuk mund të krahasohet me asgjë nga koha kur tekstet i kemi përgatitur në makinën e shkrimit. Funksioni “kërko” mundëson kërkimin e shenjave ose të shprehjeve të caktuara në tekst dhe pozicionimin në vendin ku gjendet vargu i kërkuar i shenjave. Kërkimi shpesh kombinohet me funksionin “ndërro”, d.m.th. kërko dhe ndërro. Në këtë mënyrë është mundësuar konversioni i

shenjave dhe shkronjave, me ç'rast krijohet teksti i ri në të cilin "përkthimi" është kryer në mënyrë shembullore.

1.2. Thyerja e faqes

Faqja e thyer më së shumti e manifeston disenjatorin, idetë, përvojën dhe veçoritë e tij. Kur të caktohet formati, numri i shtyllave dhe radhitja e nënkaptinave nëpër faqe, duhet zgjedhur fontin, respektivisht llojin e shkronjave që do të përdoret në libër (revistë, gazetë).

Problem i veçantë paraqet planifikimi i ilustrimeve. Të supozojmë se të gjitha ilustrimet në kompjuter janë vizatuar apo janë skanuar me programet e grafikës kompjuterike. Nëse e shkruajmë fotografinë së bashku me tekstin, atëherë programet mundësojnë rezultate të ndryshme: sistemimi i fotografive dhe zgjedhja e rasterit varet nga disa faktorë. Përpunimi i fotografisë ose i shumë fotografive në faqe kërkon kompjuter të shpejtë, çfarë sot i kemi edhe në aplikimin e DTP-së (Desk Top Publishing) shtëpiake.

Radhitja e relacioneve matematikore gjithnjë ka qenë punë e veçantë grafike – e veçantë për shkak se dinin ta përpunonin vetëm radhitësit me përvojë të madhe, si dhe nga shkakku se për realizimin e librit matematikor është pritur edhe ndonjë vit, prandaj gjuha matematikore manipulon me mbi 400 shenja të veçanta. Radhitja matematikore në radhitjen e përgjithshme që e realizojmë nuk është aq e parëndësishme. Relacionet matematikore i kemi thuajse në të gjitha publikimet teknike dhe çdo program për përpunim dhe radhitje të tekstit ka ndonjë zgjidhje për punimin e radhitjes matematikore.

Shkrimi, radhitja, fotografimi dhe disenjimi i materialit për nota është shembull i mirë i gjerësisë së aplikimit të konceptit të DTP-së dhe zgjidhjes së trajtësimit më të

komplikuar grafik me kompjuter. Në alfabetin tonë i përdorim rreth tridhjetë shenja versale dhe po aq shenja kurrencte të alfabetit, dhjetë shenja për shifra dhe rreth njëzet shenja të veçanta. Krahas disa shenjave të veçanta, radhitja librare përdor rreth 120 shenja. Alfabeti muzikor, përkundrazi, njih mbi 500 simbole të ndryshme (muzika klasike, roku, avangarda, muzika e vjetër kishtare), kurse disa simbole paraqiten në disa forma të ndryshme alfabetike dhe këtu mund të flitet edhe për fontet e veçanta, që në mënyrë të konsiderueshme e rrisin numrin e shenjave dhe e komplikojnë punën e radhitjes.

Radhitja e notave me kompjuter mund të ndahet në tri faza: shkrimi i notave në kompjuter, editimi dhe shkrimi i faqes së notave. Sikur që gjatë regjistrimit të tekstit përdoret tastiera e makinës për shkrim ose lexuesi optik, ashtu edhe në punët e regjistrimit të notave në kompjuter përdoret tastiera e pianos me radhitjen tipike të pianos apo tastiera e kompjuterit të cilat notat janë të bashkuara me shenjat e shkrimit. Standardi MIDI (Musical Instrument Digital Interface) shërben për ndërlidhjen e kompjuterit dhe tastierës së pianos.

Sot koncepti i veprimtarisë botuese të tavolinës është bërë i zakonshëm në të gjitha institucionet kompjuterike, në shtëpitë softuerike dhe të firmave të cilat deri para pak kohësh kanë qenë porositës vetëm të aparaturës profesionale për fotoskop. Kombinimi i përpunimit të tekstit, fotografisë dhe desktop publishing-ut ka marrë emrin "document processing" dhe është bërë elementi më i rëndësishëm për aplikimin e gjerë të kompjuterit në afarizmin e zyrës. Trend i veçantë në zhvillimin e desktop-sistemit është integrimi me bazat e të dhënave.

Gjithnjë është konsideruar se paraqitja grafike e të dhënave numerike është shumë më e afërt dhe më e kuptueshme se shtyllat dhe radhët në tabela. Përpunimi manuel i grafive dhe fotografive është punë e bezdissh-

me dhe e mundimshme dhe kërkon shumë kohë. Grafika afariste në hapësirën koordinatave i inkuadron diagramet në X, Y, Z, hapësirat e hijezuara të trajtave të rregullta dhe jo të rregullta gjeometrike e të ngjashme me këtë. Grafika afariste përdoret në të gjitha raportet financiare dhe statistike – përndryshe në çdo publikim që duhet t'i ilustrojë të dhënat numerike.

Në suaza të programit për përpunimin e tekstit ekzistojnë dy grupe të programeve ndihmëse: një grup quhet *veglat* dhe realizon operacione të caktuara mbi shenjën e shkronjës, fjalën, pasusin, faqen apo tekstin, ndërsa grupi i dytë janë funksionet të cilat mundësojnë përmirësimin plotësues të cilësisë së tekstit. Ky është program për verifikimin e korrektësisë së tekstit të shkruar, programi-fjalor, i cili në tekst ofron sinonime të ndryshme, si dhe program për verifikimin e gramatikës dhe mënyrës së të shkruarit.

2. Pajisjet kompjuterike për DTP

2.1. Njësitë hyrëse

Kompjuteri i pranon të dhënat hyrëse nëpërmjet njësisive hyrëse. Detyra e tyre është t'i pranojnë të dhënat nga përdoruesi, t'i shndërrojnë ato në trajtën e pranuar për kompjuterin (në grumbull të shifrave binare) dhe t'i përcjellin në njësinë qendrore në përpunim të mëtejshëm. Pajisja hyrëse e përdorur më së shpeshti është tastiera. Përveç tastierës, ekzistojnë edhe pajisje të tjera hyrëse, por në të shumtën e rasteve janë si plotësim i saj. Këto pajisje bëjnë pjesë në pajisjet treguese, sepse shërbejnë për zgjedhjen e pozicionit në ekran, aty ku gjendet ndonjë e dhënë e nevojshme për përpunim të mëtejshëm.

Në këto pajisje më shpesh përdoret: miu –pajisje treguese e cila lëviz në bazën horizontale, kurse në ekran tregohet pozita e tij momentale. Në anën e sipërme të miut gjenden tastet me të cilat zgjedhen tipat e ndryshëm të komandave. Këtu janë edhe tableti, dorëza për lojë, lapsi optik, sfera komanduese, ekranet e ndjeshëm në prekje etj.

Skeneri është pajisje e cila formën e dokumentit të shkruar nga letra apo nga ndonjë medium tjetër të shtypur e përcjellë në kompjuter në formën digjitale, ashtu që një dokument i këtillë mund të përpunohet sipas dëshirës në pajtim me kërkesat e veprës.

2.2. Njësitë dalëse

Të dhënat që fitohen nga pajisjet dalëse quhen rezultatet e përpunimit të të dhënave. Roli i pajisjeve dalëse janë rezultatet e përpunimit të të dhënave që t'i bëjnë ato më të kapshme për përdoruesin dhe përjetësisht ose përkohësisht t'i ruajnë për përdorim të mëtejshëm. Sipas kohës së ruajtjes së të dhënave, ato i ndajmë në pajisje me shënime të përhershme dhe të përkohshme.

2.2.1. Shtypësit (Printerët)

Pajisjet dalëse të cilat vazhdimisht i shkruajnë rezultatet e përpunimit në formën e kapshme për përdoruesit janë llojet më të ndryshme të shtypësve. Dokumentet e letrës janë dokumente të përhershme, të cilat shërbejnë për përdorim të shumëfishtë të rezultateve dalëse, për dokumentim dhe arkivim. Për këtë arsye roli i shtypësve si pajisje dalëse është i pazëvendësueshëm. Shtypësit janë direkt të lidhur me kompjuterin. Në bazë të të dhënave dalëse binare nga kompjuteri, shtypësi formon

grumbullin e shenjave numerike dhe të shkronjave dhe i shënon në letër. Pasi që në kompjuter përpunohen sasi të mëdha të dhënash, edhe numri i rezultateve dalëse të përpunimit është i madh. Kështu para shtypësit vendosen shumë kërkesa, ndër të cilat më të rëndësishmet janë shpejtësia e shtypjes dhe siguria.

2.2.2. Ekranet

Rëndësia e ekranit është në atë që ata sot paraqesin mjetin kryesor të komunikimit dhe kompjuterit. Asnjë pajisje tjetër dalës nuk siguron mënyrë aq të pasur dhe efektive të prezantimit të informacioneve. Kompjuterët e sotëm të gjitha objektet në ekran i vizatojnë nëpërmjet një varg pikash – pikselesh. Çdo pikë i ka karakteristikat e saj. Sipërfaqja e ekranit kundrohet si sipërfaqe në kuadrantin e djathtë të sipërm të sistemit koordinativ në rrafsh (vlerat pozitive të koordinatave X dhe Y). Tërë sipërfaqja është ndarë në pika. Çdo pikë në sistemin koordinant e ka pozicionin e saj direkt të përcaktuar me koordinatat X dhe Y. Këto koordinata, si edhe të gjitha të tjerat në kompjuter, shkruhen me anë të shifrave binare, ashtu që koordinatat e pikës paraqesin dy vija bitësh – fjalë kompjuterike (për pozicionin X dhe pozicionin Y). Përveç kësaj, është e nevojshme të dihen edhe karakteristikat e tjera të pikës (ngjyrës, ndriçimi etj.). Secila nga këto karakteristika gjithashtu regjistrohen me një varg bitësh – fjalësh. Prandaj, për çdo pikë duhet numër i caktuar i fjalëve që të shkruhen. Nëse me anë të vargut të pikave e komponojmë një objekt – shkronjë apo fotografi, atëherë na nevojitet renditja e të gjitha pikave në atë objekt me karakteristikat e tyre. Kjo renditje e pikave quhet harta e pikave, ndaj edhe mënyra e prezantimit të fotografisë quhet bit-harta. Sa më i madh të jetë numri i pikave në ekran, aq fo-

tografia e objektit do të jetë më cilësore. Numri i pikave mbi njësinë e sipërfaqes është rezolucioni.

Mënyra tjetër e mbamendjes së pozicionit të pikës bëhet nëpërmjet vektorit. Pozicioni i pikës mbahet mend me anë të koordinatave të pikënisjes së vektorit, gjerësisë së tij dhe këndit në raport me boshtin x. Krahas kësaj, vektorit i jepen edhe karakteristikat e tjera – ngjyra, ndriçimi etj. Gjatë kësaj tërë vektori përshkruhet me tipin e njëjtë të karakteristikave, respektivisht të gjitha pikat e tij i kanë karakteristika të njëjta, për dallim prej bit-hartës, ku çdo pikë i ka karakteristikat e saj.

Diversiteti i këtyre mënyrave të përshkrimit të objekteve manifestohet në operacionet me objektet. Te bit-harta çdo ndryshim i madhësisë së objektit mund të sjellë deri te keqësimi i cilësisë së fotografisë së objektit, për shkak se tërë sistemi koordinant “zgjatet” (shtrihet) dhe me këtë ndërrohet distanca ndërmjet pozicioneve, gjë që i kontribuon keqësimin të cilësisë së fotografisë. Nga ana tjetër, te fotografitë e skanuara – fotografitë të cilat po ashtu janë skanuar pikë për pikë, është e mundur që duke e përdorë bit-hartën shumë thjeshtë të kryhet ndërrimi në fotografi. Te shënimi i vektorit nuk ka ndryshim në cilësinë e fotografisë kur e ndryshojmë nivelin e vështrimit të objektit, kurse përpunimi i pjesëve individuale të ndonjë objekti është më i thjeshtë, nëse nuk ka të bëjë me objektet të cilat janë paraqitur si një varg pikash. Programet bashkëkohore kryesisht i kanë të dy mënyrat e prezantimit të objekteve, kurse përdoruesi mund të zgjedhë se cila mënyrë mund të përdoret në rastet e veçanta.

2.3. Memoret periferike

Edhe përkundër shpejtësisë së madhe të punës dhe kapacitetit të madh, memoria qendrore nuk është e për-

shtatshme për ruajtje të përhershme të të dhënave, *e para* për shkak se kapaciteti i saj nuk është i atillë që të mund të ruhen të gjitha të dhënat dhe programet e domosdoshme për të gjitha përpunimet të cilat kryhen në kompjuter dhe, *e dyta*, për shkak se përmbajtja e qelizave memorike ndërrohet gjatë punës dhe ashtu përmbajtja paraprake fshihet. Për këtë shkak për vendosjen e të dhënave të nevojshme për punimin e kompjuterëve në ndonjë proces të përpunimit, përdoren njësitë memorike të cilat janë të ndara nga njësia qendrore (në periferi) dhe quhen memorie periferike, memorie ekstere, të jashtme ose aparatura memorike periferike.

Karakteristikat e këtyre memorieve janë:

- Mundësia e shënimit të përhershëm të të dhënave dhe ruajtja e asaj të dhëne për periudhën e caktuar kohore;
- Mundësia e aksesit të kësaj të dhëne që të sillet në memorien qendrore gjatë procesit të përpunimit;
- Aksesimi më i ngadalësuar i të dhënave në raport me të dhënë të cilat gjenden në memorien qendrore;
- Memorizimi shumë më i madh, gati i pakufizuar i të dhënave të memorizuara.

Memoriet themelore periferike janë disku dhe diske-ta me shënim magnetik dhe disku optik me shënim optik të të dhënave.

3. Trajtësimi i tekstit dhe interneti

Gjatë disa viteve të kaluara ka ndodhur revolucion i vërtetë në botën e rrjeteve telekomunikuese, d.m.th. në botën e cila ka mundësuar ndërlidhjen e kompjuterëve në mënyrë që të mund të këmbejnë informatat. Për këtë qëllim lindi edhe Interneti, i cili paraqet rrjetin e rrjeteve

kompjuterike, e jo një rrjet si mendohet zakonisht. Ky është rrjeti më i madh edhe për nga shtrirja edhe për nga numri i kompjuterëve të lidhur, si edhe për nga numri i përdoruesve. Interneti u mundëson individëve nga një rrjet t'i ndajnë informatat me përdoruesit në rrjetin tjetër në largësi prej mijëra kilometrash, kurse informatat që ndahen mund të jenë në forma të ndryshme (p.sh.: shënim me video, zë, tekst, grafika etj.).

Në komunikimin, të sendërtuar në këtë mënyrë, kompjuterët "bisedojnë" duke përdorë modelin i cili quhet klient/server. Serverët ose shërbëtorët janë kompjuterë (ose programe) të veçantë të cilët ofrojnë shërbim të caktuara në rrjet ose në Internet. Aty gjenden të dhënat të cilat mund të kontrollohen dhe në to kanë akses të gjithë që janë në rrjet, kurse kërkimin e të gjitha të dhënave të disponueshme në server e bën klienti, i cili mund të jetë kompjuteri ose programi softuer, ai që e ka rolin e përdoruesit të shërbimeve të serverit. Pra, përdoruesi si pjesëmarrës skajor në komunikim nëpërmjet ndonjë programi (browseri) kërkues në kompjuterin e tij (i cili në mjedisin e vështuar paraqet klientin) ka mundësi t'i shfrytëzojë të dhënat në formën HTML - faqja gjegjëse e Internetit.

Koncepti i theksuar mundëson që përdoruesi me anë të kompjuterit të tij dhe rrjetit të Internetit, kurse me anë të World Wide Web (WWW), të rivendosë lidhje me ndonjë server, i cili mund të jetë kudo në botë dhe t'i shikojë dokumentet dhe të dhënat e vendosura në bazën e të dhënave të tij. Tërë skenari duket mjaft i thjeshtë nga aspekti i përdoruesit, sepse ai është i vetëdijshëm vetëm për faktin që në ekranin e kompjuterit të tij t'i marrë web dokumentet me atë radhë ose me atë tematikë që ai e zgjedh. Mundësia e renditjes së zgjedhjes së këtyre dokumenteve është e llojlojshme, pikërisht si gjerësia e hulumtimit në internet, e cila është mjaft e madhe, e që krijon mundësinë për mbistrukturimit të sërishëm të ekzis-

tueses dhe shtimin e asaj që është krejtësisht e re, me qëllim të plotësimit të nevojave të përdoruesit. Duke e përdorur internetin, për një kohë shumë të shkurtër, mund të keni qasje në të dhënat e nevojshme dhe t'i tuboni të dhënat e dëshiruara, por tash shtrohet pyetja si funksionon tërë kjo dhe si është e mundur tërë kjo.

Ideja nga e cila është zhvilluar World Wide Web ka lindur në pranverë të vitit 1989. Tim Berners-Lee nga laboratorin evropian për fizikë nukleare në Zvicër, CERN, propozoi formimin e sistemit hipertekstual i cili do të mundësojë këmbimin e thjeshtë të informative ndërmjet ekspertëve nga e tërë bota. Krahas kësaj, qenë shtruar dy kërkesa: mundësia e paraqitjes së dokumenteve të llojeve të ndryshme dhe mundësia e aksesit dokumenteve nga tërë bota. Po ashtu është kërkuar që softueri me të cilin do t'i qasemi WWW-së të bëhet krejtësisht falas dhe në të jetë në disponim të të gjithëve. Për përpunimin e web-faqeve është hartuar gjuhë e posaçme - HTML (Hyper Text Markup Language). Protokollin me të cilin Web-faqet dhe të dhënat e tjera transmetohen ndërmjet klientëve dhe shërbëtorit quhen HTTP (HyperText Transfer Protocol).

Për përdoruesin Web-i është koleksion i dokumenteve ose faqeve të cilat përmbajnë tekst, fotografi si edhe lidhje hypertext (linqet) kundrejt faqeve të tjera. Përdoruesi i largët, duke i përdorur disa nga programet kërkuese, e vë në lëvizje ndonjërin nga adresat në server (sipas zgjedhjes së tij) dhe si rezultat i kësaj zgjedhjeje e fiton dokumentin HTML (respektivisht, home page - faqen amë në serverin e kërkuar). Përndryshe HTML paraqet një lloj gjuhe universale për hartimin e dokumenteve hipermediale, kurse vetë aplikimin HTML mund ta imagjinojmë si një faqe e cila përmban tekst dhe fotografi të formatizuar. Përdoruesi arrin të të dhënat duke i zgjedh temat e ofruara ose duke dhënë çelësat për kërkim e duke futur një nocion në formë të destinuar ndaj këtij

qëllimi. Nga aspekti i tij kjo do të dukej sikur të dhënat gjenden në kompjuterin e tij dhe vetëm duhet t'i marrim në çastin e caktuar, d.m.th. kur për to jepet rasti.

Kur përdoruesi nëpërmjet programit të tij kërkues (browserit) ka dërguar kërkesën për faqe të re, me anë të protokolit HTTP vendoset lidhja me serverin. Së pari është e nevojshme të konstatohet se kërkesa e pranuar ka të bëjë me faqen statike ose dinamike të HTML-së, e cila si rezultat do t'i kthehet përdoruesit. Nëse është fjala për faqen statike, e cila është përgatitur si dokument HTML, ka mundësi që ajo menjëherë t'i kthehet përdoruesit, i cili do ta shikojë me ndonjë nga programet kërkuese që i ka në dispozicion. Kjo është e mundur për shkak se ai nuk kërkon të dhëna nga baza, d.m.th. dokumenti statik vetëm duhet të lexohet. Në rast të kërkesës për faqen dinamike, e cila në vete duhet të bartë të dhëna nga baza e caktuar e të dhënave, kthimi i përgjigjes së klientit në formë të faqes HTML është diç më e komplikuar, sepse duhet të bëhet marrja e të dhënave nga baza.

Në bazë mund të depozitohen teksti, fotografitë dhe shënimet tonike e pastaj në video që me anë të interfejsit përkatës të sigurohen dhe ekspozohen përdoruesit skajor në formën e dokumentit HTML, kurse për shkak të të dhënave të theksuara që mund t'i përmbajnë, është korrekte të quhen edhe hipertekstuale, d.m.th. hipermediale. Hipermedia është nocion i cili ka të bëjë me dokumentet hipertekstuale të cilat përveç tekstit përmbajnë edhe objekte multimediale si fotografi dhe shënimet tonike edhe për video. Mënyra e këtillë e organizimit të informatave quhet aplikacion hipertekstual, d.m.th. hipermedial. Krahas tyre të mund të prezantohen edhe lidhjet hipertekstuale të cilat në mënyrë të ndërsjellë mund t'i lidhin edhe dy dokumente të vendosura në skajet e ndryshme të botës dhe shumë elemente të tjera të cilat e

përbëjnë dokumentin HTML, ashtu që përdoret protokoli komunikues HTTP.

World Wide Web i mundëson çdo përdoruesi të Internetit që të ketë akses në çdo informacion të depozituar në rrjet pa njohjen e mënyrës në të cilën ato informacione transferohen dhe depozitohen. Bazat hipermediale të Web-it i zgjerojnë potencialet e Internetit dhe njerriut që nuk merret me kompjuter i ofrojnë mundësi që në mënyrë të thjeshtë të marrë dhe të shpallë informacionet, mendimet, shënimet multimediale dhe materialet e tjera para publikut milionësh përgjatë tërë botës.

Ajo që Web-in e bënë veçanërisht interesant dhe argëtues është fakti se faqet që përmbajnë informacione mund të depozitohen në të gjitha llojet e mundshme të kompjuterëve të vendosur në tërë rruzullin tokësor. Vetë faqet mund të jenë mjaft dokumente të komplikuar, por kjo u jep fuqi e cila manifestohet në mundësitë e lidhjes hipermediale të dokumentit.

Me rëndësi është të thuhet se këtu kemi të bëjmë me hipertekstin, respektivisht hipermediumin, karakteristika themelore e së cilës është organizimi jolinear, ndërsa rrjedha e këtyre informacioneve varet para së gjithash nga zgjedhja momentale e përdoruesit.

Servisi më së shumti i përdorur është protokoli HTTP i punuar për përcjelljen e të dhënave në World Wide Web. Sintaksa e cila përdoret te adresa HTTP është: `http://<host:> <dera> / <shtek >? <kërkimi>`

Host është adresa e Internetit të serverit WWW, pas së cilës pason numri i derës me anë të së cilës kryhet bashkimi. Udhëtimi i tregon serverit WWW se cilën datotekë e dëshiron. Pjesa e fundit e adresës që është përcaktuar si "kërkim" mund të përdoret për transferimin e të dhënave të caktuara, d.m.th. parametrave, serverit, respektivisht programit ekzekutiv i cili për ata parametra në bazë do ta bëjë kërkimin. Këto të dhëna nga doku-

menti HTML merren me anë të shembullit, i cili përdoret i mundëson që në to të shkruhen të dhënat.

Ekzistimi i DTP-së sigurisht ndikon në industrinë grafike. Shtypshkronjat tash kanë mundësi që t'i heqin nga procesi i prodhimit teknologjitë e vjetruara dhe përgatitjen për shtyp ta marrin drejtpërdrejt nga kompjuteri. Me këtë hapet mundësia e shtypjes së materialit që deri sot nuk kanë qenë i mundur të shtypet nga aspekti i tirazhit, vazhdimësisë dhe shpenzimeve. Këto, për shembull janë, dokumentet e organizatave punuese, skriptet për një vit e të ngjashme.

Ndryshimet që momentalisht ndodhin në teknologjinë grafike zakonisht quhen valët e katërta inovative. Sipas kësaj ndarjeje, vala e parë ka qenë me zbulimin e makinës për radhitje dhe kjo periudhë shtrihet nga fundi i shekullit XIX deri në gjysmë të shekullit XX. Valën e dytë të inovacioneve në vitet e gjashtëdhjeta e solli aparati i fotoradhitjes, kompjuterët e parë me programet për ndarjen e fjalëve dhe programet për përjashtimin e rreshtave, si dhe skanerët e parë për reprodukimin analog të fotografive shumëngjyrëshe. Valën e tretë inovatore e karakterizojnë sistemet integruese adekuate, të cilët me shumësinë dhe laramaninë e tyre të standardeve edhe sot dominojnë në prodhimin grafik.

Përkundër kësaj, vala e katërt inovatore është karakterizuar me shembuj të atyre standardeve industriale që kanë lindur në degët e tjera industriale, kërkimet kozmike dhe teknikën telekomunikuese. Aplikimi i kompjuterëve të veçantë në këtë fushë është vetëm njëra nga karakteristikat e jashtme të kësaj ndodhie, kurse ndryshimet e mirëfillta janë shumë më largpamëse. Aplikimi i kompjuterit në veprimtarinë botuese i bashkon disa fusha. Në rend të parë përpunimin e tekstit, shfrytëzimin e bazës së të dhënave dhe integrimin e tekstit dhe fotografisë me ndihmën e editorëve grafikë. Fushën tjetër të këtyllë e formojnë pa-

jisjet për publikim dhe shumëzim me mundësinë e trajtësimit të lartë profesional të tekstit. Nga kjo mund të thuhet se në koncept të veprimtarisë botuese të tavolinës dhe të zyrës është inkuadruar përvoja e përgjithshme e shtypshkronjës dhe trajtësimit artistik. Dega e grafikës merret me teknologjinë e veprimtarisë botuese, gjegjësisht të publikimit. Të publikohet d.m.th. të shpallet, të nxirret në dritë, kurse nënkupton përgatitjen dhe shtypjen e materialit të shtypur dhe futjen e tij në distribuimin publik. Të publikohet d.m.th. publikisht të prezantohen idetë, me dëshirë që opinioni t'i pranojë dhe të gjykojë për to. Desk Top publishing mundëson prezantimin e ideve duke i publikuar. Ai po ashtu mundëson që individët të bëhen botues në kuptimin profesional. Deri para pak kohësh kjo nuk ka qenë e mundur, sepse procesi i shtypit, i shumëzimit dhe përgjithësisht i botimit ka qenë shumë i shtrenjtë, shumë i komplikuar dhe i gjatë. Fjala e parë – desktop – udhëzon në mënyrën e realizimit të formës tekstore dhe të informacionit. Tërë teknika, tërë hardueri dhe veglat e tjera të nevojshme për zbatimin e disa detyrave janë në duar dhe në “tavolinë” (desk) para personit i cili e përgatit dhe e shumëzon radhitjen e trajtësuar grafike.

Disa vepra të dr. M. Shamiqit*

- Les voyageurs français en Bosnie à la fin du XVIII^e siècle et au début du XIX^e et le pays tel qu'ils l'ont vu. (Paris, M. Didier, 1960. Coll. "Études de littérature étrangère et comparée, No. 38.)

- Francuski putnici u Bosni na pragu XIX stoljeća i njihovi utisci o njoj. (Sarajevo, Veselin Masleša, 1966.)

- Francuski putnici u Bosni i Hercegovini u XIX stoljeću (1836 – 1878) i njihovo vidjenje ovih zemalja. (Sarajevo, "Veselin Masleša", 1980.) Knjiga II.

- Istorijski izvori Travničke hronike Ive Andrića i njihova umjetnička transpozicija. (Sarajevo, Veselin Masleša, 1962.)

- Iz strane uporedne književnosti, (Sarajevo, Svjetlost, 1968.)

- Metodika nastave i tehnička učenja živih jezika, (Sarajevo, Svjetlost, 1959.)

- Panorama de la littérature française. Textes choisis d'auteurs français du Moyen age a nos jours (me vërejtjet hyrëse, komentim dhe shpjegime). (Sarajevo, Zavod za izdavanje udžbenika, 1971.)

* Në botimin shqip po i theksojmë vetëm disa vepra të prof. dr. Mid'hat Shamiq. *Bibliografia më e plotë, por jo e tëra gjendet në: Kako nastaje naučno djelo*, botimi V, Sarajevë, prej nga edhe e kemi bërë përkthimin në gjuhën shqipe. Përkthyesi.

- Ličnost, djelo i doba A. Žida u svjetlu njegova dnevnika, Književna studija, (Sarajevo, izd. Akademije nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine, 1976.)

Studije i ogledi. (Sarajevo, Svjetlost, 1982.)

Rasprave i članci:

»Molijerova komedija-balet Uobraženi bolesnik«

»François Rabelais«

»Quelques échos de la légende et de l'époque napoléoniennes dans la littérature yougoslave« (Revue de littérature compare, Paris, 1958)

»La connaissance de la littérature française dans la Yougoslavie d'aujourd'hui, 1945-1960« (Culture Française, Paris, 1962)

»Jedna francuska naučna ekspedicija u Bosni i Hercegovini 1898 g.« (Glasnik arhiva Bosne i Hercegovine, 1962)

»Opis putovanja Pjera Leskalopjea kroz naše zemlje 1574. godine« (Glasnik arhiva Bosne i Hercegovine, 1963)

»Un coup d'oeil sur les traductions serbo-croates des écrivains français dans la Yougoslavie d'aujourd'hui, 1945-1963« (*Annales de l'Institut Français de Zagreb*, 1961-1964)

»Strana književnost u bosansko-hercegovačkim časopisima krajem XIX i početkom XX stoljeća« (*Radovi Filozofskog fakulteta u Sarajevu*, III, 1965.)

»Orientations nationales et cosmopolites des revues littéraires en Bosnie-Herzégovine á la fin du XIX^e siècle et au début du XX^e: 1885-1914« (*Actes du IV^e congrés de l'association Internationale de Littérature Comparée*, The Hague, Mouton et C^{ie}, 1966.)

»Intelektualne veze J. J. Štrosmajera i francuskog slaviste Luja Ležea.« (*Radovi Filozofskog fakulteta u Sarajevu*, IV, 1968.)

»Književna vokacija i stvaralački nemir Andrea Žida.« (*Radovi Filozofskog fakulteta u Sarajevu*, V, 1969.)

»Život, lik i djelo Salke Nazečića.« (*Izraz*, 1970.)

»Otvaranje francuskog konzulata 1853. godine i boravak prvog konzula Eduarda Vjeta u Sarajevo.« (*Radovi Filozofskog fakulteta u Sarajevu*, VI, 1970-1971.)

»Intelektualno formiranje i književna orijentacija Vladimira Gaćinovića.« (*Zbornik posvećen uspomeni Salke Nazečića*. Sarajevo, Filozofski fakultet, 1972.)

»Andre Žid i Rože Marten di Gar: književno prijateljstvo.« (*Radovi Odjeljenja za književnost i umjetnost ANUBiH*, Sarajevo, 1973.)

»Fra Grgo Martić prevodilac Rasinove *Ifigenije*«. (*Radovi Filozofskog fakulteta u Sarajevu*, knj. VII, 1972/73.)

»Francuska književnost renesanse (1494-1598)«, u: *Francuska književnost 1*. Sarajevo, Svjetlost-Beograd, Nolit, 1976.

»Francuska književnost na stranicama književnog časopisa *Bosanska vila*«. *Radovi ANUBiH*, 1975.

»Doktorat Ive Andrića«, *Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklore*, Beograd, XLI, 3-4, 1975.

»Ivo Andrić kao naučnik: njegov doktorat i doktorska disertacija«. *Književnost Bosne i Hercegovine u svjetlu dosadašnjih istraživanja*, Sarajevo, ANUBiH, 1977.

Mid'had Shamiq
SI SHKRUHET VEPRA SHKENÇORE

Boton: Logos-A
Biblioteka: Lexo

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Dr. Ali Pajaziti

Redaktor gjuhësor: Fatmire Ajdini-Hoxha
Redaktor artistik: Edi Agagiysihi
Redaktor teknik: Naser Fera
Faqosës: Afrim Gashi

Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogjufi
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus - Shkup

Çopyright©Logos-A, 2005

Shënimi i ČIP katalogut i këtij libri gjendet
në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare
ISBN: 9989-58-051-0

www.logos-a.com.mk





ISBN 998958051-0



9 789989 580512